



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 186

Tiranë – E premte, 3 dhjetor 2021

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 84/2021, datë 25.11.2021	Për një shtesë në vendimin nr. 79/2021, “Për ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit, Për kontrollin e veprimtarisë së organeve të administratës publike dhe pushtetit vendor, për të verifikuar përdorimin e burimeve të administratës shtetërore, për qëllime elektorale, në zgjedhjet e 25 prillit 2021”.....	16713
Vendim i Kuvendit nr. 85/2021, datë 25.11.2021	Për një shtesë në vendimin nr. 70/2021, “Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit”.....	16713
Dekret i Presidentit nr. 13341, datë 23.11.2021	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare.....	16713
Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 701, datë 18.11.2021	Për miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve, 2021–2025.....	16714
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 33, datë 1.11.2021	Me objekt konstatimin e shkeljes së aksesit në një gjykatë të caktuar me ligj. Konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave në gjykimin e çështjes civile nr. 11243-02837-00-2017 akti, datë regjistrimi 14.9.2017, dhe i çështjes nr. 6 regjistri, datë 30.12.2020, në Gjykatën e Lartë të Republikës së Shqipërisë. Konstatimin e mungesës së një mjeti efektiv për konstatimin, dëmshpërblimin dhe përshpejtimin e procedurave të sipërpërmendura.....	16817
Vendim i Gjykatës së Lartë nr. 23-2021-712, datë 27.7.2021	Me objekt parashtrimin e mosmarrëveshjes së kompetencës drejtuar Gjykatës së Lartë. Gjykimin e të akuzuarit për veprën penale “Shpifja”, parashikuar nga neni 120/2 të Kodit Penal.....	16828

Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 233, datë 19.11.2021	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, për vitin 2022.....	16845
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 234, datë 19.11.2021	Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë OST sh.a., për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike, për vitin 2022 dhe periudhën 2022–2024.....	16847

**VENDIM**
Nr. 84/2021

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 79/2021, “PËR NGRITJEN E KOMISIONIT HETIMOR TË KUVENDIT, ‘PËR KONTROLLIN E VEPRIMTARISË SË ORGANEVE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE PUSHTETIT VENDOR, PËR TË VERIFIKUAR PËRDORIMIN E BURIMEVE TË ADMINISTRATËS SHTETËRORE, PËR QËLLIME ELEKTORALE, NË ZGJEDHJET E 25 PRILLIT 2021”

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, si dhe të neneve 21/1, pika 1, dhe 55, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në pikën V, të vendimit nr. 79/2021, “Për ngritjen e komisionit hetimor të Kuvendit ‘Për kontrollin e veprimtarisë së organeve të administratës publike dhe pushtetit vendor, për të verifikuar përdorimin e burimeve të administratës shtetërore, për qëllime elektorale, në zgjedhjet e 25 prillit 2021””, bëhet kjo shtesë:

I. Deputetët Enslemvera Zake (PS) dhe Denis Deliu (PS) caktohen anëtarë zëvendësues.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 25.11.2021.

VENDIM
Nr. 85/2021

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 70/2021, “PËR CAKTIMIN E ANËTARËVE ZËVENDËSUES NË PËRBËRJEN E KOMISIONEVE TË PËRHERSHME TË KUVENDIT”

Në mbështetje të nenit 78, pika 1, të Kushtetutës, si dhe të neneve 21/1, pika 1, dhe 55, të Rregullores së Kuvendit, me propozimin e kryetarit të Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në pikën V, të vendimit nr. 70/2021, “Për caktimin e anëtarëve zëvendësues në përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit”, bëhet kjo shtesë:

I. Deputetja Desantila Tahiraj caktohet anëtare zëvendësuese në Komisionin për Sigurinë Kombëtare.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Lindita Nikolla

Miraturar në datën 25.11.2021.

DEKRET
Nr. 13341, datë 23.11.2021

PËR LEJIMIN E LËNIES SË SHTETËSISË SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c” dhe të nenit 93, të Kushtetutës, si dhe të neneve 13, 14, 20, 23 dhe në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozimin e Ministrisë së Brendshme

DEKRETOJ:

Neni 1

U lejohe lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:



1. Edmond Ruzhdi Alla
2. Suzana Resul Alla
3. Justin Edmond Alla
4. Ray Edmond Alla
5. Sara Abdulla Krantja
6. Ami Pullump Begaj
7. Juna Fatos Toska
8. Manushaqe Xhelal Christidis (Luca)
9. Melina Christos Christidi
10. Natalia Christos Christidi
11. Alien Nazmi Spaho
12. Shejdi Tefik Dobruna (Lama)
13. Zef Tom Gjoka
14. Mirela Qazim Lifa
15. Intila Gafur Muka
16. Arba Shaqir Ocka (Avdiu)
17. Laura Kujtim Demiraj
18. Bujar Osman Halili
19. Adelajda Ismet Allushi
20. Elton Mit'hat Qevani
21. Megi Agim Kamberi (Halili)
22. Jetmir Xhevat Murati
23. Silvana Rifat Schmidt (Qosja)
24. Alesja Edmond Biba
25. Lirim Shpend Bajrami
26. Arnold Spiro Muhaj
27. Joana Zihni Çeto (Ceto)
28. Eni Kujtim Demiraj
29. Edlira Luftetar Abdessalem (Roçi)
30. Elona Perparim Halili (Nuredinaj)
31. Elidona Shefqet Zeqiraj
32. Egi Artan Dervishaj
33. Edison Riza Prifti
34. Marjan Bozho Ajković
35. Zvezdanka Jagosh Ajković (Kerstoja)
36. Artur Nazmi Greca
37. Anila Nikoll Maçi (Ndreu)
38. Maria Armand Maçi
39. Nicole Armand Maçi
40. Armand Pal Maçi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

VENDIMI

Nr. 701, datë 18.11.2021

PËR MIRATIMIN E PLANIT KOMBËTAR TË VEPRIMIT PËR BARAZI, PËRFSHIRJE DHE PJESËMARRJEN E ROMËVE DHE EGJIPTIANËVE, 2021–2025

Në mbështetje të neneve 18, 20 e 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, dhe të ligjit nr. 10/221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve, 2021–2025, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen të gjitha ministritë dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

PLANI KOMBËTAR I VEPRIMIT PËR BARAZI, PËRFSHIRJE DHE PJESËMARRJEN E ROMËVE DHE EGJIPTIANËVE (2021–2025) (NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË) Tetor, 2021

PËRMBAJTJA

SHKURTIMET

PJESA I – KONTEKSTI STRATEGJIK

Hyrja dhe qëllimi i dokumentit

Kuadri ligjor dhe institucional

Parimet themelore

Kushtet aktuale, problematikat dhe sfidat

Vizioni dhe misioni i dokumentit

PJESA II – QËLLIMET E POLITIKËS DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË



Qëllimet e politikës të PKVBPPRE-së 2021–2025

PJESA III – ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, LLOGARIDHËNIA, RAPORTIMI DHE MONITORIMI

Përgjegjësia e institucioneve

Kuadri vlerësues dhe monitorues

PJESA IV – ANALIZA BUXHETORE

ANEKS 1 – MATRICA E PLANIT KOMBËTAR

TË VEPRIMIT PËR BARAZI, PËRFSHIRJE DHE PJESËMARRJEN E ROMËVE DHE TË EGJIPTIANËVE, 2021–2025

SHKURTIMET

AFP	Aftësim dhe formim profesional
AKPA	Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim
AMA	Autoriteti i Mediave Audiovizive
AMSHDF	Agjencia Shtetërore e Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve
ARSIS	Nisma për ndryshim shoqëror
ASCAP	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar
ASHDMF	Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
AZHBR	Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural
BE	Bashkimi Evropian
BK	Biblioteka Kombëtare
DAP	<i>Departamenti i Administratës Publike</i>
DRAP	Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar
DRKK	<i>Drejtori Rajonale e Kulturës Kombëtare</i>
DROSHKSH	Drejtoria Rajonale e Operatorit të Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor
DPAP	Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar
DPPS	Dokumenti i politikave për përfshirjen sociale
DPT	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
ECRI	Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës
FSDKSH	Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor
GMIP	Grupi i Menaxhimit të Integruar të Politikave
IAL	Institucionet e arsimit të lartë
INSTAT	Instituti Shqiptar i Statistikave
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
KPK	Komiteti për Pakicat Kombëtare
KMD	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
MAS	<i>Ministria e Arsimit dhe Sportit</i>
MB	<i>Ministria e Brendshme</i>
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
MFE	<i>Ministria e Financave dhe Ekonomisë</i>
MIE	<i>Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë</i>
MK	<i>Ministria e Kulturës</i>
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MSHMS	<i>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale</i>
NJMF	<i>Njësia për Mbrojtjen e Fëmijëve</i>
NJMVP	Njësia për Monitorimin dhe Vlerësimin e Politikave
NJVKSH	Njësitë vendore të kujdesit shëndetësor
NJVV	<i>Njësia e vetëqeverisjes vendore</i>
NJVRN	<i>Njësia e vlerësimit dhe e referimit të nevojave</i>
OSHC	Organizata të shoqërisë civile
OSHKSH	Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor



PATP	Programet Aktive të Tregut të Punës
PNP	Programet e Nxitjes së Punësimit
PKVBPPRE	Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe të Egjiptianëve
<i>QKTE</i>	<i>Qendra Kombëtare Tranzitore e Emergjencave</i>
QKLL	Qendra Kombëtare e Leximit dhe e Librit
QKEV	Qendra Kombëtare e Edukimit në Vazhdim
RCC	Këshilli i Kooperimit Rajonal
RKGjC	Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile
RTSH	Radiotelevizioni Shqiptar
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SPSBGJ	Sektori i Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore
SHSSH	<i>Shërbimi Social Shtetëror</i>
TLAS	Shërbimi Ligjor Falas, Tiranë
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
VKM	<i>Vendim i Këshillit të Ministrave</i>
ZVAP	Zyrat vendore të arsimit parauniversitar

PJESA I

KONTEKSTI STRATEGJIK

1. Hyrja dhe qëllimi i dokumentit

Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe të Egjiptianëve, 2021–2025 (këtu e në vijim “PKVBPPRE 2021–2025”) u përgatit në emër të qeverisë së Shqipërisë nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në koordinim dhe në konsultim me ministrinë e tjera përgjegjëse, njësitë e vetëqeverisjes vendore, institucionet e pavarura, organizatat e shoqërisë civile, si dhe organizatat ndërkombëtare, të cilat punojnë për çështjet e integritit të romëve dhe të egjiptianëve në Shqipëri.

Ky plan është një angazhim i ri me kohështrirje 2021–2025, i cili targeton pakicat rome dhe egjiptiane. Plani prezanton një përshkallëzim të masave tashmë të zbatuara dhe në zbatim, dhe do të parashikojë, gjithashtu, nisjen e aktiviteteve të reja për nxitjen e integritit të romëve dhe të egjiptianëve me fondet e parashikuara nga buxheti i shtetit, por duke identifikuar edhe hendekun financiar për periudhën 2021–2025. PKVBPPRE 2021–2025 është hartuar në konsultim të ngushtë me ministrinë përgjegjëse të linjës, përfaqësues nga komuniteti rom dhe egjiptian, njësitë e vetëqeverisjes vendore, organizata të shoqërisë civile, si dhe aktorë të tjerë.

Në deklaratën e Partnerëve të Ballkanit Perëndimor mbi Integrimin e Romëve në Procesin e Zgjerimit të BE-së, Shqipëria bëri një angazhim për të vazhduar dhe rritur përpjekjet për barazi të plotë dhe integrimin e romëve, veçanërisht përmes zbatimit dhe ndjekjes së Konkluzioneve të Përbashkëta të Seminareve Rome, në sektorët

e punësimit, strehimit, arsimit, shëndetit, regjistrimit civil, mbrojtje sociale dhe mosdiskriminim. Shqipëria u angazhua për të zhvilluar, miratuar dhe zbatuar standarde rajonale mbi buxhetimin publik, në lidhje me integrimin e romëve për politikat e synuara, si dhe rritjen e buxhetit publik (qendror dhe lokal) për integrimin e këtij komuniteti; të krijojë kanale dhe mekanizma zyrtarë për përfshirjen e përbashkët të vetëqeverisjes vendore dhe komunitetit rom në formulimin e politikave, vendimmarrjes, zbatimit dhe monitorimit të përpjekjeve të ndërmarra për arritjen e objektivave të kësaj deklarate.

Plani përputhet plotësisht me kornizën e re strategjike rome të BE-së për barazi, përfshirje dhe pjesëmarrje 2020–2030.

Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe të Egjiptianëve (2016–2020) demonstroi njohje nga administrata qendrore, në lidhje me rëndësinë e hartimit të masave dhe të aktiviteteve të reja për promovimin e integritit të romëve dhe të egjiptianëve me fokus të veçantë në uljen e barrierave me të cilat përballen romët dhe egjiptianët, si hyrja në shërbime, përmirësimi i kushteve të jetesës përmes integritit dhe promovimi i dialogut ndërkulturor.

Masat e PKVIRE (2016–2020) u hartuan në gjashtë fusha prioritare: regjistrimi civil, arsimi dhe dialogu ndërkulturor, punësimi dhe zhvillimi i aftësive, kujdesi shëndetësor, strehimi dhe integrimi urban dhe mbrojtja sociale. Mbrojtja e të drejtave të njeriut, përfshirë romët dhe politikat antidiskriminim është një nga pesë përparësitë kryesore të agjendës së integritit në BE për Shqipërinë.

Edhe me përpjekjet e qeverisë shqiptare dhe organizatave të tjera, të dhënat nga 5 vitet e



mëparshme tregojnë se ekzistojnë ende probleme të regjistrimit civil, arsimit, punësimit, kujdesit shëndetësor, strehimit dhe mbrojtjes sociale. Këto probleme janë edhe më të mëdha kur shtohet stigma sociale aktuale, stereotipat dhe diskriminimi, që për fat të keq janë akoma të pranishme ndaj romëve dhe egjiptianëve.

Romët dhe egjiptianët përballen me pengesa të drejtpërdrejta dhe të tërthorta në aksesin e shërbimeve publike, të cilat lindin nga kriteret e pranueshmërisë që ata nuk mund t'i plotësojnë, nga mungesa e informacionit ose nga moskuptimi i procedurave administrative, si dhe nga stigmatizimi dhe diskriminimi i vazhdueshëm nga pjesa tjetër e popullatës. Përjashtimi afatgjatë ka ndikuar në kushtet e jetesës së romëve dhe egjiptianëve, në trajtimin diskriminues në disa raste nga pjesa tjetër e popullatës dhe në marrëdhënien me institucionet shtetërore. 730 romë dhe egjiptianë janë identifikuar gjatë vitit 2019, vendbanimi i të cilëve, sipas regjistrimit civil, nuk përputhej me atë real. Sipas të dhënave të sondazhit rajonal për komunitetin rom, 84% e komuniteti rom kanë akses në elektricitet dhe 50% e tyre kanë akses në ujë dhe pijshëm në banesat e tyre krahasuar me shifrën 89% që i takon pjesës jorome. Nga të dhëna të vitit 2017, ekziston një hendek midis romëve të marginalizuar dhe fqinjëve joromë, për sa u përket aftësive njerëzore dhe mirëqenies materiale¹. Hendeku është veçanërisht i madh për të rinjtë - vetëm 22 për qind e romëve të marginalizuar të moshës 18–24 vjeç janë në punësim, arsim ose trajnim krahasuar me 58 për qind të fqinjëve joromë². Bazuar në raportin vjetor të Komisionerit kundër Diskriminimit, ka pasur 43 raste për periudhën 2017–2018 të diskriminimit për shkak të racës³. Komuniteti rom dhe egjiptian nuk është i

informuar mirë për të drejtat, shërbimet ose rrugët ligjore për të ofruar këto shërbime. Një shoqëri që respekton dhe mbron të drejtat e njeriut, garanton parimin e barazisë dhe promovon shanse dhe mundësi të barabarta si një mjet efikas për një demokraci të konsoliduar dhe shtet ligjor.

PKVBPPRE 2021–2025 do të sigurojë vazhdimësinë e një qasjeje për dhënien e kujdesit përtej projekteve afatshkurtra të organizatave ndërkombëtare dhe/ose atyre lokale. PKVBPPRE 2021–2025 është hartuar në mënyrë të tillë që të sigurojë integrimin me aspektet e planifikimit, aspektet operacionale dhe aspektet e kontrollit/monitorimit. Për të rikuperuar hendekun midis planifikimit dhe kontrollit, PKVBPPRE 2021–2025 parashikon operacione efektive dhe efikase.

Financimi për zbatimin e masave të parashikuara në PKVBPPRE 2021–2025 është parashikuar në buxhetin e shtetit, pas një vlerësimi të fondeve të disponueshme në ministrinë përkatëse të linjës. Në rastet kur buxheti i shtetit nuk është i mjaftueshëm për përmbushjen e plotë të objektivave, PKVBPPRE 2021–2025 parashikon një ndarje të hendekut të financimit, si dhe propozimin për fonde donatorësh. Gjithashtu, fondet dhe lloje të tjera burimesh të ofruara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe shoqëria civile janë thelbësore për nxitjen e përfshirjes në nivel vendor, por ato nuk pasqyrohen në këtë Plan Kombëtar Veprimi, i cili fokusohet në angazhimet, aktivitetet dhe buxhetet e qeverisjes qendrore.

Zbatimi i PKVBPPRE 2021–2025 do të monitorohet nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, dhe me përfshirjen direkte të pikave fokale në ministrinë e linjës, si dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore. Zbatimi i suksesshëm i këtij Plani, do të varet edhe nga bashkëpunimi i ngushtë ndërmjet aktorëve të ndryshëm, kryesisht i institucioneve të qeverisjes qendrore dhe vendore dhe organizatave të shoqërisë civile.

2. Kuadri ligjor dhe institucional

Shqipëria i përmbush instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe e ka zhvilluar kuadrin e saj ligjor, në përputhje me standardet evropiane. Brenda këtij konteksti, Shqipëria ka zhvilluar një kuadër ligjor dhe nënligjor të përparuar, që adreson çështjet e pakicave rome dhe egjiptiane bazuar në standardet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare.

¹ Regional Roma Survey 2017

<https://www.eurasia.undp.org/content/rbec/en/home/library.html>; Banka Botërore <https://www.worldbank.org/en/news/press-release/2018/05/17/marginalized-roma-community-still-most-excluded-in-albania>

² Balkan Investigative Reporting Network (prill, 2020), *Roma: Europe's Neglected Coronavirus Victims*. Përgatitur nga Stephan Müller, Fikrija Tair, Bashkim Ibishi and Dragan Gracanin. <https://balkaninsight.com/2020/04/01/roma-europes-neglected-coronavirus-victims/>

³ Report on the Implementation of National Roma Integration Strategies, 2019 <https://op.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/4ff1ac7f-3749-11ea-ba6e-01aa75ed71a1/language-en>



2.1 Kuadri ligjor

Legjislacioni kombëtar ka shumë akte ligjore dhe nënligjore, që prekin të gjitha sferat e jetës së romëve dhe të egjiptianëve, duke përfshirë fusha të ndryshme të politikës, si të drejtat njerëzore, strehimi, arsimi shëndetësia, punësimi dhe aftësimi, mbrojtja sociale, aksesit në drejtësi, regjistrim civil, kultura etj.

- Të drejtat njerëzore dhe barazia

Ligji nr. 8137, datë 31.7.1996, “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore”.

Ligji nr. 8496, datë 3.6.1999, “Për ratifikimin e Konventës Kuadër të Këshillit të Evropës për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare”.

Ligji nr. 10221, datë 4.2.2010, “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, i ndryshuar.

Ligji nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

VKM-ja nr. 127, datë 11.3.2004, “Për krijimin e Komitetit Shtetëror të Minoriteteve”, i ndryshuar.

VKM-ja nr. 396, datë 22.8.1994, “Për arsimimin në gjuhën amtare të personave të pakicave”, i ndryshuar.

- Aksesit në drejtësi dhe regjistrim civil

Ligji nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”.

Ligji nr. 69/2018, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, e vendbanimit/adresës së shtetasve.

VKM-ja nr. 55, datë 6.2.2019, “Për përcaktimin e procedurave dhe dokumentacionit për autorizimin e organizatave jofitimprurëse, që ofrojnë ndihmë juridike parësore të garantuar nga shteti”.

Urdhër i Kryeministrit nr. 59, datë 25.3.2019, “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së drejtorisë së ndihmës juridike falas”.

VKM-ja nr. 1243, datë 11.12.2009, “Për përcaktimin e dokumenteve, që duhet të paraqesin shtetasit, e të procedurave që duhet të kryejnë zyrtarët e gjendjes civile, në bashki/njësi bashkiake/komuna, dhe institucionet shtetërore, të posaçme, për ndryshimin e vendbanimit/adresës së shtetasve”.

Udhëzimi nr. 284, datë 11.3.2019, “Për procedurën e mbajtjes së aktit të lindjes së fëmijëve, në rastet kur nuk është respektuar afati kohor i

regjistrimit të tyre, brenda 60 ditëve nga data e lindjes”.

Udhëzimi nr. 285, datë 11.3.2019, “Për krijimin, administrimin dhe përditësimin e regjistrit të përkohshëm për lindjet e raportuara”.

Udhëzimi nr. 509, datë 27.8.2019, “Për procedurën e korrigjimit të emrit, mbiemrit, emrit të babait, emrit të nënës, si gabim material”.

Udhëzimi nr. 286, datë 11.3.2019, “Për përcaktimin e procedurës administrative që zbatohet nga zyrtarët e gjendjes civile, kur në aktin e lindjes, mbajtur jashtë Republikës së Shqipërisë, është e paplotësuar rubrika e emrit”.

Udhëzimi nr. 509, datë 27.8.2019, “Për procedurën e korrigjimit të emrit, mbiemrit, emrit të babait, emrit të nënës, si gabim material”.

VKM-ja nr. 740, datë 12.12.2018, si dhe me udhëzimin e përbashkët të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Brendshëm nr. 870, datë 24.12.2018, “Për përcaktimin e veprimeve dhe procedurës që kryejnë nëpunësit e zyrave të gjendjes civile dhe personi i autorizuar pranë institucionit të shërbimit spitalor për përfitimin e masës së ndihmës së menjëhershme financiare për nënat me foshnja të sapolindura”.

- Strehimi

Ligji nr. 22/2018, “Për strehimin social”.

Ligji nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”.

VKM-ja nr. 384, datë 12.6.2019, “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim, sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”.

VKM-ja nr. 361, datë 29.5.2019, “Për përcaktimin e procedurave të zhvendosjes së individëve ose familjeve nga vendbanimi a strehimi i tyre”.

VKM-ja nr. 362, datë 29.5.2019, “Për kriteret e dhënies së subvencionit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë”.

VKM-ja nr. 384, datë 12.6.2019, “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim, sipas çdo programi social të strehimit”.

VKM-ja nr. 453, datë 3.7.2019, “Për masën e subvencionit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët”.



VKM-ja nr. 458, datë 3.7.2019, “Për procedurën e kthimit në fond banese, me qëllim strehimi, të objekteve pronë shtetërore”.

VKM-ja nr. 496, datë 24.6.2020, “Për organizimin, funksionimin, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Strehimit”.

Udhëzim-2020-06-05-22, “Për mënyrën e ndërveprimit të programeve sociale të strehimit me shërbimet sociale të punësimit, arsimit dhe kujdesit shëndetësor”.

Udhëzim-2020-08-26-33, “Për kushtet e tjera që duhet të plotësojnë strehët e përkohshme”.

VKM-ja nr. 454, datë 3.7.2019, “Për kriteret dhe procedurat e përfitimit e të dhënies së granteve konkurruese për përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave ekzistuese”.

VKM-ja nr. 522, datë 25.7.2019, “Për metodikën e llogaritjes së masës së qirasë për banesat sociale me qira”.

Udhëzimi nr. 31, datë 18.11.2019, “Për procedurat standarde të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit”.

VKM-ja nr. 459, datë 3.7.2019, “Për rregullat për administrimin e kërkesave të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njëjësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”.

VKM-ja nr. 823, datë 18.12.2019, “Për procedurën e blerjes së banesave në tregun e lirë, që i shtohen fondit publik të banesave sociale me qira”.

VKM-ja nr. 179, datë 26.2.2020, “Për rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave, që kanë qenë subjekt i ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992, “Për privatizimin e banesave shtetërore”, dhe të ligjit nr. 9321, datë 25.11.2004, “Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyer në banesa, të ndërtuara me fondet e shoqërive dhe të ndërmarrjeve shtetërore”.

VKM-ja nr. 300, datë 15.4.2020, “Për përcaktimin e procedurës së shkëmbimit të banesës me kosto të ulët”.

VKM-ja nr. 301, datë 15.4.2020, “Për normat e strehimit, si dhe kushtet e standardet për banesat

sociale me qira, që blihen në treg dhe banesat me kosto të ulët”.

VKM-ja nr. 555, datë 15.7.2020, “Për procedurat, kriteret dhe përparësitë për akordimin e grantit të menjëhershëm për banesat me kosto të ulët nga buxheti i shtetit”.

VKM-ja nr. 579, datë 22.7.2020, “Për përcaktimin e institucioneve publike që administrojnë strehët, i kriterëve, procedurave dhe kapaciteteve të mjaftueshme për të menaxhuar çështjet sociale, financiare e teknike, si dhe procedurat e administrimit dhe mirëmbajtjes së strehëve të përkohshme, kompetencat e subjekteve përgjegjëse dhe bashkëpunimi ndërmjet tyre”.

VKM-ja nr. 580, datë 22.7.2020, “Për procedurat e blerjes nga tregu, të vlerësimit të shitjes, si dhe kriteret e përcaktimit të çmimit të shitjes së truallit familjeve që përfitojnë banesa me kosto të ulët, në varësi të nivelit të të ardhurave të tyre”.

Udhëzim i ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 40, datë 23.10.2020, “Për mënyrën e administrimit dhe të mirëmbajtjes së banesave të specializuara”.

VKM-ja nr. 898, datë 18.11.2020, “Për rregullat, kushtet, kriteret e procedurat e privatizimit të banesave dhe të objekteve të kthyer në fond banese të paprivatizuara”.

VKM-ja nr. 142, datë 10.3.2021, “Për përcaktimin e kriterëve për përfituesit nga programi për zhvillimin e zonës, me qëllim strehimin, mënyrën e sigurimit të strehimit të tyre gjatë periudhës së ndërtimit, formën e kalimit të pronësisë për kuota të përcaktuara për banesa sociale nga ndërtuesit ose pronarët, për strehimin e përfituesve që janë zhvendosur prej tyre”.

VKM-ja nr. 441, datë 22.7.2021, “Për procedurat e përzgjedhjes, mënyrat e kontraktimit, format dhe kushtet e përgjithshme të kontratës për ndërtimin e banesave në zonat e zhvilluara me qëllim strehimin”.

- Kujdesi shëndetësor

Ligji nr. 10/107, datë 30.3.2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”.

Ligji nr. 10/383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

**- Arsimi dhe nxitja e dialogut ndërkulturor**

Ligji nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Urdhri i përbashkët MAS, MB, MSHMS nr. 292, datë 28.5. 2019, “Për miratimin e rregullores për zbatimin e marrëveshjes së bashkëpunimit ndërmjet tri ministrive, “Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës të detyrimit shkolle”.

Vendimi nr. 682, datë 29.7.2015, “Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë, që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit”, i ndryshuar.

VKM-ja nr. 597, datë 4.9.2019, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”.

VKM-ja nr. 666, datë 10.10.2019, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, i ndryshuar.

VKM-ja nr. 903, datë 21.12.2016, “Për përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave nga fondi i mbështetjes studentore për studentët e shkëlqyer, studentët që studiojnë në programe studimi në fushat prioritare dhe studentët në nevojë”, i ndryshuar.

VKM-ja nr. 269, datë 29.3.2017, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, i ndryshuar.

Udhëzimi nr. 17, datë 9.5.2018, “Për procedurat e ndjekjes së arsimit të detyruar nga nxënësit që nuk kanë ndjekur të paktën dy klasa të arsimit bazë dhe për arsimin në kohë të pjesshme në arsimin bazë”.

Urdhri nr. 21, datë 18 gusht 2016, i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, “Për organizimin dhe funksionimin e shkollës së mesme me kohë të pjesshme”, i ndryshuar.

Udhëzimi i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 21, datë 13.8.2020, “Për përcaktimin e procedurave

për administrimin e teksteve shkollore në përdorimin falas në arsimin parauniversitar”.

- Punësimi dhe aftësimi

Ligji nr. 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”.

Ligji nr. 15/2017, datë 16.2.2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”.

VKM-ja nr. 882, datë 24.12.2019, “Për mekanizmin e bashkërendimit ndërinstitucional të punës për referimin për punësim të individëve dhe anëtarëve në moshë aktive pune të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike”.

VKM-ja nr. 17, datë 15.1.2020, “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale”.

VKM-ja nr. 348, datë 29.4.2020, “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes nëpërmjet vetëpunësimit”.

VKM-ja nr. 535, datë 8.7.2020, “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të punëve publike në komunitet”.

VKM-ja nr. 608, datë 29.7.2020, “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes nëpërmjet punësimit të personave të dalë të papunë si pasojë e COVID-19”.

- Mbrojtja sociale

Ligji nr. 121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”.

Ligji nr. 57/2019, “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”.

Ligji nr. 104/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Ligji nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”.

Ligji nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, ndryshuar me ligjin nr. 7/2018, datë 15.2.2018 (i përditësuar, 2018).

Udhëzimi nr. 21, datë 8.8.2014, “Për rritjen e frekuentimit të arsimit parashkolle nga fëmijët romë”.

Marrëveshja 3-ministore (MAS, MSHMS, MPB) e bashkëpunimit, “Për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve në situatë rruge” nr. 4496, datë 12.6.2015.

VKM-ja nr. 449, datë 29.08.2018, “Për miratimin e procedurave standarde të veprimtimit për



mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”.

VKM-ja nr. 882, datë 24.12.2019, “Për mekanizmin e bashkërendimit ndërinstytucional të punës për referimin për punësim të individëve dhe anëtarëve në moshë aktive punë të familjeve përfutuese të ndihmës ekonomike”.

Udhëzimi nr. 911, datë 27.12.2018, “Për miratimin e standardeve të ofrimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror në qendrat komunitare shumëdisiplinare”.

Udhëzimi nr. 15, datë 15.1.2019, “Për një ndryshim dhe shtesa në udhëzimin nr. 8, datë 25.2.2015, “Për planifikimin e fondeve për ndihmën ekonomike”.

Urdhri nr. 31, datë 28.1.2020, “Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë”.

2.2 Kuadri strategjik

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015–2020.

Dokumenti Politik për Përfshirjen Sociale 2016–2020.

Strategjia Kombëtare për Migracionin dhe Plani i Veprimit 2019–2022.

Strategjia e Strehimit Social 2016–2025.

Plani Kombëtar i Veprimit për Luftën kundër Trafikimit të Personave 2018–2020.

Strategjia e Kujdesit Parësor 2020–2025.

Plani i Veprimit për Promovimin e Shëndetit 2017–20212.

Strategjia Kombëtare Shëndetësore 2016–2020.

Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Plani i Veprimit 2016–2020.

Strategjia për Zhvillimin e Arsimit Parauniversitar 2016–2020.

Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019–2025.

Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019–2022.

Strategjia Kombëtare dhe Plani i Veprimit për Mbrojtjen Sociale 2020–2023.

Lidhja me SKZHI-në: PKVBPPRE 2021–2025, si një dokument strategjik që parashikon politikat për romët dhe për egjiptianët në Republikën e Shqipërisë është tërësisht në harmoni dhe në përputhje me objektivat strategjike të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2015–2020 aktuale, që është dokumenti kryesor strategjik kombëtar që mbështet zhvillimin

e qëndrueshëm social dhe ekonomik të vendit dhe siguron përmbushjen e standardeve dhe progresin në procesin e integritit evropian.

Shtylla 3. Investimi në kapitalin njerëzor dhe kohezionin social.

Qëllimi i politikës. Forcimi i të drejtave të njeriut.

Objektivat strategjikë. Rritja e integritetit dhe e sigurimit të të drejtave të njeriut përmes:

- Sigurimit të një kuadri ligjor për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, në përputhje me legjislacionin e BE-së dhe detyrimet ndërkombëtare; veçanërisht nëpërmjet: i. përmirësimit të legjislacioni për krijimin e mekanizmave të monitorimit dhe të ndjekjes, në lidhje me zbatimin e të gjitha konventave të drejtave të njeriut të ratifikuara nga Shqipëria; ii. përmirësimi i kuadrit ligjor për mbrojtjen e pakicave dhe krijimin e mundësive për arsimimin e tyre, në përputhje me angazhimet ndërkombëtare;

- Rritja e ndërgjegjësimit për mbrojtjen nga diskriminimi dhe garantimi i mbrojtjes nga diskriminimi, sidomos për grupet e cënueshme, të tilla si: komunitetet romë dhe egjiptiane, gratë, personat e paafte, fëmijët, pakicat dhe grupet e tjera të cënueshme nëpërmjet: i. forcimit të kapaciteteve të grupeve të cënueshme dhe organizatave të shoqërisë civile, për të kërkuar të drejtat e tyre; ii. rritjes së numrit të ankesave dhe të hetimeve administrative të nisura për shkak të detyrës nga Komisionari për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe rritjes së numrit të opinioneve me shkrim të paraqitura në gjykatë;

- Sigurimi i përfshirjes sociale të të gjitha kategorive shoqërisht të përjashtuara, për shkak të varfërisë, statusit social, mungesës së qasjes në shërbime publike, mungesës së vëmendjes së institucioneve publike etj.

Lidhja me SDG (Objektivat e zhvillimit të Qëndrueshëm):

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm janë një thirrje për veprim nga të gjitha vendet – të varfra, të pasura dhe me të ardhura të mesme – për të promovuar prosperitetin, duke mbrojtur planetin. PKVBPPRE 2021–2025 është tërësisht në harmoni dhe në përputhje me objektivat 1, 3, 5, 10 dhe 16 të SDG-së, si më poshtë:

Objekivi 1: Fund varfërisë në të gjitha format e saj dhe kudo.



Objektivi 3: Sigurimi i një jete të shëndetshme dhe promovimi i mirëqenies për të gjithë dhe në të gjitha moshat.

Objektivi 5: Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave.

Objektivi 10: Ulja e pabarazisë brenda dhe ndërmjet vendeve.

Objektivi 16: Promovimi një shoqërie me të drejta, paqësore dhe gjithëpërfshirëse.

3. Parimet themelore

Plani Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe të Egjiptianëve 2021–2025 do të udhëhiqet nga disa parime bazë:

1. Hartimi i politikave konstruktive, pragmatike dhe jodiskriminues – Objektivat e përfshirë në Planin e Veprimit synojnë përfshirjen e romëve dhe të egjiptianëve dhe realizojnë vlerat thelbësore të Bashkimit Evropian, të cilat përfshijnë të drejtat dhe dinjitetin e njeriut, mosdiskriminimin dhe barazinë e mundësive, si dhe zhvillimin ekonomik.

2. Përdorimi i një qasjeje të targetuar/synuar për trajtimin e çështjeve specifike të përjashtimit – Plani i Veprimit propozon masa të targetuara për përgjigjen ndaj situatave të emergjencës që nuk mund të trajtohen përmes burimeve të përgjithshme.

3. Nxitja e përfshirjes sociale – Aktivitetet e Planit të Veprimit synojnë të nxisin përfshirjen e romëve dhe të egjiptianëve në shoqëri e jo të krijojnë sisteme paralele për t'u përdorur nga këto komunitete.

4. Respektimi i dallimeve – Plani i Veprimit do të respektojë dallimet mes komunitetit rom dhe atij egjiptian, si dhe brenda vetë këtyre komuniteteve. Plani i Veprimit do të trajtojë anëtarët vulnerabel të këtyre komuniteteve, duke njohur faktin që disa romë dhe egjiptianë janë tashmë të integruar në shoqëri.

5. Vënia e theksit mbi angazhimin e romëve dhe të egjiptianëve – Plani i Veprimit përfshin mekanizmat për angazhimin e romëve dhe të egjiptianëve në hartimin, në zbatimin dhe në monitorimin e politikave publike.

6. Nxitja e bashkëpunimit midis aktorëve të ndryshëm lokalë dhe qendrorë – Krijimi dhe zbatimi i Planit të Veprimit është bazuar në bashkëpunimin midis qeverisjes qendrore, rajonale dhe vendore, komunitetit ndërkombëtar dhe veçanërisht vetë komuniteteve.

7. Promovimi i lidhjeve ndërsektoriale – Plani i Veprimit trajton nevojat në një sërë fushash kyçe, duke përfshirë: arsimin dhe promovimin e dialogut ndërkulturor, shëndetësinë, strehimin dhe integrimi urban, punësimin dhe arsimin e aftësimin profesional, mbrojtjen sociale dhe regjistrimin civil dhe aksesin në sistemin e drejtësisë, me synim nxitjen e integritetit në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të qëndrueshme.

8. Politika bazuar në evidenca dhe matjen e progresit – Plani i Veprimit është pajisur me tregues për matjen e progresit të zbatimit dhe treguesit fillestarë (nga ku do të nisë puna) kur është e mundur. Zbatimi dhe monitorimi i aktiviteteve të përfshirjes së romëve do të krijojë një bazë të mirë të të dhënave socioekonomike të cilat do të mbledhen rregullisht.

9. Ndërgjegjësimi mbi dimensionin gjinor – Plani i Veprimit pranon faktin se gratë rome dhe egjiptiane kanë më tepër gjasë të vuajnë përjashtimin dhe diskriminimin gjinor. Sidoqoftë, gratë rome, gjithashtu, kanë një rol thelbësor për të luajtur në promovimin e përfshirjes (p.sh. si ndërmjetës për integrimin e fëmijëve në sistemin arsimor).

10. Përfshirja e shoqërisë civile – Bashkëpunimi me organizata jofitimprurëse (OJF), partnerë socialë, akademikë/studiues dhe vetë komunitetet rome është esenciale në këtë plan të ri. Këta aktorë kanë marrë pjesë në mënyrë aktive në hartimin e këtij plani dhe do të marrin pjesë në zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e tij. Organizatat dhe rrjetet rome kanë jo vetëm ekspertizë të vlefshme për të ofruar, por ato, gjithashtu, do të jenë aktorë të rëndësishëm për shpërndarjen e informacionit tek të tjerët.

11. Buxhetimi për zbatimin – Ministritë e linjës kanë identifikuar buxhetet përkatëse për zbatimin e çdo aktiviteti. Në rastet kur financimi publik është i pamjaftueshëm, ministritë kanë identifikuar hendeqet e financimit ku mund të kërkohej ndihmë nga donatorë.

4. Kushtet aktuale, problematikat dhe sfidat

Gjatë 10-të vjetëve të fundit, qeveria shqiptare ka intensifikuar përpjekjet e saj për të përmirësuar kushtet e jetesës së pakicave rome dhe egjiptiane, dhe integrimin në shoqërinë shqiptare. Përveç ratifikimit të konventave ndërkombëtare për mbrojtjen e të drejtave themelore të njeriut është zhvilluar, gjithashtu, kuadri ligjor në përputhje me



standardet evropiane, diktuar edhe nga marrja e statusit të vendit kandidat në BE⁴. Në këtë kuadër qeveria miratoi në dhjetor 2015, Planin Kombëtar të Veprimit për Integrimin e Romëve dhe të Egjiptianëve 2016–2020. Plani i Veprimit ishte një vazhdim i Strategjisë Kombëtare të mëparshme, “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së pakicës rome” dhe vazhdim i Planit të Veprimit të “Dekadës së përfshirjes së Romëve” (2005–2015).

Ndërkohë që gjatë vitit 2019, qeveria shqiptare mori një angazhim të ri për të arritur përfshirjen barazinë dhe integrimin e plotë të romëve dhe të egjiptianëve, duke firmosur Deklaratën e Poznanit. Megjithatë ka progres dhe situata e pakicave rome dhe egjiptiane është përmirësuar ndjeshëm gjatë dekadës së fundit, mbetet sfida e mëtejshme varfëria, diskriminimi, integrimi në tregun e punës, qasja në shërbimet shëndetësore dhe përmirësimi i kushteve të strehimit. Gjithashtu konstatohet dhe vazhdon të jetë problematik hendeku i krijuar midis romëve dhe egjiptianëve në raport⁵ me joromët në të gjitha fushat jetësore, dhe në përfitimin e shërbimeve apo të mirave publike. Pandemia COVID-19 ka ndikuar, gjithashtu, në përkeqësimin e situatës të familjeve rome dhe egjiptiane sidomos atyre me të ardhura të pamjaftueshme.

Niveli i arsimimit të popullsisë rome dhe në një masë më të vogël egjiptiane është shumë më i ulët se i banorëve të tjerë në vend. Në arsimin parashkollor hendeku midis romëve dhe joromëve arrin në 31%. Në mënyrë të ngjashme, në arsimin e detyrueshëm, hendeku midis romëve dhe joromëve arrin në 31% me 66% të fëmijëve romë të regjistruar⁶. Fëmijët romë dhe egjiptianë kanë përqindje relativisht të ulëta të regjistrimit në shkollë, analfabetizmit dhe përfundimit të shkollës

krahasuar me mesataren kombëtare, ndonëse së fundmi ka pasur një progres thuajse eksponencial. Gjatë vitit 2019, 14379 djem dhe vajza rome dhe egjiptiane u regjistruan dhe morën pjesë në arsimin parashkollor dhe arsimin e detyrueshëm⁷. Megjithatë, rritja e nivelit të regjistrimit dhe përfundimit të romëve në arsimin bazë në 90 për qind dhe shkalla e regjistrimit dhe përfundimit të romëve në arsimin e mesëm të lartë në 50 për qind, mbetet një sfida në Ballkanin Perëndimor⁸. Megjithatë, rritja e nivelit të regjistrimit dhe përfundimit të romëve në arsimin bazë në 90 për qind dhe shkalla e regjistrimit dhe përfundimit të romëve në arsimin e mesëm të lartë në 50 për qind, mbetet një sfida në Ballkanin Perëndimor.

Sipas të dhënave të raportit të ECRI⁹ 2020¹⁰, problematike mbetet situata e arsimit gjithëpërfshirës ku masat e marra kundër bullizmit dhe ekstremizmit në shkolla deri më tani kanë konsistuar vetëm në masa të përgjithshme të ndërgjegjësimit kundër bullizmit, të cilat nuk përmbajnë module që mbulojnë grupet veçanërisht të cënueshme, siç janë fëmijët romë dhe egjiptianë. Kjo shfaq një sfida madhore në dialogun ndërkulturor dhe integrimin¹¹.

Situata e strehimit është ende e vështirë për shumë anëtarë të pakicave rome dhe egjiptiane në Shqipëri. Përveç kushteve shpesh shumë të rrënuara, mungesa e titujve të pronësisë ose e marrëveshjeve të sigurta të qiramarrjes i bën shumë anëtarë të këtij komuniteti të prekshëm nga dëbimet. Shumë njerëz ngritën banesat e tyre në tokë publike të papërdorur edhe në pronë, pronësia e së cilës mbetet e paqartë pas rënies së

⁴ Raporti për Shqipërinë 2020: Komunikimi nga Komisioni për Parlamentin Evropian, Këshillin, Komitetin Ekonomik dhe Social Evropian dhe Komitetin e Rajoneve Komunikimi i vitit 2020 mbi politikën e zgjerimit të BE-së

⁵ Regional Cooperation Council. Declaration Of Western Balkans Partners On Roma Integration Within The Eu Enlargement Process. 5 July 2019, Poznan. <https://www.rcc.int/docs/464/orhan-usein-while-one-out-of-four-young-people-in-the-region-is-in-limbo-this-is-true-for-three-out-of-four-roma>

⁶ Report on the Implementation of National Roma Integration Strategies, 2019 <https://op.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/4ff1ac7f-3749-11ea-ba6e-01aa75ed71a1/language-en>

⁷ www.romalb.org - Romalb është sistemi elektronik për monitorimin e progresit të masave për përfshirjen e romëve dhe të egjiptianëve.

⁸ Regional Cooperation Council. Declaration Of Western Balkans Partners On Roma Integration Within The Eu Enlargement Process. 5 July 2019, Poznan: <https://www.rcc.int/docs/464/declaration-of-western-balkans-partners-on-roma-integration-within-the-eu-enlargement-process>

⁹ Komisioni Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës.

¹⁰ Raporti i Gjashtë i ECRI-t për Shqipërinë, 2020 <https://rm.coe.int/report-on-albania-6th-monitoring-cycle-translation-in-albanian-/16809e8240>

¹¹ Raporti i Gjashtë i ECRI-t për Shqipërinë, 2020 <https://rm.coe.int/report-on-albania-6th-monitoring-cycle-translation-in-albanian-/16809e8240>



komunizmit në fillim të viteve 1990. Sipas të dhënave të sondazhit rajonal për komunitetin rom, 84% e komunitetit rom kanë akses në elektricitet dhe 50% e anëtarëve të pakicës romë kanë akses në ujë e pijshëm në banesat e tyre krahasuar me shifrën 89%, që u takon fqinjëve joromë.

Aksesi në të drejtat politike, sociale, shëndetësore, arsimore është i lidhur në mënyrë të pazgjidhshme me regjistrimin civil. Ka romë dhe egjiptianë të paregjistruar në regjistrin e gjendjes civile, që vijnë si pasojë e lindjeve jashtë sistemit shëndetësor, lindjeve nga prindër nën moshë, lindjeve në lëvizje, moskuptimit të rëndësisë dhe procedurave të regjistrimit civil apo dhe të vendbanimit, gjendjes së bashkëpunimit dhe koordinimit jo në nivelin e duhur mes strukturave që punojnë drejtpërdrejt në komunitet etj.

Deklarata e Partnerëve të Ballkanit Perëndimor për integrimin e romëve, në kuadër të procesit të zgjerimit të Bashkimit Evropian (Deklarata e Poznanit) 2019¹², kërkon që rritja e shkallës së punësimit të romëve në sektorin publik të kryhet në shkallën proporcionale të pjesëmarrjes së romëve në raport me popullatën e përgjithshme dhe rritja e nivelit të punësimit midis romëve duhet të jetë të paktën 25 për qind. Kjo deklaratë tregon se Ballkani Perëndimor ndodhet përballë sfidash punësimi për romët dhe egjiptianët. Për Shqipërinë kjo sfidë mbetet edhe më e madhe duke konsideruar të ardhurat për frymë dhe zhvillimin ekonomik. Nga ana tjetër, varfëria dhe rëndësia e sigurimit të nevojave bazë ul ndjeshëm interesin e romëve dhe të egjiptianëve për të përfunduar FP-në (formimin profesional) dhe programet e nxitjes së punësimit, si dhe i detyron ata të gjejnë zgjidhje alternative që shpesh janë informale. Sektorët informalë, si p.sh. mbledhja individuale e mbetjeve të riciklueshme, tregtimi i mallrave të përdorura apo veprimtari të tjera që nuk kërkojnë trajnim të specializuar, gjenerojnë të ardhura më të larta krahasuar me pagën mujore minimale në sektorët formalë. Gjithashtu, kultura e varfërisë dhe e përjashtimit, mungesa e besimit te programet ekzistuese të punësimit, përvojat negative në të

kaluarën etj., bëjnë që pjesa më e madhe e romëve dhe e egjiptianëve që punojnë në sektorin informal detyrohen të vazhdojnë të mbeten aty (duke pranuar pasiguritë e tregut informal të punës) dhe nuk parapëlqejnë të përfshihen në programet e nxitjes së punësimit¹³.

Situata aktuale e punësimit, sidomos me impaktin e pandemisë COVID-19, nuk dihet saktësisht, për arsye sepse mungojnë të dhëna të përditësuara. Projektionet që janë kryer nga viti 2017 deri në arrijtjen e integritetit në BE (supozivisht 2029)¹⁴ janë tejet optimiste, duke shpalosur një panoramë të rritjes sistematike të punësimit të romëve dhe të egjiptianëve (ndonëse thuajse me të njëjtin hendek krahasuar me joromë/egjiptianë), si edhe rënie të punës së padeklaruar¹⁵. Nga të dhëna të vitit 2017, ekziston një hendek midis romëve të marginalizuar dhe fqinjëve joromë, për sa u përket aftësive njerëzore dhe mirëqenies materiale. Hendeku është veçanërisht i madh për të rinjtë – vetëm 22 për qind e romëve të marginalizuar të moshës 18–24 vjeç janë në punësim, arsim ose trajnim krahasuar me 58 për qind të fqinjëve joromë. Kjo ka implikime gjatë gjithë jetës, duke bllokuar mundësitë e mëtejshme për punësim të mirë. Vetëm 18 për qind e romëve të moshës 15–64 vjeç janë të punësuar në krahasim me 27 për qind të fqinjëve joromë¹⁶.

Romët dhe egjiptianët ndihen të diskriminuar nga pikëpamja e aksesit në shërbimet civile. Regjistrimi civil e vështirëson aksesin në shërbime, si: arsim, shëndetësi, ndihmë ekonomike etj. Megjithatë romët dhe egjiptianët ndiejnë

¹³ Mapping the Skills, Employment Opportunities and Undertaking by Roma and Egyptians Communities in the Municipalities of Tirana, Durrës, Berat and Shkodra, UNDP, 2017.

¹⁴ OSFA (2019). Udhërrëfyti për Integrimin e Romëve 2019–2021 për Shqipërinë.

<https://www.rcc.int/romaintegration2020/docs/101/roma-integration-roadmap-albania-2019-2021>

¹⁵ OSFA (2019). Udhërrëfyti për Integrimin e Romëve 2019–2021 për Shqipërinë.

<https://www.rcc.int/romaintegration2020/docs/101/roma-integration-roadmap-albania-2019-2021>

¹⁶ Balkan Investigative Reporting Network (prill, 2020), Roma: Europe's Neglected Coronavirus Victims.

Përgatitur nga Stephan Müller, Fikrija Tair, Bashkim Ibishi and Dragan Gracanin.

<https://balkaninsight.com/2020/04/01/roma-europes-neglected-coronavirus-victims/>

¹² Regional Cooperation Council. Declaration of western Balkans Partners On Roma Integration Within The Eu Enlargement Process. 5 July 2019, Poznan. <https://www.rcc.int/docs/464/orhan-usein-ehile-one-out-of-four-young-people-in-the-region-is-in-limbo-this-is-true-for-three-out-of-four-roma>



diskriminim edhe pranë sporteve të shërbimeve civile. Në një studim të vitit 2017, nga anketat (duke përdorur Shkallën e Racizmit Simbolik 2000 – SR2KS¹⁷), intervistat, simulimet, *workshop*-et dhe *coaching* me punonjës të administratës publike në 4 bashki (Tiranë, Durrës, Berat dhe Shkodër), u diagnostikua prania e dukurisë së *racizmit simbolik*¹⁸ në nivele thuhet mbi mesataren¹⁹.

Nga ana tjetër, romët dhe egjiptianët kanë më pak gjasa për të plotësuar kriteret për përfitimin nga shërbimet sociale (duke përfshirë ndihmën ekonomike), për shkak të mungesës së dokumenteve personale ose të transferimit formal të vendbanimit, analfabetizmit ose paaftësisë për të plotësuar formularët e aplikimit, procedurave tepër të komplikuar, pasja e pronësisë ligjore mbi toka që ata nuk i zotërojnë etj. Ndonjëherë, ata humbasin përfitimet, për shkak të pamundësisë për të regjistruar transferimin e vendbanimit brenda afatit të caktuar²⁰.

Raporti i 2019-ës mbi zbatimin e strategjive kombëtare të integritetit të romëve ka gjetur, se, veçanërisht në nivelin lokal, ligji i antidiskriminimit dhe i mekanizmave përkatës të zbatimit nuk është kuptuar mjaftueshëm. Gjithashtu ekziston mungesa e kapaciteteve të brendshme për të adresuar rregullisht çështjet e diskriminimit. Mekanizmat institucionalë për të njohur dhe për të sanksionuar gjuhën e urrejtjes mbeten kryesisht joefektive. Bazuar në raportin vjetor të Komisionerit kundër Diskriminimit, ka pasur 43 raste për periudhën 2017–2018 të diskriminimit për shkak të racës. Pakicat rome dhe egjiptiane nuk janë të informuar

mirë për të drejtat, shërbimet ose rrugët ligjore për të ofruar këto shërbime.

Romët dhe egjiptianët vazhdojnë të përballen me pengesa në qasjen në kujdesin shëndetësor mbi baza të barabarta. Ndërsa të dhënat zyrtare për gjendjen e tyre shëndetësore janë ende të paqarta, sipas grupeve të ndryshme të komunitetit, progresi duket të jetë i kufizuar. Kushtet e dobëta të strehimit, niveli i ulët i arsimit dhe njohuri të lidhura me shëndetin, distanca fizike nga qendrat e kujdesit shëndetësor dhe përvojat e diskriminimit përkeqësojnë problemet ekzistuese²¹. Shkalla e vaksinimit midis fëmijëve, shpesh është më e ulët për anëtarët e pakicave rome dhe egjiptiane në krahasim me popullsinë e përgjithshme. Masa në lidhje me sigurimin e paketave të kujdesit për bebe dhe për nëna, për nënat rome dhe egjiptiane, që lindin në spital u zbatua me shumë sukses. Gjatë vitit 2016, u raportuan 1961 nëna rome dhe egjiptiane përfituese, gjatë 2017 kjo shifër është rritur në 2059, ndërkohë që viti 2018 numëron 7080 përfitues në këtë kategori²².

4.1 Regjistrimi civil dhe aksesimi në sistemin e drejtësisë

Akcesi në të drejtat politike, sociale, shëndetësore, arsimore është e lidhur në mënyrë të pazgjidhshme me regjistrimin civil. Ka romë dhe egjiptianë të paregjistruar në regjistrin e gjendjes civile që vijnë si pasojë e lindjeve jashtë sistemit shëndetësor, lindjeve nga prindër nën moshë, lindjeve në lëvizje, moskuptimit të rëndësishëm dhe të procedurave të regjistrimit civil apo dhe të vendbanimit, gjendjes së bashkëpunimit dhe të koordinimit jo në nivelin e duhur mes strukturave që punojnë drejtpërdrejt në komunitet etj. Në tetor 2018, Parlamenti i Shqipërisë miratoi ndryshime ligjore në ligjin e regjistrimit civil të vendit²³. Qëllimi i këtyre ndryshimeve ishte heqja e pengesave në regjistrimin e lindjeve dhe zvogëlimi i rrezikut të mungesës së shtetësisë në Shqipëri,

¹⁷ Henry, P. J., & Sears, D. O. (2002). The symbolic racism 2000 scale. *Political Psychology*, 23(2), 253–283.

¹⁸ Racizmi simbolik (i njohur edhe si paragjykim simbolik dhe pakënaqësia racore) është një sistem besimi koherent, që pasqyron një paragjykim themelor unidimensional ndaj çdo etnie. Këto besime përfshijnë stereotipin se njerëzit me ngjyrë janë moralisht inferiorë ndaj personave të bardhë, të bardhët janë racist dhe se njerëzit me ngjyrë shkelin vlerat tradicionale të të bardhëve. Këto besime mund të shpien në veprime diskriminuese dhe justifikim të këtyre veprimeve.

¹⁹ Hysa, X., & Titka, M. (2017). ESERE Behavioral Change Model Changing Attitudes and Behaviors of Public Servants with Regards to Roma and Egyptians' Access to Public Services. Tirana/Albania: UNDP. <http://www.al.undp.org/content/dam/albania/docs/ESERE%20Behavioural%20Change%20Model.pdf>

²⁰ Plani Kombëtar i Veprimit për Integritetin e Romëve dhe Egjiptianëve në Republikën e Shqipërisë (2016–2020).

²¹ Monitorimi nga Shoqëria Civile i Zbatimit të Strategjisë Kombëtare dhe i Planit të Veprimit të Dekadës Rome në vitin 2012 në Shqipëri (2013), Roma Active Albania & Zyra e Iniciativave Rome të Fondacionit të Shoqërisë së Hapur.

²² www.romalb.org – Romalb është sistemi elektronik për monitorimin e progresit të masave për përfshirjen e romëve dhe të egjiptianëve.

²³ <https://diaspora.gov.al/wp-content/uploads/2018/10/ligj-nr-69-dt-11-10-2018.pdf>



veçanërisht për fëmijët e prindërve shqiptarë të lindur jashtë vendit dhe për fëmijët e pakicave rome dhe egjiptiane.

Këto ndryshime u pasuan me nxjerrjen e 3 (tre) udhëzimeve me nr. 284, 285 dhe 286, datë 11.3.2019, të ministrit të Brendshëm. Me këto ndryshime, u plotësua e gjithë korniza ligjore dhe nënligjore, për regjistrimin e të gjitha familjeve, pavarësisht se ku kanë lindur, brenda ose jashtë territorit të Shqipërisë. Nëpërmjet këtyre ndryshimeve, pavarësisht nga rastet e mungesës së dokumentacionit, dokumentacionit të pasaktë ose dokumentacionit jo të plotë, fëmija do të regjistrohet në njërin prej procedurave të përcaktuara: administrative ose gjyqësore. Këto ndryshime ligjore bënë të mundur që gjatë vitit 2019, të regjistroheshin 530 fëmijë nga pakica rome. Rastet që ishin identifikuar më parë dhe nuk mund të regjistroheshin²⁴.

Pothuajse të gjithë romët e marginalizuar në Shqipëri, si dhe joromë që jetojnë në afërsi të tyre, kanë certifikata të lindjes, ndërkohë që aksesit në dokumentet personale është përmirësuar për të dyja grupet. Megjithatë, posedimi i dokumentit personal të identifikimit nuk nënkupton domosdoshmërisht akses në lloje të tjera dokumentacioni që mund të jetë e nevojshme për marrjen e shërbimeve të caktuara sociale, përfshirë shërbimet shëndetësore dhe huat.

Në vitin 2017, raportohet 3 për qind niveli i romëve të kthyer në Shqipëri gjatë 12 muajve të kaluara, i cili është disi i lartë në krahasim me pjesën tjetër e vendeve të Ballkanit Perëndimor²⁵. Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “c”, të pikës 2, të nenit 38, të ligjit nr. 18/2017, “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijëve”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave miratoi VKM-në nr. 740, datë 12.12.2018, në lidhje me “Përcaktimin e masës së ndihmës së menjëhershme financiare (bonusi) për nënat me foshnja të

porsalindura dhe procedurën e dhënies së tij”, si më poshtë vijon:

a) në masën 40 000 (dyzet mijë) lekë për lindjen e fëmijës së parë;

b) në masën 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë për lindjen e fëmijës së dytë;

c) në masën 120 000 (njëqind e njëzet mijë) lekë për lindjen e fëmijës së tretë dhe fëmijëve të tjerë në vijim;

ç) për nënat që lindin binjakë, masa e përfitimit do të jetë në masën 80 000 (tetëdhjetë mijë) lekë për secilin fëmijë;

d) për nënat që lindin trinjakë dhe më shumë, masa e përfitimit do të jetë në masën 120 000 (njëqind e njëzet mijë) lekë për secilin fëmijë.

Ndihmën e menjëhershme financiare (bonusi) e përfitojnë edhe nënat shtetase shqiptare për fëmijë të lindur jashtë vendit dhe të regjistruar sipas afateve ligjore të përcaktuara në ligjin për gjendjen civile.

Nëpunësi i gjendjes civile, i atashuar pranë institucioneve të shërbimit spitalor ku kryhet lindja, kryen veprimet e verifikimit *online* të statusit të nënës dhe regjistrojnë fëmijën e lindur në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGjC) të vitit 2010. Ndihma e menjëhershme financiare (bonusi) i jepet nënës, menjëherë, pas lëshimit të dokumentit “certifikatë asistence në lindje”, në përfundim të procedurave të regjistrimit të fëmijës në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile.

Me miratimin e ndryshimeve të ligjit të gjendjes civile në vitin 2018, ndihen ndryshime pozitive në aspektin e regjistrimeve të lindjeve me më pak kosto, pasi rruga administrative e zgjidhjes së rasteve është përdorur më shumë dhe është mënjeluar rruga gjyqësore²⁶.

Zyrat e gjendjes civile kanë bashkëpunuar dhe koordinuar më mirë me njësitë për mbrojtjen e fëmijëve për identifikimin e rasteve dhe rekomandimin e tyre në rast nevojë për asistencë ligjore falas, gjë që tregon se shkalla e sensibilizimit dhe e ndërgjegjësimit është më e lartë.

Edhe pse ka një zhvillim pozitiv në kuadrin e bashkëpunimit për zgjidhjen e rasteve të lindjeve të ndodhura jashtë shtetit, ka vend dhe nevojë që ky koordinim të përmirësohet në të ardhmen, sepse

²⁴ Raporti i monitorimit të implementimit të Planit të Veprimit për Integrimin e Komunitetit Rom dhe Egjiptian, vitin 2019, faqe 49.

²⁵ *Country fact sheet*. Sondazhi Rajonal për Komunitetin Rom.

<https://www.eurasia.undp.org/content/rbec/en/home/library/roma/regional-roma-survey-2017-country-fact-sheets.html>

Faqe | 16726

²⁶ Informacion i ofruar nga TLAS gjatë takimeve konsultative për hartimin e Planit të Veprimit për Integrimin e Komunitetit Rom dhe Egjiptian, 2021–2025.



procedurat ecin shumë ngadalë dhe humb aktualiteti i ngjarjes, si edhe mohohen të drejtat e fëmijëve.²⁷ Është evident fakti që familjet apo prindërit romë dhe egjiptianë jo rrallë kryejnë veprime që komplikojnë më shumë jetën e tyre familjare. Konkretisht, vitet e fundit gjendemi para fenomenit të “martesave fiktive”. Martesa fiktive për interes, edhe pse në momentin e pare është joshës, sepse sjell përfitimin e një sasive të ardhurash në para, më pas sjell shumë probleme komplekse, e cila vë në rrezik jetën e fëmijëve të tyre të ardhur në jetë nga kjo martesë fiktive²⁸.

Romët dhe më pak egjiptianët hasin barrierë në shërbimin e gjendjes civile në rastet e ndryshimit të vendbanimit. Kjo është pasojë e mungesës së certifikatës së pronësisë ose të kontratës së qirasë së banesës në bashkinë ku janë shpërngulur²⁹. Sipas Ministrisë së Punëve të Brendshme, në vitin 2017, 235 romë dhe egjiptianë janë asistuar për sigurimin e dokumenteve për fëmijët të lindur jashtë vendit. Këto të dhëna janë të padisponueshme për vitet në vijim. Ka rreth 150 fëmijë romë dhe egjiptianë të lindur çdo vit jashtë vendit, të cilët duhet të mbështeten me asistencë teknike për marrjen e dokumenteve. Ky numër pritet të rritet në vitet e ardhshme për arsye se shumë emigrantë, përfshirë anëtarët e pakicave romë dhe egjiptiane, për shkak të krizave globale ekonomike, po kthehen në Shqipëri³⁰. 730 romë dhe egjiptianë janë identifikuar gjatë vitit 2019, vendbanimi i të cilëve, sipas regjistrimit civil, nuk përputhej me atë real.

Sipas të dhënave më të fundit mbi popullsinë të mbledhura gjatë Censusit të Popullsisë dhe Banesave të vitit 2011 dhe të hartuara nga Instituti Shqiptar i Statistikave (INSTAT), në Shqipëri janë identifikuar 7443 persona pa shtetësi. Nuk ka të dhëna të tjera të mëtejshme në dispozicion në

lidhje me demografinë e këtyre individëve, përveç ndarjes gjinore (3874 burra dhe 3569 gra sipas Censusit të popullsisë të vitit 2011). Duhet të vihet në dukje se nuk ka të dhëna zyrtare për numrin e personave me shtetësi të panjohur ose në rrezik pashtetësie, të cilët janë për shembull fëmijë ose pakica apo ndonjë kategori tjetër e veçantë. Shifrat më të sakta, aktualisht në dispozicion janë mbledhur nga TLAS (Shërbimi Ligjor Falas Tiranë) në Raportin e Hartëzimit të Popullsisë në Rrezik Pashtetësie në Shqipëri të realizuar në bashkëpunim me UNHCR-në dhe botuar në maj 2018.³¹

Si rezultat i këtij ushtrimi të hartëzimit u identifikuan 1031 persona në rrezik pashtetësie. Numri prej 7443 i personave pa shtetësi të raportuar nga censusi i popullsisë i vitit 2011 mendohet të jetë zvogëluar ndjeshëm, për shkak të aksesit ligjor në regjistrim të siguar me mbështetjen e TLAS-së dhe i mbështetur në vite nga organizatat ndërkombëtare (UNHCR është një prej tyre). Ky ishte, gjithashtu, një fakt i rëndësishëm që doli nga raporti i hartëzimit i përgatitur nga TLAS-UNHCR, që konfirmoi se numri i personave në rrezik pashtetësie (1031) është shumë më i ulët se numri i raportuar më parë nga censusi. Kjo është me vend në kontekstin e pashtetësisë së romëve në Shqipëri, ku shkak kryesor (rreziku) i pashtetësisë është mungesa e dokumenteve në gjendjen civile dhe trashëgimi i pashtetësisë. Siç ka arritur në përfundim Roma Belong Report³², Romët ndikohen, preken në mënyrë disproporcionale nga këto shkaqe, për shkak të cenueshmërisë dhe marginalizimit të tyre, si dhe për shkak se përkatësia e tyre ka më shumë gjasa të vihet në dyshim nga autoritetet. Censusi i popullsisë i vitit 2011 identifikoi, gjithashtu, numrin e vlerësuar të romëve dhe të egjiptianëve, që ishte 8300 romë dhe 3368 egjiptianë³³, por ky numër kundërshtohet fort dhe popullata reale romë dhe egjiptiane konsiderohet të jetë shumë më e lartë.³⁴

Në Shqipëri nuk ka në fuqi status për personat pa shtetësi, as mekanizëm për përcaktimin e pashtetësisë që do të bënte të mundur identifikimin

²⁷ Informacion i ofruar nga TLAS gjatë takimeve konsultative për hartimin e Planit të Veprimit për Integrimin e Komunitetit Rom dhe Egjiptian, 2021–2025.

²⁸ Informacion i ofruar nga TLAS gjatë takimeve konsultative për hartimin e Planit të Veprimit për Integrimin e Komunitetit Rom dhe Egjiptian, 2021–2025.

²⁹ Raporti i Monitorimit të Implementimit të Planit të Veprimit për Integrimin e komunitetit Rom dhe Egjiptian – 2019.

³⁰ Raporti i monitorimit të Implementimit të Planit për Integrimin e Komunitetit Rom dhe Egjiptian për vitin 2017, faqe 40: <https://www.rcc.int/romaintegration2020/docs/81/progress-report-albania-for-2017>

³¹ TLAS dhe UNHCR, Raport mbi Hartëzimin e Popullsisë në Rrezik Pashtetësie në Shqipëri, maj 2018, gjendet [këtu](#).

³² Roma Belong Report – shkurt 2018, gjendet [këtu](#).

³³ Të dhënat e censusit mund të gjenden [këtu](#).

³⁴ Shënimi 2, në faqen 13.



e rasteve. Si rezultat, personat pa shtetësi nuk identifikohen në mënyrë sistematike dhe as individuale dhe ka pengesa për arritjen e qëndrimit të ligjshëm në vend nga personat pa shtetësi. Për më tepër, është e vështirë të mblidhen të dhëna të besueshme, për shkak të vetë natyrës së të qenit “ligjërisht e padukshme”, dhe për shkak të kufizimeve metodologjike (p.sh. të dhënat e censusit të popullsisë bazuar në vetidentifikimin).

Për sa u përket romëve dhe egjiptianëve, mungesa e ndërgjegjësimit, cenueshmëria sociale dhe ekonomike, si dhe stili i jetës me lëvizje të vazhdueshme vazhdojnë të pengojnë regjistrimin e tyre dhe pajisjen me dokumente. Në vitin 2019, afërsisht 60% e çështjeve të punës së TLAS-it lidhet me komunitetet rome dhe egjiptiane.

Sipas Kodit të Familjes, regjistrimi i lindjes së fëmijës në Shqipëri është i lidhur ngushtë me përcaktimin e amësisë dhe atësisë, regjistrim që kërkon një procedurë gjyqësore për fëmijët e lindur jashtë martese. Disa familje zgjedhin të mos i regjistrojnë fëmijët derisa të zgjidhen mosmarrëveshjet familjare, në mënyrë që të shmangin hapjen e procedurave komplekse në gjykatë. Disa raste përfshijnë të rritur që kurrë nuk mund të regjistrohen, për shkak të mohimit ose paqartësive të amësisë/atësisë. Me rishikimin e ligjit për gjendjen civile, i cili hyri në fuqi në tetor 2018, çështje të tilla rregullohen në aspektin e kuadrit ligjor, por akoma është e nevojshme të finalizohen çështjet e mbetura pezull dhe të monitorohet zbatimi i tij, veçanërisht zbatimi i një numri të madh të udhëzimeve që u përgatitën dhe hynë në fuqi në vitin 2019.³⁵

Në qershor të vitit 2018, hyri në fuqi ligji nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, i cili ka për qëllim krijimin e një sistemi për organizimin dhe ofrimin e ndihmës juridike falas për të siguruar akses të barabartë të të gjithë individëve në sistemin e drejtësisë. Me hyrjen në fuqi të këtij ligji u reformua i gjithë sistemi i ndihmës juridike. Për rrjedhojë, një prej institucioneve përgjegjëse të ngritura për administrimin dhe funksionimin e sistemit të ndihmës juridike falas është dhe Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas. Ky institucion, në

bashkëpunim me institucione të tjera shtetërore dhe organizata ndërkombëtare, organizata të shoqërisë civile (vendëse dhe të huaja), klinikat ligjore, mundëson ofrimin e ndihmës juridike përmes juristëve/avokatëve falas për individët të cilët nuk e përballojnë dot pagesën e një juristi/avokati, apo që bëjnë pjesë në kategoritë e veçanta. UNDP-ja në Shqipëri ka luajtur një rol thelbësor në hartimin ligjit nr. 111/2017 dhe të kuadrit nënligjor të domosdoshëm për të bërë të mundur zbatimin e tij; ofrimin e mbështetjes për të ngritur mekanizma institucionalë, si Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas në Ministrinë e Drejtësisë, si dhe pilotimi dhe forcimi i Qendrave të Ndihmës Ligjore Falas në 6 rrethe gjyqësore: Durrës, Fier, Lezhë, Dibër, Shkodër dhe Pogradec. Qytetarët që kanë përfituar më së shumti nga shërbimet ligjore falas në këto qendra janë anëtarë të pakicave rome dhe egjiptiane (numri).

Bazuar në nenet 10–12 të këtij ligji nr. 111/2017, mundësinë të përfitojnë nga shërbimi i ndihmës juridike të garantuar nga shteti dhe të aksesojnë drejtësinë janë shtetasit në kushtet e pamundësisë ekonomike (me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme), si dhe kategoritë vulnerabel përfshirë edhe romët dhe egjiptianët, si grup që përballen me pengesa të shumëllojshme. Sipas një studimi të kryer në vitin 2017 nga UNDP-ja në Shqipëri, pothuajse tri të katërtat (73,4%) e popullatës nuk kishin kërkuar informacion për ligjin. Popullata rome dhe egjiptiane ishte më e pakënaqura me informacionin e marrë. Gjithashtu, niveli i ulët i njohurive ligjore është më i theksuar në radhët e popullatës rome, personave me nivel arsimor të ulët, dhe nivel të ardhurash më të ulëta.³⁶ Për më tepër, të drejtat pronësore dhe familjare të grave nuk njihen në mënyrë të njëtrajtshme në të gjithë Shqipërinë. 61,9% e romëve janë të mendimit se një grua e ve ka të drejtën të marrë gjysmën e pasurisë së bashkëshortit pas vdekjes së tij. Po kështu, vetëm pak më shumë se gjysma e popullatës rome (50,5%) mendon se pas divorcit gjykata duhet të caktojë se cilit prind t'i jepet kujdestaria e fëmijës, duke mbajtur parasysh interesin më të lartë të fëmijës, dhe jo thjesht t'ia

³⁵ Informacioni i plotë, kuadri ligjor dhe udhëzimet për regjistrimin efikas të lindjes së fëmijëve mund të gjenden në udhëzuesin e botuar nga TLAS-ja në vitin 2020 (gjendet vetëm në gjuhën shqipe) dhe mund ta gjeni [këtu](#).
Faqe | 16728



japë fëmijët babait³⁷. Mungesa e ndërgjegjësimit për të drejtat e garantuara nga Kushtetuta, së bashku me mungesën e njohurive për ligjet dhe dispozitat kryesore, tregojnë se sistemi i ndihmës juridike duhet t'i kushtojë një vëmendje të madhe proaktive rritjes së njohurive dhe ngritjes së ndërgjegjësimit për ligjin. Këto përpjekje duhet t'i drejtohen të gjithë popullatës në përgjithësi por ato duhet të përqendrohen te personat me nivel më të ulët arsimor e me nivel më të ulët të ardhurash, si dhe te komuniteti rom – grupe të cilat duket se kanë mangësitë më të mëdha në njohjen e ligjit dhe, për rrjedhojë, hasin edhe pengesat më të mëdha për të pasur akses në drejtësi. Rritja e ndërgjegjësimit për ligjin, si në radhët e këtyre grupeve ashtu edhe në përgjithësi, do të kërkojë përdorimin e metodave proaktive për t'i plotësuar mangësitë në njohuritë ligjore të personave që nuk dinë ku të drejtohen për të kërkuar informacion. Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas, në kuadër të ndërgjegjësimit dhe të edukimit ligjor të qytetarëve mbi sistemin e ndihmës juridike të garantuar nga shteti, detyrim ligjor i përcaktuar në nenin 8, shkronjat “d” dhe “e”, të ligjit nr. 111/2017, “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”, *ka vijuar me hartimin dhe publikimin e një manuali të thjeshtëzuar* mbi kriteret dhe procedurën e përfitimit nga shërbimet e ndihmës juridike falas.

Kërkesa në rritje për shërbime pa ndërprerje, të barabarta dhe të papenguara të ndihmës juridike për gratë dhe vajzat në nevojë, anëtarët e komunitetit rom dhe egjiptian, persona me të ardhura të ulëta, persona të moshuar dhe persona me aftësi të kufizuara u vunë re gjatë periudhës posttërmetit dhe gjatë pandemisë COVID-19. Në të dyja rastet, UNDP Shqipëri mbështeti qendrat e Ndhmës Ligjore Falas që ishin operacionale dhe në partneritet me Organizatat e Shoqërisë Civile, Ministrinë e Drejtësisë dhe autoritetet gjyqësore zhvilluan një plan për të rregulluar mjetet e komunikimit të shërbimeve përmes platformave *online*, telefonike dhe mediave sociale.

Sipas Ministrisë së Punëve të Brendshme, në bashkëpunim me organizata të shoqërisë civile në vitin 2019³⁸ u regjistruan 82 fëmijë nga pakica rome

si regjistrime të vonuara dhe u identifikuan rreth 730 raste të individëve romë, që kanë nevojë për ndihmë të natyrave të ndryshme për regjistrimin në gjendjen civile. Vështirësitë në këtë fushë janë të ndryshme, përfshirë: prindërit e fëmijës së lindur nuk disponojnë dokumentin “Asistencë në lindje”; prindërit e fëmijës së lindur jashtë territorit të republikës së Shqipërisë nuk disponojnë dokumentin “Asistencë në lindje”, për rastet kur kanë lindur në institucionet shëndetësore; prindërit e fëmijës së lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, nuk disponojnë asnjë dokument që provon lindjen, për shkak se ka lindur jashtë mjediseve shëndetësore etj.

Regjistrimi i fëmijëve të lindur jashtë shtetit mbetet një sfidë e vështirë pasi prindërit/të interesuarit janë deportuar nga vendet e hapësirës Shengen e për pasojë nuk mund të sigurojnë vetë dokumentet. Kjo gjendje kërkon ndihmë juridike qoftë edhe nëpërmjet shërbimeve konsullore shqiptare që operojnë në këto shtete, që shpesh romët dhe egjiptianët nuk mund t'i përballojnë financiarisht apo t'i ndjekin. Në vitin 2017, Ministria e Punëve të Brendshme identifikoi mbi 235 raste të tilla në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile. Mungon rimbursimi i anëtarëve të komunitetit rom dhe egjiptian për tarifat e legalizimit (certifikimit) të dokumenteve të ngarkuara nga konsullatat shqiptare dhe të nevojshme për regjistrimin civil. Problemet në dokumentacionin ekzistues përfshijnë përmbajtjen e të dhënave të pasakta për të cilat nevojitet gjurmimi përmes procedurave administrative, në mënyrë që të bëhet korrigjimi i tyre. Në vitin 2019, Ministria e Punëve të Brendshme ka identifikuar 730 raste të tilla. Regjistrimi në gjendjen civile në mungesë të “asistencës së lindjes” kërkon ndihmë juridike dhe administrative, të cilën shumica e romëve nuk dinë ku ta marrin dhe nuk mund ta përballojnë financiarisht. Në vitin 2019, Ministria e Punëve të Brendshme në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile ka identifikuar 82 raste të fëmijëve të lindur në shtëpi, të cilët më pas duhen regjistruar.

Ndihma juridike/administrative për regjistrimin civil ofrohet kryesisht nga organizatat e shoqërisë civile dhe shumë rrallë nga shërbimi i ndihmës juridike nën varësinë e Ministrisë së Drejtësisë. Për vitin 2018 Ministria e Drejtësisë raporton ekzistencën e 8 qendrave të ndihmës ligjore falas

37

<https://www.al.undp.org/content/albania/en/home/library/poverty/survey-on-access-to-justice-in-albania.html>

³⁸ Të dhëna të Ministrisë së Punëve të Brendshme të ofruara në shtator 2014.



dhe ato janë në Durrës, Fier, Lezhë, Dibër, Shkodër dhe Pogradec me mbështetjen e UNDP-së, Tiranë me mbështetjen e OSFA-së dhe Lushnjës me buxhetin e shtetit. Duke qenë se këto qendra bazohen në fondet e donatorëve, për rrjedhojë edhe kohëzgjatja e funksionimit të tyre varet nga këto fonde. Më 25 nëntor 2017, në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë u krijua Zyra për Ndhimën Juridike Falas dhe Dhuna në Familje, e cila në thelb të misionit të tyre është të ofrojë këshilla juridike falas për qytetarët në nevojë. Largësia e klinikave të ligjit të ngritura gjatë këtyre dy viteve të fundit me vendbanimet e pakicave rome dhe egjiptiane, si dhe mungesa e ndërmjetësve të të dy pakicave, të cilët do të përmirësonin shërbimin e ndihmës ligjore parësore dhe dytësore falas, janë faktorë shtesë të cilët ndikojnë në aksesin e ulët në shërbimin e ndihmës ligjore falas³⁹. Të vetëdijshëm për këtë problem, organizatat partnere me UNDP Shqipëri, të cilat kanë pilotuar qendrat e ndihmës ligjore falas, kanë ofruar shërbime mobile (të lëvizshme) ligjore falas, ditë të hapura në njësi të ndryshme administrative ku janë hapur qendrat.

Sipas informacionit të dhënë nga Zyra e Ndhimës Juridike pranë Ministrisë së Drejtësisë, nga 2,000 rastet e trajtuara për periudhën dhjetor 2017–dhjetor 2019 nga Klinika e Ligjit Tiranë, është e pamundur identifikimi i romëve dhe i egjiptianëve që kanë përfituar nga shërbimi ndihmës juridike parësore falas.

Familjet rome dhe egjiptiane akoma përballen me pengesa dhe vështirësi për transferimin e vendbanimit të tyre ligjor nga njëri qytet tek tjetri dhe si rezultat nuk përfitojnë nga sigurimet shoqërore apo përfitime të tjera sociale. Transferimi i vendbanimit kërkon që aplikanti të dorëzojë një certifikatë pronësie ose kontratën e qirasë së një apartamenti/banese që ndodhet në bashkinë ku kërkohet të bëhet transferimi. Shumica e romëve dhe e egjiptianëve nuk i kanë këto dokumente, pasi shumë prej tyre jetojnë në kasolle/baraka të improvizuara ose në banesa të palegalizuara. Për rrjedhojë, ata nuk përfitojnë nga shërbimet dhe programet vendore, si p.sh. strehimi social. Megjithatë, duke shfrytëzuar klauzolat ligjore

për këtë komunitet, në bashkëpunim me organet e vetëqeverisjes vendore, mund të gjenden zgjidhje për këtë procedurë.

Është e vështirë të sigurohen të dhëna për të rikthyerit vullnetarë, si dhe ka mungesa në njohuritë bazë nga autoritetet vendore për të përdorur në mënyrë efektive instrumentet e ndryshme financiare, në lidhje me riintegrimin e të rikthyerve.

Shumë pak përpjekje ka në drejtim të ofrimit të shërbimeve psikologe falas të mandatuara nga gjykata për romët dhe egjiptianët në nevojë në procedurat gjyqësore, të tilla si divorci, kujdestaria e fëmijëve, urdhrat e ndalimit, përgjegjësia prindërore dhe fëmijët në konflikt me ligjin. Bazuar në të dhënat e sistemit Romalb⁴⁰, në tri vitet e fundit kjo masë nuk është zbatuar dhe rrjedhimisht raportuar.

Trafikimi

Varfëria, përjashtimi social dhe tendenca për të mbijetuar me anë të punës informale i bëjnë romët dhe egjiptianët vulnerabël ndaj trafikimit. Në periudhën janar–nëntor 2018, qendrat rezidenciale identifikuan dhe ndihmuan 95 viktima dhe viktima të mundshme të trafikimit, mes tyre edhe 7 romë dhe egjiptianë⁴¹.

Në kufijtë e RSH-së agjencia përgjegjëse për identifikim fillestar është Policia e Kufirit (të gjelbër dhe blu). Në territorin e RSH-së agjencitë përgjegjëse për identifikim fillestar janë agjencitë shtetërore dhe joshtetërore, përfshirë: KKSAT, qendrat e përkujdesjes shoqërore për persona në nevojë, organizatat me programe të ndihmës për persona në nevojë, zyrat rajonale të shërbimit social shtetëror në qarqe, strukturat e policisë së shtetit, inspektorati shtetëror i punës dhe i shërbimeve shoqërore, shkollat dhe institucionet arsimore, institucionet e kujdesit shëndetësor, strukturat e shërbimeve sociale në bashki. Jashtë territorit të RSH-së, agjencitë/institucionet përgjegjëse për identifikimin e viktimave të mundshme të trafikimit me shtetësi shqiptare, janë punonjësit e përfaqësive diplomatike të RSH-së, si dhe agjenci të tjera shtetërore dhe joshtetërore me veprimtari në fushën e mbrojtjes së viktimave të trafikimit.⁴²

³⁹ Inpute nga përfaqësues të komunitetit rom e egjiptianë nëtakimet konsultative për hartimin e Planit të Veprimit 2021–2025.

⁴⁰ Sistemi Romalb është një sistemi elektronik për monitorimin e progresit të masave për përfshirjen e romëve dhe egjiptianëve.

⁴¹ CARITAS Shqipëri (2019). Trafikimi i fëmijëve është

krim: <https://www.caritas.eu/child-trafficking-is-a-crime/>

⁴² [Raporti-vjetor-2018.pdf \(mb.gov.al\)](https://www.caritas.eu/child-trafficking-is-a-crime/)



Burime të ndryshme deklarojnë se fëmijët romë në Shqipëri janë shumë të ekspozuar ndaj rrezikut të trafikimit për shfrytëzim seksual, pasi ata përbëjnë një përqindje tepër të lartë të fëmijëve në situatë rruge⁴³. Po kështu, bazuar në studimin e UNICEF-it, “Martesa e fëmijës”, ka dalë në përfundimin, se në komunitete të veçuara apo të integruara rome, disa forma të martesave në moshë fëmijërore, në moshë shumë të re, apo martesa me detyrim pranohen dhe mbështeten nga një gamë e gjerë traditash dhe zakonesh⁴⁴. Presioni vjen edhe nga komuniteti dhe farefisi përreth vajzave, duke nxitur martesat në moshë të vogël, madje një pjesëmarrës në studimin e përmendur më lart tha se “nëse vajza e fqinjëve martohet, duhet që të gjejnë se s’bën një burrë edhe për vajzën e tyre”⁴⁵. Ky studim, gjithashtu nënvizoi ekzistencën e qëndrimeve konservatore të disa komuniteteve të veçuara rome, që i japin një rëndësi shumë të madhe mbrojtjes së “nderit” të vajzave, duke justifikuar kështu martesat e vajzave në moshë të vogël, megjithëse dihej se martesa në moshë të vogël do t’i shkaktonte dëm fëmijës.⁴⁶

Sipas raporteve të Departamentit Amerikan të Shtetit 2017 dhe 2018, ka shumë fëmijë në situatë rruge i përkasin pakicës rome dhe se ata fëmijë në përgjithësi janë në rrezik të lartë të trafikimit.⁴⁷

Sipas po këtij raporti, ARSIS pohoi se në disa komunitete që u përkasin pakicave rome dhe egjiptiane, vajza të moshës 7 vjeç dhe djem të moshës nëntë vjeç konsideroheshin të martuar. Disa organizata lokale raportojnë se martesat e hershme dhe të detyruara kanë ndodhur në anëtarë të këtyre komuniteteve në zonat rurale si pjesë e skemave të trafikimit të qenieve njerëzore, me prindërit që pranojnë vajzat e tyre të mitura që

martohen me burra të moshuar të huaj, të cilët më pas i transferuan në vendet e tjera.⁴⁸

Familjet pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme mund të marrin ndihmë ekonomike nga shteti (ekuivalent me rreth 40 dollarë në muaj) dhe nga pushteti vendor. Ata që kanë të drejtë janë ndër të tjera edhe viktimat e mundshme të trafikimit, pasi të largohen nga strehëzat dhe derisa të punësohen. Sidoqoftë, jo të gjithë ata që kanë nevojë mund të marrin mbështetje. Familjet rome që nuk kanë dokumentacion ose nuk janë të regjistruar në NJVV-të e tyre, nuk mund të marrin përfitime. Organizatat lokale shpesh përpigjen të plotësojnë boshllëqet, duke siguruar mbështetje, të tilla si përmes ushqimit, veshjeve, arsimit ose trajnimit. Mbështetja familjare është e dobët në përgjithësi dhe nuk i plotëson nevojat e familjes.

Në këtë situatë është shumë e rëndësishme të ndërmerren fushata ndërgjegjëse mbi avantazhet e martesave në mosha më të mëdha, si dhe për arsimim e edukim më të mirë, në lidhje me seksin dhe marrëdhëniet me dëshirë, në mënyrë që “mbrojtja e nderit” të mos konsiderohet më si e nevojshme. Të rritet niveli i bashkëpunimit i të gjitha institucioneve në luftën kundër antitrafikimit të personave, përfshi institucionet që kryejnë veprimtari në pikat e kalimit të kufirit, për mbikëqyrjen e shtetasve të cilëve u është refuzuar azili në vendet BE. Në mënyrë të veçantë të bashkëpunohet për informimin dhe ndërgjegjësimin e shtetasve për detyrimet, lidhur me lëvizjen e lirë, pamundësinë e plotësimit të kërkesave për azil, duke qenë se Shqipëria është vend i sigurt, si dhe nga ana e zyrave vendore të arsimit parauniversitar (në të gjithë sistemin e arsimit parauniversitar) informimin, lidhur me nxënësit që nuk vazhdojnë procesin mësimor, e kanë ndërprerë, nuk frekuentojnë rregullisht, duke specifikuar nxënësit e komunitetit rom dhe egjiptian, nxënësit e familjeve me kryefamiljar gra, nxënësit jetim etj.

4.2 Kujdesi shëndetësor

Më 27 janar 2016 hyri në fuqi ligji nr. 10383, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, i

⁴³ CARITAS Shqipëri (2019). Trafikimi i fëmijëve është krim: <https://www.caritas.eu/child-trafficking-is-a-crime/>

⁴⁴ UNICEF Shqipëri (2018). Martesa e fëmijës, faqe 44: https://www.unicef.org/albania/media/1031/file/Child_marriage_report_2018.pdf

⁴⁵ UNICEF Shqipëri (2018). Martesa e fëmijës, faqe 44: https://www.unicef.org/albania/media/1031/file/Child_marriage_report_2018.pdf

⁴⁶ UNICEF Shqipëri (2018). Martesa e fëmijës, faqe 45: https://www.unicef.org/albania/media/1031/file/Child_marriage_report_2018.pdf

⁴⁷ Source: US Department of State (USDOS), *Country Report on Human Rights Practices 2018 - Albania*, 13 March 2019 – page 21

⁴⁸ Source: US Department of State (USDOS), *Country Report on Human Rights Practices 2016- Albania*, 3 March 2017 – page 21



amenduar, që mundëson vizitën pa pagesë te mjeku i familjes për të gjithë popullatën rezidente në Shqipëri, përfshirë edhe anëtarë të pakicave romë dhe egjiptiane. Ky shërbim lidhet me vizitën te mjeku i familjes edhe individët e pasiguruar. Në janar 2018, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nisi Programin Kombëtar të Kujdesit Shëndetësor në Komunitet, i cili kryesisht synon sigurimin e kujdesit shëndetësor për pakicat e marginalizuara romë dhe egjiptiane. Përpjekje të mëtejshme janë të nevojshme për të përmirësuar aksesin në shërbime për popullatat në nevojë, përfshirë: gratë; romët dhe pakicat egjiptiane; personat me aftësi të kufizuara; dhe popullatat në zonat rurale ose të thella. Përpjekje të mëtejshme janë të nevojshme për të përmirësuar qasjen në shërbime për popullatën në nevojë, përfshirë romët dhe pakicat egjiptiane.⁴⁹

Anëtarët e pakicave romë dhe egjiptiane vazhdojnë të përballen me pengesa në qasjen në kujdesin shëndetësor mbi baza të barabarta. Ndërsa të dhënat zyrtare për gjendjen e tyre shëndetësore janë ende të paqarta, sipas grupeve të ndryshme të komunitetit, progresi duket të jetë i kufizuar. Kushtet e dobëta të strehimit, niveli i ulët i arsimit dhe njohuri të lidhura me shëndetin, distanca fizike nga qendrat e kujdesit shëndetësor dhe përvojat e diskriminimit përkeqësojnë problemet ekzistuese. Shkalla e vaksinimit midis fëmijëve, shpesh është më e ulët për anëtarët e pakicave romë dhe egjiptiane, në krahasim me popullsinë e përgjithshme. Masa në lidhje me sigurimin e paketave të kujdesit për bebe dhe për nëna, për nënat romë dhe egjiptiane, që lindin në spital u zbatua me shumë sukses, me një rritje të konsiderueshme të numrit të nënave që u arrit nga 1961 në vitin 2016 në 2059 në vitin 2017 dhe 7080 në vitin 2018.⁵⁰

Sidoqoftë, masat e tjera si: i. ndërtimi i qendrave të reja shëndetësore afër vendbanimeve romë dhe egjiptiane të cilëve u mungon qasja në objektet shëndetësore; ii. punësimi i romëve dhe i egjiptianëve të kualifikuar si personel i kujdesit shëndetësor; dhe iii. trajnimi i profesionistëve të

kujdesit shëndetësor për ofrimin e shërbimeve të barabarta për njerëzit në nevojë, përfshirë romët dhe egjiptianët – ishin shumë më pak të suksesshme. Në vitin 2017 vetëm një klinikë (qendër shëndetësore) është ndërtuar afër vendbanimeve romë dhe egjiptiane dhe nuk është bërë ndonjë përparim i mëtejshëm në vitin 2018 gjatë të cilit buxheti i planifikuar prej 25 000€⁵¹ mbeti plotësisht i papërdorur. Dy praktikantë romë dhe egjiptianë u rekrutuan më 2017-ën, por ata nuk arritën të punësohen si personel i kujdesit shëndetësor pas përfundimit të programit të praktikës një vit më pas. Nga 520 profesionistë të kujdesit shëndetësor që duhej të trajnoheshin në vitin 2018, vetëm 56 morën pjesë në të vërtetë në trajnimin për ofrimin e shërbimeve të barabarta për njerëzit në nevojë, përfshirë romët dhe egjiptianët.

Dhënia e kartave të kujdesit shëndetësor për romët dhe egjiptianët, të cilët nuk kanë sigurim shëndetësor është një progres i bërë në fushën e shëndetësisë. Në vitin 2019, 55 947 romë dhe egjiptianë janë pajisur me karta të kujdesit shëndetësor. Sidoqoftë, shqetësimet për qëndrueshmërinë e kësaj mase lindin nga fakti se ajo mbështetet plotësisht me financim të donatorëve.⁵²

Në Shqipëri, situata shëndetësore e pjesëtarëve të pakicave romë dhe egjiptiane dhe jetëgjatësia e tyre priret të jetë përgjithësisht më e ulët krahasuar me popullsinë në shumicë dhe se treguesit e gjendjes shëndetësore të romëve po përkeqësohen krahasuar me treguesit e shëndetit të popullsisë së përgjithshme të vendit. Romët kanë një incidencë më të lartë sëmundshmërie dhe janë më të prekshëm sidomos ndaj sëmundjeve të transmetueshme. Është e gjithëpranuar se qasja në shërbimet shëndetësore të pakicave romë dhe egjiptiane është e shoqëruar me një seri problemesh dhe sfidash. Varfëria, kushtet e vështira të jetesës, pamundësia për të paguar për shërbimet dhe mjekimet, diskriminimi i hapur ose i fshehur, traditat dhe kultura e romëve dhe e egjiptianëve (martesat dhe lindjet e hershme), niveli i ulët arsimor, mungesa e informacionit dhe e njohurive rreth shëndetit riprodhues, shtatzënisë, sëmundjeve

⁴⁹ “Commission Staff working Document: Albania 2019 Report”, European Commission, 29 May, 2019, Page 93,

<https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20190529-albania-report.pdf>

⁵⁰ Romalb.

⁵¹ <https://rm.coe.int/report-on-albania-6th-monitoring-cycle-/16809e8241>

⁵² ECRI REPORT ON ALBANIA (sixth monitoring cycle); <https://rm.coe.int/report-on-albania-6th-monitoring-cycle-/16809e8241>



infektive dhe seksualisht të transmetueshme, ndryshimet e shpeshta të vendbanimeve, punët me risk të madh shëndetësor, kequshqyerja, trajtimi jo i mirë nga ofruesit e kujdesit shëndetësor, mungesa e kapaciteteve të personelit mjekësor etj., përbëjnë shkaqet kryesore të qasjes së vështirë në shërbimet shëndetësore të pakicave romë dhe egjiptiane.

Sipas të dhënave të publikuara në Raportin e Sondazhit Rajonal për Romët, në mesin e romëve, pjesa e nevojave të paplotësuara është përgjithësisht e madhe në 36 për qind. Madhësia e hendekut të mbulimit të sigurimeve shëndetësore është gjithashtu e madhe. Hendeku në përballueshmërinë e kujdesit shëndetësor është më i gjerë në rastin e përballueshmërisë së ilaçeve të nevojshme nga anëtarët e familjes. Shumica e romëve raportojnë se nuk kanë mundësi të blejnë ilaçe⁵³.

Ka boshllëqe në mbulimin e sigurimeve shëndetësore dhe ekziston një lidhje e fortë dhe pozitive midis posedimit të një karte identiteti dhe qasjes në kujdesin shëndetësor. Hendeku i sigurimit shëndetësor është rrjedhojë e një marrëdhënie midis posedimit të një karte identiteti dhe hyrjes në sigurim shëndetësor. Problemi i shpërndarjes së kartave të identitetit shpjegon vetëm një pjesë të këtij hendeku.⁵⁴ Papunësia, angazhimi në punë informale dhe rastësore përfaqëson pjesën tjetër të burimit të kësaj problematike.

Mungesa e ndërmjetësve shëndetësorë është një tjetër pengesë që vështirëson hyrjen e grave romë në institucione dhe qendra që ofrojnë shërbime të shëndetit riprodhues, veçanërisht për ato gra romë që nuk flasin dhe nuk kuptojnë shqip. Ky konstatim nënkupton faktin se një pjesë e popullatës romë vazhdon flet romanisht brenda shtëpisë. Mungesa e njohurive gjuhësore është një nga arsyet e diskriminimit të tyre, sepse për shkak të mungesës së komunikimit në gjuhën shqipe ata humbasin shërbime të kujdesit shëndetësor të ofruara.

Situata e Pandemisë COVID-19 ka sjellë nevojën e sigurimit të ofrimit të shërbimeve të

veçanta të kujdesit shoqëror, duke respektuar distancimin social. Nuk ka kanale informimi në gjuhën romë, në lidhje me masat nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për higjienën personale të anëtarëve të pakicave romë dhe egjiptiane, në mënyrë që të sigurohet që ata janë të vetëdijshëm se si të zbatojnë këto masa. Anëtarë të këtyre dy komuniteteve, vlerësuar nga situata e tyre ekonomike, e kanë të vështirë të blejnë maska dhe dezinfektues të përcaktuara nga protokollet anticovid. Anëtarë të komunitetit janë të painformuar, në lidhje me rregullat e distancimit fizik në qendrat shëndetësore.

Pandemia COVID-19 demonstroi ekspozimin ekstrem të romëve dhe të egjiptianëve të marginalizuar, si ndaj ndikimeve afatshkurtra negative në shëndet ashtu edhe ndaj ndikimeve socioekonomike afatmesme. Shumë komunitete romë vuajtën në mënyrë disproporcionale për shkak të aksesit të tyre të përgjithshëm të kufizuar në infrastrukturën themelore higjienike dhe sanitare, qasjes së kufizuar në ujë të pastër dhe shërbimeve të kujdesit shëndetësor, niveleve të larta të pasigurisë ekonomike, familjeve të mbipopulluara dhe vendbanimeve ose kampeve të veçuara, të mbipopulluara. Ekziston, gjithashtu, një rrezik i qartë që, për shkak të ndikimeve socioekonomike afatmesme të pandemisë, pabarazitë do të rriten më tej. Për shembull, arsimi në distancë dhe digjital, shpesh nuk është i arritshëm dhe/ose i përballueshëm për fëmijët romë të marginalizuar, duke përkeqësuar kështu pabarazitë në arsim. Ky bllokim shkëputi shumë romë që jetojnë në vendbanime të ndara nga çdo burim të ardhurash dhe aktivitet ekonomik (zyrtar ose jozyrtar), duke çuar në rritje të varfërisë⁵⁵.

4.3 Strehimi

Situata e strehimit është ende e vështirë për shumë romë dhe egjiptianë në Shqipëri. Përveç kushteve shpesh shumë të rrënuara, mungesa e përhapur e titujve të pronësisë ose marrëveshje të sigurta të qiramarrjes i bën shumë anëtarë të këtij komuniteti të prekshëm nga dëbimet. Shumë njerëz ngritën banesat e tyre në tokë publike të papërdorur edhe në pronë, pronësia e së cilës mbeti e paqartë pas rënies së komunizmit në fillim të

⁵³ Sondazhi Rajonal për Komunitetin Rom, faqe 52: <https://www.eurasia.undp.org/content/rbec/en/home/library/roma/regional-roma-survey-2017-country-fact-sheets.html>

⁵⁴ Sondazhi Rajonal për Komunitetin Rom, faqe 52: <https://www.eurasia.undp.org/content/rbec/en/home/library/roma/regional-roma-survey-2017-country-fact-sheets.html>

⁵⁵ https://ec.europa.eu/info/files/union-equality-eu-roma-strategic-framework-equality-inclusion-andparticipation_en



viteve 1990. Autoritetet zakonisht toleruan përdorimin e tokës publike nga romët dhe egjiptianët për aq kohë sa parcelat në fjalë nuk ishin caktuar për ndonjë qëllim tjetër, siç janë projektet e infrastrukturës ose shitja e ndërmarrjeve tregtare. Me rritjen e zhvillimit ekonomik në Shqipëri, romët dhe egjiptianët që jetojnë në banesa joformale kanë qenë nën presion për të braktisur vendbanimet e tyre, në disa raste duke u dëbuar shumë herë nga vende të ndryshme pa qasje të lehtë në zgjidhje alternative dhe të përthershme të strehimit. Duke pasur parasysh kërkesën në rritje për strehim social në vend karshi mundësive të pakta për të ofruar këtë shërbim, zakonisht kjo e fundit nuk është një zgjidhje e menjëhershme dhe vetëm një numër i vogël janë përfitues të strehimit social. Sidoqoftë, shumë romë dhe egjiptianë preferojnë ose, madje insistojnë, të qëndrojnë së bashku në grupet e tyre të krijuara, të cilat jo vetëm që përbëjnë një identitet kulturor për ta, por edhe rrjete të rëndësishme mbështetëse për të përballuar më mirë varfërinë dhe efektet e marginalizimit shoqëror⁵⁶.

ECRI-ja vëren se në fillim të vitit 2019, grupi i parashikuar i punës brenda ish-Ministrit të Zhvillimit Urban dhe Territorit, përgjegjës për të ndihmuar romët dhe egjiptianët në procedurat administrative të kërkuara për legalizimin e ndërtesave ende nuk ishte ngritur. Për shkak të natyrës shumë burokratike të procesit të legalizimit nga njëra anë dhe situatës së vështirë socioekonomike dhe arsimore të shumë romëve dhe egjiptianëve (si dhe një sistemi të ndihmës juridike ende joefektive) nga ana tjetër, krijimi i një grupi të tillë pune mund të jetë një hap shumë i dobishëm drejt zgjidhjes së çështjeve të pazgjidhura të legalizimit. Prandaj ECRI-ja inkurajon fuqimisht autoritetet që më në fund të krijojnë një grup të tillë pune.

Në anën pozitive, një ligj i ri për strehimin shoqëror u miratua nga parlamenti shqiptar në maj 2018. Ndër të tjera, ligji ndalon dëbimin me forcë të individëve/familjeve nga vendbanimi i tyre. Në rast se qëndrimi në një vendbanim ose strehim është i pamundur, për shkak të investimeve me interes publik, ligji përcakton qartë procedurat për kryerjen e zhvendosjes, të cilat janë në përputhje me udhëzimet e Kombeve të Bashkuara. VKM-ja e

miratuar në këtë kuadër, është universale për të gjitha familjet e prekura nga zhvendosja, pavarësisht nga fakti nëse gëzojnë ose jo titull pronësie mbi banesën.

Gjithashtu, ligji parashikon që deri në 2 vjet, pas hyrjes së tij në fuqi, jo më pak se 5% e përfituesve nga programet e strehimit, të jenë nga pakicat romë dhe egjiptiane. Sidoqoftë, legjislacioni dytësor përkatës ende ka nevojë të miratohet në tërësi. Për më tepër, shumë vëzhgues tregojnë, se, në mënyrë që ligji për strehimin social të jetë efektiv, burimet e nevojshme buxhetore për programet e strehimit social duhet të rriten ndjeshëm, veçanërisht për të mbështetur Bashkitë. Sa i përket programit të përmirësimit të banesave ekzistuese dhe programit të rikonstuksionit të godinave ekzistuese në pronësi të NJVV, të cilat i shtohen fondit publik të banesave sociale, në vitin 2018 u shpallën fituese 22 projekte, të cilat targetonin 436 familje romë dhe egjiptiane. (508 në vitin 2017).

Pavarësisht, të metat e përgjithshme në fushën e strehimit mbeten të adresuara në mënyrë të pamjaftueshme dhe rastet e përmendura më poshtë thjesht ilustrojnë disa nga problemet.

Sipas të dhënave të Sondazhit Rajonal për pakicat Rome⁵⁷, 84% e komunitetit rom kanë akses në elektricitet dhe 50% e anëtarëve të komunitetit rom kanë akses në ujë dhe pijshëm në banesat e tyre krahasuar me shifrën 89% që i takon pjesës jorome.

Rreth 356 familje (afërsisht 1.541 persona) nga pakicat romë dhe egjiptiane u prekën nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019⁵⁸. Pas kësaj fatkeqësie, të dyja këto pakica janë të ekspozuar ndaj shumë dobësive të lidhura me të drejtat dhe shërbimet themelore, të tilla si hyrja në tregun e punës, kujdesi shëndetësor, arsim, strehim etj. Pasojat negative të tërmetit dhe mungesës së strehimit ka shumë të ngjarë të rritin vështirësitë për gratë, pasi ato do të detyrohen të ushtrojnë më shumë rolet dhe aktivitetet e tyre tradicionale si, kujdesi për fëmijët dhe të moshuarit, kujdesi për anëtarët e familjes me aftësi të kufizuara ose dhe të sëmurë.

⁵⁷ Sondazhi Rajonal për Komunitetin Rom: https://www.eurasia.undp.org/content/rbec/en/home/library/_roma/regional-roma-survey-2017-country-fact-sheets.html

⁵⁸ Albania Post-Disaster Needs assessment report – February 2020.

⁵⁶ <https://rm.coe.int/report-on-albania-6th-monitoring-cycle-/16809e8241>



Asistencë teknike i është dhënë qeverisë lokale për hartografin e vendbanimeve joformale rome dhe egjiptiane, të cilat nuk bien ndesh me planet rregulluese, përfshirë llogaritjen e kostove të nevojshme për urbanizimin. Kjo masë është përfunduar në vitin 2016, në kuadër të zbatimit të Planit të Veprimit për Strehimin Social 2016–2020⁵⁹.

Gjatë periudhës 2016–2020, 415 familje rome dhe egjiptiane kanë përfituar nga shërbime shtesë në rast të paafësisë për të paguar detyrime financiare brenda një programi strehimi. Këto kanë qenë familje që nuk ishin në gjendje të paguanin qiranë e banesave sociale dhe ato që kishin të drejtë të merrnin kredi. Përfitimet përfshinë, negocimin e planeve të pagesave, referimin në punësim dhe shërbime të tjera përkatëse etj.⁶⁰

Gjatë viteve 2016–2019, 1,460 familje rome dhe egjiptiane, ishin përfituese në drejtim të përmirësimit të infrastrukturës, ujësjellësit dhe kanalizimeve, pajisjeve hidrosanitare ose ndërtimeve të reja, përmes granteve të vogla për bashkitë.⁶¹

Bazuar në të dhënat e raportuara nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, 106 familje të pakicave rome dhe egjiptiane në 16 bashki (ose 19.7% e totalit të familjeve të mbështetura) kanë përfituar strehim me ndihmë të buxhetit të shtetit për vitin 2019 nëpërmjet subvencionimit të qirasë në treg.

Figura 1. Bashkitë në të cilën është ofruar mbështetja e familjeve rome dhe egjiptiane nëpërmjet subvencionimit të qirasë në treg për vitin 2019

Nr.	Bashkia	Romë	Egjiptian
1	Klos		3
2	Tropojë	4	
3	Kamzë	1	
4	Cërrik		3
5	Tepelenë		7
6	Durrës	4	13
7	Belsh	1	
8	Gramsh		
9	Vlorë		14
10	Has		
11	Elbasan	17	
12	Lezhë	7	3
13	Lushnjë		5
14	Berat		
15	Devoll	11	
16	Librazhd		13
	Total	45	61
		8.3% e totalit të familjeve të mbështetura	11.4% e totalit të familjeve të mbështetura

⁵⁹ Raporti i Monitorimit të Planit të Veprimit për përfshirjen e Romëve dhe Egjiptianëve – 2019 – Masa 1.3, Strehimi.

⁶⁰ Raporti i Monitorimit të Planit të Veprimit për përfshirjen e Romëve dhe Egjiptianëve – 2019 – Masa 2.1, Strehimi.

⁶¹ Raporti i Monitorimit të Planit të Veprimit për përfshirjen e Romëve dhe Egjiptianëve – 2019 – Masa 2.5, Strehimi.



Sa i përket programit të përmirësimit të banesave ekzistuese dhe programit të rikonstruksionit të godinave ekzistuese në pronësi të NJVV-së, të cilat i shtohen fondit publik të banesave sociale, në vitin 2019 u shpallën fituese 15 projekte, të cilat targetonin 255 familje rome dhe egjiptiane.

4.4 Arsimi dhe nxitja e dialogut ndërkulturor

Fëmijët romë dhe egjiptianë kanë përqindje relativisht të ulëta të regjistrimit në shkollë, analfabetizmit dhe përfundimit të shkollës krahasuar me mesataren kombëtare, ndonëse së fundmi ka pasur një progres thuajse eksponencial. Megjithatë, rritja e nivelit të regjistrimit dhe e përfundimit të romëve në arsimin bazë në 90 për qind dhe shkalla e regjistrimit dhe të përfundimit të romëve në arsimin e mesëm të lartë në 50 për qind, mbetet një sfidë në Ballkanin Perëndimor⁶².

Nxënësit e pakicave rome dhe egjiptiane kanë mundësi të pajisjen me tekste shkollore në përdorim falas, që nga arsimi bazë deri në përfundim të arsimit të mesëm të lartë, në zbatim të vendimit nr. 486, datë 17.6.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për shtypjen, botimin, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit të arsimit parauniversitar”, të ndryshuar. Procesi i shtypjes, botimit, shpërndarjes dhe shitjes së teksteve shkollore të arsimit parauniversitar bëhet nga shtëpitë botuese. Shtëpitë botuese, të cilat marrin përsipër ta kryejnë këtë proces, paraqesin tekstet, për miratim, në bazë të kriterëve e të procedurave të parashikuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për arsimin. Shpenzimet për tekstet shkollore të dërguara në institucionin arsimor ose zyrën vendore të arsimit parauniversitar, për të konkurruar në përzgjedhjen e tyre, përballohen nga shtëpia botuese. Tekstet shkollore shpërndahen/shiten në mjediset shkollore. Drejtoritë e institucioneve arsimore ofrojnë një ose dy mjedise shkollore, që përdoren nga të gjitha shtëpitë botuese, që lëvrojnë tekste në institucionin arsimor në fjalë.

Sipas të dhënave të raportit të ECRI-t 2020⁶³, problematike mbetet situata e arsimit gjithëpërfshirës ku masat e marra kundër bullizmit dhe ekstremizmit në shkolla deri më tani kanë konsistuar vetëm në masa të përgjithshme të ndërgjegjësimit kundër bullizmit, të cilat nuk përmbajnë module që mbulojnë grupet veçanërisht të cenueshme, siç janë fëmijët romë dhe egjiptianë apo grupet LGBTI. Kjo shfaq një sfidë madhore në dialogun ndërkulturor dhe integrimin.

Megjithatë, aktualisht 14379 djem dhe vajza romë dhe egjiptianë u regjistruan dhe morën pjesë në arsimin parashkollor dhe arsimin e detyrueshëm gjatë vitit 2019. Të dhënat tregojnë se 6767 ishin femra dhe 7612 ishin meshkuj; 4469 ishin romë dhe 9910 ishin egjiptianë; 11196 banonin në zona urbane dhe 3183 banonin në ato rurale. Objektivi i vitit 2019 ishte 4993 fëmijë dhe performanca ndaj objektivit është 287 për qind.⁶⁴ Ky është një rezultat pozitiv, ndonëse hendeuku mbetet i gjerë mes popullsisë rome dhe egjiptiane dhe jorome. Komisioni Evropian shquan si problematike pabarazitë në arsim midis romëve dhe joromëve, të cilat shfaqen që në fillim të jetës me një regjistrim të ulët në arsimin parashkollor (moshat 3–5 vjeç) në Ballkanin Perëndimor. Në Shqipëri, ky hendeuk arrin në 31%. Në mënyrë të ngjashme, në arsimin e detyrueshëm, hendeuku midis romëve dhe joromëve në Shqipëri arrin në 31% me 66% të fëmijëve romë të regjistruar. Përparimet në krahasim me vitin 2011 janë të jashtëzakonshme, megjithëse akoma më shumë përmirësime janë të nevojshme për t’iu përgjigjur vendit dhe mesatareve të BE.⁶⁵

⁶³ Raporti i Gjashtë i ECRI-t për Shqipërinë, 2020: <https://rm.coe.int/report-on-albania-6th-monitoring-cycle-translation-in-albanian-/16809e8240>

⁶⁴ Report on the Implementation of Roma Integration Public Policy in Albania For 2019: www.romalb.org

⁶⁵ Report on the Implementation of National Roma Integration Strategies, 2019: <https://op.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/4ff1ac7f-3749-11ea-ba6e-01aa75ed71a1/language-en>

⁶² Regional Cooperation Council. *Declaration Of Western Balkans Partners On Roma Integration Within The Eu Enlargement Process*. 5 July 2019, Poznan: <https://www.rcc.int/docs/464/orhan-usein-while-one-out-of-four-young-people-in-the-region-is-in-limbo-this-is-true-for-three-out-of-four-roma>




Figura 2. Frekuentimi i arsimit parashkollor dhe të detyrueshëm për nxënësit romë dhe egjiptianë 2019

Regjistrimi i fëmijëve romë dhe egjiptianë në shkolla varet në mënyrë të ndjeshme nga të ardhurat, mirëpo heqja e tarifave të regjistrimit nuk ka qenë në nivel të kënaqshëm, duke ndikuar drejtpërdrejt frekuentimin e kopshteve dhe të shkollave. Vetëm 745 fëmijë romë dhe egjiptianë u përjashtuan nga tarifat në arsimin parashkollor gjatë vitit 2019, shifër kjo shumë e ulët krahasuar me pritshmëritë⁶⁶. Përpos rritjes së ndjeshme të numrit të regjistrimeve të fëmijëve romë dhe egjiptianë në shkolla në periudhën 2011–2017 dhe zvogëlimit të hendeikut me 12% krahasuar me fëmijët joromë, përsëri numrat janë të ulët dhe Shqipëria pozicionohet ulët krahasuar me shumicën e vendeve të Ballkanit Perëndimor⁶⁷.

Edhe transporti mbetet një sfidë për ndjekjen e shkollës, sidomos në familjet rome dhe egjiptiane që jetojnë në periferi dhe ku mjediset edukuese janë mbi 2 km larg. P.sh., 336 fëmijët romë dhe egjiptianë përfituan nga transporti shkollor falas

gjatë vitit 2019, një target ky i arritur vetëm në masën 2.2%⁶⁸.

Gjithashtu, një numër i madh nxënësish romë braktisin arsimin e detyruar jo vetëm si rezultat i qëndrimeve diskriminuese, mungesës së mbështetjes dhe të ngacmimeve në shkollë, por edhe për shkak të nevojës për të ndihmuar prindërit e tyre në aktivitete që gjenerojnë të ardhura⁶⁹. Duke konsideruar këto barrierë shumica e prindërve romë që përballen me përjashtimin social besojnë se vajza e tyre do të jetë më e mbrojtur nëse e braktis shkollën në vitet e para të adoleshencës dhe të përgatitet për të krijuar familjen e saj⁷⁰, se sa të mbetet pas me mësim, të trajtohet me inferioritet nga bashkëmoshatarët e saj joromë mbi të gjitha të nisë një sjellje jo të hijshme. Sipas studimit të kryer nga Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA), bashkitë më të prekura nga braktisja e arsimit të detyrueshëm janë Tërana, Korça, Elbasani, Fieri, Durrësi dhe Berati⁷¹.

Fëmijët romë dhe egjiptianë ndeshin vështirësi edhe si pasojë e nivelit arsimor të prindërve të tyre të cilët nuk e shikojnë arsimin si parësi. Edhe

⁶⁶ Report on the Implementation of Roma Integration Public Policy in Albania For 2019: www.romalb.org

⁶⁷ Në vitin 2017, PNUD-i dhe Banka Botërore, me mbështetjen e Komisionit Evropian, realizoi Anketën Rajonale mbi Pozicionin Social-Ekonomik të Romëve në Ballkanin Perëndimor. Sondazhi kontribuoi në plotësimin e boshllëkut të disponueshmërisë së të dhënave të nevojshme për të monitoruar dhe për të informuar politikat socioekonomike për përfshirjen e romëve (dhe egjiptianëve, ku këta të fundit janë trupëzuar nën emërtimin “rom”). Për materialin e plotë shiko: Regional Roma Survey 2017 <https://www.eurasia.undp.org/content/rbec/en/home/library.html>

⁶⁸ www.romalb.org – Romalb është sistemi elektronik për monitorimin e progresit të masave për përfshirjen e romëve dhe të egjiptianëve.

⁶⁹ Sipas studimit të OSFA-së, 4% e fëmijëve të moshës 6–17 vjeç janë të angazhuar në punë të ndryshme.

⁷⁰ Sipas anketës social-ekonomike të vitit 2011, 31% e vajzave rome dhe 13,6% e vajzave egjiptiane midis moshës 13 dhe 17 vjeç ishin të martuara.

⁷¹ OSFA, *Censusi për banesat dhe popullatën rome në Shqipëri*, prill 2014, www.osfa.al/sites/default/files/roma_census_albanian.pdf



sistemi i edukimit bazë me kohë të pjesshme në ndihmesë të të rriturve mbi moshën 16 vjeç nuk ka rezultuar produktiv. Në vitin 2019, niveli i interesimit ka qenë vetëm 6% krahasuar me objektivin.

Lidhur me studime e arsimit të lartë, të dhënat janë shumë të kufizuara. Sistemi Romalb ka mungesë në databazë, mirëpo Fondi i Edukimit për Romët (REF) shpalos disa të dhëna interesante për vitin akademik 2019–2020 (i cili ishte edhe vit problematik, për shkak të pandemisë COVID-19). Bazuar në sistemin e bursave të “Roma Memorial University Scholarship Program”⁷², në vitin akademik 2019–2020 ka pasur 43 aplikime, nga të cilat 33 të vlefshme dhe ku 19 prej tyre kanë përfutur bursë. Interesant është fakti i brezit të parë të të diplomuarve përfutur të kësaj burse: nga 11 vende përfutuese të programit RMUSP, romët nga Shqipëria janë diplomuar të gjithë (100%), ku mesatarja e % së suksesit e vendeve përfutuese të programit ishte 82%.⁷³ Megjithatë, sipas raportit të Komisionit Evropian të 2019-ës, hendeku në përfundimin e arsimit terciar u rrit në mënyrë të konsiderueshme në Shqipëri, pasi shkalla e romëve që përfunduan arsimin terciar mbeti rreth 1%, si më 2011 ashtu edhe më 2017⁷⁴.

Për sa i përket AP-së (arsimit profesional), numri i nxënësve romë dhe egjiptianë ka ardhur në rritje si rezultat i promovimit të programeve të AFP-së dhe mbështetjes me bursa të plota, në një nivel që mbulon kostot e jetesës, tarifat e shkollimit dhe librat shkollorë⁷⁵ për këto kategori. Të dhënat tregojnë se, 333 nxënës romë dhe egjiptianë kanë ndjekur arsimin profesional gjatë vitit akademik shkollor 2015–2016. Ndërkohë që gjatë vitit

akademik 2020–2021, janë 674 nxënës që frekuentojnë arsimin profesional.

Promovimi i dialogut ndërkulturor

Promovimi dhe njohja e identitetit rom dhe egjiptian si pjesë përbërëse e trashëgimisë kulturore shqiptare has vështirësi të natyrave të ndryshme. P.sh., punësimi i ulët i romëve dhe i egjiptianëve pranë Ministrisë së Kulturës; mospërktimi dhe botimi i letërsisë romë/egjiptiane në gjuhën shqipe dhe anasjelltas; mospërfshirja e historisë romë dhe egjiptiane, artizanatit dhe identitetit në udhëzuesit e turizmit dhe prodhimi i broshurave për të dyja këto komunitete në Shqipëri. Me miratimin më 13 tetor 2017 të ligjit për “Mbrotjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë” nga Parlamenti Shqiptar, romët dhe egjiptianët janë njohur zyrtarisht si një pakicë kombëtare. Ligji i ri midis të tjerave, krijon detyrime për qeverinë shqiptare të sigurojnë pjesëmarrjen e pakicave kombëtare në jetën publike, kulturore, si dhe mbështetjen financiare nga institucionet, me qëllim promovimin, ruajtjen dhe mbrotjen e traditave, identitetit kulturor, etnik dhe gjuhësor të tyre. Në këtë kuadër është risi miratimi i fondit për pakicat kombëtare, megjithëse akoma nuk ka marr zbatim në praktikë⁷⁶.

Për sa i përket promovimit të dialogut ndërkulturor në shkolla ka nevojë për përmirësime të mëtejshme. Shikohet një regres nga viti 2015 deri më sot lidhur me trajnimet për mësuesit në të gjitha nivelet e arsimit me materiale për menaxhimin e klasave multikulturore, bashkëpunimin me prindërit me prejardhje të ndryshme kulturore dhe socioekonomike, promovimin e tolerancës, ndërveprimin kulturor dhe barazisë. Sfidë mbetet edhe rishikimi i programeve mësimore të arsimit të detyrueshëm dhe të mesëm të lartë dhe librave shkollorë për të pasqyruar tolerancën dhe ndërkulturën, si edhe shtimi i materialeve për identitetin rom dhe egjiptian. Të dhëna ka vetëm për vitin 2018, ku 12 tekste janë rishikuar në këtë kuadër⁷⁷.

4.5 Punësimi dhe formimi profesional

Deklarata e Partnerëve të Ballkanit Perëndimor për integrimin e romëve, në kuadër të procesit të

⁷² RMUSP-ja është skema më e madhe e bursave terciare e REF, e krijuar për të lehtësuar qasje në arsimin terciar dhe për të mundësuar një numër më të madh të romëve për të hyrë në tregun e punës si profesionistë kryesor. Studentët marrin 800 € ndihmë për vitin akademik për të mbuluar shpenzimet themelore të studimit dhe të jetesës, si dhe deri në 1,200 € për të mbuluar tarifat e shkollimit, nëse aplikohet.

⁷³ Roma Education Fund Annual Report 2019: <https://www.romaeducationfund.org/>

⁷⁴ Report on the Implementation of National Roma Integration Strategies, 2019: <https://op.europa.eu/en/publication-detail/-/publication/4ff1ac7f-3749-11ea-ba6e-01aa75ed71a1/language-en>

⁷⁵ Report on the Implementation of Roma Integration Public Policy in Albania For 2019: www.romalb.org

⁷⁶ Ligji nr 96/2017, “Për mbrotjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”.

⁷⁷ Report on the Implementation of Roma Integration Public Policy in Albania For 2019 www.romalb.org



zgjerimit të Bashkimit Evropian (Deklarata e Poznanit) 2019, kërkon që rritja e shkallës së punësimit të romëve në sektorin publik të kryhet në shkallën proporcionale të pjesëmarrjes së romëve në raport me popullatën e përgjithshme dhe rritja e nivelit të punësimit midis romëve duhet të jetë të paktën 25 për qind⁷⁸. Kjo deklaratë tregon se Ballkani Perëndimor ndodhet përballë sfidash punësimi për romët dhe egjiptianët. Për Shqipërinë kjo sfidë mbetet edhe më e madhe duke konsideruar të ardhurat për frymë dhe zhvillimin ekonomik. Nga ana tjetër, varfëria dhe rëndësia e sigurimit të nevojave bazë ul ndjeshëm interesin e romëve dhe të egjiptianëve për të përfunduar FP-në (formimin profesional) dhe programet e nxitjes së punësimit, si dhe i detyron ata të gjejnë zgjidhje alternative që shpesh janë informale. Sektorët informalë, si p.sh. mbledhja individuale e mbetjeve të riciklueshme, tregtimi i mallrave të përdorura apo veprimtari të tjera që nuk kërkojnë trajnim të specializuar, gjenerojnë të ardhura më të larta krahasuar me pagën mujore minimale në sektorët formalë. Gjithashtu, kultura e varfërisë dhe e përjashtimit, mungesa e besimit të programet ekzistuese të punësimit, përvojat negative në të kaluarën etj., bëjnë që pjesa më e madhe e romëve dhe e egjiptianëve, që punojnë në sektorin informal detyrohen të vazhdojnë të mbeten aty (duke pranuar pasiguritë e tregut informal të punës) dhe nuk parapëlqejnë të përfshihen në programet e nxitjes së punësimit.

Situata aktuale e punësimit, sidomos me impaktin e pandemisë COVID-19, nuk dihet saktësisht për arsye, sepse mungojnë të dhëna të përditësuara. Projektionet që janë kryer nga viti 2017 deri në arritjen e integritimit në BE (supozivisht 2029) janë tejet optimiste, duke shpalosur një panoramë të rritjes sistematike të punësimit të romëve dhe të egjiptianëve (ndonëse thuhet me të njëjtin hendek krahasuar me joromë), si edhe rënie të punës së pa deklaruar⁷⁹. Nga të

dhëna të vitit 2017, ekziston një hendek midis romëve të marginalizuar dhe fqinjëve joromë për sa u përket aftësive njerëzore dhe mirëqenies materiale⁸⁰. Hendeku është veçanërisht i madh për të rinjtë – vetëm 22 për qind e romëve të marginalizuar të moshës 18–24 vjeç janë në punësim, arsim ose trajnim krahasuar me 58 për qind të fqinjëve joromë. Kjo ka implikime gjatë gjithë jetës, duke bllokuar mundësitë e mëtejshme për punësim të mirë. Vetëm 18 për qind e romëve të moshës 15–64 vjeç janë të punësuar në krahasim me 27 për qind të fqinjëve joromë.⁸¹

Asnjë vend tjetër në Ballkanin Perëndimor, në periudhën 2011–2017, nuk pësoi një rënie kaq të madhe në shkallën e punësimit të romëve të marginalizuar. Shkalla e punësimit ra si për romët meshkuj ashtu edhe për femrat e marginalizuar; por se rënia ishte më e madhe për femrat, hendeu gjinor brenda këtij grupi u ul me 20 pikë përqindje (nga 35 pikë përqindje në 2011 në 15 pikë përqindje në 2017). Për dallim nga shumica e vendeve të Ballkanit Perëndimor, romët kanë më pak të ngjarë të marrin pjesë në tregun e punës. Pjesëmarrja në forcën e punës është veçanërisht e ulët mes grave romë të marginalizuara (29 për qind në 2017). Shqipëria shfaq nivelet më të larta të papunësisë në rajon. Papunësia prek romët ekonomikisht aktivë, gratë më shumë se sa homologët e tyre meshkuj. Veçanërisht, në vitin 2017, shkalla e papunësisë për femrat romë të marginalizuara ishte 62 për qind, kundrejt 51 për qind për meshkujt.⁸²

Romët që arrijnë të gjejnë punë merren kryesisht me tregti të vogël të dorës së dytë dhe mbledhjen e mbetjeve të riciklueshme, ndërsa popullsia egjiptiane është më tepër e përfshirë në

[2020/docs/101/roma-integration-roadmap-albania-2019-2021](https://www.eurasia.undp.org/content/rbec/en/home/library.html)

⁸⁰ Regional Roma Survey 2017

<https://www.eurasia.undp.org/content/rbec/en/home/library.html>; Banka Botërore

<https://www.worldbank.org/en/news/press-release/2018/05/17/marginalized-roma-community-still-most-excluded-in-albania>

⁸¹ Balkan Investigative Reporting Network (Prill, 2020), *Roma: Europe's Neglected Coronavirus Victims*. Përgatitur nga Stephan Müller, Fikrija Tair, Bashkim Ibishi and Dragan Gracanin. <https://balkaninsight.com/2020/04/01/roma-europes-neglected-coronavirus-victims/>

⁸² Roma at a Glance: Albania, April 2018, UNDP-World Bank-European Commission.

⁷⁸ Regional Cooperation Council. Declaration Of Western Balkans Partners On Roma Integration Within The Eu Enlargement Process. 5 July 2019, Poznan. <https://www.rcc.int/docs/464/orhan-usein-while-one-out-of-four-young-people-in-the-region-is-in-limbo-this-is-true-for-three-out-of-four-roma>

⁷⁹ OSFA (2019). *Udhërrëfyesi për Integrimin e Romëve 2019–2021 për Shqipërinë*. <https://www.rcc.int/romaintegration>



sektorin e shërbimeve, të kujdesit familjar dhe të ndërtimit⁸³. Punësimi formal bazohet kryesisht në bujqësinë me të cilën sigurohen nevojat bazë (për komunitetet që banojnë në zonat rurale), e cila karakterizohet nga parcela të vogla toke, mungesa e infrastrukturës dhe e sistemit ujitës, si dhe nga kostot e larta të mirëmbajtjes⁸⁴. Megjithatë, ai numër i madh romësh dhe egjiptianësh që punojnë si mbledhës të mbetjeve të riciklueshme, ndonjëherë në burim (p.sh. në restorante), por shpesh edhe nëpër kazanët e plehrave dhe në zonat e grumbullimit të mbetjeve, tashmë është nën kërcënimin e dy faktorëve kryesorë: a) Me privatizimin e landfilleve, shumë prej tyre do të mbeten pa burimin e vetëm të jetesës, nëse nuk gjenden mekanizma për përfshirjen formale të tyre në mbledhjen e privatizuar të mbetjeve dhe në sistemet e klasifikimit të tyre; b) Pandemia COVID-19 dhe sidomos izolimi është një kërcënim akoma më i madh për romët dhe egjiptianët të cilët nuk e kanë mundësinë e punës në distancë.

Romët dhe egjiptianët përballen, gjithashtu, me barriera të fshehta në punësim, duke përfshirë distancën nga puna apo shkolla, diskriminimin dhe stigmatizimin e të qenët romë dhe egjiptianë, shpeshësinë e migrimit, mungesën e kartave të identitetit dhe të dokumenteve të tjera personale dhe administrative, mungesën e informacionit mbi ekzistencën e programeve të punësimit etj.⁸⁵ Duke mos pasur informacionin e mjaftueshëm rreth avantazheve të regjistrimit si të papunë, shumë romë nuk kanë akses në masat e marra për arsimin dhe formimin profesional dhe në masat e tregut aktiv të punës. Pjesa më e madhe e zyrave të punës dhe e qendrave FP nuk kanë asnjë të punësuar me origjinë romë ose egjiptiane, gjë që sjell keqkuptime mes administratës dhe komuniteteve dhe ndonjëherë edhe qëndrime diskriminuese gjatë ofrimit të shërbimit. Ndërsa trajnimet profesionale dhe programet aktive të punësimit u ofrohen punëkërkuesve të regjistruar si të papunë, shumica

e romëve nuk janë regjistruar⁸⁶ dhe prandaj mbeten jashtë mundësive të programeve të tilla. Për më tepër, kërkesat minimale arsimore për të marrë pjesë në aktivitete të tilla trajnimi shpesh janë shumë të larta, duke pasur parasysh rezultatet e ulëta arsimore të shumë romëve dhe egjiptianëve⁸⁷.

Lidhur me vlerësimin e ndikimit të mundshëm të përjashtimit nga taksat për sipërmarrësit romë dhe egjiptianë/të vetëpunësuar, që po kalojnë në tregun e punës nga papunësia afatgjatë, mirëqenia sociale, lypja dhe puna informale, si dhe ata që jetojnë në kushte joadekuate (p.sh. në vendbanimet informale, në banesat sociale, por që rrezikojnë debimin për shkak të pamundësisë për të paguar qiranë), Ministria e Ekonomisë dhe Financës si organ implementues nuk disponon të dhëna përditësuese. Kjo situatë vështirëson dhe shkurajon veprimtaritë sipërmarrëse të këtyre komuniteteve. Gjithashtu, sipërmarrësit romë dhe egjiptianë në fushën e bujqësisë nuk zotërojnë informacion të mjaftueshëm lidhur me grantet e mundshme nga agjencitë qeveritare.

Gjithashtu, për rritjen e punësimit të romëve dhe të egjiptianëve është konsideruar me vlerë prania e ndërmjetësuesve të punësimit të cilët shërbejnë si një urë informuese dhe facilituese midis komuniteteve dhe programeve të punësimit⁸⁸. Lidhur me këtë, një praktikë pozitive është ajo e pilotuar nga UNDP-ja përgjatë viteve 2016–2019, ku në bashkëpunim me Shërbimin Kombëtar të Punësimit u mbështet punësimi i mediatorëve romë dhe egjiptianë pranë zyrave të punës në katër bashki⁸⁹ në vend. Evidencat tregojnë që mediatorët e punësimit luajtën një rol deciziv në funksion të përmirësimit të aksesit, eficiencës dhe impaktit të programeve PNP kundrejt pakicave romë dhe egjiptiane⁹⁰.

Duke pasur parasysh nevojat e veçanta individuale dhe familjare, mungesën e një rrjeti social mbështetës, botën artistike dhe shpirtërore të

⁸³ Mbrojtësit e të Drejtave Civile 2018: 11.

⁸⁴ PNUD, *Vlerësimi i nevojave të individëve romë dhe egjiptianë për punësimin dhe sipërmarrjen në rrethin e Korçës*, Beratit dhe Vlorës, i përgatitur nga Krisela Hackaj, f. 29.

⁸⁵ PNUD, *Vlerësimi i nevojave të individëve romë dhe egjiptianë për punësimin dhe sipërmarrjen në rrethin e Korçës*, Beratit dhe Vlorës, i përgatitur nga Krisela Hackaj, f. 21.

Faqe | 16740

⁸⁶ Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare (FCNM) 2019: §§ 155–156.

⁸⁷ Raporti i Gjashtë i ECRI-t për Shqipërinë, 2020: <https://rm.coe.int/report-on-albania-6th-monitoring-cycle-translation-in-albanian-/16809e8240>

⁸⁸ UNDP, Inception Report - Economic and Social Empowerment for Roma and Egyptians - a booster for social inclusion (ESERE) project January - August 2016.

⁸⁹ Bashkitë: Tiranë, Durrës, Berat dhe Shkodër.

⁹⁰ www.romalb.org



romëve dhe të egjiptianëve, shumë organizata burokratike, të paktën në fazat e para të integritimit në treg dhe shoqëri, nuk i përshtaten mirë nevojave, karakterit, kulturës dhe mënyrës së jetesës së tyre, pavarësisht nga aftësitë teknike të zotëruara. Organizatat me strukturë organike dhe orë fleksibël pune që theksojnë lirinë dhe performancën (por jo shumë burokracinë), mund të jenë një zgjidhje e mirë për këto komunitete (sidomos atë rom), të cilat ndeshin vështirësi në përshtatjen me punën me turne fikse 8-orëshe.⁹¹ Një sfidë e ngjashme që lidhet me vendin e punës pas punësimit të romëve dhe të egjiptianëve është edhe përgatitja e materialeve informuese për mbrojtjen nga diskriminimi etnik në vendin e punës, promovimi i shembujve të suksesshëm të diversitetit kulturor dhe gjithëpërfshirjes. Përpos materialeve, janë me rëndësi edhe trajnimet, *workshop*-et dhe seksionet mbështetëse.

Përmbledhje e sfidave dhe rekomandimeve: Sipas të dhënave zyrtare nga Agjencia Kombëtare e Punësimit, në vitin 2018 vetëm 239 romë dhe egjiptianë nga 5,845 kërkues të regjistruar të romëve ishin të punësuar. Jo të gjithë romët mbeten të punësuar dhe disa nga arsyet e braktisjes së tyre nga vendet e punës janë diskriminimi dhe kushtet e rënda të punës.

Gjithashtu, sipas zyrës së punës, në tetëmujorin e vitit 2020 në zyrat e punësimit 8072 ose 9% e totalit të punëkërkuesve të papunë ishin romë (88,468). Ata janë të regjistruar kryesisht në zyrat e punësimit të qarqeve në Tiranë, Elbasan, Korçë, Fier dhe Berat. Vështirësitë për integrimin në tregun e punës janë moshë, arsimimi mungesa e një profesioni.

Figura 3. Struktura e punëkërkuesëve të papunë (pu.pa-ve) të kategorisë romë dhe egjiptianë të regjistruar në ZP

Pu.pa/romë	2018	2019	8-mujori 2020
Pu.pa të regjistruar në ZP	2,442	2,646	3723
në % ndaj totalit të pu.pa-ve të regjistruar	3.70%	4%	4%

Pu.pa/egjiptianë	2018	2019	8-mujori 2020
Pu.pa të regjistruar në ZP	3,063	3,505	4349
në % ndaj totalit të pu.pa-ve të regjistruar	4.7%	5%	5%

⁹¹ Hysa, X., & Titka, M. (2017). ESERE Behavioral Change Model Changing Attitudes and Behaviors of Public Servants with Regards to Roma and Egyptians' Access to Public Services. Tirana / Albania: UNDP, pp. 16. <http://www.al.undp.org/content/dam/albania/docs/ESE/RE%20Behavioural%20Change%20Model.pdf>



Punëkërkuessit e papunë të regjistruar nga këto kategori janë të një moshe relativisht të re, rreth 60%, 15–44 vjeç. Pjesa më problematike e kësaj kategorie është arsimit. Rreth 67% e romëve dhe 45% e egjiptianëve janë pa arsim ose me arsim bazë, çka e bën të pamundur punësimin dhe dërgimin në formim profesional të këtyre pu.pa-ve, si dhe në kurset e aftësive bazë (*Soft skills*), të cilat i parapërgatitin këto targete për t'i përfshirë më pas në programet aktive të punësimit.

Mungesa e arsimit reflektohet edhe në aftësitë e këtyre punëkërkuessve. Rreth 90% e romëve dhe 78% e egjiptianëve kategorizohen pa profesion dhe me profesione tepër elementare.

Në thelb, kërkohet një përpjekje më e fortë për të promovuar sipërmarrjen sociale dhe vetëpunësimin e romëve dhe të egjiptianëve përmes: financimit të mjaftueshëm, legjislacionit dhe programeve të duhura; studimit të ndikimit të mundshëm të përjashtimeve nga taksat për transferimin e romëve dhe të egjiptianëve nga papunësia; studimit të ndikimit të mundshëm të koncesioneve për mbledhësit e mbeturinave të mbetjeve të riciklueshme; granteve për fermerët romë; angazhimit të romëve dhe të egjiptianëve në shërbimet publike. Masat e lartpërmendura do të shërbenin, gjithashtu, për të trajtuar punën joformale të romëve.

4.6 Përkujdesja sociale

Mbrojtja sociale luan një rol të rëndësishëm për të mos lejuar që individë dhe familjet romë dhe egjiptiane të bien dhe të mbeten në varfëri, por, gjithashtu, nxit kohezionin social dhe integrimin e këtyre pakicave në shoqëri. Ekziston një hendek i madh midis romëve të marginalizuar dhe banorëve joromë, që jetojnë në afërsi të tyre për sa u përket aftësive njerëzore dhe mirëqenies materiale. Megjithatë ka progres në mbulimin me shërbimet bazë, ka mungesa sa i takon barazisë në dhënien e këtyre shërbimeve⁹².

Romët dhe egjiptianët ndihen të diskriminuar nga pikëpamja e aksesit në shërbimet civile. Regjistrimi civil e vështirëson aksesin në shërbime si arsim, shëndetësi, ndihmë ekonomike etj. Megjithatë romët dhe egjiptianët ndiejnë diskriminim edhe pranë sporteve të shërbimeve civile. Në një studim të vitit 2017, nga anketat (duke përdorur Shkallën e Racizmit Simbolik

2000–SR2KS⁹³), intervistat, simulimet, *workshop*-et dhe *coaching* me punonjës të administratës publike në 4 bashki (Tiranë, Durrës, Berat dhe Shkodër), u identifikua prania e dukurisë së *racizmit simbolik*⁹⁴ në nivele thajse mbi mesataren⁹⁵.

Nga ana tjetër, një problematikë persistente për romët dhe për egjiptianët për përfitimin e shërbimeve sociale (duke përfshirë ndihmën ekonomike) lidhet me mungesën e dokumenteve personale ose të transferimit formal të vendbanimit, analfabetizmit ose paaftësisë për të plotësuar formularët e aplikimit, procedurave tepër të komplikuar, pasja e pronësisë ligjore mbi toka që ata nuk i zotërojnë etj. Ndonjëherë, ata humbasin përfitimet për shkak të pamundësisë për të regjistruar transferimin e vendbanimit brenda afatit të caktuar.

Skema e re e reformuar e ndihmës ekonomike (NE) shmang deri diku kriteret përjashtuese dhe dokumentacionin e tepërt, duke bërë të mundur që të gjenerohen të dhëna nga sistemet e tjera. Skema shmang paraqitjen e dokumenteve, si certifikata personale e familjare, vërtetimin e punëkërkuessit të papunë, librezën e punës, dokumentet e pronësie për automjet etj. Parimisht, ky ndryshim në skemën e NE-së u siguron përparësi romëve dhe egjiptianëve të cilët kishin problem sigurimin e dokumenteve të nevojshme dhe të kuptuarit e procedurave administrative, megjithatë në praktikë ka nevojë për përmirësime të mëtejshme. Pasaktësia e llogaritjes së masës së ndihmës ekonomike nga ana e administratorëve apo mos hedhja në sistemin e zyrës së punës të anëtarëve madhorë të familjes edhe pse figurojnë të

⁹³ Henry, P. J., & Sears, D.O. (2002). The symbolic racism 2000 scale. *Political Psychology*, 23(2), 253–283.

⁹⁴ Racizmi simbolik (i njohur edhe si paragjykim i simbolik dhe pakënaqësia racore) është një sistem besimi koherent, që pasqyron një paragjykim themelor unidimensional ndaj çdo etnie. Këto besime përfshijnë stereotipin se njerëzit me ngjyrë janë moralisht inferiorë ndaj personave të bardhë, të bardhët janë racistë dhe se njerëzit me ngjyrë shkelin vlerat tradicionale të të bardhëve. Këto besime mund të shpien në veprime diskriminuese dhe justifikim të këtyre veprimeve.

⁹⁵ Hysa, X., & Titka, M. (2017). *ESERE Behavioral Change Model Changing Attitudes and Behaviors of Public Servants with Regards to Roma and Egyptians' Access to Public Services*. Tirana / Albania: UNDP. <http://www.al.undp.org/content/dam/albania/docs/ESERE%20Behavioural%20Change%20Model.pdf>

⁹² Anketa Rajonale 2017, UNDP & WB.



regjistruar si punëkërkues pranë zyrave të punës, kanë qenë disa nga problematikat e evidentuara në raport progresin e Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale (2019), që kanë ndikuar në mosmarrjen e plotë të përfitimit monetar apo përjashtimin e familjeve nga skema.

Ndërkohë që institucioni i Avokatit të Popullit rekomandon, se i duhet kushtuar vëmendje më e madhe dhe prioritet, aplikimit të drejtë të sistemit të pikëzimit për përfitimin e ndihmës ekonomike. Gjithashtu nënvizohet nevoja e trajnimit të individëve që plotësojnë formularët në terren, me qëllim që të mund të bëjnë pasqyrim të realitetit për çdo rast dhe jo thjesht një sistem pikëzimi digjital që përjashton apriori, qoftë edhe për gabime teknike, individë apo familje me të vërtetë në nevojë për përfitimin e pagesës së ndihmës ekonomike⁹⁶.

Sipas sistemit Romalb gjatë vitit 2018 janë 8,691 individë romë dhe egjiptianë përfitues të NE-së. Ndërsa, gjatë vitit 2019 numri është ulur në 8,294 përfitues. Megjithatë, pavarësisht problematikave Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes sociale raporton se aktualisht për vitin 2020, 95% e aplikuesve të skemës së ndihmës ekonomike janë përfitues, ku rreth 11 mijë individë përfitues të ndihmës ekonomike janë romë dhe egjiptianë. Mbetet sfida për të ardhmen riintegrimi social i këtyre familjeve, nëpërmjet zbatimit të programeve të daljes nga skema e ndihmës ekonomike.

Bazuar në rekomandimin e Komisionit Evropian për heqjen e barrierave dhe krijimin e mundësive të financimit për zhvillimin e sipërmarrjes sociale, qeveria miratoi ligjin nr. 65/2016, “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë” për të mbështetur punësimin e grupeve vulnerabel, të cilët nuk kanë burime të mjaftueshme dhe situata e tyre nuk iu mundëson një qasje aktive në tregun e punës. Thirrja e parë nga qeveria u lançua më maj të 2019-ës, ku morën statusin e ndërmarrjes sociale 6 OJF. Që ky model të jetë gjithëpërfshirës dhe të shërbejë efektivisht për nxitjen e punësimit, është i nevojshëm krijimi i një mjedisi mundësues të favorshëm, ku romët dhe egjiptianët rritin njohuritë

lidhur me produktet, shërbimet dhe impaktin e sipërmarrjeve sociale⁹⁷.

Në ciklin e gjashtë monitorues për Shqipërinë, Raporti i ECRI-t thekson se gjuha e urrejtjes dhe dhuna e motivuar nga kjo gjuhë kundrejt romëve dhe egjiptianëve janë dukuri ende të pranishme në Shqipëri, gjë e cila vështirëson përfshirjen e këtyre komuniteteve në jetën e përditshme dhe aksesin në shërbime⁹⁸. Në vitin 2019, Komiteti i Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Diskriminimit Racor (CERD) shprehu shqetësimin e tij për ndjekjen e kufizuar të rekomandimeve dhe të vendimeve të marra nga organet e barazisë⁹⁹. Në rastin e Komisionit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që, gjithashtu, mund të merret me çështje të diskriminimit të pretenduar në sektorin privat, një numër i madh (deri në 90%) të vendimeve të tij sfidohen në gjykata. Ndërsa në të kaluarën, vendimet e KMD-së shpesh rrëzoheshin nga gjyqësori, kjo prirje duket se është ndalur dhe përmbysur. Duket se një kuptim shumë më i mirë i parimeve të barazisë dhe mosdiskriminimit, si dhe i jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, po përhapet gjithnjë e më shumë në sistemin gjyqësor. Përpos trendit pozitiv, problematika është ende e pranishme.

Sipas Rekomandimeve të Seminarit të Dialogut Publik Shqipëri-BE, dhjetor 2018, lista e problemeve të kujdesit shoqëror është si vijon:

- Mungesa e shërbimeve të integruara, veçanërisht për fëmijët në situatë rruge dhe familjet e tyre. Mungesa e informacionit në lidhje me shërbimet komunitare të ofruara nga bashkitë;
- Pamundësia e pakicave romë dhe egjiptiane, të cilat për shkak të arsyeve të ndryshme (p.sh. vendbanimi gjendet larg qendrës shëndetësore) nuk përfitojnë dot shërbime shëndetësore ose sociale;
- Mungesa e informacionit për skemën e re të ndihmës ekonomike dhe numri i ulët i aplikimeve nga kategoria e pakicave romë dhe egjiptiane;

⁹⁷ Raport i Progresit (2019) të Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale (2015–2020)

⁹⁸ Raporti i Gjashtë i ECRI-t për Shqipërinë, 2020: <https://rm.coe.int/report-on-albania-6th-monitoring-cycle-translation-in-albanian-/16809e8240>

⁹⁹ Komiteti i Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Diskriminimit Racor (UN CERD) 2019: § 13–14. – Shihni gjithashtu: Këshilli i Evropës, Komiteti i Ministrave, Rekomandimi CM/REC (2019)6 mbi zhvillimin e institucionit të Avokatit të Popullit; dhe GPR-në nr. 2, § 36.

⁹⁶ Raporti Vjetor për Veprimtarinë e Institucionit të Avokatit të Popullit 2019.



- Numri i shpeshtë i rasteve kur anëtarët e pakicave rome dhe egjiptiane nuk përfitojnë nga sigurimet shoqërore, për shkak të invaliditetit ose nga ndihma ekonomike;

- Mungesa e shërbimeve sociale dhe e zbatimit të fondit social në shumë bashki të vendit.

Përpos këtyre, pushteti vendor duhet të fillojë të parashikojë fonde të vetat për ngritjen, mbështetjen dhe zgjerimin e shërbimeve shoqërore në territorin e tij, si edhe ngritjen e një strukture të posaçme të vlerësimit të nevojave dhe referimit të rastit. Stafet lokale duhet të punojnë për një integrim të skemave të transfertave në para me shërbimet e kujdesit shoqëror, bazuar në vlerësimin e nevojave të individit/familjes.

Nga të dhëna e fundit, sipas studimit të vitit 2019, për vlerësimin e nevojave për shërbime sociale në 12 qarqet e Shqipërisë, realizuar nga Shërbimi Social Shtetëror dhe UNDP-ja nënvizohet se 34% e bashkive të vendit (21 bashki) nuk ofrojnë asnjë shërbim të kujdesit social. Nga këto, 43% janë bashki me popullsi mbi 20 000 banorë. Vetëm 7 bashki ose 9% e bashkive ofrojnë të gjitha shërbimet. 38 bashki ose 62% e të gjitha bashkive të vendit nuk kanë shërbime për të moshuar, 43 bashki ose 71% e tyre nuk kanë shërbime për fëmijë, 37 bashki ose 61% e bashkive nuk ofrojnë shërbime për individë me aftësi të kufizuara dhe 39 bashki ose 64% e tyre nuk ofrojnë shërbime për individë në nevojë, përfshirë romët dhe egjiptianët.

Skema e reformës së shërbimeve sociale ka mundësuar për herë të parë nëpërmjet krijimit të një linje buxhetore të veçantë, Fondit Social dhe alokimit të buxhetit qendror, të mundësohet që çdo bashki të ngrejë shërbime shoqërore në territor për grupet në nevojë, duke garantuar shërbimet shoqërore minimale (apo shporta e shërbimeve), si dhe qëndrueshmëri të shërbimeve aktuale, sipas nevojave të specifikuar në Planin Social të çdo bashkie. Megjithatë për vitin 2021, kanë aplikuar disa bashki për të ofruar shërbim për komunitetin rom dhe egjiptian, vazhdon të mbetet sfida shumë e rëndësishme aftësia e pushtetit vendor për të planifikuar dhe për të menaxhuar këto fonde.

Pandemia COVID-19 dhe sidomos izolimi afatgjatë paraqiti një kërcënim të madh veçanërisht për romët dhe egjiptianët, një pjesë e të cilëve jetojnë në kushte të vështira, aq sa shërbimet e mbrojtjes sociale janë një domosdoshmëri për

mbijetesë. Si përgjigje ndaj krizës COVID-19, qeveria ndërmori disa masa emergjente ku romët dhe egjiptianët ishin përfitues. Rreth 18,144 familje rome dhe egjiptiane përfituan paketë ndihme (ushqimore dhe joushqimore) dhe barna të rimbursueshme. Ndërkohë që 10,436 individë romë dhe egjiptianë përfituan dyfishimin e masës së ndihmës ekonomike në para, kurse 4,524 familje u mbështetën me ndihmë financiare prej 16 000 (gjashtëmbëdhjetë mijë) lekësh përfshirë edhe familjet të cilat kishin aplikuar për ndihmë ekonomike, por që nuk kishin përfituar nga skema e NE-së dhe as nga fondi 6 për qind. Gjithashtu, romët dhe egjiptianët kanë përfituar edhe nga falja e kamatëvonesave të energjisë elektrike. Ky reagim i menjëhershëm nga qeveria duhet të vazhdojë edhe në të ardhmen e afërt me masa të ngjashme që të garantojë ofrimin e shërbimeve të nevojshme familjeve rome dhe egjiptiane në pamundësi për të plotësuar nevojat jetike bazë.

Ndërkohë që Plani i OKB-së për Përgjigjen Socioekonomike dhe Rimëkëmbjen ndaj COVID-19 në Shqipëri finalizuar në korrik të vitit 2020 konstaton se, pandemia COVID-19 ka rritur rrezikun, gjithashtu, për punën dhe shfrytëzimin e fëmijëve, sidomos të atyre në situatë rruge, sepse burimet e jetesës dhe të ardhurat e familjeve të tyre janë zvogëluar. Rreziku është jashtëzakonisht i lartë dhe kërkon mbështetje të menjëhershme për të siguruar shërbime mbështetëse për fëmijët dhe familjet e tyre.

4.7 Antixhopsizmi

Racizmi kundër romëve dhe egjiptianëve (RRE), diskriminimi ndaj tyre i akumuluar në kohë, si dhe streotipat dhe paragjykimet ndaj romëve dhe egjiptianëve hasen në Shqipëri, ashtu si edhe në shumë vende të tjera ku ato janë prezente¹⁰⁰. Janë pikërisht këto fenomene që qëndrojnë në themel të problematikave me të cilat anëtarë të pakicave rome dhe egjiptiane ballafaqohen, ku në nivele më të larta e ku më të ulëta, në të gjitha fushat e jetës social-kulturore, ekonomike dhe politike. Shkalla e ulët e përfshirje së romëve dhe të egjiptianëve në tregun formal të punës, niveli më i ulët i regjistrimeve, ndjekjes, si dhe i rezultateve në shkollë për fëmijët e pakicave rome dhe egjiptiane, kushtet shumë të vështira të strehimit apo nivelet e

¹⁰⁰ Civil Rights Defenders (2018) The wall of anti-gypsies: Roma and Egyptians in Albania; Printing Press.



ulëta të angazhimit të romëve dhe të egjiptianëve në procese politikëbërëse dhe vendimmarrëse, në nivel qëndron dhe/ose vendor, janë tregues të pasojave të racizmit dhe diskriminimit, të drejtpërdrejtë apo të fshehtë, të akumuluar apo të krijuar rishtazi¹⁰¹.

Ky seksion fokusohet në problematikat e racizmit dhe diskriminimit ndaj romëve dhe egjiptianëve, duke u ndalur kryesisht në mjedisin ligjor dhe institucional, në çështje të stereotipizimit të Romëve dhe të Egjiptianëve, gjuhës dhe krimeve e urrejtjes ndaj tyre, si dhe nevojave që mbeten për t'u adresuar në kuadër të luftës kundër tyre. Më tej, manifestimi i këtyre problematikave trajtohet në mënyrë të drejtpërdrejtë për sektorë të veçantë, nën seksionet e këtij kapitulli mbi fusha prioritare si regjistrimi civil, edukimi, punësimi, strehimi, shëndetësia, mbrojtja shoqërore etj.

Klima e përgjithshme për sa i takon kuadrin ligjor dhe institucional në raport me statusin e pakicave rome dhe egjiptiane në Republikën e Shqipërisë ka ardhur duke u përmirësuar. Duke filluar nga tetori i vitit 2017, si romët, ashtu edhe egjiptianët janë njohur si pakica kombëtare në Republikën e Shqipërisë¹⁰². Në mënyrë eksplicite, ligji nr. 97/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, sanksionon ndër të tjera, mbrojtjen e pakicave kombëtare nga diskriminimi (neni 8)¹⁰³. Në nenin 8 të tij, pika 2, ligji nr. 97/2017, ngarkon institucionet publike, qendrore dhe vendore, me përgjegjësi për të miratuar dhe zbatuar masa, për të:

a) garantuar barazi të plotë dhe efektive në jetën ekonomike, shoqërore, politike dhe kulturore ndërmjet personave që i përkasin një pakice kombëtare dhe atyre që i përkasin shumicës;

b) mbrojtur personat që u përkasin pakicave kombëtare nga kërcënimet, diskriminimi, armiqësia

¹⁰¹ Këto janë të evidentuara dhe targetuara si në Planin e Veprimit 2015–2020, ashtu edhe në planet vendore të një sërë prej bashkive në Republikën e Shqipërisë, që kanë hartuar plane vendore për integrimin e romëve dhe të egjiptianëve.

¹⁰² Më herët, romët dhe egjiptianët nuk e gëzonin këtë status. Deri atëherë romët janë njohur si një pakicë gjuhësore, ndërsa egjiptianët nuk gëzonin asnjë njohje të vecantë.

¹⁰³ Ligji nr. 97/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare”, Republika e Shqipërisë, Kuvendi: <https://www.parlament.al/LibrariaAkteve/LibrariaAkteDetails/4060>

apo dhuna për shkak të identitetit të tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, fetar ose tradicional;

c) për të forcuar dialogun ndërkulturor;

ç) për të nxitur respektin e ndërsjellë, mirëkuptimin dhe bashkëpunimin ndërmjet të gjithë qytetarëve të Republikës së Shqipërisë, pa dallim për sa i përket identitetit të tyre të dallueshëm kulturor, etnik, gjuhësor, fetar ose tradicional.

Përveç ligjit të dedikuar për mbrojtjen e pakicave, Republika e Shqipërisë ka konkretizuar vullnetin për mbrojtjen e pakicave rome dhe egjiptiane, si dhe për adresimin e problematikave dhe të pengesave drejt qëllimit final për integrimin e tyre të plotë në shoqëri, edhe përmes ligjeve dhe dokumenteve të tjera politike, ashtu edhe me ngritjen e fuqizimin e mekanizmave për zbatimin e tyre.

Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë¹⁰⁴ është një dokument ligjor shumë i rëndësishëm pasi një sërë artikujsh të tij adresojnë diskriminimin me bazë etninë dhe racën, ashtu si edhe krimet e urrejtjes dhe gjuhën e urrejtjes (duke përfshirë gjuhën e urrejtjes në internet). Sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë, diskriminimi është një rrethanë rënduese për çdo vepër që lidhet me gjuhën, fenë, kombësinë, besimet politike dhe ato shoqërore. Çështjet e diskriminimit dhe sigurimit të mundësive të barabarta trajtohen edhe në një sërë ligjesh sektoriale (p.sh. në fushën e arsim, punësimit etj.), ashtu edhe në dokumente politike që targetojnë në mënyrë specifike pakicat rome dhe egjiptiane.

Në këtë kuadër, vlen të veçohet Plan i Veprimit për Integrimin e Romëve dhe të Egjiptianëve 2015–2020, që në vitet e fundit ka qenë dokumenti kryesor për mbrojtjen dhe përfshirjen sociale të romëve dhe të egjiptianëve në Shqipëri. Si një vazhdim i Strategjisë Kombëtare të mëhershme, “Për përmirësimin e kushteve të jetesës së pakicës rome” dhe Planit të Veprimit të “Dekadës së Përfshirjes së Romëve” (2005–2015), ai targeton objektiva dhe aktivitete në fusha si arsimi dhe promovimi i dialogut ndërkulturor, punësimi dhe formimi profesional, kujdesi shëndetësor dhe

¹⁰⁴ Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, Republika e Shqipërisë: http://www.pp.gov.al/web/kodi_penal_2016_1033.pdf



mbrojtja sociale, strehimin dhe integrimin urban, si dhe regjistrimi civil dhe aksesin në drejtësi, duke parashikuar edhe faturën financiare të mbuluar nga fondet publike dhe përmes financiare e donatorëve të ndryshëm.

Vullneti politik është reflektuar edhe në ngritjen dhe fuqizimin e institucioneve dhe mekanizmave për garantimin e zbatimit të kuadrit ligjor. Kështu, vlerësohet se një rol shumë të rëndësishëm luajnë institucioni i Avokatit të Popullit (AP), si dhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD). Misioni i Gjashtë Monitorues i Komisionit Evropian kundër Racizmit dhe Intolerancës (ECRI), në raportin e tij (2020), nënvijëzon rolin e AP-së dhe KMD-së, si dhe marrëdhënien kolegjiale, shumë efektive që të dyja institucionet kanë ndërtuar me njëri-tjetrin, ku një nga komponentët më të spikatur të punës së tyre fokusohen në çështje të gjuhës së urrejtjes raciste¹⁰⁵. Këta janë tregues të njohjes së seriozitetit të problematikës, si dhe nevojës për adresimin e saj në mënyrë sa më efektive. Për këtë, raportohet se KMD-ja ka rritur ndjeshëm kapacitetet e personelit dhe ka intensifikuar punën në monitorim dhe raportim, përfshi edhe në nivel lokal përmes zyrave rajonale¹⁰⁶.

Në vitin 2018, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë miratoi Kodin e Sjelljes që, ndër të tjera, ndalon deputetët të përdorin gjuhën e urrejtjes raciste në Parlament, si dhe format e diskriminimit dhe stereotipizimet si në parlament, ashtu edhe në veprimtaritë joparlamentare. Në rast të shkeljeve, parashikohet që ndaj deputetit të zbatohen masa disiplinore¹⁰⁷.

Në vijim të pasurimit të kuadrit ligjor për të siguruar akses efektiv në drejtësi për viktimat e diskriminimit përmes zhvillimit të një sistemi funksionues të ndihmës juridike dhe të financuar siç duhet, në vitin 2017 është miratuar legjislacioni për sigurimin e ndihmës juridike. Megjithatë, siç haset shpesh edhe në fusha të tjera, implementimi i kuadrit ligjor nuk ecën me ritme të ngjashme. Pengesat lidhen së pari me vonesat në plotësimin e tij me aktet nënligjore përkatëse. Raporti i ECRI-t

2020, vëren vonesa të tilla, si në pajisjen me akte nënligjore të ligjit të ri për ndihmën juridike, ashtu edhe për ligjin për strehimin social, të dyja këto ligje me impakt të drejtpërdrejtë për pakicave romë dhe egjiptiane në vend¹⁰⁸. Në mënyrë të ngjashme, ligji për Mbrojtjen e Minoriteteve Kombëtare të vitit 2017 është ende pa legjislacion dytësor të plotësuar, i cili është i nevojshëm për të siguruar zbatimin efektiv të tij. Në këtë kontekst, mbetet ende shumë për t'u bërë që autoritetet të plotësojnë kuadrin ligjor me aktet nënligjore, siç është rekomanduar edhe nga Komiteti Këshillimor i Këshillit të Evropës për Konventën Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, si dhe nga Komiteti i Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Diskriminimit Racor¹⁰⁹.

Jo vetëm pasurimi i kuadrit ligjor me akte nënligjore kërkon ritme më të shpejta, por edhe evidentimi, matja dhe adresimi i problematikave të racizmit dhe diskriminimit. Efektiviteti i zbatimit të kuadrit ligjor, si dhe treguesit e suksesit në luftën kundër racizmit ndaj romëve dhe egjiptianëve në Shqipëri mbeten të vështirë për t'u dokumentuar si pasojë e një sërë faktorësh, ndër më kryesorët janë mungesat në mbledhjen e të dhënave, raportimin e tyre në mënyrë sistematike dhe të disagreguar. Të dhënat mbi çështjet e racizmit kundër romëve dhe egjiptianëve janë të pakta, sporadike dhe kryesisht të siguruar nga sektori i organizatave joqeveritare¹¹⁰. Ende nuk ka të dhëna statistikore tërësore dhe të përditësuara mbi krimet e urrejtjes të bazuara në racë, si dhe të dhënat e përgjithshme nuk disagregohen sipas etnisë, gjë që e bën të vështirë njohjen e shtrirjes së problematikës së romëve dhe egjiptianëve që bëhen preh e dhunës e krimit të urrejtjes¹¹¹.

¹⁰⁸ Shiko për shembull problematikën e strehimit që ECRI ka vërejtur, e krijuar si pasojë e mungësës së akteve nënligjore, të cilat synojnë të sigurojnë detajet e nevojshme për të funksionalizuar legjislacionin në fushën e strehimit social (faqe 27).

¹⁰⁹ FCNM 2019: 2 dhe 7 (faqe 16); dhe Komiteti i Kombeve të Bashkuara për Eliminimin e Diskriminimit Racor (UN CERD) 2019, faqe 11–12.

¹¹⁰ ECRI (2020) Raporti i ECRI-t për Shqipërinë (Cikli i gjashtë monitorues), Council of Europe, June 2020.

¹¹¹ Shiko: ECRI (2020) Raporti i ECRI-t për Shqipërinë (Cikli i gjashtë monitorues), Council of Europe, June 2020, si dhe Civil Rights Defenders (2018) The wall of anti-gypsies: Roma and Egyptians in Albania; Printing Press.

¹⁰⁵ ECRI (2020) Raporti i ECRI-t për Shqipërinë (Cikli i gjashtë monitorues), Council of Europe, June 2020, faqe 7.

¹⁰⁶ Ibid.

¹⁰⁷ Kuvendi i Republikës së Shqipërisë (vendimi nr. 61/2018): neni 6.



Nga ana tjetër, mungesa e praktikave të mira, të stabilizuara apo e besimit në funksionimin e legjislacionit dhe mekanizmave bën që racizmi dhe diskriminimi, gjuha dhe krimet e urrejtjes ndaj romëve dhe egjiptianëve të jenë në nënraportuara¹¹². Përtej raportimeve statistikore nga Zyra e Prokurorit të Përgjithshëm, i cili ka për detyrë mbledhjen e përgjithshme të të dhënave për krimin e urrejtjes¹¹³, duket se mungon një sistem gjithëpërfshirës i mbledhjes së të dhënave për incidente raciste të gjuhës së urrejtjes¹¹⁴. Sipas Zyrës së OSBE-së për Institucione Demokratike dhe të Drejtat e Njeriut (ODIHR), Shqipëria nuk ka raportuar sistematikisht numrat e krimeve të urrejtjes të regjistruara nga policia¹¹⁵, si dhe nuk ekziston informacion më i detajuar, as nga policia e as nga Ministria e Drejtësisë mbi rastet e gjykuara¹¹⁶.

KMD-ja ka trajtuar disa ankesa në lidhje me gjuhën e urrejtjes në vitet e fundit, përfshirë raste kur gjuha e urrejtjes ka qenë e drejtuar ndaj romëve dhe egjiptianëve. Organizatat e Shoqërisë Civile (OSHC-të) luajnë një rol thelbësor në këtë drejtim. Sipas raportit më të fundit të KMD-së, gjatë vitit 2020 përveç ankesave individuale, janë depozituar edhe 11 ankesa nga organizata me interes legjitim (4 ankesa të mbartura dhe 7 ankesa të regjistruara në vitin 2020), të cilat janë depozituar kryesisht nga organizata që mbrojnë interesat e fëmijëve, pakicat rome dhe egjiptiane, si dhe personave me aftësi të kufizuara etj. Në raste të tjera, informacioni i dhënë nga ana e OSHC-ve dhe media kanë shërbyer si indicie apo informacion për Komisionerin për nisjen kryesisht të çështjeve¹¹⁷. Edhe Autoriteti i

Mediave Audiovizive (AMA), merr ankesa në lidhje me gjuhën e urrejtjes, shumica e të cilave kanë qenë të lidhura me mediat sociale/portalet televizive në internet, ku grupet e synuara shpeshherë janë personat romë dhe egjiptianë¹¹⁸.

Lipset ende që autoritetet të krijojnë një sistem gjithëpërfshirës të monitorimit për incidente të gjuhës së urrejtjes dhe krimeve të urrejtjes. Në këtë drejtim, kërkohet, siç rekomandon edhe ECRI (2020), një bashkërendim më i mirë i përpjekjeve të Avokatit të Popullit, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, prokurorisë, policisë dhe OSHC-ve që përfaqësojnë/mbrojnë romët dhe egjiptianët. Po kështu, nevojitet të punohet intensivisht për ndërtimin e besimit¹¹⁹ ndër anëtarët romë e egjiptianë, për t'i raportuar këto vepra, si dhe për të fuqizuar organizatat dhe zërat përfaqësues të R&E, pasi edhe ata vetë janë bërë objekte të gjuhës së urrejtjes¹²⁰. Kjo kërkon masa dhe veprime në shumë plane, që shtrihen nga ndërgjegjësimi tek hetimi penal dhe ndëshkimi dhe që realizohen me pjesëmarrjen e shumë aktorëve, pasi përveç Avokatit të Popullit dhe KMD-së, dënimi publik i gjuhës së urrejtjes dhe reagimet aktive nga figura të larta politike ose figura të tjera publike mbetet ende tejet të rralla¹²¹. Për më tepër, lufta kundër racizmit ndaj romëve dhe egjiptianëve nevojitet të jetë jo vetëm gjithëpërfshirëse, por dhe strukturore. Për këtë kërkohen ndërhyrje që targetojnë çështjet e racizmit dhe të diskriminimit në përgjithësi, si dhe në veçanti për fusha ku problematika manifestohet me segregim dhe përjashtim (si p.sh. në strehim, shkollim etj.).

Suksesi i luftës kundër RRE përcaktohet ndër të tjera edhe nga shkalla e përfshirjes në procese

¹¹² Civil Rights Defenders (2018) The wall of anti-gypsims: Roma and Egyptians in Albania; Printing Press.

¹¹³ Shiko për shembull raportin për vitin 2019 këtu http://www.pp.gov.al/web/kuvendit_raporti_vjetor_2019_28_3_2020_pp_perf_1864.pdf

¹¹⁴ ECRI (2020) Raporti i ECRI-t për Shqipërinë (Cikli i gjashtë monitorues), Council of Europe, June 2020.

¹¹⁵ Ibid, faqe 15.

¹¹⁶ Civil Rights Defenders (2018) The wall of anti-gypsims: Roma and Egyptians in Albania; Printing Press; shiko, gjithashtu, raportin më të fundit të Ministrisë së Drejtësisë mbi rastet gjyqësore gjykuar gjatë 2019 ku nuk gjenden deja mbi krimet e urrejtjes, i aksesueshem në: <https://www.drejtesia.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/VJETARI-STATISTIKOR-2019.pdf>

¹¹⁷ Shiko raportin përkatës, faqja 8. I aksesueshem në <https://www.kmd.al/wp->

[content/uploads/2020/09/Raporti-KMD-6-mujori-i-I-re-i-vitit-2020.pdf](https://www.kmd.al/wp-content/uploads/2020/09/Raporti-KMD-6-mujori-i-I-re-i-vitit-2020.pdf)

¹¹⁸ ECRI (2020) Raporti i ECRI-t për Shqipërinë (Cikli i gjashtë monitorues), Council of Europe, June 2020.

¹¹⁹ ECRI (2020) raporton se ka marrë informacione nga OJQ-të, që tregojnë për dhunë sporadike të bazuar në urrejtje ndaj anëtarëve të komuniteteve LGBTI dhe rome, por cilëson se fakti që ato nuk janë sjellë në vëmendjen e autoriteteve të zbatimit të ligjit mund të jetë për shkak të mungesës së besimit te policia midis anëtarëve të këtyre komuniteteve (faqe 17).

¹²⁰ ECRI (2020) raporton me shqetësim se edhe ata që i mbrojnë këto grupe, për shembull organizatat e shoqërisë civile, disa anëtarë të Parlamentit dhe organet e barazisë, gjithashtu, janë bërë vetë gjithnjë e më shumë objektiva të gjuhës së urrejtjes (faqe 16).

¹²¹ Ibid.



politikëbërëse dhe vendimmarrëse dhe shkalla e fuqizimit të romëve dhe të egjiptianëve. Eksperienca si ato të hartimit të Planit të Veprimit në nivel kombëtar apo të planeve vendore për integrimin e romëve dhe të egjiptianëve me përfshirjen dhe angazhimin e organizatave të komunitetit rom dhe egjiptian në hartimin, implementimin dhe monitorimin, janë shumë të rëndësishme dhe për t'u vlerësuar në këtë drejtim. Megjithatë, edhe pse kujdesi për çështjet e pjesëmarrjes të drejtpërdrejtë në vendimmarrje është i pranishëm në Kushtetutën dhe në legjislacionin zgjedhor në raport me pakicat dhe barazinë gjinore në vend, praktikatat e mira janë ende të kufizuara, kryesisht të hasura në nivelin vendor se sa në atë qendror, si dhe të lidhura me çështjet e vendimmarrjes me pjesëmarrje sesa me problematikat e antidiskriminimit dhe/ose antiracizmit.¹²² Fuqizimi i pakicave rome dhe egjiptiane, pjesëmarrja dhe përfshirja më e madhe e tyre në vendimmarrjen në përgjithësi dhe në adresimin e çështjeve që lidhen me luftën kundër RRE-së, kombinuar me ndjeshmërinë për respektimin e dallimeve midis komuniteteve rome dhe egjiptiane, janë një strategji frytdhënëse në këtë drejtim.

5. Vizioni dhe misioni i dokumentit

VIZIONI: Krijimi i kushteve të përshtatshme për të arritur barazinë, pjesëmarrjen dhe përfshirjen e pakicave rome dhe egjiptiane në Republikën e Shqipërisë, në të gjitha aspektet e jetës shoqërore veçanërisht qasjen në arsim, punësim, strehim, shërbime shëndetësore dhe sociale, për të përmirësuar cilësinë e jetës dhe mirëqenien, si dhe të zvogëloj hendekun social - ekonomik dhe kulturor ndërmjet romëve dhe egjiptianëve nga njëra anë dhe pjesës tjetër të shoqërisë.

MISIONI: Qeveria shqiptare merr përsipër obligimin që gjatë periudhës 2021–2025 të sigurojë përfshirjen sociale, ekonomike dhe kulturore të pakicave rome dhe egjiptiane në Republikën e Shqipërisë nëpërmjet përcaktimit të prioritetëve strategjike dhe duke zbatuar politika të integruara

afatgjatë dhe afatmesme në fushat e aksesit në drejtësi, arsimit dhe kulturës, punësimit, strehimit, mbrojtjes sociale, dhe antixhopsizmit, duke respektuar parimet e barazisë dhe të mosdiskriminimit, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe në kuadër të zbatimit të konventave dhe kuadrit ligjor për respektimin e të drejtave të njeriut dhe pakicave.

Treguesit e impaktit dhe treguesit e rezultatit:

- në fund të vitit 2025, 100% e anëtarëve të pakicave rome dhe egjiptiane kanë akses të plotë dhe të përmirësuar në shërbimin e gjendjes civile;

- në fund të vitit 2025, 100% e anëtarëve të pakicave rome dhe egjiptiane, të cilët kanë pasur nevojë, kanë përfituar nga shërbimet ligjore të ndihmës juridike parësore;

- më shumë se 5% e përfutuesve të programeve të strehimit u përkasin pakicave rome dhe egjiptiane deri në fund të vitit 2025;

- 40% më shumë NJVV kanë përfituar mbështetje financiare nga qeveria qendrore deri në fund të vitit 2025 krahasuar me vitin 2020 për përmirësimin e kushteve të strehimit të pakicave rome dhe egjiptiane;

- deri në fund të vitit 2025, 100% e pakicave rome dhe egjiptiane do të kenë akses në shërbime cilësore shëndetësore dhe parandaluese;

- deri në fund të 2025, 80% më shumë fëmijë romë dhe egjiptianë përfundojnë arsimin parashkollor, arsimin bazë dhe arsimin e mesëm të lartë në krahasim me vitin 2020;

- deri në fund të vitit 2025 është përfshirë në të gjitha nivelet arsimore kurrikula e historisë dhe e kulturës rome dhe egjiptiane;

- deri në fund të 2025 janë realizuar 80% më shumë aktivitete që promovojnë dhe ruajnë identitetin, historinë dhe kulturën e pakicave rome dhe egjiptiane në shoqërinë shqiptare;

- deri në fund të 2025 janë punësuar 60% e romëve dhe e egjiptianëve punëkërkues të papunë të cilët: janë regjistruar pranë zyrave të punës; ii. janë bërë pjesë e PNP-ve dhe iii. kanë përfunduar AFP-në;

- deri në fund të 2025, të paktën 300 romë dhe egjiptianë më shumë se viti 2020 do të mbështeten financiarisht për sipërmarrje dhe vetëpunësim, me qëllim akomodimin e tyre në ekonominë formale;

- deri në fund të vitit 2025, 70% e pakicave rome dhe egjiptiane përfitues të ndihmës

¹²² Shiko p.sh. OSCE/ODIR (2013) praktikatat më të mira për integrimin e romëve (BPRI). Raporti rajonal mbi antidiskriminimin dhe pjesëmarrjen e romëve në vendimmarrjen lokale. Maj 2013, si dhe planet vendore për integrimin e romëve dhe të egjiptianëve në bashkitë Korçë, Pogradec, Vlorë, Përmet, Elbasan dhe Roskovec, të mbështetura nga programi ROMACTED, CoE.



ekonomike kanë dalë nga skema dhe janë riintegruar në punë;

- deri në fund të vitit 2025, 100% e pakicave rome dhe egjiptiane janë informuar mbi të gjitha format e trafikimit njerëzor përfshirë; shfrytëzimi i fëmijëve për punë, lypje dhe martesat në moshë të hershme;

- 90% e institucioneve që ofrojnë shërbime publike të trajnuar për antixhopsizmin deri në fund të 2025-ës.

PJESA II QËLLIMET E POLITIKËS DHE OBJEKTIVAT SPECIFIKË

Qëllimet e politikës të PKVBPPRE 2021–2025

1. Qasje e barabartë në drejtësi dhe shërbime të gjendjes civile për romët dhe për egjiptianët.

2. Përmirësimi i kushteve të strehimit për anëtarë të pakicave rome dhe egjiptiane, si dhe legalizimi i të gjitha vendbanimeve joformale.

3. Ulja e hendekut në cilësinë e shëndetit midis romëve dhe egjiptianëve dhe pjesës tjetër të popullsisë.

4. Rritja e aksesit të barabartë në arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës për romët dhe egjiptianët në të gjitha nivelet arsimore.

5. Krijim i mundësive të barabarta për punësim cilësor dhe të qëndrueshëm për romët dhe egjiptianët.

6. Përmirësim i qasjes dhe rritja e aksesit të romëve dhe egjiptianeve në programet e mbrojtjes sociale.

7. Antixhopsizmi njihet dhe adresohet në politikat publike, si dhe përmes ndryshimeve sistematike dhe strukturore, për të garantuar një shoqëri të çliruar nga diskriminimi ndaj R&E.

Arritja e këtyre qëllimeve kërkon përpjekje të gjithanshme nga të gjitha ministrat dhe institucionet që zbatojnë politika, të cilat ndikojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë në jetesën e pakicave rome dhe egjiptiane. Masat dhe ndërhyrjet që propozohen kanë karakter ligjor, institucional, por edhe karakter specifik, në përputhje me nevojat e romëve dhe të egjiptianëve, me qëllim që ata të ushtrojnë me lehtësi të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.

Një nevojë e domosdoshme dhe e vazhdueshme është gjetja e mekanizmave të duhur dhe të përshtatshëm që sigurojnë një bashkëpunim

të fortë dhe efektiv ndërinstitucional si në drejtimin horizontal ashtu dhe atë vertikal. Bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile dhe grupet e interesit, kanë gjithashtu rëndësi themelore, pasi ato ndikojnë ndjeshëm për zhvillimin e standardeve rreth procesit të përfshirjes dhe integritetit të romëve dhe të egjiptianëve në shoqëri. Gjithashtu, ato duhet të luajnë një rol të rëndësishëm edhe në monitorimin e zbatimit të këtij Plani Veprimi.

Qëllimi i politikës 1. Realizimi i barabartë i aksesit në drejtësi dhe në regjistrimin civil për të gjithë anëtarët e komuniteteve rome dhe egjiptiane.

Një nga fushat politike me shumë rëndësi, që renditet si një fushë prioritare në PVKR&E 2021–2025, është ajo e sigurimit të barabartë të aksesit në drejtësi dhe në regjistrimin civil për të gjithë anëtarët e komuniteteve rome dhe egjiptiane.

Për zbatimin e kësaj politike, institucionet shtetërore që kanë përgjegjësi në këtë fushë në partneritet me institucione dhe organizata të tjera do të fokusohen në këta objektiva specifikë:

Objektivi specifik 1	Ofrimi i ndihmës ligjore për pasqyrimin e të dhënave reale në regjistrin kombëtar të gjendjes civile të pakicave rome dhe egjiptiane, me qëllim zgjidhjen e problematikave që i pengojnë në aksesin e tyre të plotë në shërbimin e gjendjes civile.
Objektivi specifik 2	Garantimi i shërbimeve të Ndihmës Juridike Falas për romët dhe egjiptianët.
Objektivi specifik 3	Fuqizimi i kapaciteteve për identifikimin e romëve dhe të egjiptianëve në rrezik trafikimi/ shfrytëzimi, si dhe referimi, mbrojtja dhe riintegrimi i rasteve të trafikuar/shfrytëzuara.

Objektivi specifik 1. Ofrimi i ndihmës ligjore për pasqyrimin e të dhënave reale në regjistrin kombëtar të gjendjes civile të pakicave rome dhe egjiptiane, me qëllim zgjidhjen e problematikave që i pengojnë në aksesin e tyre të plotë në shërbimin e gjendjes civile

Masat e parashikuara për arritjen e qëllimit të kësaj politike fokusohen në radhë të parë te mundësitë për përmirësimin e aksesit në drejtësi dhe regjistrimin civil. Një element i rëndësishëm në realizimin e aksesit në regjistrimin civil është marrja



e kartave të identitetit për fëmijët romë dhe egjiptianë të lindur jashtë shtetit ose aplikantët që kanë ndryshuar emrin jashtë shtetit. Për këtë qëllim nevojitet ndihmë ligjore dhe shërbime konsullore që shpesh romët dhe egjiptianët nuk mund t'i përballojnë financiarisht dhe nuk mund t'i gjejnë. Për këtë qëllim, ky plan parashikon ngritjen e zyrës për ofrimin e ndihmës për marrjen e dokumenteve për fëmijët e lindur jashtë vendit.

Bazuar në procedurat që ndjekin njësitë e vetëqeverisjes vendore, transferimi i vendbanimit kërkon që aplikanti të dorëzojë një certifikatë pronësie ose kontratën e qirasë së një apartamenti/banese që ndodhet në njësitë e vetëqeverisjes vendore në të cilën kërkohet të bëhet transferimi. Shumica e romëve dhe e egjiptianëve nuk i kanë këto dokumente pasi zakonisht jetojnë në streha të improvizuara/baraka. Plan i ri parashikon forcimin e bashkëpunimit të zyrave të gjendjes civile me vetëqeverisjen vendore për transferimin e vendbanimit të anëtarëve të pakicave rome dhe egjiptiane. Ky plan rrit përgjegjësinë e vetëqeverisjes vendore, në lidhje me këtë çështje, duke mundësuar ofrimin e ndihmës nga strukturat e pushteti lokal “administrator social” për të verifikuar dhe pajisur me vërtetim faktik familjet që nuk jetojnë në vendbanimin e deklaruar pranë gjendjes civile dhe që për arsye të pavarura prej tyre nuk mund të ndryshojnë vendbanimin.

Ka mangësi të informacionit, si dhe kapacitete të limituara të personelit të zyrave të gjendjes civile. Mungesa e informimit për të kryer procedurat e regjistrimit civil është pasojë e mungesës së bashkëpunimit të zyrave të gjendjeve civile me qytetarët romë dhe egjiptianë. Kjo është rrjedhojë e mungesës së informimit dhe të trajnimit të nëpunësve të zyrave të gjendjeve civile për legjislacionin përkatës, si dhe për ofrimin e shërbimeve, si dhe zbatimin e tij. Për këtë qëllim plani i ri parashikon ngritjen e kapaciteteve të punonjësve të gjendjes civile për zbatimin e rekomandimeve për regjistrimin civil, përfshirë rekomandimet lidhur me romët dhe egjiptianët, si dhe zgjidhjen dhe ndjekjen e rasteve të regjistrimit civil dhe transferimit të vendbanimit.

Zyrat e gjendjes civile nuk i regjistrojnë/shqyrtojnë kërkesat e personave të paregjistruar, dhe ndihma ligjore/administrative, për qëllimet e regjistrimit civil ofrohet vetëm nga OJQ-të, ndërkohë që shërbimi i ndihmës ligjore i

ofruar nga Ministria e Drejtësisë nuk e mbulon regjistrimin civil.

Plani i ri parashikon një masë të rëndësishme, që ka lidhje me hartimin i një metodologjie të përpiktë për matjen e numrit të popullsisë rome dhe egjiptiane në Shqipëri përmes Censurit të popullsisë të vitit 2020.

Objektivi specifik 2. Garantimi i shërbimeve të ndihmës juridike falas për romët dhe për egjiptianët

Ende është evidente mungesa e qasjes në ndihmën ligjore falas. Marrja e kartave të identitetit/regjistrimi në regjistrin e gjendjes civile në mungesë të certifikatës së lindjes kërkon ndihmë ligjore/administrative, të cilën shumica e romëve nuk di ku ta marrë dhe nuk mund ta përballojë financiarisht. Zyrat e gjendjes civile, nën presionin e njësisë të vetëqeverisjes vendore, refuzojnë lëshimin e kartave të identitetit nëse aplikantët nuk kanë paguar taksat vendore, pavarësisht faktit që një praktikë e tillë është denoncuar nga Ministria e Brendshme. Plan i ri parashikon përfundimin e regjistrit të posaçëm të përkohshëm që do të krijojë bazën e të dhënave, e cila do të japë mundësinë për trajtim dhe zgjidhje, sipas rastit personave që nuk janë regjistruar dhe regjistrimin dhe zgjidhjen, përmes zyrave të gjendjes civile, e rasteve të individëve të paregjistruar, të cilët nuk janë të pajisur me dokumentacionin e nevojshëm. Gjithashtu, plani parashikon ngritjen e shërbimeve të lëvizshme të ndihmës ligjore falas për romët dhe egjiptianët, si dhe ofrimin e ndihmës juridike parësore dhe dytësore.

Shpeshherë kartat e identitetit janë konstatuar me pasaktësi ose probleme të ndryshme si, p.sh.: nëna ka dhënë mbiemrin e partnerit të saj të pamartuar kur ka lindur foshnja, në vend që të jepte mbiemrin e saj të vërtetë, si dhe prindërit romë dhe egjiptianë nuk disponojnë një dokument që vërteton lindjen e fëmijës, pasi lindja është kryer jashtë institucioneve shëndetësore.

Ka shumë prindër të komuniteteve rome dhe egjiptiane, të cilët janë depërtuar, sepse kanë shkelur rregullat e qëndrimit jashtë shtetit dhe në këto kushte e kanë të pamundur të tërheqin dokumentet.

Ka shumë raste kur fëmijëve romë dhe egjiptianë nuk u është vendosur emri në aktin e lindjes. Prindërit e fëmijës disponojnë aktin e lindjes por ky dokument nuk e ka emrin e fëmijës.



Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nuk raporton për rastet e identifikuar për lindjet e bëra në kushte shtëpie. Njësitë e mbrojtjes së fëmijëve dhe punonjësit socialë nuk e raportojnë rastin kur e identifikojnë atë.

Objektivi specifik 3. Fuqizimi i kapaciteteve për identifikimin e romëve dhe të egjiptianëve në rrezik trafikimi/shfrytëzimi, si dhe referimi, mbrojtja dhe riintegrimi i rasteve të trafikuar/shfrytëzuara

Anëtarë të komuniteteve rome dhe egjiptiane janë më të cenueshëm ndaj trafikimit të qenieve njerëzore (parandalimi dhe ndjekja penale). Për shkak të varfërisë, romët dhe egjiptianët janë më të prirur për të pranuar oferta të rrezikshme punësimi jashtë vendit. Fëmijët që banojnë dhe punojnë në rrugë shpesh vijnë nga familjet më të cenueshme dhe më të varfra. Pa një vendbanim fiks, është e vështirë për ta që të sigurojnë dokumente personale dhe të përfitojnë qasje në shërbime. Plani i ri parashikon ngritjen dhe funksionimin e skuadrave të terrenit, të cilat kanë në përbërjen e tyre punonjës të Drejtorisë të Kujdesit Social dhe Komunitar, si dhe përfaqësues të aktorëve lokalë, që kanë në fokus fëmijët. (Këto skuadra do të identifikojnë dhe do të monitorojnë rastet e fëmijëve romë dhe egjiptianë që shfrytëzohen për punë të ndryshme (lypje, shitje ambulate, mbledhjen e mbeturinave të riciklueshme etj.)

Qëllimi i politikës 2. Përmirësimi i kushteve të strehimit për anëtarë të pakicave rome dhe egjiptiane, si dhe legalizimi i të gjitha vendbanimeve joformale.

Për zbatimin e kësaj politike, institucionet shtetërore që kanë përgjegjësi në këtë fushë në partneritet me institucione dhe organizata të tjera do të fokusohen në këta objektiva specifikë:

Objektivi specifik 1	Rritja e numrit të përfituesve romë dhe egjiptianë nga çdo program strehimi.
Objektivi specifik 2	Miratimi i kuadrit ligjor dhe bashkëpunimi midis institucioneve në nivel qendror dhe vendor për adresimin e nevojave për legalizimin dhe strehimin social.

Objektivi specifik 1. Rritja e numrit të përfituesve romë dhe egjiptianë nga çdo program strehimi

Masat e parashikuara për arritjen e qëllimit të kësaj politike fokusohen në mundësinë për përmirësimin e kushteve të strehimit për anëtarë të pakicave rome dhe egjiptiane, si dhe legalizimi i të gjitha vendbanimeve joformale.

Anëtarë të komunitetit rom dhe egjiptian vazhdojnë ende të përballen me vështirësi për sa u takon çështjeve të strehimit. Këtu përfshihen vështirësitë në aplikimin për strehim social. Në më të shumtën e rasteve ka mungesa në burimin e verifikueshëm të të ardhurave dhe dokumenteve të tjera, si dhe procedurat janë të ndërlikuara. Kjo situatë e vështirë shoqërohet edhe me mungesën e strehëve të përkohshme (si: Qendra Kombëtare Tranzitore e Emergjencave) dhe mungesës së alternativave afatgjata dhe e zgjidhjeve të qëndrueshme të strehimit për këto komunitete. Mbështetja me ndihmë ligjore falas për anëtarët e pakicave rome dhe egjiptiane për problemet që ata mund të hasin gjatë procesit të përfundimit të legalizimit është domosdoshmëri. Shumë familje rome dhe egjiptiane jetojnë në objekte të paprivatizuara ende, si: ish-ndërmarrje, pulari, pallate etj., ose i kanë nisur procedurat dhe nuk i kanë përfunduar ato, pra nuk zotërojnë titujt e pronësisë së vendbanimit. Edhe pse ka zhvillime pozitive nga Plani Kombëtar i Veprimit për Integrimin e Komuniteteve Rome dhe Egjiptiane (2016–2020), vazhdon të mbetet nevojë sigurimi i ndihmës për familjet rome dhe egjiptiane që nuk janë në gjendje të paguajnë qiranë e banesave sociale dhe ato që kanë ose do të kenë të drejtë të marrin kredi të subvencionuar (përfshirë, pa kufizime, negocimin e planeve të pagesave, referimin në punësim dhe shërbime të tjera përkatëse). Plani i ri parashikon zbatimin e programit të subvencionit të qirasë në njësitë e vetëqeverisjes vendore, si dhe të programit të banesave me kosto të ulët, nëpërmjet instrumenteve financiare, si granti i menjëhershëm apo i subvencionimit të interesave të kredisë, për pakicat rome dhe egjiptiane. Gjithashtu, vënia në funksionim i sistemit elektronik të aplikimeve *online* për strehim social dhe krijimi i bazës së të dhënave në nivel kombëtar do të jetë një risi e këtij plani.

Objektivi specifik 2. Miratimi i kuadrit ligjor dhe bashkëpunimi midis institucioneve



në nivel qendror dhe vendor për adresimin e nevojave për legalizimin dhe strehimin social

Legalizimi i banesave ekzistuese të anëtarëve të pakicave rome dhe egjiptiane kërkon ndjekjen e një procedure të ndërlikuar. Për rrjedhojë lind nevoja për ofrimin e asistencës teknike në ndjekjen e procedurave të legalizimit. Pagesa e truallit dhe e kostove të tjera që implikohen me legalizimin janë të papërballueshme për shumë familje rome dhe egjiptiane. Këtë e vështirëson edhe më shumë mungesa e ndërgjegjësimit dhe e kapacitetit për ndjekjen e procedurave të legalizimit nga anëtarët e të dy komuniteteve.

Rikonstruksioni i banesave ekzistuese të romëve është i pamundur nëse janë ndërtuar në mënyrë të paligjshme përfshirë këtu edhe mungesën e financimit në nivel vendor. Përmirësimi i infrastrukturës në zona të banuara nga romët dhe egjiptianët është ndonjëherë i mundur, por i kushtueshëm për t'u trajtuar vetëm nga vetëqeveritë vendore. Plani i ri i veprimit parashikon investime infrastrukturore në zonat ku jeton pjesa më e madhe e romëve dhe e egjiptianëve, përfshirë këtu: rregullimin e rrugëve, kanalizimeve, ujësjellësit, ndriçimi dhe rikonstruksion banesash.

Aktualisht, shumica e banesave informale të romëve shkatërrohen për të mundësuar realizimin e projekteve të punëve publike dhe familjet e prekura nuk përfitojnë asnjë kompensim ose kompensim të papërshtatshëm. Prishja e këtyre banesave shpesh nuk kryhet në bashkëpunim me autoritetet e mbrojtjes sociale dhe familjeve të prekura nuk u ofrohet asnjë mundësi strehimi, p.sh. bonus për qiranë, truall i pajisur me infrastrukturë, kredi me kushte lehtësuese ose sistemin në banesa sociale. Plani i ri parashikon miratimin e aktit nënligjor në zbatim të pikës 2, neni 33, të ligjit nr. 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë". Ky akt do të përcaktojë mënyrat e trajtimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit financiar, format alternative të trajtimit, si dhe rregullat dhe afatet për realizimin e tyre. Përfitues janë të gjithë poseduesit e ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen dhe që trajtohen nga shteti nëpërmjet shpërblimit financiar, programeve sociale të strehimit ose formave alternative të trajtimit.

Ka një mungesë të koordinimi dhe bashkërendimi të veprimeve midis institucioneve

vendore dhe qendrore. Për pasojë nuk ka studime paraprake lidhur me impaktin human dhe social dhe realitetin specifik të një zone apo grupimi të caktuar. Numri i aplikimeve me projekte konkrete bazuar në terma të referencës të njësive të vetëqeverisjes vendore pranë Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë në programin për përmirësimin e kushteve të jetesës së pakicave rome dhe egjiptiane është i ulët. Kapacitetet e stafit të vetëqeverisjes vendore për përgatitjen e propozimeve narrative dhe financiare, me qëllim tërheqjen e fondeve dhe zbatimin e projekteve të strehimit që u përgjigjen nevojave të romëve dhe të egjiptianëve dhe parandalimin e ndarjes kanë nevojë të forcohen. Ka mungesë të planit të strehimit për familjet e prekura nga zhvillimi i infrastrukturës, mbështetur kjo në planet rregulluese të NJVV-së. Për këtë qëllim plani parashikon trajnimin e stafit të vetëqeverisjes vendore dhe grupeve përfituese mbi bazën ligjore, zbatimin e programeve 5-vjeçare të strehimit dhe mënyrën për të aplikuar për mbështetje financiare nga buxheti i shtetit, ku trajtohen edhe nevojat e Komunitetit Rom dhe Egjiptian.

Tërmeti i vitit 2019 shkaktoi dëme të mëdha në disa bashki të vendit të cilat kanë një numër të madh banorësh nga pakicat rome dhe egjiptiane. Si pasojë e kësaj fatkeqësie natyrore 356 familje (afërsisht 1.541 persona) nga pakicat rome dhe egjiptiane u prekën nga tërmeti i datës 26 nëntor 2019. Fatkeqësia natyrore bëri që pakicat rome dhe egjiptiane të jenë të ekspozuara ndaj shumë dobësive të lidhura me të drejtat dhe shërbimet themelore, të tilla si hyrja në tregun e punës, kujdesi shëndetësor, arsim, strehim.

Qëllimi i politikës 3. Ulja e hendekut në cilësinë e shëndetit midis romëve dhe egjiptianëve dhe pjesës tjetër të popullsisë

Për zbatimin e kësaj politike, institucionet shtetërore që kanë përgjegjësi në këtë fushë në partneritet me institucione dhe organizata të tjera do të fokusohen në këta objektiva specifikë:

Objektivi specifik 1	Përmirësimi i shëndetit të romëve dhe të egjiptianëve përmes rritjes së aksesit të tyre në shërbime cilësore shëndetësore dhe atyre parandaluese.
Objektivi specifik 2	Krijimi dhe fuqizimi i pozicionit të mediatorit shëndetësor.



Objektivi specifik 3 Fuqizimi i strukturave për informim dhe promocion shëndetësor për shërbimet e kujdesit shëndetësor për romët dhe egjiptianët.

Objektivi specifik 4 Ulja e numrit të anëtarëve të pakicave rome dhe egjiptiane me sëmundje infektive seksualisht të transmetueshme.

Objektivi specifik 1. Përmirësimi i shëndetit të romëve dhe të egjiptianëve përmes rritjes së aksesit të tyre në shërbime cilësore shëndetësore dhe atyre parandaluese

Të dhënat e raportit të Bashkimit Evropian vunë në dukje se pandemia COVID-19 shkaktoi përjashtimin, varfërinë dhe diskriminimin për një kohë të gjatë ndaj romëve. Në përgjigje të krizës, u vendosën masa të synuara emergjente dhe parandaluese për të mbrojtur popullsinë, përfshirë komunitetet e marginalizuara rome. Sidoqoftë, disa masa emergjente, të tilla si: higjiena personale, provuan një sfidë për 30% të romëve që jetojnë në familje pa ujë çezme. Përputhshmëria me rekomandimet e higjienës personale ishte, gjithashtu, e diskutueshme, pasi 40% e romëve nuk kanë pajisje sanitare në banesat e tyre. 80% të romëve jetojnë në lagje të ngushta, të mbipopulluara, të cilat e bënin distancën fizike, një element kryesor të masave parandaluese të shëndetit publik, pranë së pamundurës. Në territoret e thella rurale, romët u përballen me më shumë disavantazhe: izolimi, përqendrimi i lartë i njerëzve të varfër dhe mungesa e larmisë së popullsisë, mungesa e zgjidhjeve alternative në rast të mungesës së shërbimeve themelore publike, rrezik i lartë i shfrytëzimit dhe i abuzimeve. Mungesa e aktivitetit ekonomik në nivel lokal dhe transporti i pamjaftueshëm publik pengoi popullatën të përfitojë nga vendet e punës dhe mundësitë e arsimit në qendrat urbane. Për të përballur këtë sfidë të pandemisë, e cila mendohet të zgjasë deri në fund të viti 2023, plani i ri parashikon masa të cilat do të mbështesin anëtarët e të dyja komuniteteve për të përballuar këtë situatë.

Objektivi specifik 2. Krijimi dhe fuqizimi i pozicionit të mediatorit shëndetësor

VKM-ja për pozicionin e ndërmjetësve të kujdesit shëndetësor për ofrimin e shërbimeve shëndetësore publike nuk u aprovua gjatë kohës së

implementimit të planit 2016–2020. Ka një mungesë të zyrtarizimit (integrimi të pozicionit të ndërmjetësuesit në shëndetësi), si dhe organizimit efektiv të romëve në programet e ndërmjetësimit shëndetësor. Plan i ri parashikon që deri në fund të vitit 2021 të krijohet pozicioni i mediatorëve, edukatorëve të shëndetit dhe vullnetarëve për institucionet që ofrojnë shërbimet publike, si dhe rekrutimi dhe trajnimi i romëve dhe egjiptianëve si mediator për shtrirjen e shërbimeve shëndetësore.

Objektivi specifik 3. Fuqizimi i strukturave për informim dhe promocion shëndetësor për shërbimet e kujdesit shëndetësor për romët dhe egjiptianët

Ka një numër të madh rastesh kur anëtarët e pakicave rome dhe egjiptiane nuk përfitojnë nga sigurimet shoqërore për shkak të invaliditetit ose nga skema e ndihmës ekonomike. Shumë anëtarë të pakicave rome dhe egjiptiane, të cilët për arsye të ndryshme (p.sh. vendbanimi gjendet larg qendrës shëndetësore) e kanë të pamundur të përfitojnë shërbime shëndetësore ose sociale. Për këtë arsye plani i ri parashikon sigurimin e informacionit, diagnostikimin bazë dhe ndihmën e parë nëpërmjet ekipeve mjekësore të lëvizshme për romët dhe egjiptianët në vendbanime informale, të cilët nuk mbulohen nga sistemi bazë (pra që u mungojnë dokumentet personale/vërtetimi i banimit). Ky plan parashikon të kryejë një studim në lidhje me largësinë e vendbanimeve rome dhe egjiptiane nga qendrat shëndetësore, si dhe nevojat për ngritjen e pikave të reja shëndetësore pranë vendbanimeve rome dhe egjiptiane dhe për rrjedhojë funksionimin i pikave të dedikuara të ambulancave pranë zonave të populluara nga anëtarë të pakicave rome dhe egjiptiane bazuar në gjetjet e studimit.

Objektivi specifik 4. Ulja e numrit të anëtarëve të pakicave rome dhe egjiptiane me sëmundje infektive seksualisht të transmetueshme

Informacioni, në lidhje me shërbimet shëndetësore, nuk arrin të përcillen tek anëtarët e të dyja komuniteteve. Ka mungesë të informacionit në lidhje me metodat e planifikimit familjar, shërbimet që ofrohen nga kujdesi parësor. Nuk ka informacione të përgatitura në gjuhën rome për të lehtësuar përthithjen e mesazheve prej anëtarëve të dyja komuniteteve. Plan i ri parashikon përgatitjen e informacioneve të thjeshta dhe materialeve promociionale për çështjet shëndetësore, edhe në



gjuhën rome dhe me figura; zhvillimin e fushatave sensibilizuese pranë vendbanimeve rome dhe egjiptiane për situata të ndryshme; informimi dhe edukimi me anëtarë të pakicave rome dhe egjiptiane në lidhje me sëmundjet seksualisht të transmetueshme, si dhe shëndetin riprodhues.

Qëllimi i politikës 4. Rritja e aksesit të barabartë në arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës për romët dhe egjiptianët në të gjitha nivelet arsimore

Për zbatimin e kësaj politike, institucionet shtetërore që kanë përgjegjësi në këtë fushë në partneritet me institucione dhe organizata të tjera do të fokusohen në këta objektiva specifike:

Objektivi specifik 1	Arsim cilësor, gjithëpërfshirës dhe i barabartë për romët dhe egjiptianët në të gjitha nivelet arsimore.
Objektivi specifik 2	Përkrahja e një sistemi gjithëpërfshirës të arsimit, duke mundësuar qasje të barabartë në arsim cilësor për romët dhe egjiptianët.
Objektivi specifik 3	Trashëgimia kulturore rome dhe egjiptiane si vlerë e trashëgimisë kulturore shqiptare.

Objektivi specifik 1. Arsim cilësor, gjithëpërfshirës dhe i barabartë për romët dhe egjiptianët në të gjitha nivelet arsimore

Zbatimi i urdhrat të përbashkët MAS, MB, MSHMS nr. 292, datë 28.5.2019, “Për identifikimin dhe për regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës së detyrimit shkollor”, shoqëruar me identifikimin në kohë të fëmijëve të moshës shkollare që nuk janë regjistruar apo kanë braktisur shkollën dhe monitorimi i frekuentimit të tyre është një ndër masat e parashikuara në plan për të mbyllur hendekun arsimor që ekziston midis fëmijëve romë dhe egjiptianë dhe atyre joromë. Pjesëmarrja e ulët e fëmijëve romë dhe egjiptianë në arsimin parashkollor dhe barrierat gjuhësore i gjen ata të papërgatitur për mjedisin shkollor, duke i bërë që të mbeten prapa dhe eventualisht të braktisin shkollën. Problemi i braktisjes lidhet, gjithashtu, me arsimin e kushtueshëm, varfërinë e lartë të familjeve, mungesën e transportit publik, përfshirja e fëmijëve si forcë pune, por edhe për shkak të martesave të hershme. Familje rome dhe egjiptiane me të ardhura mujore nën pagën minimale hasin vështirësi për të përballuar tarifën dhe kostot e tjera që lidhen me regjistrimin/frekuentimin e kopshtit dhe arsimit të detyrueshëm. Në këtë drejtim plani

parashikon që njësitë e vetëqeverisjes vendore të sigurojnë dhe të përmirësojnë kushtet për arsim cilësor gjatë fëmijërisë së hershme, nëpërmjet regjistrimit të të gjithë fëmijëve romë dhe egjiptianë 3–6 vjeç në arsimin parashkollor, duke i përjashtuar nga tarifën financiare dhe pagesat për ushqim. Gjithashtu do të sigurohet transport falas për nxënësit romë dhe egjiptianë, të cilët banojnë larg kopshteve dhe shkollave (edhe nën distancën 2 km për raste specifike të justifikuara). Ndërkohë që plani parashikon edhe rritje të subvencionimit shtesë, mbi ndihmën ekonomike, për nxënësit romë dhe egjiptianë që ndjekin rregullisht arsimin e detyrueshëm.

Shkollat publike të arsimit bazë (i detyrueshëm) mund të ofrojnë arsim plotësues dhe jo kurse për të ndërtuar dhe zhvilluar njohuritë bazë në shkrim/lexim. Në disa shkolla të arsimit bazë zbatohet nisma “Bëjmë detyrat e shtëpisë”, ku mund të përfshihen nxënësit romë dhe egjiptiane, për të cilët raportohet se kanë vështirësi të natyrave të ndryshme, pasi kanë prindër të paarsimuar dhe nuk arrijnë të ndihmojnë me detyrat e shtëpisë.

Një çështje tjetër që lidhet me arsimin cilësor është që fëmijët romë dhe egjiptianë shpesh nuk kanë prindër të arsimuar, për rrjedhojë ata nuk përfshihen mjaftueshëm në edukimin shkollor të fëmijëve të tyre ose nuk arrijnë t’i ndihmojnë me detyrat e shtëpisë. Në këtë drejtim në plan është parë shumë i nevojshëm që shkollat publike të arsimit të detyruar, në bashkëpunim me njësitë e vetëqeverisjes vendore të ofrojnë kurse për të ndërtuar dhe për të zhvilluar njohuritë bazë në shkrim/lexim dhe aftësitë jetësore të prindërve romë dhe egjiptianë dhe, gjithashtu, programeve të veçanta mbashkollare për fëmijët.

Gjithashtu, incentivat, si bursat apo kuotat e veçanta për të rinjtë romë dhe egjiptianë janë shumë të rëndësishme për një tranzicion efektiv të kalimit të tyre në të gjitha nivelet arsimore. Prandaj plani ka përfshirë masa që mbështesin studentëve romë dhe egjiptianë që ndjekin arsimin e mesëm të lartë dhe të lartë nëpërmjet ofrimit të bursave, reduktimit të tarifës së shkollimit dhe përjashtimit nga tarifa e pagesës për mbrojtjen e gjuhës së huaj, detyruese për pajisjen me diplomë dhe, gjithashtu sigurimin e kuotave të veçanta¹²³.

¹²³ Për studentët romë dhe egjiptiane të cilët identifikohen nëpërmjet vetë deklaratimit, nuk aplikohet

**Objektivi specifik 2. Përkrahja e një sistemi gjithëpërfshirës të arsimit, duke mundësuar qasje të barabartë në arsim cilësor për romët dhe egjiptianët**

Qëndrimet negative dhe paragjykimet ndaj pakicave rome dhe egjiptiane pasqyrohen në komunitetin e shkollës (p.sh. romëve/egjiptianëve u vihen nofka, nuk ka një standard sjelljeje në lidhje me mosdiskriminimin, nxënësit romë dhe egjiptianë me rezultate të dobëta nuk futen në klasat më të mira ose ulen në bankat e fundit). Për të përkrahur një sistem gjithëpërfshirës të arsimit është i domosdoshëm trajnimi i stafit të institucioneve arsimore parashkollore dhe parauniversitare dhe promovimi i historisë dhe i kulturës rome. Ndërkohë që ka shumë raste të shkollave me një përqendrim shpërpjesëtimor të nxënësve romë dhe egjiptianë, që krijon segregim dhe ndarje. Për këto çështje plani parashikon që 90% e personelit arsimor të jetë trajnuar për arsimin gjithëpërfshirës, diversitetin dhe antixhopsizmin deri në fund të 2025-ës, ndërkohë që do të bëhet rishikim i kurrikulave dhe i librave shkollorë të arsimit të detyruar dhe të mesëm të lartë, për të siguruar që ato pasqyrojnë tolerancën dhe bashkëpunimin ndërkulturor dhe përfshijnë materiale mbi historinë dhe identitetin rom dhe egjiptian. Zhvillimi i kurrikulës për mësimin e gjuhës rome në arsimin parauniversitar dhe atë të lartë dhe zbatimi i parimit të barazisë në punësimin e mësuesve romë dhe egjiptianë janë, gjithashtu, pjesë e planit të ri. Kjo është në përputhje me standardet evropiane, sipas rekomandimit CM/Rec(2020)2 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës për shtetet anëtarë për përfshirjen e historisë së romëve dhe/ose

reduktim i tarifave të shkollimit, por përjashtim nga pagesa e këtyre tarifave, nëse ata kanë plotësuar kriteret e pranimit në programe të studimeve profesionale, programe të ciklit të parë të studimeve ose programe të integruara të studimeve në institucionet publike të arsimit të lartë në zbatim të vendimit nr. 269 datë 29.3.2017, i Këshillit të Ministrave, i ndryshuar. Ndërsa në bazë të VKM-së nr. 780, datë 26.12.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë “studentët romë dhe ballkano-egjiptianë, kur janë të konfirmuar si të tillë nga ministria përgjegjëse për mbrojtjen sociale, përfitojnë reduktim të tarifës së shkollimit, kur plotësojnë kriteret e pranimit në ciklin e dytë të studimeve.

udhëtarëve në kurrikulat shkollore dhe materialet mësimore dhe mund të vendoset edhe linku i rekomandimit.

Identifikimi dhe adresimi i nevojave të nxënësve, që nuk janë regjistruar në arsimin e detyrueshëm, nuk vijojnë rregullisht mësimin apo janë në rrezik braktisjeje, është, gjithashtu, pjesë e masave të planit. Synohet ngritja e grupeve të punës ndërsektoriale funksionale në 61 bashki dhe referimi i familjeve të këtyre fëmijëve në shërbimet e mbrojtjes sociale.

Objektivi specifik 3. Trashëgimia kulturore rome dhe egjiptiane, si vlerë e trashëgimisë kulturore shqiptare

Brenda kornizës së trashëgimisë kulturore, plani parashikon evidentimin, promovimin dhe ruajtjen e trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale të romëve dhe të egjiptianëve. Në këtë kontekst plani përfshin planifikim dhe mbështetje të projekteve artistiko-kulturore që promovojnë identitetin, kulturën dhe historinë e romëve dhe të egjiptianëve në nivel kombëtar dhe lokal që do të mbështeten nga fondi i Ministrisë së Kulturës dhe nga Fondi për Pakicat Kombëtare përcaktuar nga Komiteti për Pakicat Kombëtare, sipas ligjit nr. 96/2017, “Për mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë”. Informim për kulturën rome dhe egjiptiane nëpërmjet programeve të institucioneve mediatike publike është planifikuar, gjithashtu, si një masë shumë e rëndësishme në plan, për ndërgjegjësimin e shoqërisë dhe promovimin e diversitetit kulturor, dhe do të zbatohet nga Ministria e Kulturës në bashkëpunim me RTSH-në.

Vazhdon të jetë problematik dhe mungon digjitalizimi i trashëgimisë kulturore të romëve dhe të egjiptianëve, në mënyrë që të ruhen dhe transmetohen tiparet e identitetit të tyre brezave të ardhshëm. Në këtë drejtim plani parashikon trajnim dhe këshillim të romëve dhe të egjiptianëve mbi standardet e dokumentimit të diversitetit dhe trashëgimisë jomateriale dhe nëpërmjet krijimit të broshurave, fletëpalosjeve, studimeve, librave me histori/përralla etj.

Qëllimi i politikës 5. Krijim i mundësive të barabarta për punësim cilësor dhe të qëndrueshëm për romët dhe egjiptianët

Për zbatimin e kësaj politike, institucionet shtetërore që kanë përgjegjësi në këtë fushë në



partneritet me institucione dhe organizata të tjera do të fokusohen në këta objektiva specifike:

Objektivi specifik 1	Nxitja e punësimit të romëve dhe të egjiptianëve nëpërmjet AFP-së, dhe PATP-ve.
Objektivi specifik 2	Nxitja e sipërmarrjes (sociale) dhe vetë-punësimit të romëve dhe të egjiptianëve.
Objektivi specifik 3	Rritja e kapaciteteve dhe përmirësimi i performancës së punës së stafit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive dhe të arsimit dhe formimit profesional, për integrimin e Romëve dhe të Egjiptianëve në tregun e punës.

Objektivi specifik 1. Nxitja e punësimit të romëve dhe të egjiptianëve nëpërmjet AFP-së, dhe PATP-ve.

Akomodimi i romëve dhe egjiptianëve në tregun e punës dhe nxitja e punësimit të tyre nëpërmjet arsimit e formimit profesional (AFP-së) dhe programeve aktive të tregut të punës (PATP-ve) është një nga objektivat kryesore të planit dhe një sfidë për shkak të problematikave që paraqet. Statusi i papunësisë afatgjatë të romëve dhe të egjiptianëve dhe kualifikimet e pakta bëjnë që të mos kenë aftësitë e nevojshme dhe kulturën e punës. Nga ana tjetër varfëria dhe rëndësia e sigurimit të nevojave bazë ul ndjeshëm interesin e Romëve dhe të Egjiptianëve për të marr pjesë dhe përfunduar programet e nxitjes së punësimit. Megjithatë riskstrukturimi i AKPA-s institucionit përgjegjës për zbatimin e politikave të punës erdhi së bashku me riprojektim të PATP-ve dhe duke marr në konsideratë nevojat e grupeve në rrezik si romët dhe egjiptianët, shumica e tyre nuk janë të regjistruar si punëkërkuar të papunë, sidomos kontigjenti i të rinjve dhe grave. Prandaj ky plan parashikon jo vetëm informimin e Romëve dhe të Egjiptianëve rreth politikave/programeve të reja të punësimit por dhe rritjen e aksesit në shërbimet e këshillimit/orientimit për karrierë. Masa të tjera pjesë e planit që do të zbatohen nga AKPA lidhen me rritjen e pjesëmarrjes së romëve dhe egjiptianëve në programet e zhvillimit të aftësive, kualifikimit profesional, dhe nëpërmjet vetëpunësimit apo programit të punëve publike në komunitet si pjesë e PNP-ve.

Një nga elementet kryesore që ndikon në mënyrë të drejtpërdrejtë në rritjen e

punësueshmërisë së romëve dhe të egjiptianëve është rekomandimi dhe mbështetja e atyre që arrijnë të përfundojnë një shkollë profesionale ose universitet të aplikojnë për punë të përshtatshme (papunësia e të sapodiplomuarit i dërgon një sinjal negativ komunitetit në përgjithësi rreth AFP-së dhe vlerës së arsimit të lartë). Përgjithësisht institucionet qeveritare (përfshirë ministritë, policinë, shkollat, spitalet, qendrat e kujdesit shëndetësor etj.) nuk punësojnë shumë romë dhe egjiptianë. Në lidhje me këtë plani parashikon dhënien përparësi të rinjve romë dhe egjiptianë të përfshihen në Programin Kombëtar të Praktikave të Punës, përcaktimin e kuotave ose të preferencave që mundësojnë punësimin e romëve dhe të egjiptianëve në administratën publike dhe shënjestrin eksplicit të romëve dhe të egjiptianëve në skemat e Garancisë Rinore.

Gjithashtu, plani parashikon marrjen e masave nëpërmjet mbështetjes financiare të bizneseve të vogla formale, dhe informale për uljen e ndikimit të epidemisë shkaktuar nga COVID-19 për romët dhe për egjiptianët, të cilët vuajtën dyfish izolimin gjatë karantinës, sepse nuk kishin mundësinë e punës në distancë. Në fakt, një nga mënyrat më efikase për të nxitur punësimin e romëve dhe të egjiptianëve është formalizimi i punës së tyre të padëklaruar.

Objektivi specifik 2. Nxitja e sipërmarrjes (sociale) dhe e vetëpunësimit të romëve dhe të egjiptianëve

Romët dhe egjiptianët janë ndër grupet kryesore përfituese prej ligjit nr. 65/2016, “Për ndërmarrjet sociale në Republikën e Shqipërisë”, megjithatë, që prej hyrjes në fuqi të ligjit dhe zbatimit të tij nuk ka pasur asnjë përfitues. Është e domosdoshme të mbështetet *zhvillimi i një mjedisi të favorshëm për të inkurajuar përfshirjen e romëve dhe të egjiptianëve në krijimin e ndërmarrjeve sociale, si një masë për nxitjen e punësimit të tyre*. Në lidhje me këtë, Planin parashikon dhënien prioritet dhe trajnimin e OJF-ve romë dhe egjiptiane për kuadrin ligjor dhe rregullator të ndërmarrjes sociale, menaxhimin financiar dhe planin e biznesit për shërbimet e ofruara.

Përveç AKPA-së, përgjegjës për mbështetjen e vetëpunësimit të romëve dhe të egjiptianëve janë edhe njësitë e vetëqeverisjes vendore, të cilat nëpërmjet skemave për garantimin e vetëpunësimit ofrojnë grante të vogla/kredi të buta dhe shërbime mbështetëse ose lehtësira si ulja e taksave apo e



tarifave vendore për bizneset. Megjithatë eksperiencia tregon jo të gjitha bashkitë kanë përmbushur këtë angazhim. Nga ana tjetër, romët dhe egjiptianët zakonisht operojnë në ekonominë informale, me produktivitet të ulët, kushte të këqija të punës, fitim të dobët dhe që ofron pak gjasa për përmirësimin dhe rritjen ekonomike. Mënyra më efikase për të nxitur punësimin e romëve është përmes formalizimit të punës së tyre të padeklaruar. Në këtë kontekst, deri në fund të 2025-ës, ky plan parashikon që të paktën 300 romë dhe egjiptianë të mbështeten financiarisht për sipërmarrje dhe vetëpunësim, me qëllim akomodimin e tyre në ekonominë formale. Disa nga masat e përfshira në plan për të arritur këtë objektiv janë: ulja e taksave dhe e tarifave vendore me 50 për qind për bizneset e ngritura nga romët dhe egjiptianët, dhe për ato biznese që kanë të punësuar një numër të konsiderueshëm të romëve dhe të egjiptianëve; ii. përjashtimi ose reduktimi nga tarifrat për ambulantët romë dhe egjiptianë, që tregtojnë produkte artizanale ose mallra të tjera; iii. rezervim i hapësirave të caktuara tregtare dhe pajisja me infrastrukturën e nevojshme për t'u përdorur nga romët dhe egjiptianët; iv. priorizim i romëve dhe i egjiptianëve për t'u përfshirë dhe përfituar nga grantet e programit IPARD II për bujqësinë dhe zhvillimin rural.

Një targetgrup tjetër brenda komunitetit rom dhe egjiptian, që i përket punës së padeklaruar, janë ricikluesit. Në lidhje me këtë është i rëndësishëm formalizimi i këtij aktiviteti dhe ndërtimi i një pakete specifike mbështetur nga legjislacioni përkatës, që mbron të drejtat e ricikluesve të mos ngelin të papunë, por të mbeten pjesë e sistemit të ri që modernizon grumbullimin e mbetjeve dhe diferencimit të tyre në burim. Për këtë plani parashikon bërjen e një studimi mbi pozicionin e ricikluesve dhe mekanizmat për përfshirjen e romëve dhe të egjiptianëve dhe një pakete të veçantë, që mbështet, favorizon dhe lejon grumbulluesit romë dhe egjiptianë të materialeve të riciklueshme të ushtrojnë aktivitetin e riciklimit direkt në burim.

Objektivi specifik 3. Rritja e kapaciteteve dhe përmirësimi i performancës së punës së stafit të AKPA-së dhe të AFP-së, për integrimin e romëve dhe të egjiptianëve në tregun e punës

Ndërmjetësimi është një nga masat e përdorura gjerësisht për të trajtuar pabarazitë me të cilat përballen romët dhe egjiptianët, në lidhje me qasjen në punësim, shëndetësi dhe arsimim. Megjithëse një praktikë pozitive e njohur në gjithë Evropën, në Shqipëri ka rezultuar i vështirë akomodimi i mediatorëve/ndërmjetësuesve pranë institucioneve shtetërore. Një nga masat e planit për përmirësimin e kapacitetit të AKPA-së për integrimin e romëve dhe të egjiptianëve në tregun e punës është pikërisht punësimi i 12 mediatorëve në 12 zyrat rajonale të punësimit. Mediatorët do të shërbejnë për të përmirësuar komunikimin dhe bashkëpunimin midis romëve dhe egjiptianëve dhe institucioneve publike në funksion të përmirësimit të aksesit, eficiencës dhe impaktit të programeve PNP kundrejt pakicave romë dhe egjiptiane.

Ndër problematikat, që ndikojnë drejtpërdrejt në integrimin në tregun e punës së romëve dhe të egjiptianëve, është edhe diskriminimi që shfaqet jo vetëm gjatë procesit të rekrutimit, por edhe në kushtet e punës, pagesa apo në avancimin në karrierë. Vetë zyrat rajonale të punësimit dhe shumica e qendrave të formimit profesional nuk kanë asnjë të punësuar me origjinë romë ose egjiptiane. Nga ana tjetër romët dhe egjiptianët nuk kanë besim tek institucionet publike, pasi ata trajtohen (shpesh jo të mirëpritur), si përfitues dhe nuk ndihen të lidhur me ofruesit e shërbimeve. Në këtë aspekt është shumë e domosdoshme rritja e ndërgjegjësimit dhe shpërndarja e materialeve informuese për mbrojtjen nga diskriminimi etnik në vendin e punës, sikurse promovimi i shembujve të suksesshëm të diversitetit kulturor dhe gjithëpërfshirjes. Në këtë drejtim plani përfshin përgatitjen e materialeve informuese mbi mbrojtjen e romëve dhe të egjiptianëve nga diskriminimi etnik në vendin e punës. Trajnime të detyrueshme të stafit AKPA-së dhe institucioneve përkatëse të varësisë për ofrimin e shërbimeve cilësore gjithëpërfshirëse të punësimit për romët dhe për egjiptianët janë planifikuar të zhvillohen. Përmirësimi i instrumenteve për parandalimin e diskriminimit të romëve dhe të egjiptianëve në



vendin e punës për shkak të përkatësisë etnike janë përfshirë, gjithashtu.

Qëllimi i politikës 6. Përmirësim i qasjes dhe rritja e aksesit të romëve dhe të egjiptianëve në programet e mbrojtjes sociale

Për zbatimin e kësaj politike, institucionet shtetërore që kanë përgjegjësi në këtë fushë në partneritet me institucione dhe organizata të tjera do të fokusohen në këta objektiva specifikë.

Objektivi specifik 1	Përfshirja e romëve dhe të egjiptianëve në programet e mbrojtjes sociale
Objektivi specifik 2	Riintegrimi social i përfituesve të ndihmës ekonomike nëpërmjet zbatimit të programit të daljes nga skema e ndihmës ekonomike
Objektivi specifik 3	Rritja e aksesit të romëve dhe të egjiptianëve në shërbimet e kujdesit shoqëror dhe modelimi i shërbimeve të reja të ofruara në komunitet
Objektivi specifik 4	Fuqizimi i kapaciteteve për identifikimin e romëve dhe të egjiptianëve në rrezik trafikimi/shfrytëzimi, si dhe referimi, mbrojtja dhe riintegrimi i rasteve të trafikuar/shfrytëzuara.
Objektivi specifik 5	Riintegrimi në shoqëri i familjeve që qëndrojnë në Qendrën Tranzitore të Emergjencave.

Objektivi specifik 1. Përfshirja e romëve dhe të egjiptianëve në programet e mbrojtjes sociale

Aplikimi i skemës së re të Ndihmës Ekonomike bëri që shumë familje rome dhe egjiptiane të mos ishin përfituese ose të ishin përfituese të pjesshme të masës së NE-së, për shkak të mungesës së informacionit dhe dokumenteve personale, moshedhjes në sistemin e zyrës së punës të punëkërkuarve të regjistruar dhe për shkak të plotësimit gabim të formularëve në terren nga ana e administratorëve shoqërorë. Prandaj masat e planit konsistojnë në garantimin e aksesit në aplikim të familjeve rome dhe egjiptiane në skemën e NE-së dhe trajnimin e administratorëve shoqërorë. Trajtimi nga fondi shtesë i kushtëzuar për bllokndihmën ekonomike, në varësi të pushtetit vendor për familjet jopërfituese, është parashikuar si masë në plan dhe, gjithashtu, përfitimi mujor i

shportës ushqimore dhe joushqimore për familjet në nevojë.

Si pjesë e programeve të mbrojtjes sociale është vlerësuar i domosdoshëm analiza dhe rishikim i kuadrit rregullator për kompensimin e energjisë, me qëllim që familjet rome dhe egjiptiane në nevojë të përfitojnë masën e kompensimit ose furnizimit me energji elektrike bazike. Në këtë kontekst plani përfshin miratimin e VKM-së “Për hartimin e kritereve dhe procedurave për përfitimin e statusit të klientit në nevojë dhe mënyrën e trajtimit të tyre”.

Gjithashtu, masa të tjera të rëndësishme në plan për këtë objektiv lidhen me mbështetjen e familjeve rome dhe egjiptiane, fëmijët e të cilëve frekuentojnë arsimin parashkollor dhe atë bazë. Në këtë drejtëm, në plan parashikohet: i. priorizim i regjistrimit të fëmijëve romë dhe egjiptianë në çerdhe dhe në kopshte; ii. rritja e shumës së subvencionit të pagesës të ndihmës ekonomike që marrin familjet rome dhe egjiptiane, fëmijët e të cilëve ndjekin arsimin bazë dhe vaksinohen; ii. miratimi i VKB-ve për reduktim/përrjashtimin nga detyrimi financiar për çerdhe dhe kopshte për fëmijët nga familjet rome dhe egjiptiane.

Objektivi specifik 2. Riintegrimi social i përfituesve të ndihmës ekonomike nëpërmjet zbatimit të programit të daljes nga skema e Ndihmës Ekonomike

Varfëria aktuale dhe kufizimet në tregun e punës e bëjnë të pashmangshme varësinë nga ndihma ekonomike për familjet rome dhe egjiptiane. Nga ana tjetër vështirësi paraqet edhe mbështetja e familjeve në skemën e ndihmës ekonomike, duke i referuar në shërbime të tjera, sidomos në nxitjen e punësimit dhe në programet e AFP-së, strehimin social, regjistrimin në gjendjen civile, kujdesin shëndetësor dhe arsimin. Në këtë aspekt është shumë i rëndësishëm rishikim i skemës riintegruese në tregun e punës së përfituesve të skemës së ndihmës ekonomike, sinkronizuar dhe me AKPA-në për të realizuar gradualisht daljen nga skema e NE-së dhe hyrjen në PNP apo tregun e punës.

Për këtë plani përfshin miratimin e një vendimi për vazhdimin e përfitimeve të NE-së për përfituesit romë dhe egjiptianë të regjistruar në PNP derisa të gjejnë punësim afatgjatë në vijim të përfundimit të programit të nxitjes së punësimit dhe priorizim për ata që dalin nga programet e



NE-së për të krijuar ndërmarrje sociale, zhvilluar *start-ups*, apo iniciativa ekonomike që gjenerojnë të ardhura.

Objektivi specifik 3. Rritja e aksesit të romëve dhe të egjiptianëve në shërbimet e kujdesit shoqëror dhe modelimi i shërbimeve të reja të ofruara në komunitet

Romët dhe egjiptianët ndihen të diskriminuar nga pikëpamja e aksesit në shërbimet publike. Ndërkohë që ofruesit e shërbimeve sociale apo të kujdesit shoqëror shfaqin mungesë aftësish për të trajtuar problematikat e diskriminimit dhe të përjashtimit social. Gjithashtu, vihet re mungesa e disa shërbimeve sociale dhe e zbatimit të fondit social në shumë bashki të vendit. Pushteti vendor duhet të fillojë të parashikojë fonde të vetat për ngritjen, mbështetjen dhe zgjerimin e shërbimeve shoqërore në territorin e tij, sipas nevojave përkatëse. Në këtë kontekst, rritja e aksesit të romëve dhe të egjiptianëve në shërbimet e kujdesit shoqëror dhe modelimi i shërbimeve të reja të ofruara në komunitet është shumë i rëndësishëm.

Për përmbushjen e këtij objekti plani përfshin këto masa: i. ngritja e kapacitetit të njësive të vlerësimit të nevojave dhe referimit; ii. funksionimin e ekipeve të lëvizshme pranë NJVV-së me pjesëmarrjen e romëve dhe të egjiptianëve, që bëjnë vlerësimin në terren për shërbime; iii. ngritja e shërbimeve të reja sociale me bazë komunitare, të financuara nga fondi social, për fëmijërinë e hershme apo të moshuarit që jetojnë vetëm; ofrimin e shërbimeve sociale specifike të integruara me bazë në komunitet për të fuqizuar individin, familjen dhe komunitetin; iv) fuqizim të mekanizmave të referimit dhe përmirësimi të shërbimeve në qendrat rezidenciale.

Objektivi specifik 4. Fuqizimi i kapaciteteve për identifikimin e romëve dhe të egjiptianëve në rrezik trafikimi/shfrytëzimi, si dhe referimi, mbrojtja dhe riintegrimi i rasteve të trafikuar/shfrytëzuara

Pandemia COVID-19 ka rritur rrezikun për punën dhe shfrytëzimin e fëmijëve, sidomos të atyre në situatë rruge, sepse burimet e jetesës dhe të ardhurat e familjeve të tyre janë zvogëluar. Rreziku është jashtëzakonisht i lartë dhe kërkon mbështetje të menjëhershme për të siguruar shërbime mbështetëse për fëmijët dhe familjet e tyre. Në këtë plan është planifikuar që deri në fund të 2025, 100% e stafit të ekipeve multidisiplinare është

trajnuar në menaxhimin e rasteve të fëmijëve në situatë rruge bazuar në parimin e “Interesi më i lartë i fëmijës”, ku i jepet prioritet riintegritit të fëmijës në familje. Gjithashtu, plani ka prioritet mbështetjen dhe fuqizimin e familjeve të fëmijëve në situatë rruge për një periudhë 2–3-vjeçare, nëpërmjet shërbimeve të integruara, paketave të start ups, gjenerimit të të ardhurave, strehimit social etj. Një aspekt tjetër i rëndësishëm i planit është informimi i romëve dhe i egjiptianëve mbi të gjitha format e trafikimit njerëzor përfshirë; shfrytëzimin e fëmijëve për punë, lypje dhe martesat në moshë të hershme.

Objektivi specifik 5. Riintegrimi në shoqëri i familjeve që qëndrojnë në Qendrën Tranzitore të Emergjencave

Plani parashikon që 100% e familjeve romë dhe egjiptiane që qëndrojnë në Qendrën Tranzitore të Emergjencave të riintegruhen deri në fund të vitit 2025. QKTE-ja në bashkëpunim me pushtetin vendor do të ofrojë mbështetje direkte për plotësimin e nevojave bazë të familjeve, me qëllim rehabilitimin, mirëqenien dhe riintegrimin e tyre në shoqëri. Përveç kësaj, plani parashikon monitorimin e familjeve mbas daljes nga qendra për të garantuar që përmirësimi i tyre është i qëndrueshëm dhe për të lehtësuar aksesin në shërbimet e reja kur nevojitet.

Qëllimi i politikës 7. Antixhopsizmi njihet dhe adresohet në politikat publike, si dhe përmes ndryshimeve sistematike dhe strukturore, për të garantuar një shoqëri të çliruar nga diskriminimi ndaj R&E

Për zbatimin e kësaj politike, institucionet shtetërore që kanë përgjegjësi në këtë fushë në partneritet me institucione dhe organizata të tjera do të fokusohen në këta objektiva specifike:

Objektivi specifik 1	Njohja dhe përfshirja e antixhopsizmit në politikat publike.
Objektivi specifik 2	Rritja e ndërgjegjësimit për R&E, si dhe publikun e gjerë për të drejtat e tyre, si pjesë integrale e shoqërisë shqiptare.
Objektivi specifik 3	Ulja e diskriminimit ndaj R&E dhe përmirësimi i aksesit në drejtësi për barazi.
Objektivi specifik 4	Minimizimi/eliminimi i gjuhës së urrejtjes dhe i krimeve të urrejtjes ndaj R&E.



Objektivi specifik 5 Rritja e fuqizimit dhe e pjesëmarrjes së qenësishme të OSHC-ve R&E në përfaqësimin e interesave dhe të drejtave të tyre.

Objektivi specifik 1. Njohja dhe përfshirja e antixhipsizmit në politikat publike

Përpyqjet për garantimin e mundësive të barabarta, përfshirjes, pjesëmarrjes dhe integritetit të plotë të pakicave romë dhe egjiptiane, si pjesë integrale e shoqërisë, mund kenë arritje të qëndrueshme vetëm nëse shkakët që kanë çuar në pabarazi dhe përjashtim adresohen rrënjësisht. Në këtë kuadër, për herë të parë, ndërmerret angazhimi politik për të përfshirë në fushat prioritare të planit kombëtar për integrimin e romëve dhe të egjiptianëve edhe antixhipsizmi (lufta kundër racizmit ndaj R&E). Për këtë, nevojitet të ndërmerren masa dhe veprimtari që synojnë realizimin e objektivave specifikë në rrugën drejt eliminimit të diskriminimit dhe racizmit. Hapi i parë në adresimin e çdo problemi është njohja e tij. Këtë synon edhe objektivi specifik 1, nën fushën e antixhipsizmit. Me përmbushjen e tij synohet që të arrihet njohja e antixhipsizmit, përkufizimi i qartë i tij, përfshirja dhe adresimi i antixhipsizmit në dokumentet dhe zbatimin e politikave publike.

Më konkretisht, nën objektivin specifik “Njohja dhe përfshirja e antixhipsizmit në politikat publike”, pritet që përgjatë jetës së këtij plani të jetë arritur që antixhipsizmi të jetë një koncept i mirëpërcaktuar, i njohur dhe integruar në 100% të dokumenteve politike dhe ligjore që trajtojnë çështje që prekin antiracizmin dhe integrimin e romëve dhe të egjiptianëve. Kjo duhet të shoqërohet me masa për ngritjen e kapaciteteve të gjithë zyrtarëve dhe profesionistëve të fushave të ndryshme, që punojmë me dhe për romët dhe egjiptianët në mënyrë që t’u krijohet mundësia për të ngritur kapacitetet e tyre në raport me njohjen dhe luftimin e antixhipsizmit. Së fundi, por jo për nga rëndësia, njohja dhe adresimi i antixhipsizmit kërkon edhe realizimin e një skanimit dhe analizimit i çdo ligji dhe politike ekzistuese, relevante për R&E, për të identifikuar dhe adresuar çdo situatë potenciale të shprehjes së diskriminimit direkte apo indirekt (apo i fshehtë) që mund të ndikojnë negativisht në jetët/mundësitë e barabarta për R&E.

Objektivi specifik 2. Rritja e ndërgjegjësimit për R&E, si dhe publikun e gjerë për të drejtat e tyre, si pjesë integrale e shoqërisë shqiptare

Përtej punës për njohjen, përfshirjen dhe ngritjen e kapaciteteve për ta përcaktuar dhe adresuar problematikën e antixhipsizmit, është e domosdoshme të punohet për rritjen e ndërgjegjësimit, si ndër anëtarët e pakicave romë dhe egjiptiane, ashtu edhe për gjithë shoqërinë, mbi rëndësinë e respektimit të të drejtave për R&E dhe mundësitë e barabarta për anëtarët e këtyre pakicave, si për çdo anëtar tjetër të shoqërisë. Për arritjen e këtij objekti kërkohej që, së pari, pakicat romë dhe egjiptiane dhe kontributi i tyre në shoqërinë shqiptare të dokumentohen, të njihen gjerësisht, si dhe të bëhen pjesë integrale e edukimit të brezave të rinj. Deri në fund të vitit 2025, synohet që e gjithë të arrijë një nivel të lartë ndërgjegjësimi mbi kontributin që pakicat romë dhe egjiptiane kanë dhënë dhe vazhdojnë të japin në jetën ekonomike, sociale, kulturore dhe politike të vendit, ashtu si edhe mbi domosdoshmërinë e respektimit dhe aktualizimit të të drejtave të tyre si pjesë integrale e shoqërisë shqiptare.

Kohët e fundit po vihet re një tendencë në rritje për dokumentimin dhe evidentimin e kulturës romë përmes çeljes së ekspozitave dhe botimit të librave. Këto dhe aktivitete të ngjashme janë disa nga veprimtaritë e pritura në kuadër të këtij objekti. Këto, si dhe aktivitete të tjera mund të shërbejnë në përkujtimin dhe festimin e kulturës romë dhe asaj egjiptiane në ditët e dedikuara si: 8 Prilli – Ditës Ndërkombëtare të Romëve; 24 Qershori – Ditës Kombëtare të Egjiptianëve; 5 Nëntori – Dita e Gjuhës Rome.

Paralelisht, kurrikula dhe tekstet shkollore të arsimit të detyruar duhen riparë, në kuadër të gjithëpërfshirjes, duke bërë pjesë të tyre (më shumë) elemente që u takojnë pakicave romë dhe egjiptiane. Së fundi, rritja e ndërgjegjësimit dhe e njohjes më të plotë, kërkon edhe hartimin dhe zbatimin e fushatave të dedikuara për ndërgjegjësimin për të drejtat e njeriut në/me komunitetet R&E.

Objektivi specifik 3. Ulja e diskriminimit ndaj R&E dhe përmirësimi i aksesit në drejtësi për barazi

Adresimi i problematikave nën fushën prioritare të antixhipsizmit e ka thelbin në përpjekjet për të ulur dhe, eventualisht, eliminuar racizmin dhe



diskriminimin, për shkak të përkatësisë racore/etnike. Përpjekjet në këtë drejtim orientohen si në planin legjislativ dhe rregullator ashtu edhe në planin e aksesueshmërisë ndaj parashikimeve ligjore. Për realizimin e këtij objekti pritët që deri në fund të 2025-ës, kuadri ligjor shqiptar për R&E të jetë 100% i përafuar me atë të BE-së, si dhe të gjithë anëtarët e pakicave R&E të kenë akses të plotë dhe të përmirësuar në shërbimet ligjore dhe të drejtësisë.

Edhe pse kuadri ligjor në raport me pakicat R&E ka ardhur gjithnjë duke u plotësuar dhe duke u bërë më garantues dhe mundësues, në kuadër të këtij objekti pritët që të avancohet më tej deri në një përafrim të plotë të kuadrit ligjor kombëtar me atë të BE-së, sa u takon gjithë komponentëve me ndjeshmëri ndaj çështjeve R&E. Në funksion të kësaj, inkurajohen dhe pritët të ndërmerren procese gjyqësore me interes publik, aksioneve pozitive etj. në luftën kundër diskriminimit të R&E. Rastet e diskriminimit ndaj R&E duhet të monitorohen në vazhdimësi përgjatë gjithë periudhës kohore të këtij plani me qëllim identifikimin e fushave me incidencë më të lartë dhe barrierave për të marrë drejtësi. Marrja e drejtësisë do të duhet të lehtësohet dhe mundësohet përmes dhënies së ndihmës ligjore falas për viktimat e diskriminimit R&E.

Objektivi specifik 4. Minimizimi/eliminimi i gjuhës së urrejtjes dhe i krimeve të urrejtjes ndaj R&E

Format më të rënda të diskriminimit dhe racizmit – gjuha dhe krimet e urrejtjes duhet të minimizohen deri në eliminimin e tyre. Masat e parashikuara në këtë plan synojnë që deri në fund të 2025, të kenë mundësuar që gjuha e urrejtjes ndaj R&E në sferën publike të jetë eliminuar plotësisht. Paralelisht, synohet që deri në fund të vitit 2025, krimet e urrejtjes ndaj R&E të jenë minimizuar dhe të mbijetuarve të këtyre krimeve t'u jetë mundësuar në të gjitha rastet mbështetja drejt rikuperimit dhe riintegrit. Për realizimin e objektit dhe targeteve të vendosura nevojitet që të kombinohen masa dhe veprimtari që ndihmojnë profesionistët të ngrenë kapacitetet e tyre për identifikimin dhe parandalimin e përdorimit të gjuhës së urrejtjes (si p.sh. trajnime për gazetarë, mësues, punonjës socialë, juristë, punonjës policie etj.). Me tej, kapacitetet duhet të ngrihen dhe të përforcohen për punonjësit e policisë, gjyqtarët dhe

prokurorët për njohjen dhe adresimin e krimeve të urrejtjes.

Përtej ndërgjegjësimit dhe rritjes së kapaciteteve në luftën kundër gjuhës dhe krimeve të urrejtjes, dokumentimi i tyre dhe krijimi i evidencave mbetet po aq i rëndësishëm. Monitorimi është thelbësor në këtë drejtim dhe do të fokusohet në monitorimin sistematik të gjuhës antixhipsiste dhe krimeve të urrejtjes (d.m.th. mbledhja e të dhënave dhe raportimi mbi gjuhën e urrejtjes ndaj R&E). OSHC-të të cilat i kanë kapacitetet dhe/ose duan të angazhohen në proceset monitoruese duhet të gjejnë mbështetje (veçanërisht për të arritur një mbulim sa më të madh me monitorimin edhe të mediumeve *online*, për të hequr/fshirë elemente të gjuhës së urrejtjes etj.).

Së fundi, por jo për nga rëndësia, angazhimi kundër gjuhës dhe krimeve të urrejtjes duhet të demonstron qartazi në të qenët proaktivë për të identifikuar viktimat të krimeve të urrejtjes dhe sigurimi i mbështetjes në raport me lehtësimin e aksesit/përfitimi i mbështetjes me shërbime mbështetëse dhe riintegruese (p.sh. asistencë psikosociale etj.) Ky komponent kërkon një qasje të integruar dhe angazhim të dedikuar në nivel vendor.

Objektivi specifik 5. Rritja e fuqizimit dhe e pjesëmarrjes së qenësishme të OSHC-ve R&E në përfaqësimin e interesave dhe të të drejtave të tyre

Si edhe në fusha të tjera prioritare, edhe nën atë të antixhipsizmit synohet që puna për R&E të bëhet me fuqizimin, përfshirjen dhe pjesëmarrjen e tyre. Kjo do të sigurojë jo vetëm një sens pronësie dhe autorësie për proceset, por edhe më shumë garanci për arritje dhe qëndrueshmëri. Pikës së pari, romët dhe egjiptianët do të garantohen me përfaqësi dhe pjesëmarrje në çdo grup pune që do të ngrihet, me qëllim adresimin e fushës prioritare të antixhipsizmit. 100% e grupeve të ngritura për punën, në kuadër të antixhipsizmit do të kenë në përbërje të tyre të paktën një përfaqësues nga SHC-ja rome dhe egjiptiane.

Në një plan tjetër do të punohet për mbështetjen, fuqizimin dhe partneritetin më të madh midis institucioneve publike dhe OSHC-ve rome dhe egjiptiane. Synimi është që deri në fund të 2025-ës, bashkëpunimi OSHC R&E – autoritet për mbrojtjen ndaj diskriminimit të jetë dyfishuar dhe OSHC-të R&E të kenë ngritur/përmirësuar



kapacitetet e tyre e të zënë të paktën 5% të projekteve të SHC-së të mbështetura me fonde publike.

PJESA III ZBATIMI, PËRGJEGJËSIA E INSTITUCIONEVE, LLOGARIDHËNIA, RAPORTIMI DHE MONITORIMI

Përgjegjësia e institucioneve

Fushat e politikave të përfshira në PKVBPPRE 2021–2025 përcaktojnë qartë ministrinë e linjës dhe institucionet në varësi të tyre, që janë përgjegjëse për zbatimin e tij.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

Ministria e Arsimit dhe Sportit

Ministria e Financave dhe Ekonomisë

Ministria e Drejtësisë

Ministria e Brendshme

Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

Ministria e Kulturës

Instituti i Statistikave

Njësitë e vetëqeverisjes vendore

Komiteti i Pakicave Kombëtare

Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Agjencia e Mbështetjes së Shoqërisë Civile

Shkolla Shqiptare e Administratës Publike

Shkolla e Magistraturës

Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nëpërmjet Drejtorisë së Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore koordinon krijimin dhe zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe të Egjiptianëve 2021–2025.

Sektori i Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore (SPSBGJ) ka në varësi *Njësine për Monitorimin dhe Vlerësimin e Politikave* (NJ MVP) për të zhvilluar studime dhe analiza që fokusohen në problemet e përjashtimit social në shoqërinë shqiptare. Kjo njësi harton një sërë *dokumentesh teknike për përfshirjen sociale*, të cilat do të trajtojnë një numër temash specifike prioritare të përcaktuara nga SPSBGJ-ja, si p.sh.: përjashtimi social i romëve dhe i egjiptianëve, i personave me aftësi të kufizuara, i komunitetit LGBT dhe tema të tilla, si dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje, trafikimi i fëmijëve, fëmijët në situatë rruge, përfshirja sociale e të rinjve, e kështu me radhë. Njësia e monitorimit dhe e vlerësimit, gjithashtu, mbështet *grupet teknike*

ndërsektoriale të politikave të përfshirjes sociale. Këto grupe përbëhen nga nëpunës civilë profesionistë të marrë nga ministrinë e linjës, që kanë njohuri rreth problemeve të përjashtimit social me të cilat përballen grupe të caktuara vulnerabël. Për çështjet e komunitetit rom dhe atij egjiptian, grupi teknik i punës mbledh së bashku nëpunës civilë profesionistë nga ministrinë e linjës përgjegjëse për punësimin, arsimin, shëndetësinë, strehimin, regjistrimin civil dhe drejtësinë dhe mbrojtjen sociale që përballen me problemet në nivel teknik. Ky grup takohet për të shkëmbyer informacion, në seminare shkëmbimi njohurish në nivel profesional dhe do të japin kontribute teknike për Planin Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe të Egjiptianëve 2021–2025 në Republikën e Shqipërisë, dhe do të raportojnë për progresin pranë Komitetit Ndërmnistror.

Ministrinë e linjës që janë përgjegjëse për arsimin, kujdesin shëndetësor, strehimin dhe integrimin urban, punësimin dhe të drejtat në punë, vetëqeverisjen vendore, drejtësinë, kulturën dhe punët e brendshme kanë caktuar pika kontakti për romët. Roli i tyre është të japin informacion për Planin Kombëtar të Veprimit, të monitorojnë dhe të raportojnë rreth ecurisë së zbatimit të tij. Organe të pavarura dhe teknike, siç p.sh. Shërbimi Kombëtar i Punësimit dhe Aftësimin, Enti Kombëtar i Banesave, Agjencia e Legalizimit, INSTAT-i dhe Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve luajnë, gjithashtu, një rol të rëndësishëm në zbatimin e politikave, mbledhjen e të dhënave dhe identifikimin e çdo problemi lidhur me pengesat me të cilat përballen romët, egjiptianët dhe grupet e tjera të marginalizuara.

Pjesa më e madhe e bashkive dhe veçanërisht ato me popullsi të madhe rome dhe egjiptiane kanë caktuar, gjithashtu, pika kontakti për zgjidhjen e vështirësive me të cilat përballen këto grupe. Pikat e kontaktit mbledhin të dhëna, promovojnë mekanizmat kundër diskriminimit, kërkojnë ndihmë për strehimin, sigurohen që fëmijët të frekuentojnë shkollën etj. Qëllimi i përgjithshëm i këtij sistemi në nivel kombëtar dhe lokal është që romët dhe egjiptianët të kenë akses në të njëjtat shërbime dhe të mund të ushtrojnë të drejta e tyre njësoj si çdo shtetas tjetër shqiptar.

*Kuadri vlerësues dhe monitorues*

Kuadri monitorues do të ushqejë orientimin e politikave në kuadër të Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI), i cili është sistemi kryesor vendimmarrës që përcakton drejtimin strategjik dhe alokimin e resurseve të vendit. Ai do të furnizojë me raporte monitoruese dhe vlerësuese Grupin e Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP), për Sektorin e Punësimit dhe atë Social, i ngritur me urdhrin e Kryeministrit nr. 157, datë 22.10.2018, “Për marrjen e masave për zbatimin e qasjes së gjerë sektoriale/ndërsektoriale, si dhe ngritjen dhe funksionimin e mekanizmit sektorial/ndërsektorial të integruar”. GMIP/Nëngrupi Tematik i Përfshirjes Sociale është grupi ku do të diskutohen çështje të ecursisë së zbatimit të objektivave dhe të masave së këtij Plani Veprimi dhe ku do të realizohet bashkëpunimi ndërinstitucional me grupet e interesit. Ky grup tematik që do të udhëhiqet nga MSHMS-ja dhe përbërje të strukturave ndërsektoriale.

Raporti i monitorimit të progresit të zbatimit të objektivave dhe të masave të këtij Plani do të paraqitet në mënyrë periodike çdo vit (brenda muajit mars të vitit pasardhës) dhe do të jetë pjesë e diskutimeve në takimet e Nëngrupit Tematik të Përfshirjes Sociale që do të udhëhiqet nga MSHMS-ja dhe përbërje të strukturave ndërsektoriale. Një raport përmbledhës i rezultateve të arritura nga implementimi i planit, analiza e performancës në 5 vjet të treguesve, mësimet e nxjerra, histori suksesi etj. do të finalizohet pas përfundimit të afatit kohor të këtij plani, në muajin mars të vitit 2026.

Sa i përket punës për monitorimin e zbatimit të PKVBPPRE 2021–2025, përgjegjëse do të jenë pikat e kontaktit për romët dhe egjiptianët në ministritë e linjës, të cilët mbledhin të dhëna dhe identifikojnë boshllëqet e informacionit që nevojitet. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka rol koordinues dhe raporton në mënyrë periodike mbi ecurinë e zbatimit. Plani i Veprimit parashikon publikimin e progresraporteve vjetore dhe mbështetjen për raportet monitoruese të shoqërisë civile.

Zyrtarët e ministrisë në Tiranë do të punojnë me përfaqësuesit rajonalë dhe lokalë për të përmirësuar cilësinë e të dhënave. Të dhënat administrative përdoren nga pjesa më e madhe e ministrive për të monitoruar pjesëmarrjen e

romëve dhe të një pjesë më të vogël egjiptianësh në programet e përgjithshme dhe të synuara të qeverisë, siç janë promovimi i punësimit, AFP, ndihma ekonomike etj. Gjithsesi, procesi i vetëdeklarimit si rom ose egjiptian nuk është i standardizuar dhe disa njësi qeverisëse në nivel qendror, rajonal dhe lokal hezitojnë të mbledhin këto të dhëna nga frika se mos dhunojnë të drejtat e privatësisë. Nevojitet ngritja e kapaciteteve për të garantuar që të gjitha zyrat shtetërore përkatëse të mund të mbledhin të dhënat e nevojshme për monitorimin e zbatimit të PKVBPPRE 2021–2025, duke mbrojtur njëkohësisht të drejtat e privatësisë të romëve dhe të egjiptianëve.

Në vazhdim të punës dhe të përpjekjeve të MSHMS-së për fuqizimin e mekanizmit efektiv të monitorimit dhe të vlerësimit të progresit në nivel kombëtar të PKVBPPRE 2021–2025, si dhe për bashkëveprimin ndërmjet ministrive të linjës dhe institucioneve/zyrave qeveritare për romët; qeveria do të vazhdojë të menaxhojë të dhënat në lidhje ndërhyrjet, përfituesit, rezultatet e këtij plani përmes sistemin elektronik *online* Romalb. Në këtë sistem do të vazhdojnë të hidhen dhe të përditësohen të dhëna për treguesit e Planit të Veprimit 2021–2025 dhe që do të kontribuojnë në: i. Lehtësimin e veprimtarisë së DPSBGJ-së pranë MSHMS-së në mbledhjen e të dhënave dhe harmonizimin e statistikave në kohë reale për nivele të ndryshme ndërhyrjesh në komunitetet rome dhe egjiptiane; ii. monitorimin dhe analizën e të dhënave në nivel kombëtar të indikatorëve të Planit të Veprimit; iii. përmirësimin e cilësisë së raporteve të gjeneruara nga stafi i DPSBGJ-së; si dhe iv. kompjuterizimin e mbledhjes së të dhënave për romët dhe egjiptianët, me qëllim monitorimin e ndërhyrjeve dhe vlerësimin e situatës për përmirësimin e cilësisë së jetesës së tyre. Koordinimi dhe harmonizimi i këtij sistemi me sisteme të ngjashme elektronike do të ndiqet qysh në hapat e parë të punës në mënyrë që të shmangen mbivendosjet dhe të rritet efektshmëria.

Udhëzuesi i indikatorëve i cili do të hartohet menjëherë pas aprovimit të PKVBPPRE 2021–2025, do të sjellë një qasje të re të mënyrës së hartimit të raporteve të progresit të indikatorëve të tij. Gjithashtu, ky (udhëzuesi) do të lehtësojë punën e DPSBGJ-së si dhe të gjitha ministrive të linjës, të cilat janë përgjegjëse për grumbullimin e informacionit të këtij plani kombëtar dhe



konkretizimin e tij në raporte periodike vjetore mbi progresin e arritur në drejtim të masave prioritare të parashikuara për periudhën 2021–2025.

SPSBGJ-ja pranë MSHMS-së do të marrë masat për trajnimin dhe ofrimin e asistencës teknike të vazhdueshme të përdoruesve të sistemit elektronik Romalb, për regjistrimin e të dhënave të treguesve të monitorimit, përditësimin e tyre, si dhe për administrimin e përshtatshëm të këtij sistemi. Në funksion të përdorimit me efektivitet të sistemit Romalb SPSBGJ, në cilësinë e koordinatorit të implementimit dhe të raportimit të këtij plani veprimi do të bashkëpunojë dhe do të bashkërendojë punën, përveçse me të gjitha ministritë e linjës, edhe me institucione të tjera të pavarura, si dhe do të propozojë masa për eficiencën e sistemit elektronik dhe përmirësimin e tij në të ardhmen.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale ka një rol koordinues dhe ndërkohë Drejtoria e Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore brenda kësaj ministrie monitoron zbatimin e PKVBPPRE 2021–2025 ndërsektorial dhe harton raportet e progresit. Për periudhën 2021–2025 është e nevojshme të forcohen kapacitetet e kësaj drejtorie, në mënyrë që të koordinohet sa më mirë zhvillimi i politikave dhe zbatimi jo vetëm i integritetit të romëve dhe të egjiptianëve, por, gjithashtu, edhe nxitja e përfshirjes sociale në nivele më të larta. Drejtoria e Përfshirjes Sociale dhe Barazisë Gjinore do të kërkojë ekspertë sektorialë dhe synon të punësojë romë dhe egjiptianë. Romët dhe egjiptianët duhet të takohen rregullisht jo vetëm me përfaqësuesit e ministrive dhe të shoqërisë civile në Tiranë, por, gjithashtu, të vizitojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore disa herë në vit, me qëllim që të fitojnë njohuri për zbatimin sa më të mirë të Planit të Veprimit dhe për të përballuar çdo sfidë.

Organizatat e shoqërisë civile luajnë, gjithashtu, një rol të rëndësishëm në ndërgjegjësimin rreth problemeve në zbatimin dhe mbështetjen e proceseve të mbledhjes së të dhënave. Duke qenë në kontakt të drejtpërdrejtë me komunitetet rome dhe egjiptiane, organizatat e shoqërisë civile janë në vendin e duhur për të nxjerrë mësimet e marra nga zbatimi i politikës dhe për t'u shpjeguar anëtarëve të komunitetit rëndësinë e mbledhjes së të dhënave.

Organizatat e shoqërisë civile që përfaqësonin komunitetet rome dhe egjiptiane morën pjesë në hartimin e PKVBPPRE 2021–2025, edhe përmes

grupeve të fokusuara, në fazën e mbledhjes së të dhënave, si dhe në seminarët sektoriale me institucionet shtetërore. Këto grupe pune duhet të vazhdojnë të funksionojnë pas miratimit të PKVBPPRE 2021–2025. Në këtë mënyrë organizatat e shoqërisë civile do të mund të mbajnë kontakte të vazhdueshme me pikat e kontaktit për romët, në ministritë e linjës, si dhe do të mund të përgjigjen me shpejtësi ndaj çdo problemi.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale do të lehtësojë gjithashtu koordinimin me organizatat ndërkombëtare, të cilat promovojnë integritetin e Romëve dhe të Egjiptianëve përmes programeve të tyre. Një grup pune sektorial për përfshirjen sociale, do të japë informacion të vazhdueshëm mbi statusin dhe situatat e emergjencës në lidhje me romët dhe egjiptianët. PKVBPPRE 2021–2025 parashikon se këto takime duhet të mbahen çdo gjashtë muaj, duke kryer ndërkohë vizita në terren në njësitë e vetëqeverisjes vendore.

PJESA IV

ANALIZA BUXHETORE

4.1 Analiza e buxhetit për zbatimin e Planit Kombëtar të Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe të Egjiptianëve 2021–2025

Ky kapitull paraqet shpërndarjen e kostove treguese dhe burimet financiare për financimin e aktiviteteve të **PKV për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe të Egjiptianëve 2021–2025**. Efektet financiare janë përlogaritur për çdo aktivitetet të Planit të Veprimit, duke mbajtur në konsideratë produktet dhe treguesit e përcaktuar për çdo aktivitet. Efektet financiare parashikohen të përballohen nga buxhetet respektive vjetore të institucioneve të ngarkuara me zbatimin e masave, nga buxhete të donatorëve dhe institucioneve të tjera që janë ngarkuar për zbatimin e një pjese të masave, si dhe buxhetet e Njësisë të Vetëqeverisjes Vendore.

Procesi i kostimit u mbështet në konsultimin e dokumenteve të tjera kombëtare, përfshirë këtu Programi Buxhetor Afatmesëm 2021–2023 (faza e III) dhe propozimet, sipas taveve të reja në kuadër të hartimit të PBA 2022–2024, konsultimet me të gjitha institucionet e përfshira, si dhe në kostot historike nga zbatimi i planit pararendës.



Plani i veprimit shoqërohet me një kostim analitik të secilës masë, i cili mbështetet nga detajimi i hollësishëm i shpenzimeve për çdo aktivitet. Kostimi i PKV-së është realizuar në bazë të metodologjive dhe të praktikave të planifikimit buxhetor, duke përdorur instrumentet e rekomanduar nga IPSIS.


Kostoja e përgjithshme e përllogaritur për zbatimin e PKV-së për Barazi, Përfshirje dhe

Pjesëmarrjen e Romëve dhe të Egjiptianëve 2021–2025 është **4,753,255,816 lekë**, ose **38,332,708 euro**. Kursi mesatar për referencë është përllogaritur me 124 lekë për 1 euro. Tabela pasqyron kostot financiare, burimet e financimit dhe hendekun financiar përgjatë 5 vjetëve të zbatimit të PKV 2021–2025.


Qëllimi i Politikave	Natyra/ Tipologjia e Kostove	Kostoja Totale 2020-2025	Kostot e Planifikuara PBA 2021-2023 Buxheti dhe Donatorët	Kosto për tu Planifikuar në Buxhetin 2024- 2025	Hendeku Financiar 2021-2025
P1: Qasje e barabartë në drejtësi dhe shërbime të gjendjes civile për romët dhe egjiptianët.	Korente	148,223,248	102,084,192	36,650,928	9,488,128
	Kapitale	0	0	0	
P2: Përmirësimi i kushteve të strehimit për anëtarë të pakicave rome dhe egjiptiane si dhe legalizimi i të gjitha vendbanimeve jo formale.	Korente	233,903,036	202,666,124	26,784,912	4,452,000
	Kapitale	561,775,000	337,065,000	224,710,000	
P3: Ulja e hendekut në cilësinë e shëndetit midis Romëve dhe Egjiptianëve dhe pjesës tjetër të popullsisë	Korente	503,046,768	363,359,920	75,830,048	63,856,800
	Kapitale	0	0	0	
P4: Rritja e aksesit të barabartë në arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës për romët dhe egjiptianët në të gjitha nivelet arsimore	Korente	317,157,976	182,407,846	118,422,292	26,677,838
	Kapitale	10,350,000	0	0	
P5: Krijim i mundësive të barabarta për punësim cilësor dhe të qëndrueshëm për romët dhe egjiptianët	Korente	355,878,368	136,361,044	77,996,724	141,520,600
	Kapitale	20,125,000	12,075,000	8,050,000	
P6: Përmirësim i qasjes dhe rritja e aksesit të romëve dhe egjiptianëve në programet e mbrojtjes sociale	Korente	2,473,229,600	1,652,031,208	781,032,432	38,739,560
	Kapitale	4,600,000	6,026,400	0	
P7: Antixhipsimi njihet dhe adresohet në politikat publike si dhe përmes ndryshimeve sistematike dhe strukturore, për të garantuar një shoqëri të çliuar nga diskriminimi ndaj R&E	Korente	124,966,820	45,799,436	33,353,880	45,813,504
	Kapitale	0	0	0	
TOTALI [Leke]		4,753,255,816	3,039,876,170	1,382,831,216	330,548,430
TOTALI [Euro] 1 euro 124 Leke		38,332,708	24,515,130	11,151,865	2,665,713

Financimi i planit të veprimit do të realizohet nga disa burime, por buxheti i shtetit mbetet burimi kryesor i financimit Për periudhën 2021–2025, buxheti i shtetit pritet të financojë zbatimin e planit në masën 78.3% të kostove indikative, 14.0% pritet të financohet nga NJVV-ja dhe 0.8% nga donatorët, Hendeku financiar është 7.0%. Hendekun më të madh me rreth 31.4% e ka objektivi specifik “Ofrimi i shërbimeve të integruara sociale me anë të kombinimit të pagesave me para në dorë (*cash*) me kujdesin social cilësor”. Për financimin e masave të këtij objektivi do të shihet mundësia e bashkëpunimit me donatorë të ndryshëm.

Për periudhën afatmesme 2021–2023, kostoja indikative është vlerësuar rreth 2.97 miliardë lekë, nga të cilat 2.33 miliardë lekë janë planifikuar në Programin Buxhetor Afatmesëm, ndërsa 23.4 milionë lekë do të mbulohen nga financimi i huaj dhe 304.6 milionë nga NJVV-ja Hendeku financiar është 172.2 milionë lekë ose 5.8% e kostos indikative për këtë periudhë dhe 52.1% e hendekut të përgjithshëm. Për periudhën afatmesme 2024–2025, kostoja indikative për zbatimin e PKV-së me fonde të buxhetit është rreth 1.38 miliardë lekë.



Kostot korrente zënë rreth 87.0% të shpenzimeve totale, ndërsa pjesa tjetër (13.0%) është e parashikuar për kosto kapitale.






Të ndara sipas qëllimeve të politikave, kostot pasqyrohen në grafikun më poshtë. Qëllimi i politikës VI, pritët të ketë në terma financiarë peshën më të madhe në zbatimin e PKV-së, përkatësisht 52.1%. Qëllimi i politikës II arrin në vlerën 16.7%, ndërsa qëllimet e politikës III dhe V arrijnë respektivisht 10.6% dhe 7.9% të kostos së përgjithshme të planit.

Financimi nga NJVV është parashikuar vetëm për një numër të kufizuar aktiviteteve dhe për funksione të veta dhe të deleguara, të cilat mbulohen nga granti dhe nga transferta e kushtëzuara. Moszbatimi i planit për mungesë fondesh mbetet një risk, por ky është i ulët pasi hendeku financiar është i ulët dhe i shpërndarë në vite. Hendeku financiar në përqindje për secilën nga politikat është i ulët.

PKV-ja do të rishikohet pas 3 vitesh (në vitin 2023) për ta përshtatur me progresin në zbatimin e masave, por edhe për ta azhurnuar atë konform nevojave dhe programeve buxhetore afatmesme 2024–2025, të çdo institucioni. Për masat të planit që janë të pambuluara financiarisht, institucionet përgjegjëse do të planifikojnë nevojat për financime buxhetore nëpërmjet programeve buxhetore përkatëse, si pjesë e procesit të planifikimit të programit afatmesëm buxhetor dhe buxhetit vjetor, si dhe do të negociojnë me donatorë të ndryshëm për t'i bashkëfinancuar disa aktivitete.





ANEKS 1

MATRICA E PLANIT KOMBËTAR TË VEPRIMIT PËR BARAZI, PËRFSHIRJE DHE PJESËMARRJEN E ROMËVE DHE TË EGJIPTIANËVE 2021–2025

Fusha prioritare: AKSES I BARABARTË NË DREJTËSI DHE NË REGJISTRIM CIVIL			
Qëllimi i politikës I:	Qasje e barabartë në drejtësi dhe shërbime të gjendjes civile për romët dhe egjiptianët.		
Objekti i I.1:	Ofrimi i ndihmës ligjore për pasqyrimin e të dhënave reale në regjistrin kombëtar të gjendjes civile të Pakicave Rome dhe Egjiptiane, me qëllim zgjidhjen e problematikave që i pengojnë në aksesin e tyre të plotë në shërbimin e gjendjes civile.		
Rezultatet e pritshme:	i. Në fund të vitit 2025, 100% e anëtarëve të pakicave rome dhe egjiptiane kanë akses të plotë dhe të përmirësuar në shërbimin e gjendjes civile.		
Treguesit:	1.1.1 Numri i fëmijëve romë dhe egjiptiane të cilët kanë lindur jashtë vendit, janë pajisur me dokumentet e lindjes. Ndarja sipas: gjinisë; etnicitetit; qytet/fshat	Baseline 1 (2020): 182	Target 5 (2025) 218
	1.2.1. Numri i fëmijëve romë dhe egjiptianë të lindur dhe të identifikuar si të paregjistruar. Ndarja sipas: gjinisë; etnicitetit; qytet/fshat	Baseline 1 (2020): 189	Target 5 (2025) 100
	1.3.1 Numri i romëve dhe egjiptianëve që jetojnë jashtë vendit, janë informuar në lidhje me ofrimin e shërbimit të ndihmës për marrjen e dokumenteve për fëmijët e lindur jashtë vendit. Ndarja sipas: gjinisë; etnicitetit; qytet/fshat	Baseline 1 (2020): 450	Target 5 (2025) 700
	1.5.1 Regjistri i posaçëm i përkohshëm përfunduar	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2022): 1
	1.6.1 Numri i personave të cilëve nuk u përputhet vendbanimi sipas zyrës së gjendjes civile me banimin real.	Baseline 1 (2020): 730	Target 5 (2025): 1000
	1.7.1 Numri i NJVV-ve të cilët kanë ngritur në bashkëpunim me zyrat e gjendjes civile mekanizma lehtësues për transferimin e vendbanimit të anëtarëve të pakicave rome dhe egjiptiane. (Të tilla mekanizma mund të jenë: i. Mbështetja juridike për kryerjen e transferimit të vendbanimit; ii. zvogëlimi i barrierave administrative që pengojnë procesin e transferimit të vendbanimit etj.)	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 12
	1.8.1 Numri i familjeve rome dhe egjiptiane që nuk jetojnë në vendbanimin e deklaruar pranë gjendjes civile dhe që mbështeten nga strukturat e pushtetit lokal për t'u pajisur me vërtetim faktik.	Baseline 1 (2020): 250	Target 5 (2025): 10% rritje nga vlera e baseline të përlogaritur
	1.9.1 Numri i romëve dhe egjiptianëve të cilët kanë lindur jashtë vendit dhe përfitojnë legalizime falas të ofruara nga konsullatat shqiptare	Baseline 1 (2020): 235	Target 5 (2025): 270
	1.10.1 Numri i nëpunësve të gjendjes civile të trajnuar dhe të udhëzuar rreth zbatimit të rekomandimeve për regjistrimin civil.	Baseline 1 (2020): 391	Target 5 (2025): 525
	1.11.1 Numri i romëve dhe egjiptianëve që marrin shërbime psikologjike falas në rastet e mandatit gjyqësor.	Baseline 1 (2020): 99	Target 5 (2025): 25% rritje nga vlera e baseline të përlogaritur
	1.12.1 Numri i romëve dhe egjiptianëve të rimbursuar për pagesat e tarifave për testet e ADN-së në regjistrimin e lindjes ose vendosjen e të drejtave prindërore.	Baseline 1 (2020): 76	Target 5 (2025): 50



	1.13.1 VKM-ja e cila lejon rimbursimin e Romëve dhe të Egjiptianëve nga pagesa e tarifës për kryerjen e testeve të ADN-së e miratuar		Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2022): 1	
	1.14.1 Numri i romëve dhe egjiptianëve të informuar rreth procedurave të regjistrimit civil dhe ndryshimit të vendbanimit,		Baseline 1 (2020): 2,902	Target 5 (2025): 300	
	1.15.1 Censusi 2021 për statistika të sakta për dy pakicat i përfunduar		Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2022): 1	
	1.16.1 Metodologjia specifike për matjen e numrit të personave pa shtetësi në Shqipëri me një zë të qartë për identifikimin e Romëve dhe të Egjiptianëve pa shtetësi, e përfunduar		Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2022): 1	
MASAT DHE AKTIVITETET		PRODUKTI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONET PARTNERE	AFATI KOHOR
1.1 Dhënia e ndihmës për marrjen e dokumenteve për fëmijët e lindur jashtë vendit (në formën e duhur dhe me përmbajtjen e duhur) përmes një bashkëpunimi më të mirë me MPJ dhe Agjencisë Shtetërorë të mbrojtjes së fëmijëve për këto raste.		218 fëmijë romë dhe egjiptiane të cilët kanë lindur jashtë vendit, janë pajisur me dokumentet e lindjes	Ministria e Brendshme	Zyrat e gjendjes civile, Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe çdo organ tjetër publik e jopublik që operon në fushën e të drejtave të fëmijëve	6M -II- 2021–6M -II- 2025
1.2 Raportimi pranë zyrave të gjendjes civile i fëmijëve të paregjistruar, përfshirë ata që janë lindur brenda dhe jashtë institucioneve shëndetësore (të porsalindur që nuk regjistrohen nga familjet e e tyre brenda 60 ditëve siç e parashikon ligji) dhe brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për ndjekjen dhe regjistrimin e tyre		100 fëmijëve romë dhe egjiptianë të lindur dhe të identifikuar si të paregjistruar	Ministria e Brendshme	Zyrat e gjendjes civile, Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe çdo organ tjetër publik e jopublik që operon në fushën e të drejtave të fëmijëve	6M -II- 2021–6M -II- 2025
1.3 Informimi dhe ndërgjegjësimi i anëtarëve të pakicave rome dhe egjiptiane, të cilët jetojnë që jetojnë jashtë vendit, nga konsullatat, në lidhje me ofrimin e shërbimit të ndihmës për marrjen e dokumenteve për fëmijët e lindur jashtë vendit.		20% më shumë se <i>baseline</i> do të jetë numri i romëve dhe egjiptianëve që jetojnë jashtë vendit, të cilët janë informuar, në lidhje me ofrimin e shërbimit të ndihmës për marrjen e dokumenteve për fëmijët e lindur jashtë vendit.	MPJ	MPJ	6M -II- 2021–6M -II- 2025
1.4 Identifikimi i fëmijëve të paregjistruar në regjistrin e posaçëm dhe me pas ndjekja e procesit të regjistrimit.		250 fëmijëve romë dhe egjiptianë të lindur dhe të identifikuar si të paregjistruar	MB,	Zyrat e gjendjes civile, Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve dhe çdo organ tjetër publik e jopublik që operon në fushën e të drejtave të fëmijëve	6M -II- 2021–6M -II- 2025
1.5 Përfundimi i regjistrit të posaçëm të përkohshëm që do të krijojë bazën e të dhënave e cila do të japë mundësinë për trajtim dhe zgjidhje sipas rastit personave që nuk janë regjistruar.		Regjistri i posaçëm i përkohshëm përfunduar	MB	MB	6M -II- 2021–6M -II- 2022
1.6 Regjistrimi dhe zgjidhja, përmes zyrave të gjendjes civile, e rasteve të individëve të paregjistruar, të cilët nuk janë të pajisur me dokumentacionin e		1000 personave të cilëve nuk u përputhet vendbanimi sipas zyrës së gjendjes civile me	MB	MFE, Zyra e Gjendjes Civile	6M -II- 2021–6M -II- 2025



nevojshëm.	banimin real janë trajtuar.			
1.7 Bashkëpunimi zyrate të gjendjes civile me vetëqeverisjen vendore për transferimin e vendbanimit të anëtarëve të pakicave rome dhe egjiptiane	12 NJVV kanë ngritur në bashkëpunim me zyrat e gjendjes civile mekanizma lehtësues për transferimin e vendbanimit të anëtarëve të pakicave rome dhe egjiptiane.	MB	NJVV	6M -II- 2021–6M -II- 2025
1.8 Ofrimi i ndihmës nga strukturat e pushteti lokal “administrator social” për të verifikuar dhe pajisur me vërtetim faktik familjet që nuk jetojnë në vendbanimin e deklaruar pranë gjendjes civile dhe që për arsye të pavarura prej tyre nuk mund të ndryshojnë vendbanimin. (Kjo masë është me qëllim trajtimin e këtyre familjeve me programet e strehimit social.)	8% më shumë se vlera e përlogaritur e <i>baseline</i> është numri i familjeve rome dhe egjiptiane që nuk jetojnë në vendbanimin e deklaruar pranë gjendjes civile dhe që mbështeten nga strukturat e pushtetit lokal për t’u pajisur me vërtetim faktik	MB	NJVV	6M -II- 2021–6M -II- 2025
1.9 Dhënie falas i anëtarëve të komunitetit rom dhe atij egjiptian për tarifën e vendosura nga konsullatat shqiptare për legalizimin (verifikimin) e dokumenteve dhe të nevojshme për regjistrimin civil	270 romë dhe egjiptianëve të kanë lindur jashtë vendit përfitojnë legalizime falas të ofruara nga konsullatat shqiptare	MPJ	MB	6M -II- 2021–6M -II- 2025
1.10 Ngritja e kapaciteteve të punonjësve të gjendjes civile, për: - zbatimin e rekomandimeve për regjistrimin civil, përfshirë rekomandimet lidhur me romët dhe egjiptianët; - zgjidhjen dhe ndjekjen e rasteve të regjistrimit civil dhe transferimit të vendbanimit; - çështjet e barazisë dhe mosdiskriminimit, të pashtetësisë dhe të drejtave të njeriut.	525 nëpunës të gjendjes civile janë trajnuar dhe udhëzuar rreth zbatimit të rekomandimeve për regjistrimin civil.	MB	NJMF, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile	6M -II- 2021–6M -II- 2025
1.11 Ofrimi falas i shërbimeve të psikologut për romët dhe egjiptianët në nevojë në procese gjyqësore të tilla si divorcet, kujdestaria e fëmijëve, urdhrat e mbrojtjes, përgjegjësia prindërore, fëmijët në konflikt me ligjin	25 % më shumë nga vlera e përlogaritur e <i>baseline</i> është numri i romëve dhe egjiptianëve që kanë marrë shërbime psikologjike falas në rastet e mandatit gjyqësor	Këshilli i Lartë i Gjyqësorit, Zyra e Administrimit të Buxhetit të Gjyqësorit (ZABGJ)	NJVV OJQ	6M -II- 2021–6M -II- 2025
1.12 Rimbursimi i romëve dhe i egjiptianëve nga pagesa e tarifës për kryerjen e testeve të ADN-së, të nevojshme për regjistrimin e lindjeve dhe njohjen/mohimin e amësisë ose atësisë	50 romë dhe egjiptianëve janë rimbursuar për pagesat e tarifave për testet e ADN-së në regjistrimin e lindjes ose vendosjen e të drejtave prindërore.	MB	MB	6M -II- 2021–6M -II- 2025
1.13 Hartimi dhe miratimi i VKM-së, e cila lejon rimbursimin e romëve dhe të egjiptianëve nga pagesa e tarifës për kryerjen e testeve të ADN-së	VKM e cila lejon rimbursimin e Romëve dhe të Egjiptianëve nga pagesa e tarifës për kryerjen e testeve të ADN-së është miratuar	MB	MB	6M -II- 2021–6M -II- 2022
1.14 Hartimi dhe shpërndarja e paketave të informacionit mbi kriteret, dokumentacionin e nevojshëm dhe burimet e mbështetjes për romët dhe egjiptianët në lidhje me regjistrimin civil dhe transferimin e vendbanimit	300 romë dhe egjiptianëve janë informuar rreth procedurave të regjistrimit civil dhe ndryshimit të vendbanimit,	MB, shpërndarja përmes zyrate të gjendjes civile	MB Dega e Qarkut, Zyra e Gjendjes Civile	6M -II- 2021–6M -II- 2025
1.15 Angazhimi (përfshirja e shoqërisë civile rome dhe egjiptiane) në kuadër të Census 2021 për statistika të sakta për dy pakicat, për të përcaktuar numrin e	Censusi 2021 për statistika të sakta për dy pakicat i përfunduar	Regional Cooperation Council (RCC)	Regional Cooperation Council (RCC)	6M -II- 2021–6M -II- 2022



saktë të anëtarëve të këtyre pakicave				
1.16 Hartimi i një metodologjie specifike për matjen e numrit të personave pa shtetësi në Shqipëri, me një zë të qartë për identifikimin e romëve dhe të egjiptianëve pa shtetësi, gjë që do të zvogëlojë nivelin e gabimit dhe do të japë një vështrim më afër realitetit.	Metodologjia specifike për matjen e numrit të personave pa shtetësi në Shqipëri me një zë të qartë për identifikimin e romëve dhe të egjiptianëve pa shtetësi, e përfunduar	Regional Cooperation Council (RCC)	Regional Cooperation Council (RCC)	6M -II- 2021–6M -II- 2022
Fusha prioritare: AKSES I BARABARTË NË DREJTËSI DHE NË REGJISTRIM CIVIL				
Qëllimi i politikës I:	Qasje e barabartë në drejtësi dhe shërbime të gjendjes civile për romët dhe egjiptianët			
Objektivi I.2:	Garantimi i shërbimeve të ndihmës juridike falas për romët dhe egjiptianët			
Rezultatet e pritshme:	i. Në fund të vitit 2025, 100% e anëtarëve pakicave rome dhe egjiptiane të cilët kanë pasur nevojë që kanë përfituar nga shërbimet ligjore të ndihmës juridike parësore			
Treguesit:	2.1.1 Numri i qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore funksionale		Baseline 1 (2020): 9	Target 5 (2025) 12
	2.1.2 Numri i klinikave të ligjit, të cilat ofrojnë shërbime juridike falas për kategoritë rome dhe egjiptiane		Baseline 1 (2020): 9	Target 5 (2025) 12
	2.1.3 Numri i organizatave jofitimprurëse që ofrojnë shërbime ligjore falas për anëtarë të pakicave rome dhe egjiptiane		Baseline 1 (2020): 12	Target 5 (2025) 15
	2.1.4 Numri i avokatëve të cilët kanë ofruar shërbimin e ndihmës juridike dytësore për anëtarë të komunitetit rom dhe egjiptian		Baseline 1 (2020): 73	Target 5 (2025): 144
	2.1.5 Numri i romëve dhe i egjiptianëve të cilët përfitojnë ndihmë juridike parësore		Baseline 1 (2020): 70	Target 5 (2022): 300
	2.1.6 Numri i romëve dhe i egjiptianëve të cilët përfitojnë ndihmë juridike dytësore		Baseline 1 (2020): Nuk ka të dhëna	Target 5 (2025): 5% më shumë se baseline i përlogaritur
	2.2.1 Numri i romëve dhe i egjiptianëve të cilët kanë përfituar ndihmë ligjore falas nëpërmjet ekipeve të lëvizshme		Baseline 1 (2020): Nuk ka të dhëna	Target 5 (2025): 130
	2.3.1 Numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit me shoqërinë civile/organizatat		Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 11
	2.4.1 Numri i aktiviteteve të ndërgjegjësimit dhe edukimit ligjor për romët dhe egjiptianët		Baseline 1 (2020): 1	Target 5 (2025): 6
	2.5.1 Numri i materialeve informuese materialeve për ndihmën juridike/ofruesve dhe subjekteve përfitues, edukimin ligjor për publikun për barazinë gjinore, DHNGJ-ja dhe dhunën në familje të prodhuara me një gjuhë të thjeshtëzuar për romët e egjiptianët dhe shpërndara		Baseline 1 (2020): Nuk ka të dhëna	Target 5 (2025): 1000



	2.6.1 Kodi i familjes i rishikuar		Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2022): 1
	2.7.1 Numri i grave dhe i vajzave rome dhe egjiptiane të informuar mbi të drejtat pronësore		Baseline 1 (2020): 25	Target 5 (2025): 10% më shumë nga baseline i përllogaritur
MASAT DHE AKTIVITETET	PRODUKTI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONET PARTNERE	AFATI KOHOR
2.1/a) Ofrimi i ndihmës juridike parësore për romët dhe egjiptianët	12 qendra të Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore do të jenë funksionale	MD	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas	6M -II- 2021–6M -II- 2025
2.1/b) Ofrimi i ndihmës juridike dytësore për romët dhe egjiptianët	12 klinika të ligjit do të ofrojnë shërbime juridike falas për kategoritë rome dhe egjiptiane	MD	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas	6M -II- 2021–6M -II- 2025
Sistemi i ndihmës juridike parësore dhe dytësore ka funksionalitet të plotë dhe siguron akses të plotë në drejtësi për qytetarët në nevojë dhe grupet vulnerabël (kategoritë rome dhe egjiptiane)	15 organizatave jofitimprurëse ofrojnë shërbime ligjore falas për anëtarë të pakicave rome dhe egjiptiane 300 romë dhe egjiptianëve do të përfitojnë ndihmë juridike parësore 144 avokatë do të ofrojnë shërbimin e ndihmës juridike dytësore për anëtarë të komunitetit rom dhe egjiptian	MD	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas	6M -II- 2021–6M -II- 2025 6M -II- 2021–6M -II- 2025 6M -II- 2021–6M -II- 2025
2.2 Shërbime të lëvizshme të ofrimit të ndihmës ligjore falas për romët dhe egjiptianët në qytetet dhe zonat ku jetojnë me së shumti këto pakica	130 rome dhe egjiptianë do të përfitojnë ndihmë ligjore falas nëpërmjet ekipeve të lëvizshme	MD	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas	6M -II- 2021–6M -II- 2025
2.3 Forcimi i bashkëpunimit ndërmjet Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas; ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike falas dhe shoqërisë civile, në kuadër të zhvillimit të aktiviteteve të përbashkëta dhe referimit të rasteve për anëtarët e pakicave rome dhe egjiptiane	11 marrëveshjeve të bashkëpunimit me organizata të shoqërisë civile/organizatat do të finalizohen	MD	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas	6M -II- 2021–6M -II- 2025
2.4 Zhvillimi i aktiviteteve ndërgjegjësuere/informuese me fokus grupe anëtarët e pakicave rome dhe egjiptiane, si dhe hartimi/publikimi dhe shpërndarja e materialeve të vizibilitetit, në kuadër të ndihmës juridike/ofruesve dhe subjekteve përfitues (në gjuhë të thjeshtëzuar)	6 aktiviteteve të ndërgjegjësimit dhe të edukimit ligjor për romët dhe egjiptianët do të zhvillohen	MD	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas	6M -II- 2021–6M -II- 2025



2.5 Përgatitja dhe shpërndarja e materialeve për ndihmën juridike/ofruesve dhe subjekteve përfitues, edukimin ligjor për publikun për barazinë gjinore, DHNGJ-ja dhe dhunën në familje, me një gjuhë të thjeshtëzuar për romët e egjiptianët		MD	Drejtoria e Ndihmës Juridike Falas	6M -II- 2021–6M -II- 2025
2.6 Rishikimi i Kodit të Familjes, me qëllim reduktimin e martesave fiktive të anëtarëve të pakicave rome dhe egjiptiane	Kodit të Familjes, me qëllim reduktimin e martesave fiktive të anëtarëve të pakicave rome dhe egjiptiane i rishikuar	Ministria e Drejtësisë	Ministria e Drejtësisë	6M -II- 2021–6M -II- 2022
2.7 Informimi i grave dhe vajzave rome dhe egjiptiane për të drejtat pronësore	10% më shumë nga <i>baseline</i> i përlogaritur është numri grave dhe vajzave rome dhe egjiptiane të informuar mbi të drejtat pronësore	Ministria e Drejtësisë	Ministria e Drejtësisë	6M -II- 2021–6M -II- 2025
Fusha prioritare: AKSES I BARABARTË NË DREJTËSI DHE NË REGJISTRIM CIVIL				
Qëllimi i politikës I:	Qasje e barabartë në drejtësi dhe shërbime të gjendjes civile për romët dhe egjiptianët			
Objekti i I.3:	Fuqizimi i kapaciteteve për identifikimin e romëve dhe të egjiptianëve në rrezik trafikimi/shfrytëzimi, si dhe referimi, mbrojtja dhe riintegrimi i rasteve të trafikuar/shfrytëzuara			
Rezultatet e pritshme:	i. Deri në fund të vitit 2025, 100% e anëtarëve të pakicave rome dhe egjiptiane do të vazhdojnë të jenë të informuar mbi mënyrat e trafikimit të qenieve njerëzore, si dhe 100% e rasteve të trafikuar do të janë marrë në mbrojtje dhe asistohen me shërbimet e riintegritit të tyre në shoqëri			
Treguesit:	3.1.1. Numri i anëtarëve të ekipeve multidisiplinore të trajnuar për PSV-të dhe Protokollin e të Drejtave të Fëmijës		<i>Baseline</i> 1 (2020): 340	Target 5 (2025) 280
	3.2.1 Numri i viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit të identifikuar dhe asistuar (përfshirë pakicat rome dhe egjiptiane)		<i>Baseline</i> 1 (2020): 7	Target 5 (2025) Nuk mund të parashikohen
	3.3.1 Numri i takimeve dhe i personave që kanë marrë pjesë në aktivitete		<i>Baseline</i> 1 (2020): 196	Target 5 (2025): 230
	3.5.1. Numri i skuadrave multidisiplinore të terrenit të ngritura.		<i>Baseline</i> 1 (2020): Nuk ka të dhëna	Target 5 (2022): 6
	3.5.2 Numri i fëmijëve romë dhe egjiptianë, të identifikuar nga skuadrat e terrenit, që shfrytëzohen për punë të ndryshme dhe që u është bërë vlerësimi i nevojave		<i>Baseline</i> 1 (2020): 10	Target 5 (2022): 40
	2.2.1 Numri i romëve dhe egjiptianëve të cilët kanë përfituar ndihmë ligjore falas nëpërmjet ekipeve të lëvizshme		<i>Baseline</i> 1 (2020): Nuk ka të dhëna	Target 5 (2025): 130
	2.3.1 Numri i marrëveshjeve të bashkëpunimit me shoqërinë civile/organizatat		<i>Baseline</i> 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 11
	2.4.1 Numri i aktiviteteve të ndërgjegjësimit dhe edukimit ligjor për romët dhe egjiptianët		<i>Baseline</i> 1 (2020): 1	Target 5 (2025): 6
	2.5.1 Numri i materialeve informuese materialeve për ndihmën juridike/ofruesve dhe subjekteve përfitues, edukimin ligjor për publikun për barazinë gjinore, DHNGJ-ja dhe dhunën në familje të prodhuara me një gjuhë të thjeshtëzuar për romët e egjiptianët dhe shpërndara		<i>Baseline</i> 1 (2020): Nuk ka të dhëna	Target 5 (2025): 1000
	2.6.1 Kodi i familjes i rishikuar		<i>Baseline</i> 1 (2020): 0	Target 5 (2022): 1



	2.7.1 Numri i grave dhe i vajzave rome dhe egjiptiane të informuar mbi të drejtat pronësore			Baseline 1 (2020): Nuk ka të dhëna	Target 5 (2025): 10% më shumë nga baseline i përlogaritur
MASAT DHE AKTIVITETET	PRODUKTI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONET PARTNERE	AFATI KOHOR	
3.1 Organizimi i trajnimeve për ekipet multidisiplinore mbi trafikimin e fëmijëve sipas procedurave standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit	280 anëtarëve të ekipeve multidisiplinore do të trajnohen për PSV-të dhe Protokollin e të Drejtave të Fëmijës	MB	ASHMDF (Agjencia Shtetërore e Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve) shërbimi social	6M -II- 2021–6M -II- 2025	
3.2 Përmirësimi i mekanizmit ekzistues për shkëmbimin e informacionit nga institucione të ndryshme, (duke përfshirë informacionin dhe të dhënat e disagreguara mbi viktimat e pakicave rome dhe egjiptiane)	Viktimave/viktimave të mundshme të trafikimit do të identifikohen dhe asistohen (përfshirë pakicat rome dhe egjiptiane)	MB	MB Autoriteti përgjegjës	6M -II- 2021–6M -II- 2025	
3.3 Fushatë ndërgjegjësuere dhe informuese e të rinjve dhe e komunitetit (përfshirë pakicat rome dhe egjiptiane) lidhur me: legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar, kuadrin institucional antitrafikim, format, metodat dhe fenomenin e trafikimit të personave dhe njohja me të drejtat e viktimës	3.3 Fushatë ndërgjegjësuere dhe informuese e të rinjve dhe e komunitetit (përfshirë pakicat rome dhe egjiptiane), lidhur me: legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar, kuadrin institucional antitrafikim, format, metodat dhe fenomenin e trafikimit të personave dhe njohja me të drejtat e viktimës	MB	Partnerë shtetërorë dhe joshetërorë	6M -II- 2021–6M -II- 2025	
3.4 Fushata ndërgjegjësimi, për të informuar shtetasit shqiptarë (përfshirë pakicat rome dhe egjiptiane) për rregullat dhe kushtet e udhëtimit pa vizë në BE, mundësitë e migracionit të rregullt dhe pasojat e migracionit të parregullt (si edhe aplikimeve të pabazuara për azil)	6 aktiviteteve të ndërgjegjësimi dhe edukimit ligjor për romët dhe egjiptianët për rregullat dhe kushtet e udhëtimit pa vizë në BE, mundësitë e migracionit të rregullt dhe pasojat e migracionit të parregullt (si edhe aplikimeve të pabazuara për azil) do të zhvillohen	MB	DK&M	6M -II- 2021–6M -II- 2025	
3.5 Ngritja dhe funksionimi i skuadrave të terrenit të cilat kanë në përbërjen e tyre punonjës të Drejtorisë të Kujdesit Social dhe Komunitar, si dhe përfaqësues të aktorëve lokal që kanë në fokus fëmijët. (Këto skuadra do të identifikojnë dhe monitorojnë rastet e fëmijëve Rom dhe Egjiptianë që shfrytëzohen për punë të ndryshme (lypje, shitje ambulatore, mbledhjen e mbeturinave të riciklueshme etj.)	6 skuadra multidisiplinore të terrenit do të ngrihen të cilat kanë në përbërjen e tyre punonjës të Drejtorisë të Kujdesit Social dhe Komunitar, si dhe përfaqësues të aktorëve lokal që kanë në fokus fëmijët.	NJVV	NJVV	6M -II- 2021–6M -II- 2025	



Fusha prioritare: STREHIMI			
Qëllimi i politikës II:	Përmirësimi i kushteve të strehimit për anëtarë të pakicave rome dhe egjiptiane, si dhe legalizimi i të gjitha vendbanimeve joformale		
Objekti i II.1:	Rritja e numrit të përfituesve romë dhe egjiptianë nga çdo program strehimi		
Rezultatet e pritshme:	i. Më shumë se 5% e përfituesve të programeve të strehimit i përkasin pakicave rome dhe egjiptiane deri në fund të vitit 2025		
Treguesit:	1.1.1 Numri i familjeve rome dhe egjiptiane që përfitojnë nga program i subvencionimit të qirasë në treg të lirë (bonus qiraje).	Baseline 1 (2020): 171	Target 5 (2025) 492
	1.2.1 Numri i familjeve rome dhe egjiptiane që përfitojnë nga programi i banesave me kosto të ulët, nëpërmjet instrumenteve financiare.	Baseline 1 (2020): 3	Target 5 (2025) 30
	1.3.1 Numri i familjeve rome dhe egjiptiane që janë strehuar me qira sociale, në godinat në pronësi të NJVV.	Baseline 1 (2020): 225	Target 5 (2022): 310
	1.4.1 Numri i familjeve rome dhe egjiptiane të cilët kanë përfituar certifikatë legalizimi	Baseline 1 (2020): Nuk ka të dhëna	Target 5 (2025): Nuk ka të dhëna
	1.5.1 Numri i familjeve rome dhe egjiptiane, pa të ardhura, me të ardhura shumë të ulëta dhe të ulëta, për të cilat plotësimi i dosjes dhe dokumentacionit për aplikim për programin social të strehimit është realizuar me shpenzimet e vetë NJVV-ve.	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 50
	1.7.1 Numri i programeve të reja për një planifikim të përshtatshëm të strehimit social, që respekton diversitetin sociokulturor apo nevoja specifike të familjes përfituese të hartuara.	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): Nuk ka të dhëna
	1.8.1 Numri i familjeve rome dhe egjiptiane të cilat kanë përfituar nga programi i zhvillimit të zonës, me qëllim strehimin, ku përfshihet dhe përmirësim i infrastrukturës	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 210
	1.9.1 Numri i familjeve rome dhe egjiptiane të cilët kanë përfituar nga rindërtimi i banesave të dëmtuara nga tërmeti, si dhe mbështetja me grante për familjet që kanë pësuar dëmtime të lehta.	Baseline 1 (2020): 50	Target 5 (2025): Nuk ka të dhëna



MASAT DHE AKTIVITETET	PRODUKTI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONET PARTNERE	AFATI KOHOR
1.1 Zbatimi i programit të subvencionit të qirasë në njësitë e vetëqeverisjes vendore për pakicat rome dhe egjiptiane.	492 familje rome dhe egjiptiane do të përfitojnë nga program i subvencionimit të qirasë në treg të lirë (bonus qiraje).	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	6M -II- 2021–6M -II- 2025
1.2 Zbatimi i programit të banesave me kosto të ulët, nëpërmjet instrumenteve financiare si granti i menjëhershëm apo subvencionimit të interesave të kredisë, për pakicat rome dhe egjiptiane.	30 familje rome dhe egjiptiane përfitojnë nga programi i banesave me kosto të ulët, nëpërmjet instrumenteve financiare. 10 familje rome dhe egjiptiane përfitojnë nga granti i menjëhershëm 365 familje rome dhe egjiptiane përfitojnë nga programimi i kreditimit të lehtësuar.	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	6M -II- 2021–6M -II- 2025
1.3 Përmirësimi i kushteve të strehimit të romëve dhe të egjiptianëve, përmes granteve konkurruese për bashkitë.	310 familje rome dhe egjiptiane janë strehuar me qira sociale, në godinat në pronësi të NJVV, të adaptuara për strehim me fondet e buxhetit të shtetit	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	6M -II- 2021–6M -II- 2025
1.4 Përmirësimi i të dhënave statistikore të raportuara nga ASHK-ja.	Familje rome dhe egjiptiane kanë përfituar certifikatë legalizimi	Agjencia Shtetërore e Kadastrës ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës ASHK	6M -II- 2021–6M -II- 2025
1.5 Zbatimi me përpikëri i ligjit nr. 22/2018, “Për strehimin social” ¹²⁴	50 familje rome dhe egjiptiane, pa të ardhura, me të ardhura shumë të ulëta dhe të ulëta, për të cilat plotësimi i dosjes dhe dokumentacionit për aplikim për programin social të strehimit do të realizohen me shpenzimet e vetë NJVV-ve.	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	6M -II- 2021–6M -II- 2025
1.6 Evidentimi dhe regjistrimi i çdo subjekti të interesuar, që kërkon të regjistrohet si pronar social, duke pasur si qëllim sigurimin e një strehimi të përshtatshëm, të qëndrueshëm dhe jodiskriminues.	70 familje rome dhe egjiptiane përfitojnë subvencionim të qirasë për banesat në pronësi të pronarit social. 300 aplikime nga pakicat rome dhe egjiptiane janë kryer për të përfituar statusin e pronarit social 10 raportime nga pakicat rome dhe egjiptiane janë kryer për	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	6M -II- 2021–6M -II- 2025

¹²⁴ Duke iu referuar pikës 2 të nenit 14 të këtij ligji përcaktohet, se: “Individi/familja rome dhe egjiptiane që aplikon, paraqet vetëm kërkesën për programin social të strehimit, sipas formatit të miratuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore. Njësia e vetëqeverisjes vendore plotëson dosjen me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, i cili sigurohet me shpenzimet e vetë njësisë së vetëqeverisjes vendore për këta aplikantë”.



	pamundësinë e marrjes së statusit të pronarit social për arsye diskriminimi			
1.7 Integrimi i familjeve rome dhe egjiptiane nëpërmjet projekteve pilot për urbanizimin dhe integrimin e zonave informale me popullsi të konsiderueshme rome dhe egjiptiane.	500 familje rome dhe egjiptiane kanë përfituar nga programi i zhvillimit të zonës me qëllim strehimin	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	6M -II- 2021–6M -II- 2025
1.8 Hartimi i programeve të reja për një planifikim të përshtatshëm të strehimit social, që respekton diversitetin socio kulturor apo nevoja specifike të familjes përfituese ¹²⁵ .	Programe të reja për një planifikim të përshtatshëm të strehimit social, që respekton diversitetin socio kulturor apo nevoja specifike të familjes përfituese të hartuara	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	6M -II- 2021–6M -II- 2025
1.9 Investime infrastrukturore në zonat ku jeton pjesa më e madhe e romeve dhe egjiptianeve. (Rregullimi i rrugëve, kanalizimeve, ujësjellësit, ndriçimi dhe rikonstruksion banesash.)	210 familje rome dhe egjiptiane kanë përfituar nga programi i zhvillimit të zonës me qëllim strehimin, ku përfshihet dhe përmirësim i infrastrukturës	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	6M -II- 2021–6M -II- 2025
1.10 Rindërtimi i banesave rome dhe egjiptiane që janë prekur nga tërmeti, si dhe mbështetja me grante për familjet që kanë pasur dëmtime të lehta.	Familje rome dhe egjiptiane kanë përfituar nga rindërtimi i banesave të dëmtuara nga tërmeti, si dhe mbështetja me grante për familjet që kanë pësuar dëmtime të lehta.	Ministri i Shtetit për Rindërtimin	NJVV	6M -II- 2021–6M -II- 2022
Fusha prioritare: STREHIMI				
Qëllimi i politikës II:	Përmirësimi i kushteve të strehimit për anëtarë të pakicave rome dhe egjiptiane, si dhe legalizimi i të gjitha vendbanimeve joformale			
Objektivi II.2:	Miratimi i kuadrit ligjor dhe bashkëpunimi midis institucioneve në nivel qendror dhe vendor për adresimin e nevojave për legalizimin dhe strehimin social			
Rezultatet e pritshme:	70 % më shumë NJVV kanë përfituar mbështetje financiare nga qeveria qendrore deri në fund të vitit 2025 krahasuar me vitin 2020 për përmirësimin e kushteve të strehimit të pakicave rome dhe egjiptiane			
Treguesit:	2.1.1 Numri i akteve nënligjore të miratuara në zbatim të ligjit të strehimit		Baseline 1 (2020): 21	Target 5 (2022) 24
	2.2.1 Numri i poseduesve të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen dhe që trajtohen nga shteti nëpërmjet shpërblimit financiar, programeve sociale të strehimit ose formave alternative të trajtimit		Baseline 1 (2020): 20	Target 5 (2025) 10
	2.3.1 Numri i vendbanimeve të legalizuara që posedohen nga romë dhe egjiptiane		Baseline 1 (2020): 20	Target 5 (2025): 36

¹²⁵ Banesa një ose dykatëshe të përshtatshme për familje të mëdha që merren me aktivitete që gjenerojnë të ardhura nëpërmjet tregtisë, punime artizanale, riciklimit apo blegtorisë. Këto programe nuk duhet kurrësi të çojnë drejt veçimit të komuniteteve rome dhe egjiptiane nga grupet e tjera të shoqërisë.



	2.4.1 Numri i raporteve të vlerësimit të përfunduara çdo vit		Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2022): 61
	2.5.1 Numri i trajnimeve të zhvilluara për njësitë e vetëqeverisjes vendore me qëllim forcimin e kapaciteteve për të aplikuar për mbështetje financiare nga buxheti i shtetit		Baseline 1 (2020): 3	Target 5 (2022): 8
	2.6.1 Numri i NJVV-së që aplikojnë për financime në MFE për përmirësimin e kushteve të jetesës së pakicave rome dhe egjiptiane		Baseline 1 (2020): 23	Target 5 (2025): 35
	2.7.1 Numri i NJVV që kanë aprovuar planin 5-vjeçar të strehimit		Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 61
	2.8.1 Numri i familjeve rome dhe egjiptiane që përfitojnë nga shërbimet shpesh në rastet e pamundësisë për të paguar detyrimet financiare për një program strehimi		Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 65
MASAT DHE AKTIVITETET	PRODUKTI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONET PARTNERE	AFATI KOHOR
2.1 Finalizimi dhe miratimi i akteve nënligjore në proces të ligjit për strehimin social	24 akte nënligjore të miratuara në zbatim të ligjit të strehimit	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	6M -II- 2021–6M -II- 2022
2.2 Miratimi i aktit nënligjor në zbatim të pikës 2, neni 33 i ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”. Ky akt do të përcaktojë mënyrat e trajtimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit financiar, format alternative të trajtimit, si dhe rregullat dhe afatet për realizimin e tyre. Përfitues janë të gjithë poseduesit e ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen dhe që trajtohen nga shteti nëpërmjet shpërblimit financiar, programeve sociale të strehimit ose formave alternative të trajtimit.	Posedues të ndërtimeve pa leje që nuk legalizohen do të trajtohen nga shteti nëpërmjet shpërblimit financiar, programeve sociale të strehimit ose formave alternative të trajtimit.	Agjencia Shtetërore e Kadastrës ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës ASHK	6M -II- 2021–6M -II- 2022
2.3 Përshpejtimi i procesit të legalizimit për poseduesit e ndërtimeve pa leje në proces legalizimi, përfaqësues të pakicave rome dhe egjiptiane pas evidentimit të tyre.	Vendbanime që posedohen nga romë dhe egjiptiane do të legalizohen	Agjencia Shtetërore e Kadastrës ASHK	Agjencia Shtetërore e Kadastrës ASHK	6M -II- 2021–6M -II- 2022



Fusha prioritare: KUJDESI SHËNDETËSOR			
Qëllimi i politikës III:	Ulja e hendekut në cilësinë e shëndetit midis pakicave rome dhe egjiptiane dhe pjesës tjetër të popullsisë.		
Objektivi III.1:	Përmirësimi i shëndetit të romëve dhe të egjiptianëve përmes rritjes së aksesit të tyre në shërbime cilësore shëndetësore dhe atyre parandaluese.		
Rezultatet e pritshme:	i. Deri në fund të vitit 2025, 100% e romëve dhe të egjiptianëve do të kenë akses në shërbime cilësore shëndetësore dhe parandaluese.		
Treguesit:	1.1.1 Numri i qendrave shëndetësore pranë vendbanimeve rome dhe egjiptiane që operojnë me staf të rregullt dhe shërbime.	Baseline 1 (2020): 375	Target 5 (2022) 375
	1.2.1 Numri pikave të dedikuara të ambulancave pranë zonave të populluara nga anëtarë të pakicave rome dhe egjiptiane të cilat funksionojnë çdo vit.	Baseline 1 (2020): 1	Target 5 (2025) 1
	1.3.1 Numri i punonjësve të kujdesit shëndetësor të trajnuar	Baseline 1 (2020): 14	Target 5 (2025): 120
	1.4.1 Numri i romëve dhe egjiptianëve që marrin shërbime nga ekipet mjekësore të lëvizshme.	Baseline 1 (2020): 30,003	Target 5 (2025): 3% më pak se viti 2020
	1.5.1 Numri i fëmijëve romë dhe egjiptianë të regjistruar të cilët kanë lindur në kushte shtëpie.	Baseline 1 (2020): Nuk ka të dhëna	Target 5 (2025): 2% më shumë se vlera e përlogaritur e <i>baseline</i>
	1.6.1 Numri i kontrolleve parandaluese shëndetësore për sëmundje specifike të kryera çdo vit për anëtarë të pakicave rome dhe egjiptiane	Baseline 1 (2020): Nuk ka të dhëna	Target 5 (2025): 5% më shumë se vlera e përlogaritur e <i>baseline</i>
	1.6.2 Numri i anëtarëve të pakicave rome dhe egjiptiane të cilët kanë përfituar nga kontrolle parandaluese shëndetësore për sëmundje specifike.	Baseline 1 (2020): Nuk ka të dhëna	Target 5 (2025): 5% më shumë se vlera e përlogaritur e <i>baseline</i>
	1.8.1 Numri i raportimeve të kryera nga anëtarë të komunitetit për rastet e diskriminimit në shërbimet shëndetësore.	Baseline 1 (2020): Nuk ka të dhëna	Target 5 (2025): 2% më pak se vlera e përlogaritur e <i>baseline</i>
	1.9.1 Numri i familjeve rome dhe egjiptiane të cilët janë pajisur në mënyrë periodike me maska mbrojtëse dhe dezinfektues.	Baseline 1 (2020): Nuk ka të dhëna	Target 5 (2023): 200,000
	1.9.2 Numri i familjeve rome dhe egjiptiane të cilëve u është kryer dezinfektimi vendbanimeve të tyre	Baseline 1 (2020): Nuk ka të dhëna	Target 5 (2023): 200,000
	1.10.1 Numri i romëve dhe të egjiptianëve të vaksinuar.	Baseline 1 (2020): Nuk ka të dhëna	Target 5 (2025): 120,000
	1.11.1 Numri i familjeve rome dhe egjiptiane që kanë përfituar bonusin për shpërblimin e lindjes.	Baseline 1 (2020): 993	Target 5 (2025): 1,010



MASAT DHE AKTIVITETET	PRODUKTI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONET PARTNERE	AFATI KOHOR
1.1 Vazhdimi i sigurimit të një stafi të rregullt (doktorë dhe infermierë) dhe shërbimeve në klinikat/qendrat shëndetësore, duke u dhënë prioritet atyre pranë vendbanimeve rome/egjiptiane	375 qendra shëndetësore pranë vendbanimeve rome dhe egjiptiane operojnë me staf të rregullt dhe shërbime	MSHMS	Njesitë vendore të kujdesit shëndetësor (NJKVSH)	6M -II- 2021–6M -II- 2025
1.2 Kryerja e studimit në lidhje me largësinë e vendbanimeve Rome dhe Egjiptiane nga qendrat shëndetësore, si dhe nevojat për ngritjen e pikave të reja shëndetësore pranë vendbanimeve rome dhe egjiptiane	1 pikë e dedikuara ambulance pranë zonave të populluara nga anëtarë të pakicave rome dhe egjiptiane është funksionale	MSHMS	Njesitë vendore të kujdesit shëndetësor (NJKVSH)	6M -II- 2021–6M -II- 2022
1.3 Funksionimi i pikave të dedikuara të ambulancave pranë zonave të populluara nga anëtarë të pakicave rome dhe egjiptiane bazuar në gjetjet e studimit	120 punonjës të kujdesit shëndetësor të trajnuar	MSHMS	Njesite vendore të kujdesit shëndetësor (NJKVSH)	6M -II- 2021–6M -II- 2025
1.4 Zhvillimi i trimeve të vazhdueshme standard për punonjësit e kujdesit shëndetësor për ofrimin e shërbimit të barabartë për personat që jetojnë në rrugë ose në vende banimi poshtë standardit, përfshirë romët dhe egjiptianët	3% më pak se viti 2020 romë dhe egjiptianë marrin shërbime nga ekipet mjekësore të lëvizshme.	QKEV	NJKVSH dhe MSHMS	6M -II- 2021–6M -II- 2025
1.5 Sigurimi i informacionit, diagnostikimi bazë dhe ndihma e parë nëpërmjet ekipeve mjekësore të lëvizshme për romët dhe egjiptianët në vendbanime informale, të cilët nuk mbulohen nga sistemi bazë (pra që u mungojnë dokumentet personale/vërtetimi i banimit)	Kontrolle parandaluese shëndetësore për sëmundje specifike të kryera çdo vit për anëtarë të pakicave rome dhe egjiptiane	MSHMS;	FSDKSH NJKVSH	6M -II- 2021–6M -II- 2025
1.6 Raportimi i rasteve të identikuara për lindjet e bëra në kushte shtëpie nga njësitë e mbrojtjes së fëmijëve dhe punonjësit social	Fëmijë romë dhe egjiptianë të regjistruar të cilët kanë lindur në kushte shtëpie	MSHMS	NJMF	6M -II- 2021–6M -II- 2025
1.7 Kontrolle parandaluese shëndetësore për sëmundje specifike (kanceri i qafës së mitrës, kanceri i gjirit dhe kanceri i zorrës së trashë, kanceri i prostatës)	Kontrolle parandaluese shëndetësore për sëmundje specifike të kryera çdo vit për anëtarë të pakicave rome dhe egjiptiane	MSHMS	ISHP OSHKSH DROSHKSH NJKVSH	6M -II- 2021–6M -II- 2025
1.8 Monitorimi i cilësisë së shërbimeve shëndetësore, përfshirë rastet e diskriminimit. <i>(Shadow Report)</i>	Raportimeve të kryera nga anëtarë të komunitetit për rastet e diskriminimit në shërbimet shëndetësore.	Organizata të shoqërisë civile	Organizata të shoqërisë civile	6M -II- 2021–6M -II- 2025
1.9 Furnizimi në mënyrë periodike i anëtarëve të pakicave rome dhe egjiptiane me maska mbrojtëse ndaj virusit COVID-19 dhe dezinfektues	200,000 familje rome dhe egjiptiane janë pajisur në mënyrë periodike me maska mbrojtëse dhe dezinfektues.	MSHMS	NJKVSH	6M -II- 2021–6M -II- 2023
1.10 Fushata për vaksinimin e pakicave rome dhe egjiptiane me vaksinën kundër COVID-19	120,000 romë dhe egjiptianë të vaksinuar.	MSHMS	ISHP NJKVSH	6M -II- 2021–6M -II- 2023
1.11 Dhënia e bonusit për shpërblimin e lindjes së fëmijëve romë dhe egjiptianë në rast regjistrimi brenda afatit 60-ditor.	1,10 familje rome dhe egjiptiane kanë përfituar bonusin për shpërblimin e lindjes.	NJKVSH	NJKVSH	6M -II- 2021–6M -II- 2025



Fusha prioritare: KUJDESI SHËNDETËSOR			
Qëllimi i politikës III:	Ulja e hendekut në cilësinë e shëndetit midis pakicave rome dhe egjiptiane dhe pjesës tjetër të popullsisë.		
Objekti i III.2:	Krijimi dhe fuqizimi i pozicionit të mediatorit shëndetësor		
Rezultatet e pritshme:	i. Deri në fund të vitit 2025, 37 mediatorë nga pakicat rome dhe egjiptiane do të mbulojnë çështjet shëndetësore në të gjithë vendin.		
Treguesit:	2.1.1 Pozicioni i ndërmjetësuesve që mbulojnë edhe çështjet shëndetësore, i miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave.	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2022) 1
	2.2.1 Numri i romëve dhe egjiptianëve të rekrutuar dhe të trajnuar si mediator për shtrirjen e shërbimeve shëndetësore.	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025) 37
	2.3.1 Numri i studentëve rome dhe egjiptianë që studiojnë në degët e mjekësisë/infermierisë	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 5
	2.4.1 Numri i romëve dhe egjiptianëve të punësuar si personel në sistemin shëndetësor (dhe përqindja e tyre në numrin total të punonjësve të kujdesit shëndetësor).	Baseline 1 (2020): 2	Target 5 (2025): 5 % më shumë se viti 2020

MASAT DHE AKTIVITETET	PRODUKTI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONET PARTNERE	AFATI KOHOR
2.1 Krijimi i pozicionit të mediatorëve, edukatorëve të shëndetit dhe vullnetarëve për institucionet që ofrojnë shërbimet publike (si p.sh. shëndetësore) me qëllim rritjen e aksesit të barabartë ndaj këtyre shërbimeve për këtë kategori.	Pozicioni i ndërmjetësuesve që mbulojnë edhe çështjet shëndetësore, është miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.	MSHMS	MSHMS	6M -II- 2021–6M -II- 2022
2.2 Rekrutimi dhe trajnimi i romëve dhe egjiptianëve si mediator për shtrirjen e shërbimeve shëndetësore	37 romë dhe egjiptianëve të rekrutuar dhe të trajnuar si mediator për shtrirjen e shërbimeve shëndetësore.	MSHMS	MSHMS OSHKSH	6M -II- 2021–6M -II- 2025
2.3 Koordinimi me MAS për t'u siguruar që t'u jepet prioritet studentëve romë dhe egjiptianë të mjekësisë/infermierisë për kuota dhe bursa në universitet.	Studentë rome dhe egjiptianë që studiojnë në degët e mjekësisë/infermierisë	Institucione të arsimit të lartë	MAS	6M -II- 2021–6M -II- 2025
2.4 Punësimi i romëve dhe egjiptianëve të kualifikuar si personel shëndetësor, përfshirë pozicione të tilla si doktorë, infermierë, punonjës socialë në stafin e kujdesit shëndetësor dhe atë të mbështetjes	Romë dhe egjiptianë të punësuar si personel në sistemin shëndetësor	MSHMS, NJVKSH	NJVKSH	6M -II- 2021–6M -II- 2025



Fusha prioritare: KUJDESI SHËNDETËSOR				
Qëllimi i politikës III:	Ulja e hendekut në cilësinë e shëndetit midis pakicave rome dhe egjiptiane dhe pjesës tjetër të popullsisë.			
Objektivi III.3:	Fuqizimi i strukturave për informim dhe promocion shëndetësor për shërbimet e kujdesit shëndetësor për romët dhe egjiptianët			
Rezultatet e pritshme:	i.100% e anëtarëve të pakicave rome dhe egjiptiane, deri në fund të vitit 2025, do të kenë informacion të plotë në lidhje me çështjet që ndikojnë në shëndetin e tyre, si dhe shërbimet e disponueshme të kujdesit shëndetësor.			
Treguesit:	3.1.1 Numri i aktiviteteve informuese të shpërndara për pakicat rome dhe egjiptiane në lidhje me situatën e pandemisë COVID-19, si dhe domosdoshmërinë e vaksinimit.		Baseline 1 (2020): 5	Target 5 (2023) 45
	3.1.2. Numri i romëve dhe egjiptianëve të informuar në lidhje me situatën emergjente të shkaktuar nga pandemia COVID-19, si dhe domosdoshmërinë e vaksinimit.		Baseline 1 (2020): 500	Target 5 (2023) 2500
	3.2.1. Numri i romëve dhe egjiptianëve të cilët kanë marrë medikamente falas për mjekimin e tyre si rezultat i infektimit me COVID-19.		Baseline 1 (2020): 25	Target 5 (2023): 200
	3.3.1 Numri i materialeve promocionale i përgatitur në gjuhën rome dhe/ose përfshirë figurat.		Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 4
	3.4.1. Numri i nënave rome dhe egjiptiane që marrin paketën për kujdesin e foshnjave dhe nënave.		Baseline 1 (2020): 11,797	Target 5 (2025): 12,622
MASAT DHE AKTIVITETET	PRODUKTI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONET PARTNERE	AFATI KOHOR
3.1 Mbështetja me paketa dhe materiale informuese për situatat emergjente (Pandemia COVID-19 dhe domosdoshmërinë e vaksinimit)	40 aktivitete informuese të kryera për pakicat rome dhe egjiptiane në lidhje me situatën e pandemisë COVID 19, si dhe domosdoshmërinë e vaksinimit	MSHMS	NJVKSH/ISHP	6M -II- 2021–6M -II- 2023
3.2 Ofrimi i medikamenteve falas për romë e egjiptianë të infektuar me COVID-19.	2500 romë dhe egjiptianë të informuar në lidhje me situatën emergjente të shkaktuar nga pandemia COVID 19, si dhe domosdoshmërinë e vaksinimit.	MSHMS	NJVKSH	6M -II- 2021–6M -II- 2023
3.3 Përgatitja e informacioneve të thjeshta dhe materialeve promocionale për çështjet shëndetësore, edhe në gjuhën rome dhe me figura.	Romë dhe egjiptianë të cilët kanë marrë medikamente falas për mjekimin e tyre si rezultat i infektimit me COVID-19.	Instituti i Shëndetit Publik	OSHKSH NJVKSH	6M -II- 2021–6M -II- 2025
3.4 Zhvillimi i fushatave sensibilizuese pranë vendbanimeve rome dhe egjiptiane për situata të ndryshme	4 materiale promocionale janë përgatitur në gjuhën rome dhe/ose përfshirë figurat	MSHMS,	OSHKSH NJVKSH	6M -II- 2021–6M -II- 2025
3.5 Mbështetja e nënave rome dhe egjiptiane duke u dhënë atyre informacione dhe pako me materiale për kujdesin për foshnjat dhe nënat për tre muajt e parë të jetës, për ato nëna që e lindin fëmijën në spital.	12,622 nëna rome dhe egjiptiane marrin paketën për kujdesin e foshnjave dhe nënave.	MSHMS	NJVKSH	6M -II- 2021–6M -II- 2025



Fusha prioritare: KUJDESI SHËNDETËSOR				
Qëllimi i Politikës III:	Ulja e hendekut në cilësinë e shëndetit midis pakicave rome dhe egjiptiane dhe pjesës tjetër të popullsisë			
Objektivi III.4:	Ulja e numrit të anëtarëve të Pakicave Rome dhe Egjiptiane me sëmundje infektive seksualisht të transmetueshme dhe egjiptianët			
Rezultatet e pritshme:	i. Deri në fund të vitit 2025, 50% më pak anëtarë të Pakicave Rome dhe Egjiptian raportohen me sëmundje seksualisht të transmetueshme			
Treguesit:	4.1.1 Numri i fushatave të informimit dhe edukimit në lidhje me sëmundjet seksualisht të transmetueshme, si dhe shëndetin riprodhues me pjesëmarrjen e anëtarëve të Pakicave Rome dhe Egjiptiane.		Baseline 1 (2020): Nuk ka të dhëna	Target 5 (2025) 5
	4.2.1 Numri i romëve dhe egjiptianëve të cilët kanë përfituar kontrolle dhe diagnostikime për sëmundje seksualisht të transmetueshme.		Baseline 1 (2020): Nuk ka të dhëna	Target 5 (2025) 300
	4.3.1 Numri i grave rome dhe egjiptiane të cilat përfitojnë medikamente falas dhe vizita gjatë periudhës së shtatzënisë		Baseline 1 (2020): Nuk ka të dhëna	Target 5 (2025): 450
MASAT DHE AKTIVITETET	PRODUKTI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONET PARTNERE	AFATI KOHOR
4.1 Fushata informimi dhe edukimi me anëtarë të pakicave rome dhe egjiptiane në lidhje me sëmundjet seksualisht të transmetueshme, si dhe shëndetin riprodhues.	5 fushata të informimit dhe edukimit në lidhje me sëmundjet seksualisht të transmetueshme, si dhe shëndetin riprodhues me pjesëmarrjen e anëtarëve të pakicave rome dhe egjiptiane.	MSHMS	NJVKSH	6M -II- 2021–6M -II- 2025
4.2 Kontrolle periodike dhe diagnostikime të anëtarëve të pakicave rome dhe egjiptiane me sëmundje seksualisht të transmetueshme	300 romë dhe egjiptianë kanë përfituar kontrolle dhe diagnostikime për sëmundje seksualisht të transmetueshme.	MSHMS	NJVKSH	6M -II- 2021–6M -II- 2025
4.3 Ofrimi i medikamenteve dhe vizitave falas për anëtarë të pakicave rome dhe egjiptiane të diagnostikuar me sëmundje seksualisht të transmetueshme.	450 gra rome dhe egjiptiane përfitojnë medikamente falas dhe vizita gjatë periudhës së shtatzënisë	MSHMS	FSDKSH	6M -II- 2021–6M -II- 2025



Fusha prioritare: ARSIMI DHE NXITJA E DIALOGUT NDËRKULTUROR			
Qëllimi i politikës IV:	Rritja e aksesit të barabartë në arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës për romët dhe egjiptianët në të gjitha nivelet arsimore		
Objektivi IV.1:	Arsim cilësor, gjithëpërfshirës dhe i barabartë për romët dhe egjiptianët në të gjitha nivelet arsimore.		
Rezultatet e pritshme:	i. Deri në fund të 2025, 80% më shumë fëmijë romë dhe egjiptianë përfundojnë arsimin parashkollor, arsimin bazë dhe arsimin e mesëm të lartë në krahasim me vitin 2020		
Treguesit:	4.1.1 Numri i nxënësve romë dhe egjiptianë të identifikuar që duhet të ndjekin arsimin parashkollor	Baseline 1 (2020): 179	Target 5 (2025) 18% më shumë mbi vlerën baseline 2020
	4.1.2 Numri i nxënësve romë dhe egjiptianë të identifikuar që duhet të ndjekin arsimin e detyruar	Baseline 1 (2020): 179	Target 5 (2025) me18% më shumë mbi vlerën baseline 2020
	4.2.1 Numri i nxënësve romë dhe egjiptianë të regjistruar në arsimin parashkollor	Baseline 1 (2020): 13,086kanë frekuentuar arsimin parashkollor dhe të detyrueshëm	Target 5 (2025) 15% më shumë mbi vlerën baseline 2020
	4.2.2 Numri i nxënësve romë dhe egjiptianë të përjashtuar nga tarifat për ndjekjen e arsimit parashkollor	Baseline 1 (2020): 482	Target 5 (2025): 53% mbi vlerën baseline 2020
	4.2.3 Numri i bashkive që kanë miratuar VKB për reduktimin/përjashtimin nga tarifat financiare ku përfshihen edhe fëmijët romë dhe egjiptianë	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2022): 10
	4.3.1 Numri i nxënësve romë dhe egjiptianë të regjistruar dhe që frekuentojnë arsimin e detyruar	Baseline 1 (2020): 13,086 kanë frekuentuar arsimin parashkollor dhe të detyrueshëm	Target 5 (2025): 19% mbi vlerën baseline 2020
	4.3.2 Numri i nxënësve romë dhe egjiptianë që përfundojnë arsimin e detyruar	Baseline 1 (2020): 13,086kanë përfunduar arsimin parashkollor dhe të detyrueshëm	Target 5 (2025): 19% më shumëmbi vlerën baseline 2020
	4.3.3 Numri i nxënësve/adultëve romë dhe egjiptianë që përfundojnë arsimin bazë me kohë të pjesshme	Baseline 1 (2020): 97	Target 5 (2025): 30% më shumëmbi vlerën baseline 2020
	4.4.1 Numri i nxënësve romë dhe egjiptianë që përfitojnë transport falas për në shkollë dhe kopsht	Baseline 1 (2020): 152	Target 5 (2025): 25% më shumë mbi vlerën baseline
	4.4.2 Rishikim vendimi nr. 682, datë 29.7.2015, “Për përdorimin e fondeve publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit” për përcaktimin e kriterëve të reja për rastet specifike që nuk përmbushin distancën 2 km dhe për ripërcaktim të kalimit të transfertës financiare për shërbimin e transportit direkt te prindërit e fëmijëve	Baseline 1 (2020): vendim nr. 682, datë 29.7.2015	Target 5 (2022): Rishikim/Aprovim VKMNr. 682, datë 29.7.2015



4.5.1 Numri i nxënësve romë dhe egjiptianë që përfitojnë nga programet mbashkolllore	Baseline 1 (2020): 956	Target 5 (2025): 62% mbi vlerën <i>baseline</i>
4.6.1 Numri i saktë dhe i plotë i prindërve romë dhe egjiptianë të cilët nuk kanë njohuri në shkrim/lexim.	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 32%
4.6.2 Numri i prindërve romë dhe egjiptianë që kanë marrë pjesë në kurset për të shkruar, lexuar dhe aftësive bazë	Baseline 1 (2020): 1370	Target 5 (2025): 20% më shumë mbi vlerën <i>baseline</i>
4.7.1 Numri i nxënësve romë dhe egjiptianë që kanë përfituar nga subvencionimi shtesë i pagesës së ndihmës ekonomike	Baseline 1 (2020): 1143	Target 5 (2025): 15% më shumë mbi vlerën <i>baseline</i>
4.7.2 Rishikim dhe rritje e subvencionimit shtesë të ndihmës ekonomike që marrin familjet romë dhe egjiptiane fëmijët e të cilëve ndjekin rregullisht arsimin bazë	Baseline 1 (2020): VKM Nr. 597, datë 4.9.2019	Target 5 (2022): Rishikim VKM Nr. 597, datë 4.9.2019
4.8.1. Rishikim VKM-së nr. 666, datë 10.10.2019, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike.” miratuar nga MAS-i	Baseline 1 (2020): VKM nr 666, datë 10.10. 2019	Target 5 (2022): Rishikim VKM nr 666, datë 10.10. 2019
4.8.2 Numri i nxënësve romë dhe egjiptianë që kanë përfituar bursën.	Baseline 1 (2020): 142 (në nivele të ndryshme arsimit)	Target 5 (2025): 24% më shumë mbi vlerën <i>baseline</i> 2020
4.9.1. Studentët romë dhe egjiptianë që marrin bursë.	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 33% më shumë mbi vlerën <i>baseline</i>
4.9.2 Numri i studentëve romë dhe egjiptianë të ciklit të parë (<i>bachelor</i>) që kanë përfituar përjashtim nga tarifa vjetore të shkollimit	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2022): 43 % më shumë mbi vlerën <i>baseline</i> 2020
4.9.3 Numri i studentëve romë dhe egjiptianë të ciklit të dytë të studimeve (master profesional/shkencor) që kanë përfituar reduktim të tarifës vjetore	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2022): 43 % më shumë mbi vlerën <i>baseline</i> 2020
4.9.4 Numri i studentëve romë dhe egjiptianë që janë përjashtuar nga tarifa e pagesës për gjuhën e huaj që nevojitet për pajisjen me diplomë	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2022): 17% më shumë mbi vlerën <i>baseline</i> 2020
4.10.1 Numri i studentëve romë dhe egjiptianë që kanë përfituar kuota të veçanta në universitetet përkatëse	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2022): 36 % më shumë mbi vlerën <i>baseline</i> 2020



MASAT DHE AKTIVITETET	PRODUKTI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONET PARTNERE	AFATI KOHOR
1.1 Identifikimi në kohë i nxënësve romë dhe egjiptianë që janë në moshë për t'u regjistruar në arsimin parashkollor dhe atë bazë, si dhe nxitja e përfshirjes në arsimin e detyruar të nxënësve të moshës 6–16 vjeç që nuk janë regjistruar apo kanë braktisur shkollën. (sipas urdhrit të përbashkët MAS, MB, MSHMS nr. 292, datë 28.5. 2019 – “Për identifikimin dhe regjistrimin në shkollë të të gjithë fëmijëve të moshës të detyrimit shkollor”)	Rritet me 18% më shumë mbi vlerën e <i>baseline</i> 2020 identifikimi në terren i fëmijëve romë dhe egjiptianë në moshë për arsimin parashkollor dhe atë bazë.	MAS	Ministria e Brendshme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	2021–2025
1.2 Sigurimi dhe përmirësimi i kushteve për arsim cilësor gjatë fëmijërisë së hershme nëpërmjet regjistrimit të të gjithë nxënësve romë dhe egjiptianë 3-6 vjeç në arsimin parashkollor duke i përjashtuar ata nga tarifat financiare dhe pagesat për ushqim.	15% më shumë fëmijë romë dhe egjiptianë regjistruar në arsimin parashkollor llogaritur mbi vlerën e <i>baseline</i> 2020. 53% më shumë fëmijë romë dhe egjiptianë të moshës 3–6 vjeç përfitojnë përjashtim nga tarifat financiare dhe pagesat për ushqim, llogaritur mbi vlerën e <i>baseline</i> 2020. 10 bashki të tjera kanë miratuar VKB për reduktimin/përjashtimin nga tarifat financiare për fëmijët romë dhe egjiptianë.	NJVV	Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, MAS	2021–2025
1.3 Regjistrimi, ndjekja e ecures së rregullt dhe përfundimi i studimeve në arsimin bazë/të detyrueshëm i të gjithë nxënësve romë dhe egjiptianë të moshës 6-16 vjeç, duke përfshirë gjithashtu edhe rastet e nxënësve që kanë kaluar moshën e arsimit të detyrueshëm dhe kanë qenë në pamundësi për ta ndjekur atë.	19% më shumë fëmijë romë dhe egjiptianë 6-16 vjeç përfundojnë arsimin e detyrueshëm, llogaritur mbi vlerën <i>baseline</i> 2020. 30% më shumë nxënës/adultë romë dhe egjiptianë përfundojnë arsimin bazë me kohë të pjesshme llogaritur mbi vlerën <i>baseline</i> 2020.	MAS	Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar, NJVV, Njësitë e mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve	2021–2025
1.4 Sigurim i transportit falas për nxënësit romë dhe egjiptianë të cilët banojnë larg kopshteve dhe shkollave (edhe nën distancën 2 km për raste specifike të justifikuar) dhe lehtësimi i procedurave për transfertën e shpenzimeve të transportit.	25% më shumë fëmijë romë dhe egjiptianë do të përfitojnë transport falas llogaritur mbi vlerën <i>baseline</i> 2020. Vendim nr. 682, datë 29.7.2015, “Për përdorimin e Fondeve Publike për transportimin e punonjësve arsimorë që punojnë dhe të nxënësve që mësojnë jashtë vendbanimit” është rishikuar dhe janë përcaktuar kriteret për rastet specifike që nuk përmbushin distancën 2 km, gjithashtu është ripërcaktuar mënyra e kalimit të transfertës financiare për shërbimin e transportit direkt te prindërit e fëmijëve.	MAS	Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar NJVV	2021–2025



1.5 Organizim i programeve të veçanta mbashkollore ku nxënësit romë dhe egjiptianë të moshës 6–16 vjeç të ndihmohen në kryerjen e detyrave mësimore ose marrin mësim plotësues.	62% më shumëfëmijë romë dhe egjiptianë do të ndihmohen në kryerjen e detyrave mësimore dhe marrin mësim plotësues, llogaritur mbi vlerën <i>baseline</i> viti 2020.	MAS	Shkollat publike të arsimit të detyruar (shkollat qendër komunitare), Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (qendrat komunitare multifunkionale), Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar	2021–2025
1.6 Ofrim i kurseve për të ndërtuar dhe zhvilluar njohuritë bazë në shkrim/lexim dhe aftësitë jetësore të prindërve romë dhe egjiptianë me mungesë arsimit, fëmijët e të cilëve frekuentojnë arsimin e detyruar.	20% më shumëprindër romë dhe egjiptianë do të marrin pjesë në kurse për të ndërtuar dhe zhvilluar njohuritë bazë në shkrim/lexim dhe aftësitë jetësore, llogaritur mbi vlerën <i>baseline</i> 2020.	MAS	Shkollat publike të arsimit të detyruar (shkollat qendër komunitare), NJVV (qendrat komunitare multifunkionale).	2021–2025
1.7 Rritja e subvencionimit shtesë, pjesë e skemës së ndihmës ekonomike, për nxënësit romë dhe egjiptianë që ndjekin rregullisht arsimin e detyrueshëm.	Numri i nxënësve romë dhe egjiptianë përfitues së subvencionimit shtesë të ndihmës ekonomike është rritur me 15% më shumë, llogaritur mbi vlerën <i>baseline</i> 2020. VKM nr. 597, datë 4.9.2019 është rishikuar dhe është rritur shuma e subvencionimit të NE që përfitojnë nxënësit romë dhe egjiptianë që frekuentojnë rregullisht arsimin e detyruar.	MSHMS	Shkollat publike të arsimit të detyruar, NJVV, <i>Shtërimi Social Shtetëror</i> , MAS	2021–2025
1.8 Përcaktimi i kriterëve për dhënien e bursës financiare për nxënës romë dhe egjiptianë që ndjekin gjimnazin, arsimin e mesëm profesional dhe arsimin e mesëm të orientuar.	VKM nr. 666, datë 10.10. 2019 është rishikuar dhe janë miratuar nga MAS-i kriteret për përfutimin e bursës financiare të nxënësve romë dhe egjiptianë që ndjekin arsimin e mesëm të lartë. Numri i nxënësve romë dhe egjiptianë që ndjekin arsimin e mesëm të lartë të përgjithshëm dhe marrin bursë rritet me 24% më shumë mbi vlerën <i>baseline</i> 2020.	MAS	NJVV	2021–2025
1.9 Mbështetje e studentëve romë dhe egjiptianë që ndjekin arsimin e lartë nëpërmjet ofrimit të bursave, reduktimit të tarifës së shkollimit dhe përjashtimit nga tarifa e pagesës për mbrojtjen e gjuhës së huaj, detyruese për pajisjen me diplomë.	43% më shumë studentë romë dhe egjiptianë të ciklit të parë (<i>bachelor</i>) dhe ciklit të dytë (Master)përfitojnë përjashtim nga tarifa vjetore të shkollimit, përcaktuar mbi vlerën <i>baseline</i> të 2020-ës. 17% më shumë studentë romë dhe egjiptianë janë përjashtuar nga tarifa e pagesës për gjuhën e huaj që nevojitet për pajisjen me diplomë.	Institucionet e Arsimit të Lartë	MAS, NJVV	2021–2025
1.10 Regjistrimi i studentëve romë dhe egjiptianë në arsimin e lartë në të gjitha nivelet dhe në programe të ndryshme studimi të arsimit të lartë nëpërmjet kuotave të veçanta.	36 % më shumë studentëve romë dhe egjiptianë përfitojnë kuota të veçanta në universitetet përkatëse, llogaritur mbi vlerën <i>baseline</i> 2020.	MAS	Institucionet e Arsimit të Lartë	2021–2025



Fusha prioritare: ARSIMI DHE NXITJA E DIALOGUT NDËRKULTUROR			
Qëllimi i politikës IV:	Rritja e aksesit të barabartë në arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës për romët dhe egjiptianët në të gjitha nivelet arsimore		
Objekti IV.2:	Përkrahja e një sistemi gjithëpërfshirës të arsimit, duke mundësuar qasje të barabartë në arsim cilësor për romët dhe egjiptianët		
Rezultatet e pritshme:	i. Deri në fund të vitit 2025 është përfshirë në të gjitha nivelet arsimore kurrikula e historisë dhe kulturës rome dhe egjiptiane; ii. Deri në fund të 2025 raportohen 0 klasa apo shkolla të segreguara; iii. 90% e personelit arsimor i trajnuar për arsimin gjithëpërfshirës, diversitetin dhe antixhopsizmin deri në fund të 2025.		
	4.2.1. Numri i mësuesve psikologëve, punonjësve social të arsimit parauniversitar të trajnuar mbi kompetencat kyçe të edukimit për arsimin gjithëpërfshirës, diversitetin, antixhopsizmin dhe ndryshimit të sjelljes.	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025) 65% mbi vlerën <i>baseline</i> 2020
	4.3.1 Numri i teksteve shkollore aktuale të analizuara dhe të rishikuara për të eliminuar stereotipat që lidhen me romët dhe egjiptianët.	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 20 tekste
	4.3.2 Numri i udhëzuesve për zbatimin e materialeve mësimore të rishikuara dhe metodave të trajnimit në bashkëpunim me komunitetet rome dhe egjiptiane dhe shoqërinë civile, akademikët, institutet e trajnimit të mësimdhënësve dhe organizatat profesionale të mësimdhënësve.	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 48% mbi vlerën <i>baseline</i> 2020
	4.3.3 Numri i materialeve shtesë të cilësisë së lartë të përgatitura për mësimdhënie dhe të nxënë, për t'u përdorur, në bashkëpunim me shoqërinë civile dhe akademikët romë dhe egjiptianë me qëllim ndërtimin dhe plotësimin e burimeve ekzistuese	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 40% mbi vlerën <i>baseline</i> 2020
	4.3.4 Numri i materialeve, mjeteve dhe publikimeve ekzistuese të mësimdhënies pedagogjike dhe hulumtuese për historinë e Romëve dhe të Egjiptianëve të shfrytëzuara, të përgatitura nga palët e interesuara ndërkombëtare si Këshilli i Evropës, Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (FRA), UNESCO, Aleanca Ndërkombëtare e Kujtimit të Holokaustit (IHRA), Fondacioni Shoah/Instituti i Historisë dhe Edukimit Vizual i Universitetit të Kalifornisë Jugore (USC), Instituti Evropian Rom për Artin dhe Kulturën (ERAC), Shoqata Evropiane e Edukatorëve të Historisë (EUROCLIO), dhe institucione të tjera.	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 38% mbi vlerën <i>baseline</i> 2020
	4.4.1 Kurrikula për mësimin e gjuhës rome në arsimin parauniversitar dhe atë universitar e miratuar nga MAS.	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 1
	4.4.2 Numri i kurrikulave shkollore të analizuara dhe të rishikuara, duke u përqendruar në kurrikulat e historisë, në mënyrë që të përfshijnë përmbajtje, që lidhen me historinë dhe kulturën e Romëve dhe të Egjiptianëve në mësimin e përgjithshëm të historisë	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 7
	4.4.2 Numri i institucioneve arsimore që zhvillojnë mësimin e gjuhës rome.	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 10
	4.5.1 Numri i shkollave të segreguara.	Baseline 1 (2020):	Target 5 (2025):
	4.5.1.2 Numri i klasave të segreguara.	5 Baseline 1 (2020): 12	0 Target 5 (2025): 0



	4.7.1 Numri i fushatave dhe sesioneve informuese të zhvilluara me prindërit romë dhe egjiptianë për rëndësinë e arsimit dhe sanksionet administrative për rastet e mosregjistrimit të fëmijës në sistemin arsimor.		Baseline 1 (2020): 26	Target 5 (2025): 38% mbi vlerën e realizimit <i>baseline</i> 2020	
	4.7.2 Numri i Grupe të punës ndërsektoriale funksionale në 61 bashki me përfshirjen e drejtorëve të shkollave, mësuesve kujdestar, njësitë e mbrojtjes së fëmijëve, punonjësit social dhe psikologët për të parandaluar braktisjen, dhe rikthimin në shkollë të nxënësve rome dhe egjiptian.		Baseline 1 (2020): 25	Target 5 (2025): 27	
	4.7.3 Numri i nxënësve romë dhe egjiptian që kanë braktisur shkollën dhe numri i fëmijëve romë dhe egjiptianë që janë rikthyer në shkollë.		Baseline 1 (2020): 179	Target 5 (2025): 36% më shumë mbi vlerën e realizimit <i>baseline</i> 2020	
	4.8.1. Skema nxitëse, mbështetëse dhe detyruese aplikuar nga bashkitë për përfundimin e arsimit bazë.		Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 5	
	4.8.2. Numri i familjeve të referuara në shërbimet e mbrojtjes sociale ose në burimet e tjera të mbështetjes.		Baseline 1 (2020): 446	Target 5 (2025): 21% më shumë mbi vlerën e realizimit <i>baseline</i> 2020	
	4.9.1 Numri i nxënësve të pajisur me kompjutera, tableta, telefona dhe linjë interneti.		Baseline 1 (2020): 1156	Target 5 (2025): 62% më shumë mbi vlerën e realizimit <i>baseline</i> 2020	
MASAT DHE AKTIVITETET		PRODUKTI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONET PARTNERE	Afati Kohor:
2.1 Trajnim dhe kualifikim i stafit të institucioneve arsimore parashkollore dhe parauniversitar, për: - Arsimin gjithpërfshirës në kuadrin e diversitetit social dhe kulturor, dhe antixhopsizmit; - Ndryshimin e qëndrimeve dhe sjelljes për të reduktuar barrierat në arsimin cilësor të romëve dhe të egjiptianëve.		Janë trajnuar 65% e mësuesve psikologëve, punonjësve social të arsimit parauniversitar mbi kompetencat kyçe të edukimit për arsimin gjithpërfshirës, diversitetin, antixhopsizmin dhe ndryshimit të sjelljes.	MAS	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar, Shkollat publike, NJVV	2021–2025
2.2 Kurrikula shkollore të analizuar dhe të rishikuara, duke u përqendruar në kurrikulat e historisë, në mënyrë që të përfshijnë përmbajtje që lidhen me historinë dhe kulturën e Romëve dhe të Egjiptianëve në mësimin e përgjithshëm të historisë.		85% e teksteve shkollore analizuar dhe rishikuara dhe janë eliminuar stereotipet që lidhen me romët dhe egjiptianët. 48% e udhëzuesve për zbatimin e materialeve mësimore dhe metodave të trajnimit kanë mbaruar së rishikuari në bashkëpunim me komunitetet rome dhe egjiptiane, akademikët, institutet e trajnimit të mësimdhënësve dhe organizatat profesionale të mësimdhënësve. Janë hartuar materiale shtesë të përgatitura për mësimdhënie dhe të nxënë, me qëllim ndërtimin dhe plotësimin e burimeve ekzistuese, llogaritur 40% më shumë mbi vlerën <i>baseline</i> 2020.	MAS	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar. Këshilli i Evropës, Agjencia e Bashkimit Evropian për të Drejtat Themelore (FRA), UNESCO, Aleanca Ndërkombëtare e Kujtimit të Holokaustit (IHRA), Fondacioni Shoah/Instituti i Historisë dhe Edukimit Vizual i Universitetit të Kalifornisë Jugore (USC), Instituti Evropian Rom për Artin dhe	2021–2025



			Kulturën (ERIAC), Shoqata Evropiane e Edukatorëve të Historisë (EUROCLIO)	
2.3 Zhvillimi i kurrikulës për mësimin e gjuhës rome në arsimin parauniversitar dhe atë universitar.	Është hartuar nga MAS 1 (një) Kurrikul e gjuhës rome, dhe kjo gjuhë mësohet në 10 institucione arsimore.	<i>Ministria e Arsimit dhe Sportit</i>	Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar	2021–2025
2.4 Parandalimi dhe trajtimi i shkollave të segreguara	Mbyllja e 12 klasave të segreguara dhe eliminimi në 5 shkolla i përqendrimit shpërpjesëtimor të nxënësve romë dhe egjiptianë duke e balancuar me fëmijët e tjerë.	<i>MAS</i>	Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë e shkollave, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar OJF-të rome dhe egjiptiane	2021–2025
2.5 Identifikimi dhe adresimi i nevojave të nxënësve që nuk janë regjistruar në arsimin e detyrueshëm, nuk vijojnë rregullisht mësimin apo janë në rrezik braktisje.	Krijohen 27 Grupe të punës ndërsektoriale funksionale të reja pranëbashkive me përfshirjen e drejtorëve të shkollave, mësuesve kujdestar, njësitë e mbrojtjes së fëmijëve, punonjësit social dhe psikologët për të parandaluar braktisjen, dhe rikthimin në shkollë të nxënësve romë dhe egjiptianë. Është rritur me 38% mbi vlerën e realizimit <i>baseline</i> 2020, numri i fushatave dhe sesioneve informuese të zhvilluara me prindërit romë dhe egjiptianë për rëndësinë e arsimimit dhe sanksionet administrative për rastet e mosregjistrimit të fëmijës në sistemin arsimor.	Drejtoritë e shkollave	Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve, Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar	2021–2025
2.6 Referimi i familjeve të fëmijëve që braktisin shkollën ose që rrezikojnë të braktisin arsimin e detyrueshëm në shërbimet e mbrojtjes sociale dhe burimet e tjera mbështetëse.	5 Skema nxitëse, mbështetëse dhe detyruese aplikuar nga bashkitë për përfundimin e arsimit bazë. Është rritur me 21% më shumë numri i familjeve të referuara në shërbimet e mbrojtjes sociale ose në burimet e tjera të mbështetjes, llogaritur mbi realizimin <i>baseline</i> të vitit 2020.	Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve	Drejtoritë e shkollave, NJVV, Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar	2021–2025
2.7 Situata COVID-19: Pajisja me mjete elektronike (kompjutera, tableta dhe telefona) dhe internet për zhvillimin e mësimin <i>online</i> , për nxënësit romë dhe egjiptianë, familjet e të cilëve kanë të ardhura të pamjaftueshme.	62% më shumë nxënës romë dhe egjiptianë janë pajisur me kompjutera, tableta, telefona dhe linjë interneti, llogaritur mbi realizimin <i>baseline</i> të vitit 2020.	<i>MAS</i>	Drejtoritë e shkollave, NJVV, Zyrat Vendore të Arsimit Parauniversitar	2021–2025
Fusha prioritare: ARSIMI DHE NXITJA E DIALOGUT NDËRKULTUROR				
Qëllimi i politikës IV:	Rritja e aksesit të barabartë në arsim cilësor dhe gjithëpërfshirës për romët dhe egjiptianët në të gjitha nivelet arsimore			
Objekti i IV.3:	Trashëgimia kulturore rome dhe egjiptiane si vlerë e trashëgimisë kulturore shqiptare			



Rezultatet e pritshme:	i. Deri në fund të 2025 janë realizuar 80% më shumë aktivitete që promovojnë dhe ruajnë identitetin, historinë dhe kulturën e pakicave rome dhe egjiptiane në shoqërinë shqiptare.		
Treguesit:	3.1.1 Numri i projekteve artistiko-kulturne organizuar në kuadër të 8 prillit; 24 qershorit; 2 gushtit Holokaustit etj.) që promovojnë identitetin, kulturën dhe historinë e Romëve dhe të Egjiptianëve në nivel kombëtar dhe lokal	Baseline 1 (2018): 2	Target 5 (2025) 10% më shumë mbi vlerën e realizimit baseline 2020
	3.1.2 Numri i panairëve me punime artistike apo festivale të muzikës rome dhe egjiptiane të organizuara	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025) 9% më shumë mbi vlerën e realizimit baseline 2020
	3.2.1 Numri i emisioneve dhe dokumentarëve të realizuar dhe koha e rezervuar e transmetimit në media	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 9% më shumë mbi vlerën e realizimit baseline 2020
	3.2.2 Numri i aktiviteteve të organizuara nga shoqatat kulturore, sidomos të punës kërkimore në bashkëpunim dhe me pushtetin vendor	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2022): 19% më shumë mbi vlerën e realizimit baseline 2020
	3.3.1 Vendorsja e % ose nr. të caktuar të thirrja për financimin e projekteve për pakicat rome dhe egjiptiane	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2022): 8 projekte
	3.3.2 Numri i projekteve të miratuar	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 8 projekte
	3.4.1 Shpërndarja e informacionit nëpërmjet krijimit të broshurave, fletëpalosjeve, studimeve, librave me histori/përralla etj.	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 9% më shumë mbi vlerën e realizimit baseline 2020
	3.4.2 Digjitalizimi i trashëgimisë kulturore të romëve dhe të egjiptianëve	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 9% më shumë mbi vlerën e realizimit baseline 2020
	3.4.3 Numri i personave nga grupet e interesit të trajnuar dhe këshilluar mbi standardet e dokumentimit të diversitetit dhe trashëgimisë jomateriale (përmes trajnimeve dhe <i>workshop</i> -eve).	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 50
	3.4.4 Publikimi i literaturës së shkruar në gjuhët e pakicave kombëtare, së bashku me përkthimin në gjuhën shqipe.	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 5
	3.5.1 Projektet e fituar nga OJF-të rome dhe egjiptiane.	Baseline 1 (2020): 1	Target 5 (2022): 14 % më shumë mbi vlerën e realizimit baseline 2020
	3.6.1.1 Numri i romëve dhe egjiptianëve të punësuar pranë institucioneve të Ministrisë së Kulturës	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 9% më shumë mbi vlerën e realizimit baseline 2020



MASAT DHE AKTIVITETET	PRODUKTI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONET PARTNERE	AFATI KOHOR
3.1 Planifikimi dhe mbështetja e projekteve artistiko-kulturore që promovojnë identitetin, kulturën dhe historinë e Romëve dhe të Egjiptianëve në nivel kombëtar dhe lokal në kuadër të 8 prillit; 24 qershorit; 2 gushtit Holokausti etj.) dhe përfshirja e tyre në kalendarin e aktiviteteve.	Janë organizuar 10% më shumë projekte artistiko-kulturore që promovojnë identitetin, kulturën dhe historinë e Romëve dhe të Egjiptianëve në nivel kombëtar dhe lokal, llogaritur në raport me vlerën e realizuar në 2020. 9% më shumë panire me punime artistike apo festivale të muzikës rome dhe egjiptiane të organizuara.	Ministria e Kulturës	Drejtoritë Rajonale të Kulturës, Qendrat Kulturore, NJVV	2021–2025
3.2 Informim dhe ndërgjegjësim i shoqërisë për kulturën rome dhe egjiptiane nëpërmjet programeve të institucioneve mediatike publike.	9% më shumë emisione dhe dokumentare të realizuar nga RTSH për ndërgjegjësimin e shoqërisë për kulturën rome dhe egjiptiane, llogaritur në raport me vlerën e realizuar në 2020. Rritet me 19% më shumë mbi vlerën e realizimit <i>baseline</i> 2020 puna kërkimore në bashkëpunim dhe me pushtetin vendor dhe OJF-të kulturore.	RTSH	Ministria e Kulturës	2021–2025
3.3 Përcaktimi i fondit për pakicat kombëtare për projekte që synojnë mbrojtjen e të drejtave, ruajtjen/ promovimin e identitetit kulturor dhe etnik për pakicat rome dhe egjiptiane.	8 projekte të caktuar të thirrja për financimin e projekteve për pakicat rome dhe egjiptiane.	Komiteti për Pakicat Kombëtare/ Fondi për Pakicat Kombëtare	n/a	2022-2025
3.4 Evidentimi dhe promovimi i trashëgimisë kulturore materiale dhe jomateriale të romëve dhe të egjiptianëve nëpërmjet procesit kërkimor dhe nxitjes së krijimtarisë artistike në muzikë, artet e bukura fotografi, veshje tradicionale, instrumente muzikore etj.	Do të jetë digjitalizuar trashëgimia kulturore e Romëve dhe të Egjiptianëve në masën 9% më shumë se <i>baseline</i> 2020. Janë krijuar broshura, fletëpalosje dhe libra me histori/përralla me informacion në lidhje me romët dhe egjiptianët. Është llogaritur 9% më shumë se <i>baseline</i> 2020. 50 romë dhe egjiptianë të trajnuar dhe këshilluar mbi standardet e dokumentimit të diversitetit dhe trashëgimisë jomateriale. 5 libra të publikuar në gjuhën rome së bashku me përkthimin në gjuhën shqipe.	Ministria e Kulturës	Qendra Kombëtare e Leximit dhe Librit) QKLL + BK (Biblioteka Kombëtare) institucionet qendrore kulturore në varësi të MK-së	2021–2025



3.5 Prioritizim i organizatave rome dhe egjiptiane për të përfutur nga thirrja për propozime e Ministrisë së Kulturës. Thirrja vjetore e përvitshme: <i>online</i> NJOFITIM PËR HAPJEN E “PROJEKTEVE ME THIRRJE 2021” - Ministria e Kulturës (kultura.gov.al)	14% më shumë projekte sesa <i>baseline</i> 2020 përfitohen nga OJF-të rome dhe egjiptiane prej MK-së.	Ministria e Kulturës	n/a	2021–2025
3.6 Punësimi i romëve dhe egjiptianëve që kanë mbaruar akademinë e arteve në institucionet qendrore/rajonale të Ministrisë së Kulturës.	9% më shumë romë dhe egjiptin janë punësuar pranë MK dhe institucioneve të saj të varësisë.	Ministria e Kulturës,	DAP	2021–2025
Fusha prioritare: PUNËSIMI DHE AFTËSIMI				
Qëllimi i politikës V:	Krijim i mundësive të barabarta për punësim cilësor dhe të qëndrueshëm për romët dhe egjiptianët.			
Objekti V.1:	Nxiti e punësimit të romëve dhe të egjiptianëve nëpërmjet AFP-së, dhe PATP-ve.			
Rezultatet e pritshme:	i. 100% e popullsisë rome dhe egjiptiane është informuar mbi PATP-te deri në fund të 2025-s. ii. Deri në fund të 2025 janë punësuar 60% e Romëve dhe të Egjiptianëve punëkërkuar të papunë të cilët: janë regjistruar pranë zyrave të punës; ii. janë bërë pjesë e PNP-ve dhe iii. kanë përfunduar AFP.			
Treguesit:	5.1.1 Numri i romëve dhe egjiptianëve të cilët kanë marrë shërbime këshillimi dhe orientimi për karrierë		<i>Baseline</i> 1 (2020): 10	Target 5 (2025): 50% mbi realizimin e vitit 2024
	5.2.1 Numri i romëve dhe egjiptianëve të regjistruar në formim profesional (privat dhe publik)		<i>Baseline</i> 1 (2020): 81	Target 5 (2025): 165
	5.2.2 Numri i romëve dhe egjiptianëve pjesëmarrës në PNP (praktika profesionale dhe formim në punë (VKM 17)		<i>Baseline</i> 1 (2020): 54	Target 5 (2025): 160
	5.2.3 Numri i romëve dhe egjiptianëve të certifikuar në formim profesional (privat dhe publik)		<i>Baseline</i> 1 (2020): 25	Target 5 (2025): 120
	5.2.4 Numri i romëve dhe egjiptianëve që kanë përfunduar me sukses PNP (praktika profesionale dhe formim në punë (VKM 17)		<i>Baseline</i> 1 (2020): 20	Target 5 (2025): 70
	5.3.1 Numri i romëve dhe egjiptianëve të integruar në tregun e punës nëpërmjet PNP-ve.		<i>Baseline</i> 1 (2020): 10	Target 5 (2025): 50
	5.3.2 Numri i romëve dhe egjiptianëve të integruar në tregun e punës nëpërmjet punësimit, programit të nxitjes nëpërmjet vetëpunësimit, programit të punëve publike në komunitet,		<i>Baseline</i> 1 (2020): 550	Target 5 (2025): 754
	5.4.1 Numri i romëve dhe egjiptianëve kursante (pu.pa dhe jo pu.pa) të cilët kanë përfunduar një kurs formimi profesional ose nxënës të cilët kanë mbaruar një nivel të arsimit të mesëm profesional (certifikuar dhe diplomuar) dhe janë punësuar.		<i>Baseline</i> 1 (2020): 150	Target 5 (2025): 254
	5.5.1 Numri i të rinjve romë dhe egjiptianë që ndjekin ose kanë përfunduar praktikën pranë institucioneve të administratës shtetërore, njërive të vetëqeverisjes vendore dhe institucioneve të pavarura.		<i>Baseline</i> 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 105



	5.5.2 Numri i të rinjve romë dhe egjiptianë që janë punësuar pranë institucioneve ku kanë kryer praktikën e punës.	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 60
	5.6.1 Numri i të rinjve romë dhe egjiptianë të përfshirë në zbatimin e skemës së garancisë rinore për përfitues të kategorisë NEET=jo në arsim, jo në trajnim jo në punësim).	Baseline 1 (2020): n/a (fillon 2022)	Target 5 (2025): Ska të përcaktuar
	5.7.1 Numri i romëve dhe egjiptianëve të punësuar në administratën publike në nivel qendror dhe vendor	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 100
	5.8.1 Vendim i aprovuar për vazhdimin e përfitimeve të NE për përfituesit romë dhe egjiptianë të regjistruar në PNP derisa të gjejnë punësim afatgjatë në vijim të përfundimit të programit të nxitjes së punësimit	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 1VKM e rishikuar
	5.9.1 Numri i eventeve promovuese dhe ndërgjegjëse të organizuara në komunitetet romë dhe egjiptiane mbi rëndësinë dhe mundësitë e ofruara nga AFP-së, PNP-së dhe PATP-ve.	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 11
	5.9.2 Promovimi i rasteve të suksesshme të romëve dhe të egjiptianëve në programet e nxitjes së punësimit.	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 16
	5.10.1 Numri i bizneseve që kanë përfituar lehtësira fiskale të vogla të familjeve romë dhe egjiptiane që kanë përfituar lehtësira fiskale ose grante të vogla për të siguruar rikuperimin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë.	Baseline 1 (2020): 262	Target 5 (2025): 300
	5.10.2 Numri i bizneseve informale të identifikuar dhe mbështetur për formalizimin.	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 140

MASAT DHE AKTIVITETET	PRODUKTI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONET PARTNERE	AFATI KOHOR
1.1 Promovim dhe rritja e aksesit të romëve dhe egjiptianëve në shërbimet e këshillimit dhe orientimit për karrierë për të siguruar procese të suksesshme të punësimit.	136 romë dhe egjiptianëve do të përfitojnë shërbime këshillimi dhe orientimi për karrierë.	Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	2021–2025
1.2 Mbështetje për rritjen e pjesëmarrjes së romëve dhe egjiptianëve në programet e zhvillimit të aftësive, kualifikimit profesional dhe programeve të nxitjes së punësimit (PNP), si dhe rritja e eficientës dhe të cilësisë së tyre në përputhje me nevojat specifike të tyre dhe kërkesat e tregut të punës.	164 romë dhe egjiptianëve do të regjistrohen në formim profesional (privat dhe publik). 122 romë dhe egjiptianë pjesëmarrës në PNP (praktika profesionale dhe formim në punë (VKM 17).	Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	2021–2025
1.3 PATP të përmirësuara dhe përshtatur që promovojnë shërbimet bazë të punësimit dhe rritjen e mundësive të romëve dhe të egjiptianëve për punësim; përfshirë edhe përcaktimin e kuotave apo masave pozitive për veprim (diskriminimi pozitiv).	349 romë dhe egjiptianëve do të jenë integruar në tregun e punës nëpërmjet PNP-ve. 754 romë dhe egjiptianëve integruar në tregun e punës nëpërmjet punësimit, programit të nxitjes nëpërmjet vetëpunësimit, programit të punëve publike në komunitet.	Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	2021–2025



1.4 Mbështetje për përfshirjen e të rinjve romë dhe egjiptianë në arsimin e mesëm profesional publik, duke përfutur dhe nga bursat përkatëse, si dhe rritja e pjesëmarrjes së romëve dhe egjiptianëve në kurset profesionale të ofruara nga qendrat e formimit profesional publik.	254 romëve dhe egjiptianëve kursante (pu.pa dhe jo pu.pa) të cilët kanë përfunduar një kurs formimi profesional ose nxënës të cilët kanë mbaruar një nivel të arsimit të mesëm profesional (certifikuar & diplomuar) janë punësuar.	Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësim	<i>Ministria e Financave dhe Ekonomisë</i>	2021–2025
1.5 Dhënia përparësi të rinjve romë dhe egjiptianë (21–26 vjeç) që kanë mbaruar ciklin e parë të studimeve të përfshihen në Programin Kombëtar të Praktikave të Punës.	105 të rinj romë dhe egjiptianë do të ndjekin praktikën pranë institucioneve të administratës shtetërore, njësite të vetëqeverisjes vendore, dhe institucioneve të pavarura, ku 60 prej tyre janë punësuar në këto institucione.	Departamenti i Administratës Publike (DAP)	<i>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale</i>	2021–2025
1.6 Përfshirja dhe shënjestrimi eksplicit i romëve dhe egjiptianëve në skemat e Garancisë Rinore të hartuara për t'u siguruar të rinjve mundësi trajnimi dhe vende pune.	Të rinjtë romë dhe egjiptianë do të jenë përfshirë dhe përfitojnë nga skema e garancisë rinore që starton në 2022.	<i>Ministria e Financave dhe Ekonomisë</i>	n/a	2022–2025
1.7 Përcaktimi i kuotave ose preferencave që prioritojnë/mundësojnë punësimin e Romëve dhe të Egjiptianëve në administratën publike.	100 romë dhe egjiptianëve janë punësuar në administratën publike në nivel qendror dhe vendor.	Departamenti i Administratës Publike (DAP)	<i>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, NJVV, Ministria e Financave dhe Ekonomisë</i>	2021–2025
1.8 Rishikim i skemës riintegruese në tregun e punës të përfituesve të skemës së ndihmës ekonomike, sinkronizuar dhe me AKPA për të realizuar gradualisht daljen nga skema e NE dhe hyrjen në PNP apo tregun e punës.	VKM-ja për vazhdimin e përfitimeve të NE për përfituesit romë dhe egjiptianë të regjistruar në PNP derisa të gjejnë punësim afatgjatë në vijim të përfundimit të programit të nxitjes së punësimit e rishikuar dhe ndryshuar.	<i>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale</i>	<i>Shërbimi Social Shtetëror</i>	2021–2025
1.9 Komunikim dhe informim i romëve dhe egjiptianëve rreth politikave/programeve të reja të punësimit dhe përfitimeve që rrjedhin prej tyre në mënyrë direkte nga strukturat e AKPA-së ose nëpërmjet bashkëpunimit me OJF-të.	11 eventeve promovuese dhe ndërgjegjësuere organizuar në komunitetet rome dhe egjiptiane mbi rëndësinë dhe mundësitë e ofruara nga AFP-së, PNP-së dhe PATP-ve. 16 rasteve të suksesshme të romëve dhe të egjiptianëve në programet e nxitjes së punësimit do të promovohen për publikun.	AKPA në bashkëpunim me OJF-të	NJVV	2021–2025
1.10 Zhvillimi dhe marrja e masave për uljen e ndikimit të epidemisë shkaktuar nga COVID-19 për romët dhe egjiptianët nëpërmjet mbështetjes financiare të bizneseve të vogla formale, dhe informale (ricikluesëve, tregtarëve të rrobave të përdorura) me qëllim formalizimin gradual të këtyre të fundit.	300 biznese të familjeve rome dhe egjiptiane kanë përfutur lehtësira ose grante të vogla për të siguruar rikuperimin dhe qëndrueshmërinë afatgjatë. 140 biznese informale janë identifikuar dhe mbështetur për formalizimin.	<i>Ministria e Financave dhe Ekonomisë</i>	Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve	2021–2025



Fusha prioritare: PUNËSIMI DHE AFTËSIMI			
Qëllimi i politikës V:	Krijim i mundësive të barabarta për punësim cilësor dhe të qëndrueshëm për romët dhe egjiptianët		
Objektivi V.2:	Nxitja e sipërmarrjes (sociale) dhe vetëpunësimit të romëve dhe të egjiptianëve		
Rezultatet e pritshme:	i. Deri në fund të 2025 të paktën 10% e ndërmarrjeve sociale të regjistruara janë rome dhe egjiptiane. ii. Deri në fund të 2025, të paktën 300 romë dhe egjiptianë më shumë se viti 2020 do të mbështeten financiarisht për sipërmarrje dhe vetëpunësim me qëllim akomodimin e tyre në ekonominë formale.		
Treguesit:	5.1.1 Numri i OJF-ve rome dhe egjiptiane të trajnuar për kuadrin ligjor dhe rregullator të ndërmarrjes sociale, duke përfshirë edhe menaxhimin financiar dhe planin e biznesit për shërbimet e ofruara.	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025) 50
	5.1.2 Numri i OJF-ve rome dhe egjiptiane që kanë përfituar statusin e ndërmarrjes sociale dhe numri i të punësuarve nga ndërmarrjet sociale	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025) 15
	5.2.1 Numri i të vetëpunësuarve dhe sipërmarrësve romë dhe egjiptianë përfitues të granteve të vogla kredi të buta dhe shërbimeve të tjera si përgatitjen e planeve individuale të biznesit.	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 250
	5.3.1 Numri i njësive të vetëqeverisjes vendore që kanë ulur taksat dhe tarifatat për bizneset e ngritura nga romët dhe egjiptianët.	Baseline 1 (2020): 1	Target 5 (2025): 45
	5.3.2 Numri i bizneseve të drejtuar nga romë dhe egjiptianë që përfitojnë nga ulja 50 për qind e taksave vendore.	Baseline 1 (2020): 262 (nga ulja 30%)	Target 5 (2025): 270 Target 5 (2025): 200
	5.3.3 Numri i të punësuarve romë dhe egjiptian pranë bizneseve që kanë përfituar uljen e taksave për shkak të punësimit nga këto komunitete	Baseline 1 (2020): 432	Target 5 (2025): 200
	5.4.1 Numri i romëve dhe egjiptianëve të pajisur me leje për zhvillimin e aktiviteteve ambulatorie në hapësirat publike dhe të përjashtuar/reduktuar nga tarifat financiare	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 50
	5.5.1 Numri i hapësirave tregtare të caktuar të përdorur nga romët dhe egjiptianët	Baseline 1 (2020): 86	Target 5 (2025): 20% më shumë mbi vlerën e realizimit baseline 2020
	5.6.1 Numri i romëve dhe i egjiptianëve të informuar/asistuar që aplikojnë për grante për bujqësinë dhe zhvillimin rural	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 1000
	5.6.2 Numri i romëve dhe i egjiptianëve që kanë përfituar grante nga programi për bujqësinë dhe zhvillimin rural	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 20
	5.7.1 Studim mbi pozicionin e grumbulluesve të mbetjeve të riciklueshme dhe identifikimi i mekanizmave për përfshirjen e romëve dhe të egjiptianëve	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 1
	5.7.2 Krijimi i një pakete të veçantë që mbështet, favorizon dhe lejon grumbulluesit romë dhe egjiptianë të materialeve të riciklueshme të ushtrojnë aktivitetin e riciklimit direkt në burim (familjet, zyrat, bizneset etj.) sipas rregullave të standardizuara	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 1



MASAT DHE AKTIVITETET	PRODUKTI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONET PARTNERE	AFATI KOHOR
2.1 Zhvillimi i një mjedisi të favorshëm për të inkurajuar përfshirjen e Romëve dhe të Egjiptianëve në krijimin e ndërmarrjeve sociale si një masë për nxitjen e punësimit të tyre, nëpërmjet rritjes së kapaciteteve të OJF-ve.	50 OJF-ve rome dhe egjiptiane trajnuar për kuadrin ligjor dhe rregullator të ndërmarrjes sociale, duke përfshirë edhe menaxhimin financiar dhe planin e biznesit për shërbimet e ofruara. 15 OJF-ve rome dhe egjiptiane që kanë përfituar statusin e ndërmarrjes sociale.	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	n/a	2021–2025
2.2 Vetëpunësimi dhe sipërmarrja e Romëve dhe të Egjiptianëve mbështetet nëpërmjet ofrimit të granteve të vogla/kreditë e buta dhe shërbimeve mbështetëse (trajtime për sipërmarrjen dhe përgatitjen e planit të biznesit) me qëllim akomodimin e tyre në ekonominë formale.	250 sipërmarrësve romë dhe egjiptianë përfitojnë granteve të vogla – kredi të buta dhe shërbimeve të tjera si përgatitjen e planeve individuale të biznesit.	NJVV	n/a	2021–2025
2.3 Miratimi nga njësitë e vetëqeverisjes vendore për të ulur taksat dhe tarifatat vendore me 50 për qind për bizneset e ngritura nga romët dhe egjiptianët, dhe për ato biznese që kanë të punësuar një numër të konsiderueshëm të romëve dhe të egjiptianëve.	45 bashki kanë ulur taksat dhe tarifatat për bizneset e ngritura nga romët dhe egjiptianët. 200 romë dhe egjiptianë janë punësuar pranë bizneseve që kanë përfituar uljen e taksave për shkak të punësimit nga këto komunitete.	NJVV	n/a	2021–2025
2.4 Njësitë e vetëqeverisjes vendore reduktojnë ose përjashtojnë nga tarifatat romët dhe egjiptianët ambulantë, që tregtojnë produkte artizanale ose mallra dhe shërbime të tjera, për një periudhë të paracaktuar	50 romë dhe egjiptianë janë pajisur me leje për zhvillimin e aktiviteteve ambulatorë në hapësirat publike dhe përjashtuar/reduktuar nga tarifatat financiare.	NJVV	n/a	2021–2025
2.5 Rezervim i hapësirave të caktuara tregtare dhe pajisja me infrastrukturën e nevojshme për t'u përdorur nga romët dhe egjiptianët për shitjen e mallrave dhe produkteve të ndryshme.	Numri i hapësirave tregtare të caktuara të përdorur nga romët dhe egjiptianët do të jetë 20% më shumë mbi vlerën <i>baseline</i> të vitit 2020.	NJVV	n/a	2021–2025
2.6 Forcimi i kapaciteteve për asistimin e Romëve dhe të Egjiptianëve për t'u përfshirë dhe përfituar nga grantet e programit IPARD II për bujqësinë dhe zhvillimin rural.	1000 individë romë dhe egjiptianë janë informuar/ asistuar për përfitimin e granteve për bujqësinë dhe zhvillimin rural.	MBZHR	AZHBR	2021–2025
2.7 Formalizimi i aktivitetit të grumbulluesve individualë romë dhe egjiptianë të mbetjeve të riciklueshme nëpërmjet mbështetjes financiare dhe përcaktimi i masave për integrimin e tyre gradual në sektorë të tjerë punësimi.	Është realizuar 1 studim mbi pozicionin e grumbulluesve të mbetjeve të riciklueshme realizuar dhe është hartuar 1 paketë që favorizon dhe lejon grumbulluesit romë dhe egjiptianë të materialeve të riciklueshme të ushtrojnë aktivitetin e riciklimit direkt në burim	NJVV	n/a	2021–2025



Fusha prioritare: PUNËSIMI DHE AFTËSIMI			
Qëllimi i politikës V:	Krijim i mundësive të barabarta për punësim cilësor dhe të qëndrueshëm për romët dhe egjiptianët		
Objektivi V.3:	Rritja e kapaciteteve dhe përmirësimi i performancës së punës së stafit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive dhe të arsimit dhe formimit profesional, për integrimin e Romëve dhe të Egjiptianëve në tregun e punës.		
Rezultatet e pritshme:	i. Deri në fund të 2025, 90% e stafit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive trajnuar për antixhopsizmin dhe ofrimin e shërbimeve cilësore gjithëpërfshirëse të punësimit për romët dhe egjiptianët. ii. Deri në fund të 2025, 12 mediatorë romë dhe egjiptianë janë pjesë e zyrave të punësimit, në funksion të përmirësimit të programeve PNP kundrejt pakicave rome dhe egjiptiane.		
Treguesit:	5.1.1. MFE harton VKM për punësimin e të rinjve romë dhe egjiptian që kanë mbaruar arsimin e lartë, pranë zyrave të punësimit, në funksion të përmirësimit të aksesit, eficiencës dhe impaktit të programeve PNP kundrejt pakicave rome dhe egjiptiane.	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025) 1
	5.1.2 Numri i mediatorëve romë dhe egjiptianë të përcaktuar pranë zyrave përkatëse të punësimit.	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025) 12
	5.2.1 Numri i materialeve të përgatitura për pakicat rome dhe egjiptiane dhe shpërndarë në zyrat rajonale dhe vendore të punësimit, drejtorive rajonale të formimit profesional publik, si dhe Shkollave të Arsimit Profesional Publik dhe sektorit privat të përfshira në programet e nxitjes së punësimit.	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 10% më shumë mbi vlerën e realizimit <i>baseline</i> 2020
	5.3.1 Numri i të trajnuarve nga Zyrat Rajonale dhe Vendore të Punësimit, Drejtorive Rajonale të Formimit Profesional Publik, si dhe Shkollave të Arsimit Profesional Publik për Ndryshimin e sjelljes, antixhopsizmin, trajtimin e barabartë dhe parandalimin e diskriminimit.	Baseline 1 (2020): 1149	Target 5 (2025): 15% më shumë mbi vlerën e realizimit <i>baseline</i> 2020
	5.3.2 Numri i rasteve të trajtuara nga Komisioni i Etikës dhe Disiplinës për diskriminimin e Romëve dhe të Egjiptianëve.	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 13
	5.4.1 Numri i eventeve informuese me të gjithë partnerët në marrëveshje bashkëpunimi që ofrojnë vende vakante të punës, në lidhje me ligjet antidiskriminuese dhe kodet e sjelljes që promovojnë trajtimin e barabartë duke përfshirë përkatësinë etnike.	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 13



MASAT DHE AKTIVITETET	PRODUKTI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS:	INSTITUCIONET PARTNERE	AFATI KOHOR
3.1 Punësimi i mediatorëve romë dhe egjiptianë pranë zyrave të punësimit për të lehtësuar ndërmjetësimin dhe akomodimin e Romëve dhe të Egjiptianëve në tregun e punës. (Punësimi i 12 mediatorëve pranë zyrave të punësimit në rang kombëtar, në bashkitë ku ka përqendrim më të madh të popullsisë rome dhe egjiptiane)	1 VKM e hartuar nga MFE për punësimin e të rinjve romë dhe egjiptian që kanë mbaruar arsimin e lartë, pranë zyrave të punësimit. 12 mediatorë të punësuar pranë zyrave të punësimit në rang kombëtar.	<i>Ministria e Financave dhe Ekonomisë</i>	AKPA	2022–2023
3.2 Përgatitja e materialeve informuese mbi mbrojtjen e Romëve dhe të Egjiptianëve nga diskriminimi etnik në vendin e punës.	10% më shumë materialeve sesa në vitin 2020 do të përgatiten për pakicat rome dhe egjiptiane dhe do të shpërndahen në Zyrat Rajonale dhe Vendore të Punësimit, Drejtorive Rajonale të Formimit Profesional Publik, si dhe Shkollave të Arsimit Profesional Publik dhe sektorit privat.	Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD)	AKPA	2021–2025
3.3 Stafi i Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive përmirëson kapacitetin teknik, profesional dhe administrativ nëpërmjet trajnimeve të detyrueshme për ndryshim të qëndrimeve dhe zhvillimit të kompetencave për ofrimin e shërbimeve cilësore gjithëpërfshirëse të punësimit për romët dhe egjiptianët.	Numri i të trajnuarve nga Zyrat Rajonale dhe Vendore të Punësimit, Drejtorive Rajonale të Formimit Profesional Publik, si dhe Shkollave të Arsimit Profesional Publik do të jetë 15% më shumë mbi vlerën e realizimit <i>baseline</i> 2020. 13 rasteve të trajtuara nga Komisioni i Etikës dhe Disiplinës për diskriminimin e Romëve dhe të Egjiptianëve.	Komiteti Për Pakicat Kombëtare	AKPA	2021–2025
3.4 Marrja e masave mbrojtëse dhe përmirësimi i instrumenteve për parandalimin e diskriminimit të romëve dhe të egjiptianëve në vendin e punës për shkak të përkatësisë etnike.	13 eventeve informuese do të realizohen me të gjithë partnerët në marrëveshje bashkëpunimi që ofrojnë vende vakante të punës, që promovojnë trajtimin e barabartë duke përfshirë përkatësinë etnike.	Komisionerin për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD)	AKPA	2021–2025



Fusha prioritare: MBROJTJA SOCIALE			
Qëllimi i politikës VI:	Përmirësim i qasjes dhe rritja e aksesit të romëve dhe egjiptianëve në programet e mbrojtjes sociale		
Objektivi VI.1:	Përfshirja e Romëve dhe të Egjiptianëve në programet e mbrojtjes sociale		
Rezultatet e pritshme:	i. Deri në fund të vitit 2025, 50% më pak familje rome dhe egjiptiane raportohen me të ardhura të pamjaftueshme.		
Treguesit:	6.1.1 Numri i familjeve rome dhe egjiptiane që kanë aplikuar në skemën e ndihmës ekonomike.	Baseline 1 (2020): 2300	Target 5 (2022) 4600
	6.1.2 Numri i familjeve rome dhe egjiptiane që kanë përfituar ndihmë ekonomike.	Baseline 1 (2020): 1642	Target 5 (2025) 3284
	6.1.3 Numri i grave kryefamiljare rome dhe egjiptiane përfitues të ndihmës ekonomike.	Baseline 1 (2020): 54	Target 5 (2025): 75% më shumë
	6.2.1 Numri i administratorëve shoqëror të informuar dhe konsultuar për plotësimin e formularëve përkatës të vërtetimit social- ekonomik, mbi bazën e të cilëve kryhet pikëzimi dhe mbi dhënien e informacioneve familjeve rome dhe egjiptiane në gjuhë të kuptueshme dhe thjeshtëzuar gjatë procesit të vlerësimit të kushteve të tyre.	Baseline 1 (2020): 100	Target 5 (2025): 167
	6.2.2 Numri i administratorëve shoqëror të informuar dhe konsultuar për bazën ligjore dhe përfshirjen/adresimin me efikasitet të nevojave të romëve dhe të egjiptianëve në të gjitha programet e mbrojtjes sociale.	Baseline 1 (2020): 101	Target 5 (2025): 121
	6.3.1 Numri i familjeve rome dhe egjiptiane të cilat kanë përfituar nga fondi shtesë mbi fondin e kushtëzuar për Ndihmën Ekonomike.	Baseline 1 (2020): Nuk ka të dhëna	Target 5 (2025): 10% më shumë mbi vlerën e baseline
	6.4.1 Rritja e shumës së subvencionit të pagesës të ndihmës ekonomike që marrin familjet rome dhe egjiptiane fëmijët e të cilëve ndjekin arsimin bazë dhe vaksinohen. (për buxhetin ky tregues është vendosur edhe te sektori i arsimit)	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 25% e vlerës së vitit 2025
	6.4.2 Numri i familjeve rome dhe egjiptiane që përfitojnë subvencion shtesë të Ndihmës ekonomike për fëmijët që ndjekin rregullisht arsimin bazë dhe vaksinohen.	Baseline 1 (2020): 1143	Target 5 (2025): 40 % më shumë mbi vlerën e baseline
	6.5.1 Numri i bashkive që kanë miratuar VKB për reduktim/përfshirjen nga detyrimi financiar për çerdhe dhe kopshte për fëmijët nga familjet rome dhe egjiptiane.	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 10
	6.5.2 Sistem pikëzimi i përcaktuar nga drejtoritë e çerdheve dhe kopshteve që favorizon regjistrimin e fëmijëve romë dhe egjiptianë pavarësisht se prindërit e tyre janë të papunë, për të lehtësuar procesin e integritetit të tyre në punësim, dhe reduktuar fenomenin e fëmijëve në situatë rruge.	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 1
	6.5.3 Numri i fëmijëve romë dhe egjiptianë të regjistruar dhe që ndjekin rregullisht çerddhet dhe kopshtet.	Baseline 1 (2020): 196	Target 5 (2025): 80% më shumë mbi vlerën e baseline
	6.5.4 Numri i fëmijëve romë dhe egjiptian të regjistruar në çerdhe dhe në kopshte që përfitojnë nga reduktimi/rimbursimi i tarifës.	Baseline 1 (2020): 196	Target 5 (2025): 80% më shumë mbi vlerën e baseline
	6.6.1 Miratim i VKM-së “Për hartimin e kriterëve dhe procedurave për përfitimin e statusit të klientit në nevojë dhe mënyrën e trajtimit të tyre”	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2023): 1



	6.6.2 Numri i familjeve rome dhe egjiptiane që përfitojnë statusin “Klient në nevojë”	Baseline 1 (2020): 30	Target 5 (2023): 80 familje
	6.6.3 Numri i familjeve rome dhe egjiptiane që përfitojnë kompensim për energjinë	Baseline 1 (2020): 403	Target 5 (2025): 80% më shumë mbi vlerën e baseline
	6.7.1 VKM-ja për uljen e moshës së përfitueseve nga 70 vjeç në 64	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 1
	6.7.2 Numri i romëve dhe egjiptianëve të moshës mbi 64 vjeç që përfitojnë pension social	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 25% më shumë mbi vlerën e baseline
	6.8.1 Numri i familjeve rome dhe egjiptiane në nevojë që kanë përfituar shportën ushqimore dhe joushqimore mujore	Baseline 1 (2020): 18,144	Target 5 (2025): 15% më shumë mbi vlerën e baseline
	6.8.2 Numri i familjeve rome dhe egjiptiane që kanë përfituar nga falja e kamat vonesave të energjisë elektrike.	Baseline 1 (2020): Nuk ka të dhëna	Target 5 (2025): 50% më shumë
	6.9.1 Studim krahasimor mbi ndikimin COVID-19 në situatën social-ekonomike të romëve dhe të egjiptianëve.	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 1

MASAT DHE AKTIVITETET	PRODUKTI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONET PARTNERE	AFATI KOHOR
1.1 Garantim i aksesit në aplikim të familjeve rome dhe egjiptiane pa të ardhura ose me të ardhura të pamjaftueshme në skemën e ndihmës ekonomike.	3284 familjeve rome dhe egjiptiane kanë përfituar ndihmën ekonomike Numri i grave kryefamiljare rome dhe egjiptiane përfitues së NE rritet me 75% më shumë.	Shërbimi Social Shtetëror	NJVV	2021–2025
1.2 Ngritja e kapacitetit të administratorit shoqëror për të lehtësuar aksesin e Romëve dhe të Egjiptianëve në programet e mbrojtjes sociale dhe specifikisht përfitimit të NE nëpërmjet orientimit për përgatitjen e dokumentacionit, për aplikim, asistimit dhe ofrimit të mbështetjes gjatë aplikimit.	167 administratorë shoqëror të informuar dhe konsultuar për plotësimin e formularëve përkatës të vërtetimit social- ekonomik, mbi bazën e të cilëve kryhet pikëzimi për NE. 121 administratorë shoqëror të informuar dhe konsultuar për bazën ligjore dhe përfshirjen/adresimin me efikasitet të nevojave të romëve dhe të egjiptianëve në të gjitha programet e mbrojtjes sociale.	Shërbimi Social Shtetëror	NJVV	2021–2025
1.3 Mundësim i aksesit maksimal për familjet rome dhe egjiptiane aplikuese për Ndihmën Ekonomike, të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit, të trajtohen nga fondi shtesë i kushtëzuar për bllokndihmën ekonomike.	Rritet me 10% më shumë mbi vlerën e baseline numri i familjeve rome dhe egjiptiane që përfitojnë nga fondi shtesë i kushtëzuar për bllokndihmën ekonomike.	NJVV	n/a	2021–2025



1.4 Mbështetje e familjeve rome dhe egjiptiane fëmijët e të cilëve ndjekin arsimin bazë dhe janë vaksinuar të përfitojnë subvencion shtesë në ndihmën ekonomike.	Shuma e subvencionit të pagesës të ndihmës ekonomike që marrin familjet rome dhe egjiptiane fëmijët e të cilëve ndjekin arsimin bazë dhe vaksinohen do të rritet me 50% më shumë mbi vlerën aktuale. Rritet numri i familjeve rome dhe egjiptiane që përfitojnë subvencionin e NE me 40 % më shumë mbi vlerën aktuale.	<i>Shërbimi Social Shtetëror</i>	<i>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale</i>	2021–2025
1.5 Garantim i frekuentimit të çerdheve dhe kopshteve nga fëmijët romë dhe egjiptianë nëpërmjet prioritizimit të regjistrimit të tyre dhe hartimit të politikave favorizuese.	10 bashki miratojnë VKB për reduktim/përfashtimin nga detyrimi financiar për çerdhe dhe kopshte për fëmijët nga familjet rome dhe egjiptiane. Ndërtohet 1 Sistem pikëzimi i përcaktuar nga drejtoritë e çerdheve dhe kopshteve që favorizon regjistrimin e fëmijëve romë dhe egjiptianë. Numri i fëmijëve romë dhe egjiptianë të regjistruar dhe që ndjekin rregullisht çerdhet dhe kopshtet synohet të rritet me 90% më shumë mbi vlerën e <i>baseline</i> të vitit 2020.	NJVV	Drejtoritë e Çerdheve dhe Kopshtëve	2021–2025
1.6 Analizë dhe rishikim i kuadrit rregullator për kompensimin e energjisë me qëllim që familjet rome dhe egjiptiane në nevojë dhe me të ardhura të paqëndrueshme/pamjaftueshme të përfitojnë masën e kompensimit ose furnizimit me energji elektrike bazike sipas kushteve përkatëse.	Miratohet VKM-së për “ hartimin e kritereve dhe procedurave për përfitim të statusit të klientit në nevojë dhe mënyrën e trajtimit të tyre”. Rritet me 40% më shumë numri i familjeve rome dhe egjiptiane që përfitojnë statusin “Klient në nevojë”. 80% më shumë familjeve rome dhe egjiptiane përfitojnë kompensim për energjinë elektrike.	<i>Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë</i>	<i>Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale</i>	2021–2025
1.7 Rishikim i legjislationit për ndryshimin e përfitimit të pensionit social për romët dhe egjiptianët të cilët nuk kanë paguar kontribute shoqërore ndër vite. (e rregulluar me ligjin nr. 104/2014 dhe VKM nr. 927). Kërkohet ulja e moshës së përfituesve nga 70 vjeç në 64 vjeç.	Miratohet 1 VKM që ul moshën e përfituesve romë dhe egjiptianë të pensionit social nga 70 vjeç në 64, dhe synohet një rritje e përfituesve me 25% më shumë mbi vlerën e <i>baseline</i> mbasi është miratuar VKM.	<i>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale</i>	<i>Ministria e Financave dhe Ekonomisë</i>	2022-2025
1.8 Përforsim të masave të mbrojtjes sociale për romët dhe egjiptianët nëpërmjet kombinimit të stimuljeve financiare dhe shërbimeve të përkujdesjes shoqërore gjatë periudhës së epidemisë shkaktuar nga COVID19.	20,865 familjeve rome dhe egjiptiane në nevojë përfitojnë shportën ushqimore dhe joushqimore mujore. 50% më shumë familjeve rome dhe egjiptiane përfitojnë nga falja e kamat vonesave të energjisë elektrike.	<i>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale</i>	NJVV	2021–2025



1.9 Analizim të ndikimit të COVID-19 në situatën social - ekonomike të romëve dhe të egjiptianëve.	Do të Realizohet 1 studim që do të bëjë vlerësimin e situatës social - ekonomike të romëve dhe të egjiptianëve mbas COVID 19.	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	NJVV	2021–2025
Fusha prioritare: MBROJTJA SOCIALE				
Qëllimi i politikës VI:	Përmirësim i qasjes dhe rritja e aksesit të romëve dhe egjiptianëve në programet e mbrojtjes sociale			
Objektivi VI.2:	Riintegrimi social i përfituesve të ndihmës ekonomike nëpërmjet zbatimit të programit të daljes nga skema e ndihmës ekonomike			
Rezultatet e pritshme:	i.Deri në fund të vitit 2025, 70% e Romëve dhe të Egjiptianëve përfitues të ndihmës ekonomike kanë dalë nga skema dhe janë riintegruar në punë.			
Treguesit:	2.1.1 Numri i romëve dhe egjiptianëve që përfitojnë nga programet e rintegritimit.		Baseline 1 (2020): 1100	Target 5 (2022) 60% më shumë mbi vlerën e baseline
	2.1.2 Numri i familjeve romë dhe egjiptiane të përfshira në skemën e ndihmës ekonomike që përfitojnë edhe nga shërbime të integruara të kujdesit social falë referimit nga administratori.		Baseline 1 (2020): 1537	Target 5 (2025) 40 % më shumë mbi vlerën e baseline
	2.1.3 Numri i familjeve romë dhe egjiptianë që janë riintegruar dhe kanë dalë nga skema e ndihmës ekonomike		Baseline 1 (2020): Ska të dhëna	Target 5 (2025): 60% më shumë
	2.2.1 Vendim i aprovuar për vazhdimin e përfitimeve të NE për përfituesit romë dhe egjiptianë të regjistruar në PNP derisa të gjejnë punësim afatgjatë në vijim të përfundimit të programit të nxitjes së punësimit.		Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 1 VKM e aprovuar
	2.3.1 Numri i start ups, iniciativave ekonomike financuar prej qeverisë/pushtetit vendor.		Baseline 1 (2020): 6	Target 5 (2025): 300
	2.3.2 Numri i OJF-ve romë dhe egjiptiane që kanë përfituar statusin e ndërmarrjes sociale.		Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 15



MASAT DHE AKTIVITETET	PRODUKTI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONET PARTNERE	AFATI KOHOR
2.1 Mbështetja e familjeve në skemën e ndihmës ekonomike duke i referuar në shërbime të tjera, sidomos në nxitjen e punësimit dhe programet e AFP-së, strehimin social, regjistrimin në gjendjen civile, kujdesin shëndetësor dhe arsimin.	Synohet që 60% më shumë romë dhe egjiptianë pjesë e NE do të përfitojnë nga programet e rintegritimit, llogaritur mbi vlerën <i>baseline</i> viti 2020. 40% më shumë familjeve rome dhe egjiptiane të përfshira në skemën e NE që përfitojnë shërbime të integruara të kujdesit social, llogaritur mbi vlerën e vitit 2020.	<i>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale</i>	NJVV, Shërbimi Social Shtetëror	2021–2025
2.2 Rishikim i skemës riintegruese në tregun e punës të përfituesve të skemës së Ndihmës Ekonomike, sinkronizuar dhe me AKPA për të realizuar gradualisht daljen nga skema e NE dhe hyrjen në PNP apo tregun e punës.	1 VKM aprovuar për vazhdimin e përfitimeve të NE për përfituesit romë dhe egjiptianë të regjistruar në PNP derisa të gjejnë punësim afatgjatë në vijim të përfundimit të programit të nxitjes së punësimit.	<i>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale</i>	AKPA, Shërbimi Social Shtetëror	2022-2025
2.3 Prioritizim i romëve dhe egjiptianëve që dalin nga programet e ndihmës ekonomike për të krijuar ndërmarrje sociale dhe zhvilluar start- ups, apo iniciativa ekonomike (gjenerimit të të ardhurave).	300 romë dhe egjiptianë janë mbështetur me start ups, iniciativa ekonomike financuar prej qeverisë/pushtetit vendor. 15 OJF-ve rome dhe egjiptiane kanë përfituar statusin e ndërmarrjes sociale.	<i>Ministria e Financave dhe Ekonomisë</i>	<i>Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, NJVV</i>	2021–2025



Fusha prioritare: MBROJTJA SOCIALE			
Qëllimi i politikës VI:	Përmirësim i qasjes dhe rritja e aksesit të romëve dhe egjiptianëve në programet e mbrojtjes sociale		
Objektivi VI.3:	Rritja e aksesit të romëve dhe të egjiptianëve në shërbimet e kujdesit shoqëror dhe modelimi i shërbimeve të reja të ofruara në komunitet		
Rezultatet e pritshme:	i.Deri në fund të 2025, 100% e romëve dhe të egjiptianëve në nevojë kanë akses dhe përfitojnë nga shërbimet e kujdesit shoqëror.		
Treguesit:	3.1.1 Numri i njësive të vlerësimit të nevojave dhe referimit të trajnuar mbi vulnerabilitetin dhe ofrimin e shërbimeve cilësore gjithëpërfshirëse.	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2022) 60
	3.2.1 Numri i bashkive dhe shërbimeve të ofruara të financuar nga Fondi Social për romët dhe egjiptianët.	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025) 6 bashki
	3.3.1 Numri i romëve dhe egjiptianëve të cilët janë mbështetur nga MKR-ja për rastet e dhunës në familje.	Baseline 1 (2020): Ska të dhëna	Target 5 (2025): 65
	3.3.2 Numri i personave të dhunuar romë dhe egjiptianë të mbështetur me masa mbrojtëse (urdhër mbrojtje, urdhër i menjëhershëm i mbrojtjes, urdhër për masat paraprake të mbrojtjes së menjëhershme).	Baseline 1 (2020): Ska të dhëna	Target 5 (2025): 40
	3.4.2. Numri i individëve dhunues romë dhe egjiptianë të përfshirë në programet e rehabilitimit	Baseline 1 (2020): Ska të dhëna	Target 5 (2025): 65
	3.5.1 Numri i romëve dhe egjiptianëve që përfitojnë shërbime në qendrat rezidenciale.	Baseline 1 (2020): 986	Target 5 (2025): 25% më shumë mbi vlerën e baseline
	3.5.2 Numri i grave dhe vajzave romë dhe egjiptiane në rrezik trafikimi të trajtuara me shërbime rezidenciale.	Baseline 1 (2020): 2,142	Target 5 (2023): 9% më shumë mbi vlerën e baseline
	3.6.1 Numri i romëve dhe egjiptianëve që përfitojnë shërbime të integruara sociale, të disagreguar sipas llojeve të shërbimeve (në shërbime punësimi, apo VET, apo edukimi, apo shërbime të specializuar sociale).	Baseline 1 (2020): 4563	Target 5 (2023): 24,390
	3.7.1 Numri i qendrave komunitare multifunksionale operationale me shërbime në zonat ku banojnë romët dhe egjiptianët.	Baseline 1 (2020): 62	Target 5 (2025): 5 qendra



MASAT DHE AKTIVITETET	PRODUKTI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONET PARTNERE	AFATI KOHOR
3.1 Ngritja e kapacitetit të njësive të vlerësimit të nevojave dhe referimit për të ofruar shërbime efektive për romët dhe egjiptianët.	60 njësi të vlerësimit të nevojave dhe referimit të trajnuar mbi vulnerabilitetin dhe ofrimin e shërbimeve cilësore gjithëpërfshirëse.	MSHMS	<i>Shërbimi Social Shtetëror NJVV</i>	2021–2025
3.2 Ngritja e shërbimeve të reja sociale me bazë komunitare, të financuara nga Fondi Social, për romët dhe egjiptianët, si ndërhyrja në fëmijërinë e hershme apo asistencë në familje për të moshuarit që jetojnë vetëm.	6 bashki ofrojnë shërbime të financuara nga Fondi Social.	<i>Shërbimi Social Shtetëror</i>	<i>NJVV, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale,</i>	2021–2025
3.3 Shërbime të aksesueshme nga Mekanizmi Kombëtar i Referimit (MKR) për romët dhe egjiptianët.	65 romë dhe egjiptianë janë mbështetur nga MKR për rastet e dhunës në familje. 40 romë dhe egjiptianë të mbështetur me masa/urdhra mbrojtës.	<i>Shërbimi Social Shtetëror</i>	<i>NJVV, Drejtoria e Policisë</i>	2021–2025
3.4 Marrja e masave për parandalimin e dhunës në familje për romët dhe egjiptianët	65 romë dhe egjiptianë me probleme të dhunës të përfshirë në programet e rehabilitimit	<i>Shërbimi Social Shtetëror</i>	<i>NJVV</i>	2021–2025
3.5 Fuqizimi i mekanizmave të referimit dhe përmirësimi i shërbimeve për romët dhe egjiptianët në qendrat rezidenciale për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore, personat me aftësi të kufizuara, jetimët dhe të moshuarit, dhe rritja e aksesit sipas nevojës.	1232 romë dhe egjiptianë përfitojnë shërbime në qendrat rezidenciale. 2334 gra dhe vajza romë dhe egjiptiane në rrezik trafikimi do të përfitojnë informacion dhe shërbime pranë qendrave rezidenciale.	<i>Shërbimi Social Shtetëror</i>	<i>NJVV, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale</i>	2021–2025
3.6 Ofrimin e shërbimeve sociale specifike të integruara me bazë në komunitet për të fuqizuar individin, familjen dhe komunitetin romë dhe egjiptian si: (shërbime punësimi, të kujdesit social, edukimi aftësimi profesional)	24,390 romë dhe egjiptianë do të përfitojnë shërbime të integruara sociale, të disagreguar sipas llojeve të shërbimeve (në shërbime punësimi, apo VET, apo edukimi, apo shërbime të specializuara sociale).	<i>NJVV</i>	<i>Shërbimi Social Shtetëror</i>	2021–2025
3.7 Ngritja e qendrave komunitare multifunktionale në zonat ku banojnë romët dhe egjiptianët dhe ku mungojnë.	5 qendra komunitare multifunktionale do të bëhen operacionale me shërbime në zonat ku banojnë romët dhe egjiptianët.	<i>NJVV</i>	<i>n/a</i>	2021–2025



Fusha prioritare: MBROJTJA SOCIALE			
Qëllimi i politikës VI:	Përmirësim i qasjes dhe rritja e aksesit të romëve dhe egjiptianëve në programet e mbrojtjes sociale		
Objektivi VI.4:	Fuqizimi i kapaciteteve për identifikimin e Romëve dhe të Egjiptianëve në rrezik trafikimi/shfrytëzimi, si dhe referimi, mbrojtja dhe riintegrimi i rasteve të trafikuar/shfrytëzuara.		
Rezultatet e pritshme:	i.Deri në fund të 2025, 100% e stafit të ekipeve multidisiplinare trajnuar në menaxhimin e rasteve të fëmijëve në situatë rruge. ii.Deri në fund të vitit 2025, 100% e Romëve dhe të Egjiptianëve janë informuar mbi të gjitha format e trafikimit njerëzor përfshirë; shfrytëzimi i fëmijëve për punë, lypje dhe martesat në moshë të hershme.		
Treguesit:	4.1.1 Numri i rasteve të identifikuar/të menaxhuar nga skuadrat e terrenit të cilave i'u është garantuar mbështetja.	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2022) 240
	4.1.2 Numri i punonjësve të pushtetit vendor (NJVRN, NJMF,PMF) të trajnuar për të menaxhuar rastet bazuar në parimin e “Interesi më i lartë i fëmijës” ku i jepet prioritet riintegritit të fëmijës në familjen biologjike.	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025) 350
	4.2.1. Numri i anëtarëve të ekipeve multidisiplinore të trajnuar për PSV-të dhe Protokollin e të Drejtave të Fëmijës	Baseline 1 (2020): 245	Target 5 (2025): 300
	4.3.1 Numri i familjeve të mbështetura (start up, bonus qiraje, punësim).	Baseline 1 (2020): Ska të dhëna	Target 5 (2025): 120
	4.3.2 Hartimi dhe institucionalizimi i një liste kriteresh kur familja mund të konsiderohet e fuqizuar.	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 1 udhëzim
	4.3.3 Numri total i fëmijëve në situatë rruge përfitues të shërbimeve të ndryshme.	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025): 220
	4.5.1. Numri i raporteve të monitorimit të zbatimit të Planit të Finalizuar	Baseline 0 (2020)	Target 5 (2025): 5



MASAT DHE AKTIVITETET	PRODUKTI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONET PARTNERE	AFATI KOHOR
4.1 Fuqizimi i grupeve multidisiplinare të terrenit për identifikimin referimin dhe menaxhimin e rasteve të fëmijëve në situatë rruge bazuar në parimin e deinstitutionalizimit. (Skuadrat identifikojnë dhe monitorojnë rastet e fëmijëve rom dhe egjiptian që shfrytëzohen për punë të ndryshme, lypje, shitje ambulatorie, mbledhjen e materialeve të riciklueshme.)	240 fëmijë në situatë rruge të identifikuar nga skuadrat e terrenit të cilave iu është garantuar mbështetja. 350 punonjës të pushtetit vendor (NJVRN, NJMF, PMF) të trajnuar për të menaxhuar rastet bazuar në parimin e “Interesi më i lartë i fëmijës” ku i jepet prioritet riintegrit të fëmijës në familjen biologjike.	MSHMS	ASHMDF (Agjencia Shtetërore e Mbrojtjes së të Drejtave të Fëmijëve) NJVV	2021–2025
4.4 Rritja e ndërgjegjësimit të romëve dhe të egjiptianëve për trafikimin e qenieve njerëzore dhe shërbimeve të disponueshme për viktimat.	2592 romë dhe egjiptianë të informuar mbi të gjitha format e trafikimit njerëzor përfshirë (shfrytëzimi i fëmijëve për punë, lypje dhe martesat në moshë të hershme).	MB/Sektori i Antitrafikut,	ASHDMF në bashkëpunim me organizatat partnerë, NJVV	2021–2025
4.5 Përgatitja e raporteve të Monitorimit të zbatimit të Planit Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe të Egjiptianëve dhe mentorimi i përdoruesve të sistemit Romalb	140 përdorues të sistemit Romalb janë aktiv në përdorimin e sistemit elektronik. Romalb Çdo vit përgatitet një raport monitorimi të zbatimit të Planit Kombëtar i Veprimit për Barazi, Përfshirje dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe të Egjiptianëve.	MSHMS	MSHMS	2021–2025



Fusha prioritare: MBROJTJA SOCIALE			
Qëllimi i politikës VI:	Përmirësim i qasjes dhe rritja e aksesit të romëve dhe egjiptianëve në programet e mbrojtjes sociale		
Objektivi VI.5:	Riintegrimi në shoqëri i familjeve që qëndrojnë në Qendrën Tranzitore të Emergjencave		
Rezultatet e pritshme:	i.100% e Familjeve asistuar nga Qendra Tranzitore e Emergjencave riintegrohen deri në fund të vitit 2025.		
Treguesit:	5.1.1 Numri i familjeve që jetojnë dhe marrin shërbime në qendër përfshirë dhe numrin e fëmijëve.	Baseline 1 (2020): 43	Target 5 (2022) 0
	5.2.1 Numri i familjeve të riintegruar pas daljes nga qendra.	Baseline 1 (2020): 3	Target 5 (2025) 43

MASAT DHE AKTIVITETET	PRODUKTI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONET PARTNERE	AFATI KOHOR
5.1 Përgatitja e një plani individual për çdo familje, duke përfshirë shërbimet e nevojshme dhe etapat, me qëllim integrimin jashtë qendrës brenda 2 viteve.	43 familje rome dhe egjiptiane që jetojnë në qendër rintegrohen në shoqëri dhe largohen prej qendrës deri në vitin 2025.	MSHMS	SHSSH, QKTE, Bashkia Tiranë	2021–2025
5.2 Monitorimi i familjeve që kanë dalë nga qendra për të garantuar që përmirësimi i tyre është i qëndrueshëm dhe për të lehtësuar aksesin në shërbimet e reja kur nevojitet.	Bashkia Tiranë dhe Shërbimi Social Shtetëror së bashku me QKTE monitoronë familjet mbas daljes nga qendra.	MSHMS	QKTE, SHSSH, NJVQV	2021–2025
5.3 Monitorimi i pabarazive që hasin romët dhe egjiptianët dhe koordinimi i politikave publike që synojnë reduktimin e tyre.	Raporte periodike monitorimi Mirëmbajtja dhe funksionimi i sistemit Romalb	MSHMS	Ministrite e linjes, NJVV	2021–2025



Fusha prioritare: Antixhipsizmi			
Qëllimi i POLITIKËSVII:	Antixhipsizmi njihet dhe adresohet në politikat publike, si dhe përmes ndryshimeve sistemike dhe strukturore, për të garantuar një shoqëri të çliuar nga diskriminimi ndaj pakicave rome dhe egjiptiane		
Objektivi VII.1:	Njohja dhe përfshirja e antixhipsizmit në politikat publike		
Rezultatet e pritshme:	i. 90% e institucioneve që ofrojnë shërbime publike janë të trajnuar për çështje që lidhen me antixhipsizmin deri në fund të 2025..		
Treguesit:	7.1.1 Numri i dokumenteve politikë, ligje etj. që në mënyrë eksplicite i referohen konceptit e antixhipsizmit	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025) 5
	7.1.3 Përqindja e ligjeve relevante të analizuara në lidhje me çështjen e antixhipsizmit.	Baseline 1 (2020): 0%	Target 5 (2025) 100% e ligjeve relevante të analizuara
	7.1.4 Kurrikula e dedikuar ndaj antixhipsizmit në Shkollën e Administratës Publike, e hartuar dhe e miratuar	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025) 1 kurrikulë e hartuar, miratuar
	7.1.5 Numri i aktiviteteve ndërgjegjësuere/trajnimeve për punonjës të administratës publike në lidhje me çështje të antixhipsizmit	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025) 150
	7.1.6 Përqindja e anëtarëve të Kuvendit të informuar/trajnuar në lidhje me çështje të antixhipsizmit.	Baseline 1 (2020): 0	Target 5 (2025) 100% e anëtarëve të Kuvendit



MASAT DHE AKTIVITETET	PRODUKTI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONET PARTNERE	AFATI KOHOR
7.1.1 Operacionalizimi i termit antixhipsizëm dhe përfshirja e tij edhe në dokumente të tjera politike, ligjore etj.	Dokument politik me përkufizimin e terminologjisë Dokumente politike dhe ligjore që i referohen/e përfshijnë atë	KMD	MSHMS OJF Ministritë e Linjës	6M-II- 2021 - 6M-II-2025
7.1.2 Ngritja e grupeve të punës me ekspertë (përfaqësues të administratës, si dhe ekspertë të pavarur) që punojnë për antixhipsizmin dhe zhvillojnë propozime dhe rekomandime për politikëbërësit / politikëbërjen në fusha të ndryshme.	1 grup pune i ngritur pranë KPK Grup/e pune të ngritura pranë KMD, MSHMS, dhe institucioneve të tjera relevante sipas nevojës.	KPK	KMD MSHMS	6M-I- 2022 - 6M-II-2025
7.1.3 Analizimi i ligjeve dhe politikave ekzistuese që janë më relevante për R&E për identifikim të diskriminimeve direkte dhe indirekte (apo të fshehta) që mund të ndikojnë negativisht në jetët e R&E	Raporte mbi monitorimin dhe analizat e realizuara	KMD	Avokati i Popullit KPK MSHMS	6M-II- 2021 - 6M-II-2025
7.1. 4 Zhvillimi dhe përfshirja e një kurrikule të dedikuar ndaj Antixhipsizmit në Shkollën e Administratës Publike.	Dokumenti i kurrikulës së zhvilluar dhe përfshirë në programin e ASPA	ASPA	MSHMS KPK	6M-I- 2022 - 6M-II-2025
7.1.5 Informimi dhe ndërgjegjësimi i nëpunësve shtetërorë (nivel qendror dhe lokal - zyrtarë, juristë, mësues, punonjës policie, punonjës social etj.) mbi antixhipsizmin për t'u aftësuar në njohjen dhe parandalimin e diskriminimit / racizmit ndaj pakicave rome dhe egjiptiane, si dhe mbi çështje të interseksionalitetit (me gjininë, moshën, paaftësitë, orientimin seksual etj.).	Punonjës të trajnuar	ASPA Ministritë e Linjës	NJVVDAP MSHMS KMD	6M-I- 2022 - 6M-II-2025
7.1.6 Trajnim i anëtarëve të Kuvendit (deputetëve/eve) mbi çështjet e antixhipsizmit.	Anëtarë të Kuvendit të RSH të informuar/trajnuar	Kuvendi i RSH	ASPA MSHMS KPK	6M-I- 2022 - 6M-II-2025

Fusha prioritare: Antixhipsizmi				
Qëllimi i politikës VII:	Antixhipsizmi njihet dhe adresohet në politikat publike, si dhe përmes ndryshimeve sistematike dhe strukturore, për të garantuar një shoqëri të çliruar nga diskriminimi ndaj pakicave rome dhe egjiptiane			
Objektivi specifik VII.2:	Rritja e ndërgjegjësimit për pakicat rome dhe egjiptiane, si dhe publikun e gjerë për të drejtat e tyre, si pjesë integrale e shoqërisë Shqiptare			
Rezultatet e pritshme:	i. Pakicat rome dhe egjiptiane dhe kontributi i tyre në shoqërinë shqiptare njihen gjerësisht dhe janë pjesë integrale e edukimit të brezave të rinj. ii. Shoqëria shqiptare është e ndërgjegjësuar mbi kontributin e pakicave rome dhe egjiptiane në jetën ekonomike /sociale /politike të vendit, si dhe të drejtat e tyre si pjesë integrale e shoqërisë.			
Treguesit:			<i>Baseline</i> 1 (2020)	<i>Target</i> 5 (2025)
	7.2.b. Numri i aktiviteteve të realizuara në kuadër të ditëve të shënuara që lidhen me pakicat rome dhe egjiptiane		2	Të paktën 13 evente, deri në fund të 2025
	7.2.c. Përqindja e teksteve dhe kurrikulave shkollore të rishikuara në lidhje me çështje të antixhipsizmit		0%	100% e teksteve dhe kurrikulave



	7.2.ç. Numri i fushatave kombetare të ndërgjegjësimi për të drejtat e njeriut në/me komunitetet R&E të ndërmarra		0	Të paktën 4 fushata kombëtare deri në fund të 2025
MASAT DHE AKTIVITETET	PRODUKTI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONET PARTNERE	AFATI KOHOR
7.2.1 Përcaktimi dhe evidentimi i kontributit të pakicave rome dhe egjiptiane në jetën ekonomike /sociale/kulturore /politike të vendit; promovimi i tyre përmes medias dhe aktiviteteve promovuese (p.sh. organizimi i ekspozitave/shkrimi i një libri nga/me bashkautorësi R&E etj.)	Aktivitete promovuese Aktivitete mediatike Botime	KPK	MK Ministritë e Linjës Njësitë e vetëqeverisjes vendore MSHMS	6M-II-2021 - 6M-II-2025
7.2.2 Festimi i ditëve të shënuara: - 8 prilli – Ditës Ndërkombëtare të Romëve - 24 qershori – Ditës Kombëtare të Egjiptianëve - 5 nëntori – Dita e Gjuhës Rome	(Të paktën) 13 aktivitete të dedikuara për festimin e ditëve të caktuar	KPK	MSHMS NJVV,Ministritë e Linjës MSHMS	6M-II- 2021 - 6M-II-2025
7.2.3 Përfshirja e pakicave rome dhe egjiptiane si pjesë integrale e kurrikulave dhe teksteve shkollore	E gjithë kurrikula dhe tekstet shkollore të arsimit të detyruar të rishikuara.	MAS	DPAP ASCAP	6M-II- 2021 - 6M-II-2025
7.2.4 Fushata ndërgjegjësimi për të drejtat e njeriut në/me pakicat rome dhe egjiptiane	4 fushata ndërgjegjësimi dhe materialet e gjeneruara në kuadër të tyre	KPK	KMD Avokati i Popullit Ministritë e linjës NJVV, MSHMS	6M-I-2022 - 6M-II-2025

Fusha prioritare: Antixhipsizmi				
Qëllimi i politikës VII:	Antixhipsizmi njihet dhe adresohet në politikat publike, si dhe përmes ndryshimeve sistemike dhe strukturore, për të garantuar një shoqëri të çliuar nga diskriminimi ndaj pakicave rome dhe egjiptiane			
Objektivi specifik VII.3:	Ulja e diskriminimit ndaj pakicave rome dhe egjiptiane dhe përmirësimi i aksesit në drejtësi për barazi			
Rezultatet e pritshme:	i.Deri në fund të 2025, kuadri ligjor shqiptar për R&E është 100% i përafër me atë të BE-së ii.Në fund të vitit 2025, 100% e anëtarëve të pakicave rome dhe egjiptiane kanë akses të plotë dhe të përmirësuar në shërbimet ligjore dhe të drejtësisë			
Treguesit:		<i>Baseline:</i> 1 (2020)	<i>Target</i> 5 (2025)	
	7.3.1 Përqindja e rekomandimeve të dhëna të reflektuara në lidhje me përmirësimin dhe përafrimin e kuadrit ligjor kombëtar me atë të BE-së, me ndjeshmëri ndaj çështjeve të pakicave rome dhe egjiptiane.	0%		100% e rekomandimeve të dhëna të reflektuara
	7.3.2 Përqindja e rasteve në lidhje me antidiskriminim të çuara para gjykatës për interes publik	0%		100% e rasteve që identifikohen ndiqen dhe/ose asistohen
	7.3.3 Realizimi i një studim bazë për evidentimin formave të diskriminimit dhe shtrirjen e tyre, si dhe barrierat për të aksesuar/marrë drejtësi.	0%		1 studim i realizuar dhe publikuar
	7.3.5 Aktivitetet e ndërmarrë, që përshkruajnë dhe analizojnë pabarazitë midis pakicave rome dhe egjiptiane dhe pjesës tjetër të popullsisë;	0		50 aktivitete
	7.3.6 Numri i NJVV-së të cilët kanë përfshirë përfaqësues të pakicave rome dhe egjiptiane në këshillat e tyre bashkiak	13		45 NJVV



MASAT DHE AKTIVITETET	PRODUKTI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONET PARTNERE	AFATI KOHOR
7.3.1 Rekomandime për përmirësimin dhe përafrimin e kuadrit ligjor kombëtar me atë të BE-së, me ndjeshmëri ndaj çështjeve të pakicave rome dhe egjiptiane	Dokumentet me rekomandimet përkatëse	KMD	Kuvendi i RSH MSHMS	6M-I-2022 - 6M-II-2025
7.3.2 Ndërmarrja e proceseve gjyqësore me interes publik, aksioneve pozitive etj. në luftën kundër diskriminimit të pakicave rome dhe egjiptiane	Proceset e ndërmarra	KMD	MD	6M-II- 2021 - 6M-II-2025
7.3.3 Monitorimi i rasteve të diskriminimit ndaj pakicave rome dhe egjiptiane për identifikimin e fushave me incidencë më të lartë dhe barrierave për të marrë drejtësi	5 Raportet e monitorimit (një për vit)	KMD	Avokati i Popullit MD	6M-II- 2021 - 6M-II-2025
7.3.4 Dhënia e ndihmës ligjore falas për viktimat e diskriminimit të pakicave rome dhe egjiptiane	Qytetarë R&E të asistuar dhe fuqizuar	MD/DNJF	OJF-të	6M-I-2022 - 6M-II-2025
7.3.5 Monitorim dhe raportim i pabarazive në akses që pakicat rome dhe egjiptiane ndeshin në arsim, shëndetësi, shërbime sociale etj.	Raportet studimore dhe monitoruese	KMD	Ministritë e linjës MSHMS	6M-I-2022 - 6M-II-2025
7.3.6 Përfshirja e pakicave rome dhe egjiptiane në këshillat bashkiakë	Dokumente të anëtarëve të këshillave bashkiakë	Partite Politike	NJVV	6M-I-2022 - 6M-II-2025

Fusha prioritare: Antixhipsizmi				
Qëllimi i politikës VII:	Antixhipsizmi njihet dhe adresohet në politikat publike, si dhe përmes ndryshimeve sistematike dhe strukturore, për të garantuar një shoqëri të çliruar nga diskriminimi ndaj pakicave rome dhe egjiptiane			
Objektivi specifik VII.4:	Minimizimi/eliminimi i gjuhës së urrejtjes dhe krimeve të urrejtjes ndaj pakicave rome dhe egjiptiane			
Rezultatet e pritshme:	i.Në fund të 2025, gjuha e urrejtjes ndaj pakicave rome dhe egjiptiane në sferën publike është eliminuar ii.Në fund të 2025, krimet e urrejtjes ndaj pakicave rome dhe egjiptiane janë minimizuar dhe të mbijetuarit e tyre kanë marrë mbështetje dhe janë riintegruar.			
Treguesit:			Baseline: 1 (2020)	Target 5 (2025)
	7.4.1. Përqindja e projekteve të mbështetura për OSHC-të të cilat lidhen me monitorimin dhe raportimin e gjuhës së urrejtjes		0%	20% e projekteve
	7.4.4. Përqindja e policëve, gjyqtarëve dhe prokurorëve të trajnuar për njohjen e krimeve të urrejtjes		0%	80%



MASAT DHE AKTIVITETET	PRODUKTI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONET PARTNERE	AFATI KOHOR
7.4.1 Mbështetja, financimi dhe zbatimi i trajnimeve edukuese mbi gjuhën e urrejtjes për gazetarë, mësues, punonjës socialë, juristë, punonjës policie etj.	Trajnime të realizuara dhe staf i trajnuar	ASP	Ministritë e linjës MSHMS	6M-I-2022 - 6M-II-2025
7.4.2 Monitorimi sistematik i gjuhës antixhipsiste dhe krimeve të urrejtjes: mbledhja e të dhënave dhe raportimi mbi gjuhën e urrejtjes ndaj pakicave rome dhe egjiptiane.	Raportet e prodhuara	KMD	MD Prokuroria AMA MSHMS	6M-II- 2021 - 6M-II-2025
7.4.3 Mbështetja e SHC-së për monitorimin dhe raportimin e gjuhës së urrejtjes (përfshi mediumet <i>online</i> , për të hequr/fshirë elemente të tilla)	Raportet e prodhuara Aksionet e ndërmarra për korrigjim	KMD	AMSHC KPK MSHMS	6M-II- 2021 - 6M-II-2025
7.4.4 Identifikimi i viktimave të krimeve të urrejtjes dhe lehtësimi i aksesit/përfitimi i mbështetjes me shërbime (p.sh. asistencë psikosociale etj.)	Të mbijetuar të krimeve të urrejtjes të mbështetur/integruar	MSHMS	MD NJVV	6M-I-2022 - 6M-II-2025
7.4.5 Trajnimi i policëve, gjyqtarëve dhe prokurorëve për njohjen e krimeve të urrejtjes	Trajnime të realizuara dhe staf i trajnuar	MB Shkolla e Magistraturës Policia Bashkiake	KPK MSHMS	6M-I-2022 - 6M-II-2025

Fusha prioritare: ANTIXHIPSIZMI				
Qëllimi i politikës VII:	Antixhipsizmi njihet dhe adresohet në politikat publike, si dhe përmes ndryshimeve sistemike dhe strukturore, për të garantuar një shoqëri të çliruar nga diskriminimi ndaj pakicave rome dhe egjiptiane			
Qëllimi i politikës VII.5:	Rritja e fuqizimit dhe pjesëmarrjes së qenësishme të OSHC-ve të pakicave rome dhe egjiptiane në përfaqësimin e interesave dhe të drejtave të tyre.			
Rezultatet e pritshme:	i.OSHC-të pakicave rome dhe egjiptiane janë pjesë e 100% të grupe të ngritura për punën në kuadër të antixhipsizmit ii.Në fund të 2025, bashkëpunimi OSHC të pakicave rome dhe egjiptiane – autoritet për mbrojtjen ndaj diskriminimit është dyfishuar iii.Në fund të 2025, OSHC-të të pakicave rome dhe egjiptiane kanë ngritur/përmirësuar kapacitetet e tyre dhe zënë 5% të projekteve të mbështetura me fonde publike.			
Treguesit:			<i>Baseline:</i> 1 (2020)	<i>Target</i> 5 (2025)
	7.5.1 Përqindja e bordeve/grupeve të punës që trajtojnë çështje të antixhipsizmit në të cilin marrin pjesë pakicat rome dhe egjiptiane		0%	100% e bordeve
	7.5.3 Përqindja e fondeve publike të përfituara nga OSHC-ja të pakicave rome dhe egjiptiane të cilat lidhen me çështje të antixhipsizmit		0%	25%
	7.5.4 Përqindja e OSHC-ve rome dhe egjiptiane të cilat mbështeten me projekte që kanë lidhje me çështje të antixhipsizmit		0%	40%



MASAT DHE AKTIVITETET	PRODUKTI	INSTITUCIONI PËRGJEGJËS	INSTITUCIONET PARTNERE	AFATI KOHOR
7.5.1 Pjesëmarrja e OSHC-ve R&E në borde/grupe pune për antixhipsizmin	Borde/grupe pune me pjesëmarrje R&E	KPK	KMD Avokati i Popullit	6M-I-2022 - 6M-II-2025
7.5.2 Forcimi i bashkëpunimi OSHC - Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi për përcjelljen, ndjekjen dhe monitorimin e ankesa.	Bashkëpunime në ndjekjen e ankesave për mbrojtje nga diskriminimi	KMD	KMD	6M-II- 2021 - 6M-II-2025
7.5.3 Mbështetja e OSHC-ve R&E me fonde në realizimin e misionit të tyre.	5% e fondeve të dedikuara për mbështetjen e SHC nga institucionet publike që kryejnë këtë aktivitet akordohen për OSHC R&E	AMSHC MK	MSHMS KPK MK	6M-II- 2021 - 6M-II-2025
7.5.4 Mbështetje e SHC R&E me aktivitete për ndërtim kapacitetesh dhe promovim të pakicave rome dhe egjiptiane	OSHC R&E janë pjesëmarrës në 100% të aktiviteteve me qëllim promovim të pakicave R&E	KPK	Avokati i Popullit MK MSHMS KMD	6M-I-2022 - 6M-II-2025



VENDIM
Nr. 33, datë 1.11.2021

**NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Vitore Tusha	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Altin Binaj	anëtar;
Përparim Kalo	anëtar;
Sonila Bejtja	anëtare;
Elsa Toska	anëtare,

me sekretare Enina Kotoni, në datat 7.10.2021 dhe 26.10.2021 mori në shqyrtim në seancë plenare publike çështjen nr. 5 (A) 2021 të Regjistrit Themeltar, që u përket:

KËRKUESE: Shoqëria “Zyra e Përmbarrimit Privat ARB” sh.p.k., përfaqësuar nga administratori, Alban Ruli.

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, në mungesë.

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, në mungesë.

Avokatura e Shtetit, përfaqësuar me autorizim nga Abaz Deda dhe Embro Ahmetaj.

Banka e Tiranës sh.a., në mungesë.

Korporata Elektroenergjetike Shqiptare, përfaqësuar me autorizim nga Vildana Kabetaj.

OBJEKTI: Konstatimi i shkeljes së aksesit në një gjykatë të caktuar me ligj.

Konstatimi i shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimi i procedurave në gjykimin e çështjes civile nr. 11243-02837-00-2017 akti, datë regjistrimi 14.9.2017, dhe i çështjes nr. 6 regjistri, datë 30.12.2020, në Gjykatën e Lartë të Republikës së Shqipërisë.

Konstatimi i mungesës së një mjeti efektiv për konstatimin, dëshmipërblimin dhe përshpejtimin e procedurave të sipërpërmendura.

BAZA LIGJORE: Neni 42, pika 2, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6, pika 1 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ); ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (ligji nr. 8577/2000).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatoren e çështjes Elsa Toska, shqyrtoi parashtrimet e kërkuases, shoqërisë “Zyra e përmbarrimit privat ARB” sh.p.k., prapësimet e Avokaturës së Shtetit, që përfundimisht kërkoj rrëzimin e kërkesës, qëndrimin me shkrim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (*Këshilli i Ministrave*) dhe qëndrimin e Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (*KESH*), të cilët e lanë në vlerësimin e Gjykatës, qëndrimin me shkrim të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë (*Kuvendi*), i cili nuk paraqiti argumente, konstatoi mungesën e prapësimeve me shkrim të subjektit të interesuar, Bankës së Tiranës sh.a., si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I
Rrethanat e çështjes

1. Shoqëria “Zyra e përmbarrimit privat ARB” sh.p.k. (*kërkuesja*) ka lidhur kontratë shërbimi me KESH-in me objekt kryerjen e shërbimit përmbarrimor për ekzekutimin e një titulli ekzekutiv, për të cilin kërkuessa ka filluar procedurën e ekzekutimit.

2. Në datën 28.5.2014 kërkuessa i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me padi kundër shoqërisë “Banka e Tiranës” sh.a., dhe person të tretë KESH-in, duke kërkuar detyrimin e shoqërisë së paditur, “Banka e Tiranës” sh.a., për shpërblimin e dëmit pasuror e jopasuror të shkaktuar nga veprimet me faj, për fitimin e munguar, si dhe për kamatat ligjore, sipas normës Tribor njëditore të vendosur nga Banka e Shqipërisë, deri në datën e ekzekutimit të vendimit të gjykatës.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 8890, datë 16.11.2015, ka vendosur rrëzimin e padisë. Në datën 17.12.2015 kërkuessa ka paraqitur ankim ndaj vendimit nr. 8890, datë 16.11.2015. Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 701, datë 23.3.2017, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 8890, datë 16.11.2015.

4. Kërkuessa ka paraqitur rekurs në Gjykatën e Lartë, i cili është regjistruar me nr. 11243-02837-00-



2017 akti, në datën 14.9.2017. Kjo çështje rezulton se nuk është gjykuar ende nga Gjykata e Lartë.

5. Në datën 14.12.2020 kërkesja ka paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave të gjykimit të çështjes pranë kësaj gjykate, bazuar në nenet 399/1-399/12 të Kodit të Procedurës Civile (KPC).

6. Me shkresën nr. 3103/1 prot., datë 21.12.2020, “*Kthim kërkesë për konstatim shkelje afati të arsyeshëm*”, kancelari i Gjykatës së Lartë ka njoftuar kërkuuesen se kërkesa për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave nuk është nënshkruar nga një avokat i pajisur me akt përfaqësimi, kriter i parashikuar në nenin 474 të KPC-së dhe, në këto kushte, e ka kthyer atë pa veprime për të bërë plotësimet përkatëse.

7. Në datën 30.12.2020 kërkesja ka paraqitur sërish në Gjykatën e Lartë kërkesë për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, të nënshkruar si nga ajo, ashtu edhe nga një avokat. Kjo kërkesë është regjistruar në datën 30.12.2020 me nr. 6 regjistri dhe nuk është gjykuar ende nga Gjykata e Lartë.

8. Me shkresën nr. 1009/1 prot., datë 1.4.2021, të kancelarit të Gjykatës së Lartë, në vijim të kërkesës së kërkuueses për informacion, ajo është njoftuar se të dyja çështjet e saj, si rekursi për themelin e çështjes, ashtu dhe kërkesa për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procesit para Gjykatës së Lartë janë në fazën e studimit dhe në pritje për t’u shqyrtuar në dhomë këshillimi, respektivisht nga kolegjet civile dhe administrative të Gjykatës së Lartë.

9. Në datën 21.4.2021 kërkesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), duke pretenduar cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor sipas objektit të kërkesës.

10. Kolegji i Gjykatës në datën 21.5.2021 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve të Gjykatës, e cila në datën 14.6.2021 ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike.

11. Gjykata, me shkresën nr. 5 (A) 2021 të Regjistrat Themeltar, në datën 15.6.2021 ka kërkuar informacion nga Gjykata e Lartë, e cila ka informuar se në bashkëpunim me Këshillin e Lartë Gjyqësor (KLGF) dhe mbështetjen e USAID-it, ka hartuar një udhërrëfyes për funksionalitetin e saj,

ku janë parashikuar një sërë masash me qëllim uljen e numrit të çështjeve të prapambetura brenda një kohe sa më të shpejtë, për të cilat ka angazhuar një numër të kualifikuar punonjësish, të cilët asistojnë këshilltarët ligjorë dhe gjyqtarët e Gjykatës së Lartë për të përpunuar sa më shumë çështje gjyqësore; ka inventarizuar 22,263 çështje të viteve 2010-2018, me qëllim evidentimin e të dhënave lidhur me objektin, natyrën e çështjes dhe të dhëna të tjera të rëndësishme për gjykimin, si dhe ka vijuar përpunimin e tyre, me qëllim përgatitjen e çështjeve për gjykim nga këshilltarët ligjorë dhe, më tej, shqyrtimin e tyre përfundimtar nga gjyqtarët; ka përgatitur planet e veprimit për secilën fushë të së drejtës, si: civile, administrative dhe penale, me qëllim shqyrtimin e çështjes sipas kronologjisë kohore dhe specifikës së çështjes; ka propozuar disa ndryshime në ligjet procedurale civile, penale dhe administrative, të cilat janë miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë dhe kanë hyrë në fuqi më 29 maj 2021.

12. Për sa u përket kërkesave për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e gjykimit për periudhën 1.1.2018–22.6.2021, Gjykata e Lartë ka informuar se janë të regjistruara 49 çështje, nga të cilat 18 për mosmarrëveshje që janë në gjykim në Gjykatën e Lartë, të cilat ndodhen në fazë studimi, si dhe 31 çështje për mosmarrëveshje që janë në gjykim pranë gjykatave të apelit. Nga këto të fundit, 27 çështje u përkasin mosmarrëveshjeve që janë në gjykim në Gjykatën Administrative të Apelit, nga të cilat janë gjykuar 11 dhe 4 çështje u përkasin mosmarrëveshjeve në gjykim në gjykatat e apelit me juridiksion të përgjithshëm.

13. Me shkresën e datës 30.6.2021, kërkesja i ka paraqitur Gjykatës parashtrime me shkrim, duke informuar, gjithashtu, se në datën 20 dhjetor 2019 ka depozituar një kërkesë edhe në Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*GJEDNJ*), e cila është regjistruar me numër aplikimi 38996/20, me të njëjtat pretendime, sikurse ato që janë objekt i këtij gjykimi.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

14. **Kërkesja** në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se janë cenuar:



14.1 *E drejta për një mjet efektiv për përshpejtim procedurash*, e garantuar në nenin 13 të KEDNJ-së, të lidhur me nenin 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së dhe nenin 42 të Kushtetutës, pasi rekursi është regjistruar në Gjykatën e Lartë më 14.9.2017 dhe prej më shumë se 3 vjetësh nuk ka ende një vendimarrje prej saj. Gjykata e Lartë nuk e ka objektivisht të mundur proceduralisht të zgjidhë ankesën për shkeljen e kohëzgjatjes dhe ndreqjen e pasojave, pasi në momentin që është paraqitur rekursi, nuk arrinte të formonte efektivisht asnjë kolegji dhe nuk kishte/ka një kolegji tjetër që të shqyrtojë vonesat në shqyrtimin e dosjeve të regjistruara dhe as ankimi të një kolegji tjetër i Gjykatës së Lartë nuk është një mjet efektiv.

14.2 *E drejta e aksesit në një gjykatë të caktuar me ligj*, e garantuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, për shkak të kthimit pa veprime të kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave nga kancelari i Gjykatës së Lartë. Në çështjen konkrete nuk ka pasur shqyrtim dhe vendim nga një gjyqtar, në kuptim të nenit 154/a, pika 3, të KPC-së, sipas të cilit kthimi i kërkesës pa veprime bëhet nga gjyqtari i vetëm, procedurë që gjen zbatim edhe në Gjykatën e Lartë. Bazuar edhe në nenin 57 të ligjit nr. 49/2012, rekursi kthehet me të meta me vendim të gjyqtarit. Formulimi në nenin 399/5 të KPC-së, duke përdorur termin “nëse” tregon se kërkesa mund të bëhet edhe nga vetë kërkuesi, por nëse bëhet nga avokati kërkohet prokurë. Interpretimi në themel i kancelarit të Gjykatës së Lartë i nenit 474 të KPC-së është *contra legem* i nenit 399/5 të KPC-së, që, për më tepër, është edhe *lex specialis* për procedurat në fjalë.

14.3 *E drejta e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, në veçanti në Gjykatën e Lartë*, e garantuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, për sa i përket procesit të themelit të çështjes, të regjistruar në datën 14.9.2017, si dhe procesit që i përket kërkesës me datë regjistrimi 30.12.2020, për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave. Në nenin 399/2 të KPC-së është përcaktuar si i arsyeshëm afati 2-vjeçar për shqyrtimin e çështjeve civile në Gjykatën e Lartë, ndërsa në nenin 399/7 të KPC-së kërkesa për konstatimin e afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurës së gjykimit merret në shqyrtim brenda 45 ditëve. Nga koha e regjistrimit të çështjes në Gjykatën e Lartë deri në paraqitjen e

kërkesës kushtetuese për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm kanë kaluar më shumë se 4 vjet dhe asnjë hap procedural nuk është ndërmarrë nga Gjykata e Lartë, përveç caktimit të gjyqtarit relator. Në kohëzgjatjen përtej afatit të arsyeshëm nuk ka ndikuar asnjë prej rrethanave të parashikuara në nenin 399/2 të KPC-së dhe nuk përbën shkak justifikues as reforma në drejtësi, as procesi i rivlerësimit të gjyqtarëve. Si pasojë e kësaj shkeljeje, kërkuësja ka kërkuar detyrimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, që në përputhje me nenet 399/6, pika 1, shkronja “ç” dhe 399/10 të KPC-së, t’i paguajë asaj dëmshpërblim ose urdhërimin e Gjykatës së Lartë që të vendosë për masën e dëmshpërblimit brenda 3 muajve nga bërja e kërkesës për këtë qëllim.

14.4 Gjykata nuk duhet të marrë në konsideratë prapësimet e Avokaturës së Shtetit, sa kohë ky subjekt është shprehur se nuk ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen objekt shqyrtimi dhe se ato janë paraqitur në tejkalim të afatit të vendosur nga Gjykata.

15. **Subjekti i interesuar, Kuvendi**, ka informuar Gjykatën se nuk kishte argumente për të paraqitur, pasi në vlerësimin e tij nuk duhet të ishte pjesëmarrës në këtë gjykim kushtetues.

16. **Subjekti i interesuar, Këshilli i Ministrave**, ka informuar Gjykatën se nuk kishte interes për çështjen objekt shqyrtimi dhe e linte zgjidhjen e çështjes në vlerësim të Gjykatës.

17. **Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit**, duke parashtruar se ndonëse nuk kishte interes të drejtpërdrejtë në çështje, ka paraqitur në mënyrë të përmblëdhur qëndrimin e saj si vijon:

17.1 Gjykata duhet të marrë në shqyrtim paraprakisht legjitimitimin e kërkueses, në kushtet kur nuk ka ende një vendim gjyqësor përfundimtar në lidhje me çështjen e saj. Çështja konkrete nuk hyn në juridiksionin kushtetues, për sa kohë është ende në shqyrtim në Gjykatën e Lartë.

17.2 Për sa i përket pretendimit për cenimin e së drejtës së aksesit, në atë kohë nuk ka pasur një parashikim të qartë ligjor në lidhje me faktin se njoftimi për kthimin e kërkesës pa veprime bëhej nga administrata gjyqësore, nga trupi gjyqësor, ose vetëm nga një gjyqtar. Në rastin konkret nuk ka shkelje të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, pasi kërkueses nuk i është mohuar asnjë e drejtë procedurale në shqyrtimin e rekursit të saj, duke qenë se çështja është ende në shqyrtim në Gjykatën



e Lartë. Kancelari i Gjykatës së Lartë nuk ka disponuar për aspekte të procesit që duket se janë në kompetencë të një gjyqtari të caktuar me ligj dhe në atë kohë ai nuk ka ushtruar asnjë kompetencë gjyqësore ose juridiksionale.

17.3 Lidhur me pretendimin për shkeljen e afatit të arsyeshëm, kërkesa duhet të rrëzohet për shkak të mosshterimit të mjeteve ligjore në dispozicion, për sa kohë që nuk ka një vendimmarrje nga Gjykata e Lartë. Pavarësisht kësaj, situata konkrete nuk lidhet vetëm me këtë rast, pasi në mënyrë objektive është e lidhur me reformën në drejtësi, si dhe nuk ka një kapërcim të afateve të shqyrtimit të çështjes, pasi kjo ka ardhur si pasojë e rrethanave objektive dhe sistematike.

18. **Subjekti i interesuar, Banka e Tiranës sh.a.**, ndonëse është njoftuar rregullisht, nuk ka paraqitur shpjegime me shkrim.

19. **Subjekti i interesuar, KESH-i**, në seancën e datës 26.10.2021, ka parashtruar se mban të njëjtin qëndrim si Avokatura e Shtetit. Në rastin konkret nuk ka pasur cenim të së drejtës për proces të rregullt ligjor, pasi kërkuessës i është dhënë akses në të gjitha shkallët e gjykimit dhe rekursi i saj pritet të gjykohet nga një kolegji tjetër civil i Gjykatës së Lartë. Gjithashtu, afatet e gjykimit nuk janë shkelur. Në përfundim, ky subjekt e ka lënë çështjen në çmim të Gjykatës.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Për legjitimitimin e kërkuessës

20. Kërkuessja pretendon se ka pasur cenim të së drejtës së aksesit në një gjykatë të caktuar me ligj, për shkak të kthimit pa veprime të kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e procedurave nga ana e kancelarit të Gjykatës së Lartë. Ajo pretendon se mjetet e parashikuara nga legjislacioni në fuqi për mbrojtjen e kësaj të drejte nuk janë efektive dhe se nuk ka mjete të tjera në dispozicion, duke kërkuar edhe konstatimin e mungesës së mjetit efektiv për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm, dëmshpërblimin dhe përsheptimin e procedurave, të garantuar në nenin 13 të KEDNJ-së, të lidhur me nenin 6, paragrafi 1, të KEDNJ-së dhe nenin 42 të Kushtetutës. Gjithashtu, kërkuessja pretendon se ka pasur një cenim të së drejtës për proces të rregullt ligjor si pasojë e mosgjykimit të çështjes

brenda një afati të arsyeshëm, lidhur me procedurat në Gjykatën e Lartë.

21. Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka parashtruar se çështja konkrete nuk hyn në juridiksionin kushtetues, sa kohë që çështja e themelit është ende në shqyrtim në Gjykatën e Lartë dhe nuk ka një vendim përfundimtar. Subjekti i interesuar, KESH-i, ka parashtruar se mban të njëjtin qëndrim si Avokatura e Shtetit.

22. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata Kushtetuese si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I” dhe pika 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor, që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë.

23. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret e nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësura në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, si dhe mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur. Kriteret paraprake të pranueshmërisë së ankimit kushtetues individual janë të natyrës kumulative.

24. Gjykata vëren se kërkuessja, si individ, legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të neneve 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pika 1, shkronja “I” dhe 134, pika 2, të Kushtetutës. Ajo ka qenë palë në procesin gjyqësor, për të cilin ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë duke pasur interes të drejtpërdrejtë.

25. Një kriter tjetër paraprak, që duhet të përmbushet nga individ i përpara se t’i drejtohet Gjykatës, lidhet me *shterimin e mjeteve juridike efektive*, që përcaktohet nga nenet 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neni 71/a, pika 1, shkronja “a”, i ligjit nr. 8577/2000. Sipas këtij kriteri kërkuessi duhet të shfrytëzojë në rrugë normale mjetet juridike, të cilat janë të përshtatshme, të disponueshme dhe të frytshme për një çështje konkrete.

26. Shterimi i mjeteve përbën parakusht që duhet përmbushur nga kërkuessi, i cili para se t’i



drejtohet Gjykatës Kushtetuese duhet të vërtetojë se ka përdorur të gjitha mjetet juridike të njohura nga ligji dhe të mjaftueshme për të rivendosur të drejtat e shkelura. Mjetet juridike shpëtojnë kur në varësi të rrethanave të çështjes rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimin nr. 38, datë 25. 4.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

27. Gjithashtu, Gjykata ka pohuar se kërkuksi duhet t'i ketë përdorur të gjitha mjetet juridike në dispozicion për mbrojtjen e së drejtës kushtetuese të pretenduar jo vetëm formalisht, por edhe në kuptimin substancial. Duke qenë se mjeti juridik mund të jetë i ndryshëm, në varësi të llojit të ankimit, efektiviteti i tij vlerësohet jo thjesht nga fakti që është parashikuar me ligj, por edhe nga zbatueshmëria e tij (*shih vendimin nr. 31, datë 4.10.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

28. Thënë ndryshe, ky rregull nënkupton që kërkuksi duhet të shpëtojë vetëm mjetet juridike “efektive”, para se t'i drejtohet Gjykatës Kushtetuese, në kuptimin e shterimit vetëm të atyre mjeteve juridike, të afta për të rivendosur të drejtën, që pretendohet se është shkelur. Në të kundërt, vetë Gjykata rrezikon të mos konsiderohet si një “mjet efektiv” (*shih Opinionin e ndërmjetëm të Komisionit të Venecias për draftndryshimet kushtetuese në sistemin gjyqësor në Shqipëri, CDL(2015)052, 4 dhjetor 2015, § 31*).

29. Sipas GJEDNJ-së, mjeti juridik përsheptues është “efektiv” nëse përshepton vendimarrjen e gjykatës në fjalë. Ajo, gjithashtu, ka theksuar rëndësinë e parimit të subsidiaritetit, i cili bën të mundur shmangien që individët t'i drejtohen sistematikisht kësaj gjykate për pretendime që do të ishin shqyrtuar më mirë brenda sistemit juridik kombëtar. Prandaj, aty ku ligjvënësi ose gjykatat vendase kanë marrë përsipër të luajnë rolin e duhur të tyre, duke parashikuar një mjet juridik të brendshëm, kësaj gjykate do t'i duhet të vlerësojë nëse mjeti është ose jo efektiv (*shih Scordino kundër Italisë (nr. 1) [GC], 29 mars 2006, §§ 184, 188–189*).

30. Në rastin konkret, Gjykata do të vlerësojë nëse kërkuksja i ka shteruar mjetet juridike në dispozicion dhe nëse këto kanë qenë efektive, për të garantuar të drejtën e individit për gjykim brenda një afati të arsyeshëm. Në këtë këndvështrim, Gjykata do të shqyrtojë edhe pretendimin tjetër të kërkukses për mungesën e mjetit efektiv të përsheptimit të procedurave, që ajo e ka ngritur në

kuptim të nenit 13 të KEDNJ-së, si dhe për cenimin e aksesit në këtë lloj procedure.

31. Sipas të dhënave të Gjykatës së Lartë, rezulton se rekursi i kërkukses është regjistruar në datën 14.9.2017, por nuk ka ende një vendimarrje për të. Gjithashtu, kërkuksja ka paraqitur një kërkesë në Gjykatë të Lartë me objekt konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e procedurave gjyqësore në gjykimin e çështjes, fillimisht në datën 14.12.2020 dhe më pas në datën 30.12.2020, e regjistruar në po atë datë, për të cilën në seancën plenare publike ka informuar se do të shqyrtohet më 3 nëntor 2021.

32. Gjykata në jurisprudencën e saj e ka legjitimuar individin për paraqitjen e kërkesave me objekt mosgjykimin e çështjeve brenda një afati të arsyeshëm, edhe kur për to nuk ishte dhënë një vendim përfundimtar, ose mosekzekutimin e vendimit brenda afatit të arsyeshëm, në kuptim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor, edhe kur legjislacioni nuk parashikonte mjete të tjera juridike efektive për mbrojtjen e kësaj të drejte kushtetuese (*shih vendimet nr. 22, datë 29.4.2021; nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 69, datë 17.11.2015; nr. 12, datë 5.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

33. Në datën 30.3.2017 ligjvënësi ka miratuar ligjin nr. 38/2017, “Për disa ndryshime në Kodin e Procedurës Civile”, i cili ka përfshirë dispozita të reja në KPC për afatet e arsyeshme të përfundimit të hetimit, gjykimit ose ekzekutimit të një vendimi të formës së prerë, nenet 399/1–399/12. Me hyrjen në fuqi të këtyre ndryshimeve në datën 5.11.2017, Gjykata ka vlerësuar se legjislacioni vendas parashikon tashmë një mjet juridik ankimi efektiv, i cili garanton si përsheptimin e procesit gjyqësor, ashtu edhe dëmshpërblimin, pra ofron një rezultat konkret në drejtim të rivendosjes të së drejtës së shkelur për proces gjyqësor brenda afateve të arsyeshme ligjore (*shih vendimin nr. 80, datë 18.12.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

34. GJEDNJ-ja ka arritur në përfundimin se mjeti juridik i parashikuar në nenet 399/1 e vijues të KPC-së në parim është efektiv, por që të jetë i tillë edhe në praktikë, kërkesa për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përsheptimin e procedurave, në bazë të nenit 399/6, pika 1, të KPC-së, duhet të shqyrtohet me shpejtësi nga gjykata (*shih Bara dhe Kola kundër Shqipërisë, 12 tetor 2021, §§ 107 dhe 119*).



35. Po në këtë vendim, për sa i përket shqyrtimit nëse mjeti juridik ishte efektiv në praktikë, GJEDNJ-ja ka konstatuar se pas hyrjes në fuqi të mjetit përshpejtues/parandalues më 5 nëntor 2017 në bazë të neneve 399/6, pika 1, e vijues të KPC-së, (dispozitat e reja), në rastin e kërkuarit nuk është efektiv, pasi nuk i ka shërbyer qëllimit të përshpejtimit të procedurave në Gjykatën e Lartë ose parandalimit të tejzgjatjes së tyre në mënyrë të paarsyeshme. Për më tepër, kërkuari nuk ka pasur mundësi të kërkojë as kompensim për kohëzgjatjen e atyre procedurave, në bazë të pikës 3 të nenit 399/6 të KPC-së, për shkak të mungesës së konstatimit të cenimit të gjykimit brenda një “afati të arsyeshëm” (*po aty*, §§ 121–123). Pavarësisht kësaj, GJEDNJ-ja është shprehur se qëndrimi i saj në këtë vendim mund të bëhet objekt rishikimi në të ardhmen, në varësi të kapaciteteve të gjykatave vendase për të zhvilluar dhe mbajtur një jurisprudencë të qëndrueshme për zbatimin e mjetit juridik, në përputhje me kriteret e KEDNJ-së (*po aty*, § 120).

36. Për sa më lart, bazuar në rrethanat e çështjes konkrete, Gjykata vlerëson se mjetet e parashikuara nga nenet 399/1 e vijues të KPC-së në parim janë efektive. Për sa i takon efektivitetit të tyre në praktikë, Gjykata, në këndvështrim të kriterit të shterimit të mjeteve juridike efektive, të parashikuara nga neni 131, pika 1, shkronja “P”, i Kushtetutës, vlerëson se duhen shqyrtuar nën dritën e rrethanave të çdo rasti konkret. Në këtë aspekt, ajo mban në konsideratë edhe faktin se për zbatimin e mjeteve juridike të parashikuara nga KPC-ja për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimit të procedurave nuk ka ende një qëndrim të konsoliduar nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, duke qenë se janë mjete relativisht të reja.

37. Përveç sa më sipër, Gjykata thekson se gjykatat e zakonshme, gjatë zbatimit të dispozitave procedurale dhe shqyrtimit të kërkesave për përshpejtim, duhet të shmangin formalizmat e tepruar dhe t’i shqyrtojnë këto kërkesa me përparësi, përndryshe ky mjet juridik do të humbiste qëllimin për të cilin është miratuar nga ligjvënësi. Në këtë aspekt, gjykatat, në shqyrtimin e këtyre kërkesave, duhet të kenë parasysh kriteret të tilla, si: lloji i së drejtës objekt kërkitimi dhe natyra e çështjes së themelit për të cilën kërkohet përshpejtimi, dëmi i mundshëm që mund t’i vijë

kërkuarit, kohëzgjatja e çështjes në shkallë të zakonshme të gjykimit, organizimi i brendshëm i punës në gjykatë, si dhe çdo kriter tjetër i rëndësishëm, me qëllim që të mos cenohet thelbi i së drejtës.

38. Duke iu kthyer rastit konkret, Gjykata vëren se deri në zhvillimin e seancës plenare publike në datën 26.10.2021, Gjykata e Lartë nuk e kishte marrë ende në shqyrtim kërkesën për përshpejtim të rekursit, të paraqitur nga kërkuarja, bazuar në nenet 399/6 e vijues të KPC-së në datën 30 dhjetor 2020. Kjo kërkesë për përshpejtim, sipas nenit 399/7 të të njëjtit kod, duhej të shqyrtohej prej Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi brenda 45 ditëve. Po ashtu, Gjykata konstaton se veprimi administrativ për kthimin e kërkesës për përshpejtim nga kancelari i Gjykatës së Lartë, për t’u nënshkruar nga një avokat, nuk ka mbajtur në konsideratë ndryshimin e këtyre kërkesave nga rekursi, në pikëpamje të përmbajtjes, të aksesit dhe sidomos të shpejtësisë që duhet të karakterizojë marrjen në shqyrtim të tyre. Thënë ndryshe, kërkesat për përshpejtim janë trajtuar njësoj si procedurat e zakonshme të gjykimit.

39. Gjykata vlerëson se veprimet administrative të kancelarit të Gjykatës së Lartë me shkresën e tij nr. 3103/1 prot., datë 21.12.2020 “*Kthim kërkesë për konstatim shkelje afati të arsyeshëm*”, kanë qenë një faktor shtesë që ka ndikuar në vonesat e shkaktuara në shqyrtimin e kërkesës së kërkuarës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimit të procedurave.

40. Në vijim, Gjykata evidenton se Gjykata e Lartë ka rifilluar të funksionojë në datën 11 mars 2020 me krijimin e një trupi gjyqësor me tre gjyqtarë, gjë që vështirësonte shqyrtimin me shpejtësi të kërkesës për përshpejtim, pasi në bazë të nenit 399/6, pika 1, shkronja “c”, të KPC-së, këto kërkesa shqyrtohen nga një kolegji tjetër i Gjykatës së Lartë nga ai që shqyrton çështjen e themelit. Megjithatë, Gjykata konstaton se ndonëse numri i gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë është rritur në vijim, në mars 2021 funksiononte me 7 gjyqtarë dhe prej korrikut 2021 funksionon me trup prej 9 gjyqtarësh, sërish kërkesa për përshpejtim, e paraqitur nga kërkuarja, nuk është marrë në shqyrtim.

41. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se nga paraqitja e kërkesës për përshpejtim deri në ditën e seancës plenare publike ka kaluar një kohë



relativisht e gjatë. Vetëm në datën 25.10.2021 Gjykata e Lartë ka shpallur gjykimin e kërkesës për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave për në datën 3.11.2021, kërkesë e paraqitur prej kërkueses fillimisht që në datën 14.12.2020. Gjykata thekson se nëse një kërkesë përshpejtimi nuk shqyrtohet me shpejtësi, ajo humbet qëllimin e saj për shkak të natyrës së këtyre procedurave, të cilat janë të ndryshme nga një procedurë e zakonshme gjykimi. Për këtë arsye, Gjykata do të ndalet veçanërisht të sjellja e autoriteteve që ndikon në shpejtësinë e gjykimit në rastin konkret.

42. Gjykata e Lartë, me shkresën nr. 2081/1 prot., datë 22.6.2021, ka informuar Gjykatën se janë 18 çështje të regjistruara për konstatim shkelje afati dhe përshpejtim të procedurave sa u përket mosmarrëveshjeve që janë në gjykim në Gjykatën e Lartë, të cilat ndodhen në fazën e studimit. Gjykata, referuar faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë, konstaton se janë arsyetuar disa vendime me objekt konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave për mosmarrëveshje në këtë gjykatë.

43. Gjykata, referuar *Raportit mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2020*, vëren se KLGJ-ja ka marrë masa për uljen e numrit të çështjeve të prapambetura dhe rritjen e efikasitetit në Gjykatën e Lartë, duke angazhuar personel ndihmës dhe duke marrë masa të tjera për këtë qëllim. Edhe në shkresën e Gjykatës së Lartë, dërguar për informacion Gjykatës, rezulton se Gjykata e Lartë ka marrë hapa konkretë duke parashikuar një sërë masash me qëllim uljen e numrit të çështjeve të prapambetura brenda një kohe sa më të shpejtë, si rritja e kapaciteteve njerëzore, inventarizimi i çështjeve, përpunimi deri në shqyrtimin e tyre, si dhe përgatitja e planeve të veprimit me qëllim shqyrtimin e çështjeve sipas kronologjisë kohore dhe specifikes së çështjes (*shih paragrafin 11 të vendimit*).

44. Ndërkohë që Gjykata i vlerëson masat e mësipërme që janë marrë nga autoritetet përkatëse, të cilat së bashku me mjetin përkatës të përshpejtimit të proceseve të gjykimit i shërbejnë qëllimit të rritjes së efektivitetit të veprimtarisë gjyqësore, ajo thekson se ky mjet mund të jetë efektiv në rrethana të zakonshme të organizimit dhe funksionimit të sistemit gjyqësor. Në rastin

konkret, ngrihen dyshime për mundësitë që mjeti përshpejtues ka për t'iu përgjigjur në shkallën e duhur nevojës së të drejtës së individëve për gjykim brenda afatit të arsyeshëm në raport me mundësitë reale të sistemit gjyqësor, për shkak të vëllimit të lartë të çështjeve, si dhe burimeve njerëzore dhe infrastrukturore të tij në tërësi.

45. Duke pasur parasysh situatën e mësipërme, Gjykata merr në konsideratë përpjekjet e autoriteteve shqiptare për përmirësimin e legjislacionit në parashikimin e mjeteve juridike efektive për kohëzgjatjen e procedurave gjyqësore, si dhe veprimet e ndërmarra nga KLGJ-ja dhe Gjykata e Lartë për uljen e numrit të çështjeve që janë për shqyrtim në Gjykatën e Lartë. Gjykata, për nevoja të gjykimit kushtetues, pikërisht për të kuptuar më shumë vështirësitë dhe problematikat në lidhje me efektet e reformës dhe masat e tjera që mund të merren në këtë drejtim, thirri autoritetet e ngarkuara edhe me marrjen e masave efektive, Kuvendin dhe Këshillin e Ministrave, të cilat u shprehën se nuk kanë interes, duke mos paraqitur të dhëna që do të ndihmonin në krijimin e një tabloje më të gjerë në këtë drejtim. Megjithatë, ajo vlerëson se Gjykata e Lartë, duke konsideruar natyrën e çështjes së themelit, ngarkesën e kolegjit përkatës dhe ngarkesën e gjyqtarit relator, mund të gjendet në vështirësi për të respektuar afatet ligjore. Pavarësisht këtyre elementeve, Gjykata e Lartë ka detyrimin të sillet në atë mënyrë që kërkesa për përshpejtim të mos humbasë qëllimin e vet dhe individit të mos i cenohet në thelb e drejta për mjet juridik efektiv.

46. Duke marrë në konsideratë rrethanat e rastit konkret, jurisprudencën e Gjykatës dhe atë të GJEDNJ-së, Gjykata çmon se kërkesa për përshpejtim, e paraqitur nga kërkuesja, nuk është marrë në shqyrtim me shpejtësi nga Gjykata e Lartë, që do të thotë se ky mjet juridik nuk i ka shërbyer qëllimit të tij - përshpejtimit të procedurave ose parandalimit të tejzgjatjes së paarsyeshme të shqyrtimit të rekursit të kërkueses para Gjykatës së Lartë. Me fjalë të tjera, mjeti juridik “kërkesa për përshpejtim”, që kërkuesja ka pasur në dispozicion, sipas nenit 399/6 të KPC-së, nuk ka qenë *efektiv*, për rrjedhojë Gjykata vlerëson se kërkuesja e ka përmbushur kriterin e shterimit të mjetit juridik¹²⁶.

¹²⁶ Votuan kundër anëtarët F. Papajorgji dhe A. Binaj.



47. Për sa i përket pretendimit të kërkuësës për dëmshpërblim, si pasojë e mosshqyrtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm, ajo në seancë plenare ka saktësuar kërkesën për detyrimin e Gjykatës së Lartë për të përcaktuar dëmshpërblim, ndërsa në diskutimet përfundimtare me shkrim ka kërkuar caktimin e një shpërblimi të drejtë, në zbatim të jurisprudencës së GJEDNJ-së në raste të ngjashme, si dhe detyrimin e Këshillit të Ministrave për të siguruar ekzekutimin e vendimit ose caktimin e një organi tjetër të ngarkuar me zbatimin e tij. Gjykata vlerëson se, bazuar në nenin 131 të Kushtetutës, ky pretendim i kërkuësës nuk bën pjesë në juridiksionin e kësaj Gjykate.

48. Në lidhje me kriterin tjetër, atë të respektimit të afatit të paraqitjes së kërkesës, bazuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000, Gjykata vëren se në kushtet e një shkeljeje që vazhdon të ekzistojë, pavarësisht se nuk ka vendim përfundimtar për kërkesën për konstatimin e shkeljes së afatit të arsyeshëm dhe përshpejtimin e procedurave, kërkuësës i lind e drejta t’i drejtohet Gjykatës në çdo kohë përgjatë periudhës që shkelja vazhdon. Në rastin konkret afati është tejkaluar dhe, në këtë kuptim, kërkuësja legjitimohet edhe *ratione temporis*.

49. Për sa i takon legjitimitetit *ratione materiae*, Gjykata vlerëson se në vështrim të neneve 42 dhe 131, pika 1, shkronja “P”, të Kushtetutës, pretendimi për kohëzgjatjen e paarsyeshme të procesit të themelit përbën objekt vlerësimi për kontrollin kushtetues.

B. Për shqyrtimin e çështjes brenda një afati të arsyeshëm

50. Kërkuësja pretendon se i është cenuar e drejta e gjykimit brenda një afati të arsyeshëm, në veçanti në Gjykatën e Lartë, e garantuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNJ-së, për sa i përket procesit të themelit të çështjes, për shkak të kalimit të afatit të arsyeshëm 2-vjeçar, të parashikuar në nenin 399/2, pika 1, shkronja “b”, të KPC-së.

51. Subjekti i interesuar, Avokatura e Shtetit, ka prapësuar se situata konkrete nuk lidhet vetëm me këtë rast, pasi në mënyrë objektive është e lidhur me reformën në drejtësi, si dhe nuk ka një kapërcim të afateve të shqyrtimit të çështjes, pasi kjo ka ardhur si pasojë e rrethanave objektive dhe sistematike. Subjekti i interesuar, KESH-i, në seancën e datës 26.10.2021 ka parashtruar se mban të njëjtin qëndrim si Avokatura e Shtetit.

52. Sipas nenit 42 të Kushtetutës, kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

53. Sipas jurisprudencës së Gjykatës, e drejta për një proces të rregullt ligjor, pjesë e të cilit është edhe gjykimi brenda një afati të arsyeshëm, luan një rol qendror në sistemin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut (*shih vendimin nr. 18, datë 19.7.2005, të Gjykatës Kushtetuese*). Kjo dispozitë vendos detyrimin për organizimin e sistemit ligjor në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregullt ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme (*shih vendimet nr. 42, datë 25.5.2017; nr. 22, datë 20.3.2017; nr. 12, datë 5.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

54. Gjykata, lidhur me kërkesat për konstatimin e cenimit të së drejtës kushtetuese për proces të rregullt ligjor, si pasojë e mosgjykimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm, ka theksuar se arsyeshmëria e zgjatjes së procesit duhet të vlerësohet sipas rrethanave të veçanta të çështjes, duke pasur parasysh sidomos sjelljen e kërkuësit dhe rrezikun që passjell për të kjo tejzgjatje e afateve të gjykimit, kompleksitetin e çështjes, si dhe sjelljen e autoriteteve (*shih vendimet nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 76, datë 4.12.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

i. Periudha që dubet marrë në konsideratë

55. Gjykata ka vlerësuar se kohëzgjatja e procesit normalisht llogaritet nga momenti i fillimit të procesit gjyqësor, deri në momentin kur jepet vendimi (*shih vendimin nr. 83 datë 30.12.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

56. Lidhur me periudhën që dubet marrë në konsideratë, Gjykata vëren se pretendimet e kërkuësës për cenimin e së drejtës për një proces të rregullt ligjor lidhen me periudhën nga data 14.9.2017, kur rekursi është regjistruar në Gjykatën e Lartë, deri ditën e gjykimit nga Gjykata, ku rekursi i kërkuësës ende nuk është marrë në shqyrtim nga Gjykata e Lartë.



57. Për sa i takon gjykimit të mosmarrëveshjeve civile, me ndryshimet e vitit 2017, Gjykata vëren se KPC-ja në nenin 399/2 ka parashikuar afatet e arsyeshme, duke përcaktuar qartësisht se çështjet civile në gjykatën e shkallës së parë, në apel dhe në Gjykatën e Lartë duhet të shqyrtohen në secilin proces brenda një afati 2-vjeçar. Neni 109 i ligjit nr. 38/2017 (dispozitë kalimtare), parashikon se për çështjet që kanë qenë në gjykim në datën e hyrjes në fuqi të neneve 399/1-399/12 të KPC-së, afati kohor i parashikuar për gjykimin e çështjes civile shtyhet me 1 vit e 6 muaj.

58. Gjykata konstaton se rekursi i kërkuësës është regjistruar në datën 14.9.2017. Në këtë kuptim, kërkuësja ka pasur pritshmëri se shqyrtimi i çështjes së saj nuk do të vonohej përtej afateve ligjore të lartpërmendura.

59. Për sa më lart, Gjykata vlerëson se *prima facie* në rastin konkret ka një tejzgjatje të procedurave gjyqësore. Në këtë kontekst, për të arritur në konkluzionin nëse jemi përpara cenimit të së drejtës për gjykim brenda një afati të arsyeshëm, duhet të analizohen elementet e tjera.

ii. Sjellja/interesi për kërkuësen dhe rrezikun që passjell tejzgjatja e procedurave për të

60. Gjykata në jurisprudencën e saj është shprehur se vlerësimi i sjelljes është një element përcaktues i kohëzgjatjes së arsyeshme të procedimeve, duke u analizuar rrethanat nëse kërkuësi ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale, duke shfaqur ose jo interes të vazhdueshëm për gjykimin e çështjes brenda një afati sa më të përshtatshëm për të dhe nëse ai është bërë shkak ose ka shkaktuar vonesa në këtë drejtim (*shih vendimin nr. 69, datë 17.11.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

61. Sipas GJEDNJ-së, sjellja e kërkuësve përbën një faktor objektiv që duhet të merret parasysh për vlerësimin nëse është tejkualuar koha e arsyeshme, sipas kërkesave të nenit 6 § 1 të KEDNJ-së (*shih Humen kundër Polonisë [GC], 15 tetor 1999, § 66*). Disa kategori çështjesh, për shkak të natyrës së tyre, kërkojnë përsheptim të posaçëm gjykimi në procedurat vendase. Në këto raste duhet të merret parasysh ajo çfarë përbën rrezik për pozitën e kërkuësit në procesin gjyqësor. Prandaj është thelbësore të trajtohen me shpejtësi të veçantë çështjet që kanë të bëjnë me kujdestarinë (*shih Tsikakis kundër Gjermanisë, 10 shkurt 2011, §§ 64 dhe 68; Nuutinen kundër Finlandës, 27 qershor 2000, § 110*),

punësimin (*shih Thlimmenos kundër Greqisë [GC], 6 prill 2000, §§ 60 dhe 62*), sëmundjet e pashërueshme dhe jetëgjatësinë e shkurtër (*A. dhe të tjerët kundër Danimarkës, 8 shkurt 1996, §§ 78-81; X kundër Francës, 31 mars 1992, § 47*).

62. Duke iu kthyer rastit në shqyrtim, Gjykata vëren se kërkuësja ka vepruar në përputhje me të drejtat procedurale dhe nuk rezultoi të jetë bërë shkak ose të ketë shkaktuar vonesa në këtë drejtim. Për sa i përket kriterit të interesit për kërkuësen dhe rrezikut që passjell tejzgjatja e procedurave për të, Gjykata vlerëson se çështja konkrete është e një natyre të tillë që interesi i kërkuësës nga kohëzgjatja e tepruar e procedurave gjyqësore nuk rrezikohet në shkallë të konsiderueshme, për sa kohë që në padinë e saj ajo ka kërkuar detyrimin e shoqërisë së paditur, “Banka e Tiranës” sh.a., për shpërblimin e dëmit pasuror e jopasuror të shkaktuar nga veprimet me faj dhe fitimin e munguar, si dhe për kamatat ligjore sipas normës Tribor njëditor të vendosur nga Banka e Shqipërisë, deri në datën e ekzekutimit të vendimit të gjykatës.

63. Po ashtu, nga arsyetimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatës së Apelit Tiranë, rezultoi se, me fillimin e procedurës së ekzekutimit të detyrueshëm, kërkuësja ka përfituar shpërblimin përkatës për efekt të kryerjes së çdo veprimi përmbartimor prej saj, në përputhje me nenin 7 të kontratës së shërbimit. Po kështu, Gjykata vëren se kërkuësja është person juridik dhe procesi për të cilin ka iniciuar procedurat gjyqësore është civil, i cili nuk ka të bëjë me interes të ngushtë vetjak, të tillë që do të diktonte shqyrtimin me përparësi të tij. Sipas praktikës së GJEDNJ-së, disa kategori çështjesh, për shkak të natyrës së tyre, kanë përparësi në radhën e shqyrtimit, siç janë ato që kanë të bëjnë me pensionin, kujdestarinë ose raste të tjera të ngjashme, për të cilat mund të tregohet një kujdes më i madh.

64. Nga ana tjetër, nga pikëpamja e shpejtësisë në gjykim, Gjykata evidenton se në *parim* çështjet civile paraqiten më pak prioritare në raport me çështjet penale, që kanë të bëjnë me kufizimin e lirisë së individit, dhe ato administrative, të cilat vetë ligjvënësi i ka përcaktuar si çështje që kërkojnë shpejtësi në gjykimin e tyre, duke parashikuar afate më të shpejta gjykimi. Po ashtu, pa paragjykuar rastet e çështjeve civile, të cilat paraqesin natyrë urgjente, Gjykata konstaton se çështja civile e kërkuësës lidhet me shpërblimin e dëmit të



shkaktuar gjatë procedurës së ekzekutimit të titullit ekzekutiv midis dy shoqërive tregtare dhe, siç u parashtrua më lart, tejzgjatja nuk paraqet shkallë të konsiderueshme rreziku.

65. Në përfundim, Gjykata çmon se në rastin konkret tejzgjatja e procedurave gjyqësore nuk paraqet një shkallë të konsiderueshme rreziku për interesin e kërkuës.

iii. Kompleksiteti i çështjes

66. Gjykata ka theksuar se për vlerësimin e kompleksitetit të procedimeve duhet të kenë rëndësi të gjitha aspektet e çështjes, përfshirë objektin e çështjes, faktet e kundërshtuara dhe volumin e provave shkresore. Kompleksiteti i çështjes, në balancë me parimin e sigurimit të administrimit të përshtatshëm të drejtësisë, mund të justifikojë kohëzgjatje kohore të konsiderueshme (*shih vendimet nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 32, datë 30.3.2017; nr. 22, datë 20.3.2017; nr. 14, datë 10.3.2016; nr. 12, datë 5.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese*).

67. Sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, kompleksiteti i çështjes mund të lidhet si me faktet, ashtu edhe me ligjin (*shih Papachelas kundër Greqisë* [GC], 25 mars 1999, § 39; *Katte Klitsche de la Grange kundër Italisë*, 27 tetor 1994, § 55), me përfshirjen e disa palëve në proces (*shih H. kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 8 korrik 1987, § 72) ose me prova të ndryshme që duhet të merren (*shih Humen kundër Polonisë* [GC], 15 tetor 1999, § 63).

68. Në rastin konkret, Gjykata, veç faktit se mosmarrëveshja objekt gjykimi është e natyrës civile, vëren, gjithashtu, se palë ndërgjyqëse në këtë proces janë kërkuësja, Banka e Tiranës sh.a. dhe KESH-i, të cilat janë persona juridikë, që kanë mosmarrëveshje për procedurën e ekzekutimit të një titulli ekzekutiv gjatë një veprimtarie tregtare. Objekti i gjykimit lidhet me pretendimin për shpërblimin e dëmit pasuror e jopasuror të shkaktuar kërkuës, fitimin e munguar dhe kamatat ligjore përkatëse. Gjykata në vijim konstaton se procedurat para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë kanë zgjatur përafërsisht 18 muaj, periudhë gjatë së cilës janë zhvilluar 20 seanca gjyqësore. Po ashtu, procedurat para Gjykatës së Apelit Tiranë kanë zgjatur rreth 15 muaj.

69. Për sa më sipër, Gjykata vlerëson se shqyrtimi i çështjes nga Gjykata e Lartë paraqet elemente kompleksiteti.

iv. Sjellja e autoriteteve

70. Gjykata ka theksuar se neni 42 i Kushtetutës, si dhe neni 6 i KEDNJ-së vendosin detyrimin për organizimin e sistemit ligjor të vendit në mënyrë të tillë që gjykatat të plotësojnë kërkesat e standardeve për një proces të rregull ligjor, përfshirë këtu edhe atë të gjykimit brenda afatit të arsyeshëm. Në këtë drejtim, gjykatat kanë për detyrë të sigurojnë që të gjitha subjektet që marrin pjesë në proces të sillen në mënyrë që të evitojnë çdo vonesë të panevojshme (*shih vendimet nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 76, datë 4.12.2017; nr. 22, datë 20.3.2017; nr. 12, datë 5.3.2012, të Gjykatës Kushtetuese*). Ngarkesa e gjykatave nuk është argument kushtetues që mund të justifikojë mosgjykimin e çështjeve brenda afateve të përcaktuara nga ligjvënësi. Hyrja në fuqi e një ligji kushtëzon hyrjen në fuqi të normave të prodhuara prej tij ose, e thënë ndryshe, zbatueshmërinë e tyre nga ana e të gjitha organeve, përveç rasteve kur ligji parashikon ndryshe. Në të kundërt është detyrë e ligjvënësit të marrë masat dhe të gjejë mjetet e duhura për ndryshimin e gjendjes faktike (vonesës në shqyrtimin e çështjeve në Gjykatën e Lartë), me qëllim që ligjet të zbatohen dhe gjykatat e të gjitha niveleve të funksionojnë normalisht (*shih vendimet nr. 81, datë 28.12.2015; nr. 69, datë 17.11.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

71. GJEDNJ-ja në jurisprudencën e saj ka mbajtur qëndrimin se akumulimi i përkohshëm i çështjeve nuk e ngarkon shtetin me përgjegjësi, me kusht që ky i fundit të ketë ndërmarrë veprime të menjëhershme që synojnë përmirësimin e situatës për të zgjidhur një situatë të jashtëzakonshme të këtij lloji (*shih Buchholz kundër Gjermanisë*, 6 maj 1981, § 51). Metodatat që mund të nxisin përkohësisht përsheptimin janë ato kur për gjykimin e çështjeve ndiqet një radhë e caktuar e bazuar jo vetëm në datën e depozitimit të tyre, por edhe në nivelin e urgjencës dhe rëndësisë së tyre, dhe, në veçanti, të vlerësimit të asaj që përbën rrezik për personat në fjalë. Megjithatë, nëse një zgjidhje e këtij lloji rezulton në tejzgjatje dhe kthehet në një problem të organizimit strukturor, atëherë këto metoda nuk janë më të mjaftueshme dhe shteti duhet të sigurojë miratimin e masave më efektive (*shih Guincho kundër Portugalisë*, 10 korrik 1984, § 40; *Zimmermann dhe Steiner kundër Zvicrës*, 13 korrik 1983, § 29). Fakti që numri i lartë i çështjeve të tilla të prapambetura është bërë i zakonshëm, nuk e justifikon tejzgjatjen



e proceseve gjyqësore (*shih Unión Alimentaria Sanders S.A. kundër Spanjës, 7 korrik 1989, § 40*).

72. Gjykata pranon faktin se interpretimi rast pas rasti i nenit 399/2, pika 3, të KPC-së i takon Gjykatës së Lartë, por po ashtu sikurse është shprehur GJEDNJ-ja, nëse efektet e reformave të vazhdueshme të sektorit të drejtësisë në funksionimin e Gjykatës së Lartë nuk do të llogariteshin në kohëzgjatjen e përgjithshme të procedurave, një qasje e tillë nuk do të ishte në përputhje me praktikën gjyqësore të saj për “afatin e arsyeshem” sipas nenit 6 § 1, pasi mund të zhvendosë te palët ndërgjyqëse barrën e plotë të çdo vonese të shkaktuar nga reformat në sektorin e drejtësisë (*shih Bara dhe Kola kundër Shqipërisë, § 71*).

73. Gjykata, referuar Raportit mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e Këshillit të Lartë Gjyqësor për vitin 2020, konstaton se në Gjykatën e Lartë janë regjistruar afërsisht 38,000 çështje të prapambetura në pritje të shqyrtimit, ngarkesë e krijuar edhe nga mosfunksionimi i kësaj gjykate për periudhën maj 2019-mars 2020. Kjo gjykatë aktualisht ka vetëm 9 gjyqtarë, nga 19 gjyqtarë që duhet të ketë në organikën e saj. Megjithatë, Gjykata e Lartë ka marrë hapa konkretë, duke parashikuar një sërë masash me qëllim uljen e numrit të çështjeve të prapambetura brenda një kohe sa më të shpejtë, si: rritja e kapaciteteve njerëzore, inventarizimi i çështjeve, përpunimi deri në shqyrtimin e tyre, përgatitja e planeve të veprimit, me qëllim shqyrtimin e çështjeve sipas kronologjisë kohore dhe specifikës së çështjes (*shih paragrafin 11 të vendimit*).

74. Gjithsesi, referuar edhe jurisprudencës së GJEDNJ-së, Gjykata vlerëson se parashikimi i një reforme të kësaj natyre, sikurse ishte reforma në drejtësi në Shqipëri, nuk mund të justifikojnë vonesat, pasi shtetet janë të detyruara të organizojnë hyrjen në fuqi dhe zbatimin e masave të tilla në një mënyrë që shmangin tejzgjatjen e shqyrtimit të çështjeve në pritje. Është përgjegjësi e shteteve kontraktuese të organizojnë sistemin e tyre gjyqësor, në mënyrë që juridiksionet e tyre mund t’u garantojnë të gjithëve të drejtën për të marrë një vendim përfundimtar për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tyre civile brenda një periudhe të arsyeshme (*shih Zoubar kundër Republikës Çeke, 11 tetor 2005, § 37; Comingersoll S.A. kundër Portugalisë [GC], 6 prill 2000, § 24*).

75. Po ashtu, Komisioni i Venecies ka mbajtur qëndrimin se mungesa e Gjykatës së Lartë mund të jetë edhe më kritike për stabilitetin e Shqipërisë sesa mungesa e Gjykatës Kushtetuese. Sipas tij, [Gjykata e Lartë] nuk mund të japë vendime për çështjet që vijnë nga gjykatat më të ulëta dhe Shqipëria shkel sistematikisht të drejtën për një proces të rregullt ligjor brenda një kohe të arsyeshme. Nëse situata aktuale ndikon edhe në mjetin përshpejtues dhe dëmshpërblyes për kohëzgjatjen e tepruar të procedurave gjyqësore, i cili ka funksionuar në Shqipëri që nga nëntori 2017, kjo mund të çojë në situatën kur shumë çështje të përfundojnë për shqyrtim para GJEDNJ-së (*shih Opinionin e Komisionit të Venecies për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, CDL-AD(2020)010, 19 qershor 2020, § 87*).

76. Nga ana tjetër, Gjykata, në vlerësimin e kohëzgjatjes së përgjithshme të procedurave, vlerëson të tregojë një qasje më të kujdesshme, duke pasur parasysh ndryshimet që solli reforma në sistemin e drejtësisë në vendin tonë dhe efektet e saj, veçanërisht lidhur me plotësimin e numrit të gjyqtarëve në gjykata dhe numrin e madh të çështjeve në pritje për t’u shqyrtuar. Në këtë situatë, Gjykata, ashtu sikundër GJEDNJ-ja, merr në konsideratë dhe njeh faktin se një vend i vogël si ky yni ka vështirësi në plotësimin me burime njerëzore të nevojshme dhe të mjaftueshme të gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih P.H. kundër Irlandës, nr. 45046/16, datë 10 tetor 2017*).

77. Pavarësisht sa më sipër, edhe pse nuk është detyrë e Gjykatës të gjejë zgjidhje e të japë rekomandime, ajo vlerëson se masat e marra nga autoritetet shqiptare nuk janë të mjaftueshme, përderisa procedurat në Gjykatën e Lartë, në rastin konkret, po zgjasin tej afateve të arsyeshme. Gjykata, gjithashtu, merr në konsideratë edhe efektet negative që sjellin reformat, megjithatë e gjithë barra nuk mund të bjerë mbi kërkuesit, sikurse GJEDNJ-ja është shprehur në vendimin *Bara dhe Kola kundër Shqipërisë* (§ 71).

78. Për sa më lart, për sa i takon sjelljes së autoriteteve, Gjykata vlerëson se situata nuk është në nivelet e duhura të eficiencës dhe efikasitetit të masave të deritanishme të marra nga autoritetet që mund të çonin në evitimin e tejzgjatjes së procedurave gjyqësore.

79. Në përfundim, në rastin konkret, edhe pse duket se deri diku ka një tejzgjatje të procesit dhe se



sjellja e kërkuësës nuk ka penguar ecurinë e tij, si dhe për faktin se masat e marra nga autoritetet janë të pamjaftueshme, Gjykata, duke pasur parasysh rrethanat e çështjes, kompleksitetin e saj, rrezikun në një shkallë jo të konsiderueshme për interesin e kërkuësës, si dhe numrin e lartë të çështjeve në Gjykatën e Lartë, në pritje për t'u gjykuar nga një numër i reduktuar gjyqtarësh, vlerëson se nuk ka cenim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosshqyrtimit të çështjes brenda një afati të arsyeshëm. Për rrjedhojë, kërkesa duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, si dhe neneve 71 dhe 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Rrëzimin e kërkesës.

Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 1.11.2021.

Shpallur më 25.11.2021.

Kryetare: Vitore Tusha

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Përparim Kalo, Altin Binaj, Elsa Toska, Sonila Bejtja

VENDIM

Nr. 23-2021-712, datë 27.7.2021

NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, i përbërë nga:

Ilir Panda kryesues;

Albana Boksi anëtare;

Sokol Binaj anëtar;

Sandër Simoni anëtar;

Klodian Kurushi anëtar,

sot, në datë 27.7.2021, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore çështjen penale, që u përket:

KËRKUES: Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar

OBJEKTI: Parashtrim i mosmarrëveshjes së kompetencës drejtuar Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Neni 90 e vijues të Kodit të Procedurës Penale.

Në çështjen penale:

VIKTIMA AKUZUESE: Lulzim Basha

I AKUZUARI: Erion Veliaj

Me pjesëmarrjen e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar

OBJEKTI: Gjykimin e të akuzuarit për veprën penale “Shpifja”, parashikuar nga neni 120/2, të Kodit Penal.

BAZA LIGJORE: Neni 120 i Kodit Penal, nenet 59, 60, 75/b, 83 dhe 89, të Kodit të Procedurës Penale; neni 8/2, i ligjit nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”.

KOLEGJI PENAL I GJYKATËS SË LARTË,

pasi dëgjoi relatimin e gjyqtarit Ilir Panda, mbrojtësit e viktimës akuzuese, Lulzim Basha, që kërkuar nga Kolegji Penal zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës, duke përcaktuar Gjykatën e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar si gjykatë kompetente, mbrojtësit e të akuzuarit, Erion Veliaj, që kërkuar zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës, duke përcaktuar Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë si gjykata kompetente, prokurorin e Prokurorisë së Posaçme, që kërkoj zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës, duke përcaktuar Gjykatën e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar



si gjykatë kompetente, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Shtetasi Lulzim Basha, me cilësinë procedurale penale të viktimës akuzuese, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me dy kërkesa penale, duke kërkuar gjykimin e të akuzuarit Erion Veliaj për veprën penale “Shpifja”, kryer botërisht, parashikuar nga neni 120, paragrafi i dytë i Kodit Penal, konkretisht me kërkesën penale nr. 115/11 akti, datë 5.10.2020 dhe kërkesën penale nr. 117 akti, datë 6.10.2020. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin datë 26.10.2020, ka vendosur bashkimin e këtyre dy kërkesave penale, në bazë të neneve 79 dhe 92, të Kodit të Procedurës Penale, dhe gjykimin e tyre në një të vetme.

2. Nga aktet rezulton se viktimja akuzuese, Lulzim Basha, është Kryetar i Partisë Demokratike të Shqipërisë, ndërsa i akuzuari, Erion Veliaj është Kryetar i Bashkisë Tiranë. Viktimja akuzuese ka pretenduar se i akuzuari, në datën 24.9.2020, ka qenë i ftuar në emisionin “Opinion”, në televizionin kombëtar “Klan”, dhe aty ka shpifur për viktimën akuzuese duke pretenduar edhe se ka prova për to. Gjithashtu, në datën 2.10.2020, ka qenë duke drejtuar fushatën elektorale në Tiranë dhe ka vijuar të thellojë shpifjen në drejtim të viktimës akuzuese. Viktimja akuzuese ka pretenduar se i akuzuari ka konsumuar veprën penale “Shpifja”, duke deklaruar një sërë thëniesh të pavërteta, prandaj i është drejtuar gjykatës me kërkesën objekt gjykimi.

3. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 11 akti, datë 2.2.2021, ka vendosur: “Shpalljen e moskompetencës lëndore të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për gjykimin e çështjes penale nr. 11 Regj. Themeltar, datë regjistrimi 5.10.2020, me viktimë akuzuese Lulzim Basha, të akuzuar Erion Veliaj, për veprën penale “Shpifja”, parashikuar nga neni 120/2 i Kodit Penal.

Dërgimin e akteve Gjykatës së Posaçme së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, si gjykatë kompetente për gjykimin e kësaj çështje penale.”.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, ndër të tjera, ka arsyetuar se në rastin konkret kompetente për gjykimin e kësaj çështje është Gjykata e

Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Kjo pasi, në nenin 75/a, të K. Pr. Penale, nën titullin “Kompetencat e Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar”, parashikohet shprehimisht se: “Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar gjykon: a) krimet e parashikuara nga nenet 244, 244/a, 245, 245/1, 257, 258, 259, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh dhe 319/e; b) çdo veprë penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal; c) akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kryetarit të Bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj; ç) akuzat penale kundër ish-funksionarëve të mësipërm, kur vepra është kryer gjatë ushtrimit të detyrës.”. Gjykata arsyeton se, nga faktet që viktimja akuzuese i atribuon të akuzuarit, rezulton se ky i fundit, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Tiranë, ka shpifur ndaj viktimës akuzuese. Ndodhur në këto kushte, kompetente për ta gjykuar këtë çështje sipas nenit 75/a, germa “c”, të K. Pr. Penale, është Gjykata e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar.

5. Aktet i kanë kaluar Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Përfaqësuesi i të akuzuarit dhe prokuroria kërkuar para gjykatës ngritjen e mosmarrëveshjes së kompetencës para Gjykatës së Lartë, pasi kanë pretenduar se kompetencën lëndore për gjykimin e kësaj çështje e ka Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

6. Gjykata e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, me vendimin nr. 27, datë 11.3.2021, ka vendosur: “Ngritjen para Gjykatës së Lartë të Republikës së Shqipërisë të çështjes së mosmarrëveshjes për kompetencë lëndore në shqyrtimin e çështjes penale nr. 77 Regj. Themeltar, datë 26.2.2021, me viktimë akuzuese Lulzim Basha, të akuzuar Erion Veliaj, për veprën penale “Shpifja”, të parashikuar nga neni 120/2 i Kodit Penal midis Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.”.



7. Gjykata e Posaçme, në ngritjen e mosmarrëveshjes së kompetencës, ndër të tjera, ka arsyetuar se në nenin 135/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili ruan parashikimin e akteve ndërkombëtare për gjykatën e krijuar me ligj, parashikohet se: *“Pushiteti gjyqësor ushtrohet nga Gjykata e Lartë, si dhe nga gjykatat e apelit e gjykatat e shkallës së parë, të cilat krijohen me ligj.”* Në paragrafin e dytë, të nenit 135, po të ligjit themelor, parashikohet se: *“Gjykatat e posaçme gjykojnë veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, si dhe akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kryetarit të Bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj, si dhe akuzat kundër ish-funksionarëve të sipërpërmendur”*.

8. Po në nenin 148/dh/1, të Kushtetutës, përcaktohet se: *“Prokuroria e Posaçme ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën para gjykatave të posaçme të parashikuara në nenin 135, pika 2, të Kushtetutës, si dhe para Gjykatës së Lartë”*. Gjithashtu, formulimi i nenit 75/a, të ligjit procedural penal aktual, me ndryshimet e bëra në ligjin nr. 35/2017, është i ndryshëm në termat e përdorura nga dispozita 75/a/2, e K. Pr. Penale, para ndryshimeve të mësipërme, duke vënë në dukje qëllimin e legjislatorit në përcaktimin e kompetencës lëndore të Gjykatës së Posaçme, duke përfshirë subjektet e posaçme vetëm për akuzat penale, në ndryshim nga kompetenca e Gjykatës së Lartë si gjykatë e juridiksionit fillestar për këto subjekte.

9. Neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale, me ndryshimet aktuale, në paragrafët e tij përshkruan, përdor termat: “krime”, “vepër penale” dhe “akuzë penale”, duke treguar dhe qëllimin e ligjvënësit në këtë detajim, lidhur me përcaktimin e kompetencës lëndore të Gjykatës së Posaçme. Në analizë gramatikore (literale) të termave të përdorur, kjo gjykatë analizon se paragrafi i parë/pika “a”, e nenit 75/a, i referohet termit “krime”, duke përjashtuar kundërvajtjet penale dhe duke mos lënë vend për diskutime, me citimin edhe të dispozitës përkatëse që emërton krimet që janë në kompetencën lëndore të Gjykatës së Posaçme.

10. Paragrafi i dytë/pika “b”, e nenit 75/a, i referohet termit “vepër penale” si term

përgjithësues, por i kryer në një nga format e veçanta të bashkëpunimit (grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur), përkufizimi i të cilave jepet në nenin 28, të Kodit Penal, duke qenë tërësisht i qartë edhe ky parashikim i kompetencës lëndore nga ligjvënësi. Paragrafi i tretë dhe i katërt/pikat “c” dhe “ç”, të nenit 75/a, janë të lidhura mes tyre për shkak të subjekteve që u referohen dhe për shkak të referimit të të njëjtit term “akuzë penale”, e cila përmendet jo vetëm në nenin 75/a të ligjit procedural penal, por edhe në dispozita të tjera të tij, pa përkufizuar kuptimin e termit “akuzë penale” të përdorur.

11. Sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, nisur nga parashikimi i nenit 6, të Konventës Evropiane, koncepti “akuzë penale” ka një kuptim “autonom”, të pavarur prej kategorizimeve të përdorura nga sistemet juridike kombëtare të shteteve anëtare (Adolf k. Austrisë, §30). Koncepti i “akuzës” duhet të merret në kuptimin e Konventës. Prandaj, ai mund të përkufizohet si njoftimi zyrtar i një individi, nga ana e autoritetit kompetent, se mendohet që ka kryer një “vepër penale”, përkufizim ky që varet gjithashtu nga ekzistenca ose jo e “pasojave të rëndësishme në situatën e të dyshuarit” (Deweert k. Belgjikës, §§42 dhe 46; Eckle k. Gjermanisë, §73).

12. Përveç jurisprudencës së GJEDNJ-së, edhe teoria e së drejtës procedurale penale njeh termat akuzë penale dhe akuzë private në procesin penal, duke iu referuar me akuzë penale asaj të përpiluar nga prokurori në ushtrim të ndjekjes penale, në përputhje me funksionin kushtetues dhe procedural të tij, dhe akuzë private atë të ngritur nga viktimat akuzuese ndaj autorit të veprës penale, për vepra penale të parashikuara nga ligji penal. Në vlerësim të kësaj gjykate, mbështetur mbi kuadrin ligjor të analizuar me sipër, parashikimet e të cilit janë në harmoni dhe koherencë mes tyre, Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar nuk është gjykatë kompetente dhe e krijuar me ligj për të gjykuar kërkesat e paraqitura nga viktimat akuzuese ndaj personave të akuzuar, të parashikuara nga neni 59 i Kodit të Procedurës Penale. Kërkesat me viktima akuzuese për veprat penale të parashikuara nga neni 59 i Kodit të Procedurës Penale duhet të gjykohen nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.



13. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, në dhomë këshillimi, meqenëse ndërmjet gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm dhe gjykatës së juridiksionit të posaçëm (GJKKO), si dhe Gjykatës së Lartë kishte qëndrime të ndryshme, në lidhje me çështjen se cila është gjykata kompetente për të shqyrtuar akuzat penale të viktimës akuzuese ndaj një subjekti të posaçëm, të parashikuar nga neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale, me vendimin e datës 4.5.2021, **vendosi kalimin e çështjes penale me nr. 52810-227-2021, datë regjistrimi 30.3.2021, për shqyrtim në seancë gjyqësore, me qëllim njësimin e praktikës gjyqësore në lidhje me çështjen:**

Cila është gjykata kompetente për gjykimin e akuzave penale të viktimës akuzuese ndaj një subjekti të posaçëm, të parashikuar nga neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale?

14. Në seancë gjyqësore, mbrojtësit e viktimës akuzuese, Lulzim Basha, kërkuar nga Kolegji Penal zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës, duke përcaktuar Gjykatën e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar si gjykatë kompetente, duke parashtruar këto argumente:

- Nga përmbajtja e neneve 75/a dhe 75/b, të KPP-së, të bie në sy fakti se kompetenca e gjykimit të kategorisë së subjekteve të posaçme/funksionarëve publikë, të cilët para ndryshimeve me ligjin nr. 35, viti 2017, ishin në kompetencë (juridiksion fillestar) të Gjykatës së Lartë, me shfuqizimin e pikës 2, të nenit 75/b, kompetenca lëndore për gjykimin e tyre i ka kaluar Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Por, ndërsa në nenin 75/b, pika 2, të KPP-së (para ndryshimeve me ligjin 35/2017), ligjvënësi parashikonte “veprat penale” të kryera nga funksionarët publikë, në dispozitën aktuale të nenit 75/a/“c”, të këtij kodi, bën fjalë për “akuza penale” kundër kësaj kategorie të veçantë të subjekteve të veprës penale.

- Dispozitat e Kodit të Procedurës Penale që normojnë ushtrimin e funksioneve të Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar dhe Prokurorisë së Posaçme pranë kësaj gjykate në gjykimin e akuzës penale ndaj funksionarëve publikë, nuk e kufizojnë gjykimin e tyre vetëm me shqyrtimin “akuzës publike” dhe as përjashtojnë “akuzën private”, por, kanë përcaktuar në kompetencë lëndore të asaj gjykate të gjithë “akuzat penale” pa përjashtim, në ngarkim të tyre,

natyrisht kur vepra është kryer gjatë ushtrimit të detyrës.

- Gjykata Kushtetuese, në vendimin nr. 3/2008, ka arritur në përfundimin se përmbajtja e nenit 59/1, të Kodit të Procedurës Penale, nuk bie ndesh me nenin 148/1, të Kushtetutës. Ato plotësojnë njëri-tjetrin në funksion të harmonizimit më të mirë të interesit publik me atë privat. Ligjvënësi ka pasur për qëllim t'i krijojë mundësi individit të çmojë në mënyrë të pavarur shkallën e cenimit të interesave të tij dhe hapat që duhet të ndërmarrë ose jo për mbrojtjen juridike penale ose civile të tyre. Megjithatë, edhe në këto raste, ligji procedural penal nuk e shmang pjesëmarrjen e prokurorit në gjykimin e këtyre çështjeve. Prokurori jo vetëm merr pjesë në gjykimin e të pandehurit, por sipas rastit, kërkon dënimin ose pafajësinë e tij.

- Gjykata e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar e ka pranuar tanimë faktin që është kompetente në shqyrtimin e kësaj kërkesë dhe se sot ndodhemi përpara një praktike të unifikuar dhe të pranuar nga gjykatat e kompetencave të ndryshme. Për rrjedhojë, sot kemi të bëjmë me një praktikë të konsoliduar dhe ndaj ne kërkojmë që në unifikimin e praktikës gjyqësore Gjykata e Lartë të vendosi si gjykatë kompetente, për shqyrtimin e këtyre kërkesave penale, ku i akuzuar është një prej subjekteve të veçanta të ligjit, dhe më konkretisht të nenit 75/a, të Kodit të Procedurës Penale, të jetë Gjykata e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

15. Mbrojtësit e të akuzuarit, Erion Veliaj, kërkuar nga Kolegji Penal zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës, duke përcaktuar Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë si gjykatë kompetente, duke parashtruar këto argumente:

- Në teorinë e të drejtës procedurale penale, ndjekja penale nënkupton kryerjen e të gjitha veprimeve procedurale të parashikuara nga ligji, me qëllim vërtetimin e akuzës së ngritur nga prokurori. Procedimi i personit të akuzuar, për kryerjen e një veprë penale nga organi i ngarkuar me këtë funksion, përfshin hetimin e plotë nga organi i akuzës, mbi bazën e të cilit gjykata do të vendosë fajësinë ose pafajësinë e të dyshuarit për kryerjen e veprës penale. Procedimi penal është tagër e prokurorisë dhe i takon këtij organi, në bazë të nenit 148/1 të Kushtetutës dhe nenit 24/3 të KPP-së, të ushtrojë ndjekjen penale dhe të ngrejë akuzë publike në emër të shtetit, nëse ndodhet para



kryerjes së një vepre penale, të parashikuar si të tillë nga Kodi Penal (shih vendimin nr. 3, datë 6.2.2008, të Gjykatës Kushtetuese).

- Akuza private është akti me të cilin personi i dëmtuar manifeston vullnetin për të iniciuar procedimin penal dhe për të venë para përgjegjësisë autorin e një vepre penale nga e cila personit të dëmtuar, sipas vlerësimit të tij, i kanë ardhur pasoja negative. I dëmtuari akuzues mund të përcaktohet si titullar i interesit juridik të mbrojtur nga norma që pretendohet se është cenuar nga vepra penale dhe KPP-ja i njuh atij cilësinë e “subjektit të procesit” (shih vendimin nr. 27, datë 9.5.2012, të Gjykatës Kushtetuese).

- Sipas nenit 148/dh, të Kushtetutës, Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën përpara gjykatave të posaçme, të parashikuar nga neni 135/2 të Kushtetutës, si edhe para Gjykatës së Lartë. Pra, është Kushtetuta ajo që ka përcaktuar funksionet e prokurorisë për ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzave përpara gjykatës së posaçme.

- Në të gjitha këto raste, akuza e ngritur përpara gjykatës së posaçme përfaqësohet nga Prokuroria e Posaçme pranë kësaj gjykate. Duke qenë kështu, edhe akuzat hetohen në të gjitha fazat nga Prokuroria e Posaçme. Veprat e hetuara janë përgjithësisht të rënda e që e cenojnë së tepërmi rendin publik.

- Në krahasim me akuzat që hetohen nga Prokuroria e Posaçme, akuza private ngrihet për vepra penale me një rrezikshmëri tepër të lehtë shoqërore dhe nuk e cenojnë rendin publik. Sipas nenit 148/dh, paragrafi i parë, i Kushtetutës, ndjekja penale dhe ngritja e akuzës penale ndaj funksionarëve publikë është e drejta ekskluzive e Prokurorisë së Posaçme, kurse ngritja e akuzës private është në tagrin ligjor të çdo personi të dëmtuar dhe kjo kërkon gjithashtu, domosdoshmërisht, praninë e prokurorit.

- Përgjatë zhvillimit të së drejtës procedurale penale, parashikohej se gjykimi i funksionarëve të lartë publikë bëhej në Gjykatën e Lartë, me juridiksion fillestar. Kjo gjykatë gjykonte të gjithë veprat e kryera nga këta funksionarë, pavarësisht nëse akuza ngrihej nga prokuroria apo vetë shtetasi, viktimë akuzuese.

- Rezulton se tashmë është bërë një ndarje në nivel kushtetues, sipas të cilit është Prokuroria e Posaçme ajo që përfaqëson akuzën përpara

gjykatave të posaçme. Në çdo rast tjetër, pra, kur akuza përfaqësohet nga viktimë akuzuese, pikërisht për shkak të këtij parashikimi kushtetues, gjykata e posaçme nuk ka kompetencë që të gjykojë kërkesën e viktimës akuzuese.

- Në këndvështrimin historik apo të shkakut për të cilin janë krijuar organet e hetimit të posaçëm, ky konkluzion është i kuptueshëm dhe logjik, pasi veprat penale që ndiqen me kërkesën e viktimës nuk janë me rrezikshmëri të lartë shoqërore.

- Ligjvënësi ka pasur parasysh se nuk është në interesin publik ushtrimi i ndjekjes penale dhe, sipas rastit, dënimi i autorit të një vepre me pasoja të vogla ose të një mase të tillë që nuk rrezikojnë shëndetin, pasurinë apo jetën e të dëmtuarit. Ligjvënësi është përpjekur të vendosë një balancë sa më të drejtë midis interesave publikë, nga njëra anë, të përfaqësuar dhe të mbrojtura nga prokuroria, dhe interesave private nga ana tjetër, që lidhen ngushtë me individin, dhe që për këtë arsye mund të mbrohen drejtpërdrejt prej tij (shih vendimin nr. 03/2008, i Gjykatës Kushtetuese).

- Në bazë të dispozitave ligjore të sipërcituara, çmujmë se Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar nuk është kompetente për gjykimin e akuzave private ndaj funksionarëve publikë sipas nenit 75/a, të K. Pr. Penale, pasi akuza përpara kësaj gjykate, sipas parashikimit kushtetues, neni 148/dh, përfaqësohet vetëm nga Prokuroria e Posaçme.

16. Prokurori pranë Prokurorisë së Posaçme kërkoi nga Kolegji Penal zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës duke përcaktuar Gjykatën e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar si gjykatë kompetente, duke parashtruar ndër të tjera këto argumente:

- Në rastet kur ndaj një subjekti të posaçëm, të parashikuar nga neni 75/a i Kodit të Procedurës, ndjekja penale ushtrohet nga prokuroria, është krejtësisht e qartë që kompetenca për gjykimin e tij është e Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Por në rastin konkret, pyetja që shtrohet për diskutim është: “A jemi para gjykimit të një akuze penale ndaj shtetasit Erion Veliaj, me funksion Kryetar i Bashkisë Tiranë?

- Kodi Penal, në nenin 120, parashikon “Shpifjen”, si vepër penale. Kjo dispozitë përcakton qartë, në dy paragrafë, anën objektive se si kryhet kjo vepër penale dhe masën konkrete të dënimit për autorët e kryerjes së saj. Kodi



Procedurës Penale, në nenin 59, parashikon që ndjekja penale në rastet e “Shpifjes” ushtrohet me kërkesë të të dëmtuarit (viktima akuzuese). Ndërkohë prokurori merr pjesë në gjykimin e këtyre çështjeve dhe, sipas rastit, kërkon dënimin e të pandehurit ose pafajësinë e tij.

- Për sa më sipër, është krejtësisht e qartë që “Shpifja” është një vepër penale e dënueshme, e parashikuar në Kodin Penal. Për autorët e kryerjes së kësaj veprë penale Kodi Penal parashikon masa konkrete dënimi, të cilat ndryshojnë nga paragrafi i parë në të dytin në varësi të rrethanave të kryerjes së veprës. Kërkesa për fillimin e gjykimit ndaj të pandehurit paraqitet drejtpërdrejt në gjykatë nga i dëmtuari (viktima akuzuese), i cili paraqet dhe provat përkatëse për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar dëmshpërblimin e dëmit. Prokurori merr pjesë në gjykim dhe në përfundim të gjykimit kërkon dënimin e të pandehurit ose pafajësinë e tij.

- Parashikimet e mësipërme ligjore përcaktojnë qartë së në rastet e ndjekjes penale me kërkesë të dëmtuarit (viktima akuzuese), jemi para një situate ku pretendohet se ka ndodhur një vepër penale, por që kërkesën për gjykim dhe paraqitjen e provave e bën i dëmtuari, ndërkohë prokurori merr pjesë pasiv gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në përfundim, në varësi të provave të paraqitura nga i dëmtuari, kërkon para gjykatës dënimin ose pafajësinë e të pandehurit. Kjo lloj zgjidhjeje ligjore është dhënë nga ligjvënësi nisur nga rrezikshmëria më e ulët shoqërore e këtyre veprave penale dhe autorëve të dyshuar, por nga kjo zgjidhje procedurale nuk mund të vihet në dyshim fakti se jemi para një akuze penale kundër një të pandehuri për të cilën do të shprehet me vendim gjykata nëse është fajtor ose i pafajshëm.

- Kodi Procedurës Penale, në nenin 75/a/c, përcakton Gjykatën kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar si gjykatë kompetente për gjykimin e akuzave penale kundër subjekteve të posaçme (në rastin konkret Kryetari i Bashkisë Tiranë). Kjo është e shprehur qartë dhe në asnjë moment nuk përmendet apo nënkuptohet fakti që Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar është kompetente vetëm për shqyrtimin e akuzave penale të paraqitura nga prokuroria dhe jo për ato të paraqitura nga të dëmtuarit (viktima akuzuese).

- Nga sa më sipër, bazuar në nenet 91, 438 dhe 441/2, të Kodit të Procedurës Penale, kërkojmë

njësimin e praktikës gjyqësore duke formuluar rregullin e së drejtës për çështjen e shtruar për zgjidhje: *“Në rastet e gjykimit të akuzave penale të viktimës akuzuese ndaj një subjekti të posaçëm, të parashikuar nga neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale, gjykatë kompetente është Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.”*

II. Vlerësimi i Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë

17. Paraprakisht, vlen të evidentohet fakti i ndryshimeve ligjore që ka pësuar Kodi i Procedurës Penale me ligjin nr. 41/2021, hyrë në fuqi në datën 29.5.2021. Në nenin 38, të ligjit nr. 41/2021, mbi dispozitat tranzitore, parashikohet se: *“1. Përbërja e trupave gjykues, si dhe procedura e gjykimit në Gjykatën e Lartë rregullohet sipas përcaktimeve të këtij ligji, pavarësisht parashikimeve të ndryshme në ligje të tjera. 2. Rekursi e paraqitura, por ende të pasqyrtuara, konsiderohen të pranueshme nëse plotësojnë parashikimet e ligjit në fuqi në kohën e depozitimit të tyre”*. Në kuptim të kësaj dispozite, në lidhje me formimin e trupit gjykues, si dhe procedurën e gjykimit, Kolegji Penal zbaton parashikimet e ligjit nr. 41/2021, ndërsa në lidhje me kushtet e pranueshmërisë së rekursit, i referohet ligjit procedural që ka qenë në fuqi në kohën e depozitimit të tij.

18. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë (në vijim Kolegji) vlerëson se në çështjen në shqyrtim ekziston konflikti për kompetencë, pasi dy gjykata të ndryshme, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (në vijim GJKKO), nuk pranojnë të gjykojnë çështjen e paraqitur, konkretisht kërkesën e paraqitur nga viktima akuzuese, Lulzim Basha, kundër të akuzuarit, Erion Veliaj, sipas nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale (në vijim K. Pr. Penale).

19. Kodi i Procedurës Penale, në kreun II, seksionin V, titulluar “Mosmarrëveshjet për kompetencat”, nenet 89, 90 dhe 91, të Kodit të Procedurës Penale, ka parashikuar rastet e mosmarrëveshjeve, mënyrën e parashtrimit të tyre dhe zgjidhjen e mosmarrëveshjeve për kompetencë. Neni 89/1 i Kodit të Procedurës Penale parashikon: *“Ka mosmarrëveshje, në çdo gjendje a shkallë të procedimit, kur dy a më shumë gjykata në të njëjtën kohë marrin ose nuk pranojnë të marrin për shqyrtim të njëjtën akuzë, që i atribuohet të njëjtë person.”*

20. Neni 90 i këtij Kodi parashikon parashtrimin e mosmarrëveshjes në këtë mënyrë:



“Mosmarrëveshja mund të parashtrohet nga prokurori pranë njëres prej gjykatave në mosmarrëveshje ose nga i pandehuri dhe palët private. Parashtrimi paraqitet në sekretarinë e njëres prej gjykatave në mosmarrëveshje, me kërkesë të shkruar e të motivuar, të cilës i bashkohet dokumentacioni i nevojshëm. 2. Gjykata që ngre çështjen e mosmarrëveshjes, merr vendim, me të cilin i paraqet Gjykatës së Lartë kopjen e akteve të nevojshme për zgjidhjen e saj, duke treguar palët dhe mbrojtësit. 3. Gjykata që ka dhënë vendimin, njofton menjëherë gjykatën në mosmarrëveshje.”

21. Neni 91 e në vijim, i Kodit parashikon: *“1. Mosmarrëveshjet zgjidhen nga Gjykata e Lartë me vendim. Gjykata merr të dhënat, aktet dhe dokumentet që i çmon të nevojshme. 2. Vendimi u komunikohet menjëherë gjykatave në mosmarrëveshje, prokurorive përkatëse, të pandehurit dhe palëve private.”*

22. Kolegji vlerëson se parashtrimi i Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar nuk është i drejtë, prandaj aktet duhet t'i kthehen kësaj gjykate, me qëllim vazhdimin e gjykimit të çështjes, referuar argumentimit që do të trajtohet në vijim. Gjithashtu, Kolegji Penal, në dhomën e këshillimit të datës 4.5.2021, vendosi kalimin e çështjes në seancë gjyqësore, me qëllim njësimin e praktikës gjyqësore, në lidhje me çështjen se cila është gjykata kompetente për të shqyrtuar akuzat penale të viktimës akuzuese ndaj një subjekti të posaçëm, të parashikuar nga neni 75/a, i Kodit të Procedurës Penale. Fillimisht, Kolegji çmon me vend të sqarojë se përse lindi nevoja për njësim të praktikës gjyqësore, në lidhje me çështjen objekt gjykimi, dhe përse është e nevojshme të përcaktohet çështja/çështjet që do të shtrohen për njësim nga Kolegji.

23. Kolegji vlerëson se vendimarrja e tij, në lidhje me çështjen e mësipërme, duhet të shërbejë si vendimarrje njësuere, pasi është konstatuar se ndërmjet gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm dhe gjykatës së juridiksionit të posaçëm, Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (GJKKO), si dhe Gjykatës së Lartë ka qëndrime të ndryshme në lidhje me çështjen se cila është gjykata kompetente për të shqyrtuar akuzat penale të viktimës akuzuese ndaj një subjekti të posaçëm, të parashikuar nga neni 75/a, i Kodit të Procedurës Penale.

24. **Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2021-254, datë 19.3.2021,** ka

vendosur: *“Zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, duke përcaktuar si Gjykatë kompetente për gjykimin e çështjes Gjykatën e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.”* Nga ana tjetër, konstatohet se në Gjykatën e Lartë janë paraqitur një sërë çështjesh për mosmarrëveshje kompetence ndërmjet gjykatave të juridiksionit të përgjithshëm dhe gjykatës së juridiksionit të posaçëm (GJKKO), në lidhje me çështjen e mësipërme. Rezulton se midis këtyre gjykatave ka qëndrime të ndryshme se cila është gjykata kompetente për të shqyrtuar akuzat penale të viktimës akuzuese ndaj një subjekti të posaçëm, të parashikuar nga neni 75/a, i Kodit të Procedurës Penale.

25. Për këto arsye, Kolegji vlerëson se jemi në kushtet që Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duhet të shprehet me një vendimarrje njësuere, konform nenit 438/1, të K. Pr. Penale, që parashikon: *“Kolegji Penal, kryesisht ose me kërkesë të palëve, mund të vendosë nisjen e procedurës së gjykimit për të njëzuar ose ndryshuar praktikën gjyqësore.”*

26. Kolegji Penal, në dhomë këshillimi, vendosi që çështja e shtruar për njësim të praktikës gjyqësore nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë duhet të jetë si më poshtë:

- Cila është gjykata kompetente për gjykimin e akuzave penale të viktimës akuzuese ndaj një subjekti të posaçëm, të parashikuar nga neni 75/a, i Kodit të Procedurës Penale?

27. Pasi trajtoi arsyen e njësimin të praktikës gjyqësore, në lidhje me çështjen e mësipërme dhe çështjen e shtruar për njësim, Kolegji vendos të ndalet në trajtimin e pyetjes njësuere dhe në vijim në zgjidhjen e çështjes konkrete. Në çështjen objekt gjykimi, rezulton se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka shpallur moskompetencën lëndore për gjykimin e çështjes penale, me argumentimin se kemi të bëjmë me një akuzë penale të ngritur ndaj Kryetarit të Bashkisë Tiranë. Ky është një subjekt i posaçëm dhe referuar nenit 75/a, të K. Pr. Penale, kompetencën lëndore për gjykimin e akuzave penale të ngritur ndaj tij, sipas Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, e ka Gjykata e Posaçme.

28. Nga ana tjetër, GJKKO-ja, në parashtrimin e mosmarrëveshjes së kompetencës, ka parashtruar se neni 75/a, i K. Pr. Penale, kur i referohet akuzës



penale nuk përfshin akuzën e ngritur nga viktimat akuzuese, sipas nenit 59, të K. Pr. Penale. Sipas GJKKO-së kjo është akuza private e njohur në të drejtën procedurale penale, e cila nuk përfshihet në kuptimin e akuzës penale që përcakton neni 75/a, i K. Pr. Penale, si kompetencë lëndore e Gjykatës së Posaçme. Kompetencë e saj është gjykimi vetëm i akuzave penale ndaj subjekteve të posaçme, akuza që përfaqësohen në gjykim nga Prokuroria e Posaçme, ndërsa akuzat e tjera të ashtuquajtura private, janë kompetencë e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm.

29. Neni 75/a i K. Pr. Penale (i ndryshuar me ligjin nr. 41/2021) përcakton kompetencën lëndore të Gjykatës kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në këtë mënyrë: *“Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar gjykon: a) krimet e parashikuara nga nenet 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a, 234/b, 244, paragrafi 2, 244/a, 245, 245/1, paragrafi 2 dhe 4, 257, 258, paragrafi 2, 259, paragrafi 2, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh, 319/e, 328 dhe 328/b të Kodit Penal;*

b) çdo veprë penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal;

c) akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kryetarit të Bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj;

d) akuzat penale kundër ish-funksionarëve të mësipërm, kur vepra është kryer gjatë ushtrimit të detyrës.”

30. Në çështjen objekt gjykimi, para Kolegjit shtrohet detyra e interpretimit të termit “akuzë penale” parashikuar nga pika “c” dhe “ç”, e nenit 75/a të K. Pr. Penale. Në kuadër të zgjidhjes drejtë të çështjes objekt gjykimi nga ky Kolegj, lind nevoja për përcaktimin, nëse tek akuza penale e përcaktuar nga neni 75/a i Kodit përfshihen edhe kërkesat e paraqitura nga viktimat akuzuese kundër subjekteve të posaçme, sipas nenit 59 të K. Pr. Penale.

31. Kolegji vlerëson të nevojshëm rikonfirmimin e qëndrimit se kompetenca nuk është gjë tjetër veçse sasia e juridiksionit ose masa e juridiksionit që i është dhënë në ushtrimin e

funksioneve të saj çdo gjykate. Ky Kolegj thekson se kompetenca lëndore përbën një nga parakushtet procedurale, me qëllim që gjykata të marrë në shqyrtim themelin e pretendimeve dhe të prapësimeve të palëve. Mungesa e kompetencës lëndore për një forum gjyqësor bën që çdo veprimtari procedural e kryer prej tij të konsiderohet nul. Shkelja e dispozitave që normojnë këtë lloj kompetence është e tillë që nuk mund të anashkalohet nga gjykata e shkallës së parë që shqyrton çështjen dhe as të vleftësohet nga shkallët më të larta të pushtetit gjyqësor, edhe sikur çështja të jetë zgjidhur drejtë (*shih vendimin nr. 917, datë 11.5.2017, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë*).

32. Kompetenca lëndore është një parakusht procedural, i cili determinon konceptin e gjykatës së krijuar me ligj. “Gjykata e krijuar me ligj” është pjesë e parimit të procesit të rregullt ligjor të parashikuar edhe nga neni 6/1, i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim KEDNJ). Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut, në jurisprudencën e saj të konsoliduar, ka trajtuar kuptimin e “gjykatës së krijuar me ligj”, duke përcaktuar se në kuadër të procesit të rregullt ligjor gjykatat gjithmonë duhet të jenë të krijuara me ligj. Kjo shprehje pasqyron parimin e shtetit të së drejtës që është pjesë e pandarë e sistemit të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, parashikuar nga KEDNJ-ja dhe Protokollet e saj.¹²⁷ Një organ i pa krijuar me ligj, do të privohej nga legjitimiteti i kërkuar në një shoqëri demokratike për të dëgjuar ankesat e individëve.¹²⁸

33. Termi “ligj”, në kuptim të nenit 6/1 të KEDNJ-së, sipas jurisprudencës së GJEDNJ-së, përfshin, në veçanti, jo vetëm legjislacionin që përcakton krijimin dhe funksionimin (kompetencën) e organeve gjyqësore por edhe çdo dispozitë ligjore të legjislacionit të brendshëm që, nëse shkelet, do ta shndërronte pjesëmarrjen e një ose më shumë gjyqtarëve në shqyrtimin e një

¹²⁷ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore, *Jorgic v Germany* nr. aplikimi 74613/01, datë 12.7.2007, paragrafi i 64; *Richert v Poland* nr. aplikimi 54809/07, datë 25.1.2012, paragrafi 41.

¹²⁸ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore, *Lavents v Latvia* nr. aplikimi 58422/00, datë 28.2.2003, paragrafi 114; *Gorgiladze v Georgia*; nr. aplikimi 4313/04, datë 20.10.2009, paragrafi 67; *Kontalexis v Greece* nr. aplikimi 59000/08, datë 21.11.2011, paragrafi 38.



çështje konkrete në një pjesëmarrje të paligjshme.¹²⁹ Shprehja “e caktuar me ligj” përfshin bazën ligjore për ekzistencën e gjykatës, pajtueshmërinë e veprimtarisë së gjykatës me normat e veçanta që rregullojnë veprimtarinë e saj, si dhe përbërja (kompozimi) e gjykatës në çdo rast që ajo merr në shqyrtim.¹³⁰

34. Doktrina dhe jurisprudenca kushtetuese evropiane, ndër vite, kanë përpunuar disa kriterë themelore, për të garantuar që shtetasi do të gjykohej nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme. Para së gjithash, gjykata duhet të jetë e krijuar me ligj, ku të jetë përcaktuar qartë kompetenca lëndore dhe tokësore e saj në shqyrtimin e çështjeve. Me fjalë të tjera, ligji për krijimin e gjykatës duhet t'i paraprijë shqyrtimit të çështjeve konkrete¹³¹ dhe ky është rregulli i përgjithshëm se si një gjykatë e zakonshme merr juridiksion dhe kompetencë për çështjet. Megjithatë në të drejtën pozitive procedurale penale, në fuqi, në Republikën e Shqipërisë nuk parashikohet në mënyrë eksplicite parimi i gjyqtarit natyral të çështjes, dispozitat ligjore në frymën e tyre, parimet kushtetuese dhe sidomos jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese ka pranuar se rendi juridik, një ndër elementet kryesor të gjykatës së caktuar me ligj, ka standardin e gjyqtarit natyral, standard¹³² i cili është nga ana tjetër edhe e drejtë themelore e individit. Qëllimi i krijimit dhe mbrojtjes kushtetuese të kësaj figure shtetërore është të nevojat për të qenë tej çdo dyshimi dhe mundësie e paanshme përgjatë gjithë procesit gjyqësor. Nëpërmjet këtij parimi dhe kësaj figure ligjore të autoritetit shtetëror kompetent për të zgjidhur një mosmarrëveshje, shteti i së drejtës siguron garantimin e mbrojtjes së të drejtave dhe lirive themelore të njeriut nëpërmjet një gjyqtari kompetent, të pavarur dhe të paanshëm.

35. Kjo do të thotë se në momentin kur çdo subjekt është bërë titullar i një procesi gjyqësor dhe përballë tij Republika ka caktuar një gjyqtar apo

trupë gjykuese, që në kohën dhe momentin e caktimit ka marrë juridiksion dhe kompetencë, çdo lloj kompetence, në bazë dhe për zbatim të ligjit, ka garancinë e akteve të gjithëpushtetshme juridike se nuk do të ketë mundësi që ky gjyqtar apo trupë gjykuese të spostohet, ndryshohet (*translatio iudicii*) apo të shndërrohet më vonë *ex ante factum* në gjykatë/gjyqtar pa juridiksion ose jokompetent. Bëjnë përjashtim këtu rastet kur gjykata suprimohet dhe nuk ekziston më apo kur Kushtetuta, marrëveshja ndërkombëtare apo ligji me shumicë të cilësuar, për arsye objektive dhe reformuese të institucioneve të drejtësisë, urdhërojnë në mënyrë eksplicite, nëpërmjet dispozitave tranzitore, ndryshe (*shih vendimin njëses të Kolegji Penal të Gjykatës së Lartë nr. 00-2018-148, datë 4.4.2018*).

36. Duke iu rikthyer çështjes së shtruar për njësim, Kolegji vlerëson se për të përcaktuar në mënyrë të qartë kuptimin e akuzës penale, të përcaktuar nga neni 75/a i K. Pr. Penale, është e nevojshme të ndalet në interpretimin historik, logjik, sistematik e së fundi në interpretimin literal të dispozitës.

37. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e miratuar në vitin 1998, në nenin 141 parashikonte: “Gjykata e Lartë ka juridiksion fillestar dhe risbikues. Ajo ka juridiksion fillestar kur gjykon akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave, deputetëve, gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese.”. Gjykata e Lartë, sipas këtij parashikimi kushtetues, kishte juridiksion fillestar të gjykonte akuzat penale kundër funksionarëve të lartë shtetërorë. Gjykata e Lartë gjykonte të gjitha akuzat penale të ngritura ndaj funksionarëve të lartë shtetërorë, pavarësisht faktit nëse akuza përfaqësohej në gjykim nga Prokuroria e Përgjithshme, apo nëse ishte akuzë me të dëmtuar akuzues, sipas nenit 59, të K. Pr. Penale. Në juridiksionin fillestar që Kushtetuta i kishte dhënë Gjykatës së Lartë nuk është vënë ndonjëherë në diskutim fakti nëse akuzat e ngritura nga viktimat/i dëmtuari akuzues ishin apo jo në kompetencë të saj, pasi çdo akuzë penale e ngritur ndaj subjekteve të posaçme shqyrtohej nga Gjykata e Lartë. Një parashikim i tillë lidhej me garancitë e nevojshme që Kushtetuta ofronte për gjykimin e këtyre subjekteve, për shkak të cilësive të tyre të posaçme dhe funksionit që ushtronin, të lidhur ngushtësisht me interesin publik. Parashikimi kushtetues nuk bënte dallim nëse akuza

¹²⁹ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore, *Pandjickidze and others v Georgia* nr. aplikimi 30323/02, datë 27.1.2010, paragrafi 104.

¹³⁰ Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore, *Posokhov v Russia* nr. aplikimi 63486/00, datë 4.6.2003, paragrafi 39; *Fatullayev v Azerbaijan* nr. aplikimi 40984/07, datë 4.10.2010, paragrafi 144.

¹³¹ Shiko vendimin nr. 31, datë 5.7.2011, të Gjykatës Kushtetuese.

¹³² Shiko vendimin nr. 31, datë 5.7.2011, të Gjykatës Kushtetuese.



përfaqësohej nga Prokuroria e Përgjithshme apo nga një subjekt privat, sipas nenit 59 të K. Pr. Penale.

38. Nga ana tjetër, neni 75/b i K. Pr. Penale, para ndryshimeve të miratuara me ligjin nr. 35/2017, parashikonte: *“Gjykata e Lartë gjykon në shkallë të parë, me trup gjykues të përbërë nga 5 gjyqtarë, të caktuar me short, veprat penale të kryera nga Presidenti i Republikës, deputetët, Kryeministri dhe anëtarët e Këshillit të Ministrave, gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese dhe gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, kur këta janë në këto funksione në kohën e gjykimit.”*

39. Më datë 11.8.2016, hynë në fuqi ndryshimet e Kushtetutës, në kuadër të paketës normative të Reformës në Drejtësi. Referuar këtyre ndryshimeve, rezulton se, aktualisht neni 135 i Kushtetutës parashikon: *“Gjykatat e posaçme gjykojnë veprat penale të korrupsionit dhe të krimit të organizuar, si dhe akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, Kryetarit të Bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj, si dhe akuzat kundër ish-funksionarëve të sipërpërmendur.”*

40. Me ndryshimet e miratuara me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, në dallim nga sa parashikohej më parë në nenin 135 të Kushtetutës së pandryshuar, ndryshimet e kësaj dispozite, në pikën 2, parashikuan krijimin e një gjykate të posaçme penale, kompetenca lëndore e së cilës parashikohej drejtpërdrejtë në Kushtetutë, njëlloj sikurse parashikohej juridiksioni fillestar penal i Gjykatës së Lartë në nenin 141, pika 1, të Kushtetutës së pandryshuar. Më tej ndryshimet kushtetuese prekën edhe nenin 148 të Kushtetutës, ku ndër të tjera u përcaktua edhe kompetenca lëndore e ndjekjes penale dhe përfaqësimit të akuzës në gjyq për prokurorinë. Pika 4, e kësaj dispozite kushtetuese, parashikon se: *“Prokuroria e Posaçme dhe Njësia e Posaçme Hetimore për ndjekjen penale dhe hetimin e veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar dhe çështjeve penale sipas nenit 135, paragrafi 2, të Kushtetutës janë të pavarura nga Prokurori i Përgjithshëm. Njësia e Posaçme Hetimore është në varësi të Prokurorisë së Posaçme.”*

41. Ndryshimet kushtetuese prekën edhe juridiksionin fillestar penal të Gjykatës së Lartë, duke e hequr këtë atribut të ushtrimit të pushtetit gjyqësor nga kjo gjykatë dhe duke e bërë pjesë integrale të juridiksionit të specializuar penal të gjykatës së posaçme, sipas nenit 135, pika 2, të Kushtetutës. Gjithashtu, juridiksioni fillestar i ushtrimit të ndjekjes penale dhe përfaqësimit të akuzës në gjyq i Prokurorisë së Përgjithshme, sipas nenit 141, pika 1, të pandryshuar, të Kushtetutës, i kaloi Prokurorisë së Posaçme.

42. Ky ndryshim i Kushtetutës është pasqyruar edhe në nenin 75/a, të K. Pr. Penale, i ndryshuar me ligjin nr. 35/2017 dhe me ligjin nr. 41/2021, datë 23.3.2021, i cili parashikon se: *“Gjykata për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar gjykon: a) krimet e parashikuara nga nenet 244, 244/a, 245, 245/1, 257, 258, 259, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh dhe 319/e; b) çdo veprë penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal; c) akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave, gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese dhe të Gjykatës së Lartë, Prokurorit të Përgjithshëm, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kryetarit të bashkisë, deputetit, zëvendësministrit, anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, dhe drejtuesve të institucioneve qendrore ose të pavarura të përcaktuara në Kushtetutë ose në ligj; ç) akuzat penale kundër ish-funksionarëve të mësipërm, kur vepra është kryer gjatë ushtrimit të detyrës.”*

43. Nga tërësia e dispozitave të mësipërme, arrihet në përfundimin se juridiksioni fillestar që Kushtetuta parashikonte për Gjykatën e Lartë u suprimua, duke i dhënë asaj të drejtën vetëm të gjykimit të çështjeve, lidhur me zbatimin dhe interpretimin e ligjit, referuar nenit 141/1 të Kushtetutës, që parashikon: *“Gjykata e Lartë shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, sipas ligjit.”*

44. Kolegji vë në dukje se, pas ndryshimeve kushtetuese të miratuara me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, Gjykata e Lartë nuk ka më juridiksion fillestar për gjykimin e akuzave penale ndaj funksionarëve të lartë shtetërorë. Kompetencën lëndore për gjykimin e subjekteve të posaçme e ka Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, kompetencë lëndore që



përcaktohet në nenin 75/a, të K. Pr. Penale. Pra, pas ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore, rezulton se kompetenca që kishte Gjykata e Lartë për të gjykuar: ... *“akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave, deputetëve, gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë dhe gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese ...”*, i ka kaluar Gjykatës së Posaçme, e cila ndër të tjera, gjykon: ... *“akuzat penale kundër Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit, anëtarit të Këshillit të Ministrave”*.

45. Nga interpretimi i mësipërm historik, Kolegji arrin në përfundimin se juridiksioni fillestar për gjykimin e akuzave penale ndaj funksionarëve të lartë shtetërorë i ka kaluar në bllok Gjykatës së Posaçme, e cila, sipas të njëjtit parashikim ligjor, ka të drejtë të gjykojë po akuzat penale të ngritura ndaj këtyre funksionarëve apo akuzat penale kundër ish-funksionarëve të mësipërm, kur vepra është kryer gjatë ushtrimit të detyrës. Në këtë linjë arsyetimi, në kushtet kur Gjykata e Lartë gjykonte çdo akuzë penale ndaj funksionarëve të lartë shtetërorë, pavarësisht nëse ajo përfaqësohej nga Prokuroria e Përgjithshme apo ngrihej nga i dëmtuari akuzues edhe Gjykata e Posaçme aktualisht ka kompetencë lëndore të gjykojë të gjitha akuzat penale të ngritura ndaj këtyre funksionarëve të lartë shtetërorë, pa u bërë një diferencim, në lidhje me akuzat e ngritura nga viktimat akuzuese, sipas nenit 59, të K. Pr. Penale.

46. Përfundimi i mësipërm arrihet nga Kolegji edhe po të bëhet interpretimi logjik i dispozitave të mësipërme, duke identifikuar qëllimin e ligjvënësit në bërjen e ndryshimeve kushtetuese dhe ligjore. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar rregullohet me ligjin nr. 98/2016, *“Për organizimin e pushtetit gjyqësor në Republikën e Shqipërisë”*. Qëllimi i krijimit të kësaj gjykate ishte krijimi i një gjykate të juridiksionit të posaçëm, e cila do të gjykonte një kategori të caktuar veprash penale që kanë një rrezikshmëri të theksuar shoqërore, për të cilat lindi nevoja për t'u gjykuar nga një gjykatë e posaçme, në kuadër të nevojës për të luftuar korrupsionin dhe veprat penale në fushën e krimit të organizuar, prioritet i shtetit shqiptar, në kuadër të paketës ligjore për reformimin e drejtësisë.

47. Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar u krijua në radhë të parë si një gjykatë veprash, pra me qëllimin për të

gjykuar një kategori të caktuar veprash penale me rrezikshmëri të lartë shoqërore dhe që cenojnë dukshëm rendin publik; krimet e parashikuara nga nenet 230, 230/a, 230/b, 230/c, 230/ç, 231, 232, 232/a, 232/b, 233, 234, 234/a, 234/b, 244, paragrafi 2, 244/a, 245, 245/1, paragrafët 2 dhe 4, 257, 258, paragrafi 2, 259, paragrafi 2, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh, 319/e, 328 dhe 328/b, të Kodit Penal, si dhe çdo veprë penale e kryer nga grupi i strukturuar kriminal, organizata kriminale, organizata terroriste dhe banda e armatosur, sipas përcaktimeve të Kodit Penal.

48. Së dyti, Gjykata e Posaçme u krijua si një gjykatë subjektsh, pasi kjo gjykatë ka kompetencë të gjykojë të gjitha akuzat penale të kryera nga funksionarët e lartë shtetërorë ose ish-funksionarët e lartë, në rast se veprat penale për të cilat akuzohen janë kryer gjatë kohës që ata kanë qenë në ushtrim të detyrës. Ligjvënësi ka përcaktuar gjykimin e akuzave penale ndaj këtyre subjekteve të posaçme dhe nuk rezulton të ketë bërë dallim, në varësi të faktit se kush e përfaqëson akuzën në gjyq, Prokuroria e Posaçme apo viktimat akuzuese, pasi qëllimi i ligjvënësit ka qenë që Gjykata e Posaçme të gjykonte funksionarët e lartë shtetërorë. Kolegji çmon që në kushtet kur ligjvënësi nuk ka bërë dallim në këtë drejtim, atëherë një dallim i tillë nuk mund të bëhet as nga gjykatat, pasi një interpretim i tillë do të ishte tejkalim i parashikimit ligjor dhe gjithashtu i qëllimit që ka pasur ligjvënësi në ndryshimet thelbësore që miratoi me paketën e Reformës në Drejtësi.

49. Së fundmi, Kolegji çmon të nevojshme të kalohet tek interpretimi sistematik dhe literal i dispozitave procedurale penale, për të arritur në një konkluzion të qartë se çfarë do të konsiderohet akuzë penale ndaj funksionarëve të lartë shtetërorë, sipas përcaktimit të bërë në nenin 75/a, të K. Pr. Penale.

50. Neni 148/1, i Kushtetutës parashikon: *“Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit. Prokuroria kryen edhe detyra të tjera të caktuara me ligj.”* Nga ana tjetër, paragrafi 4 i kësaj dispozite parashikon se: *“Prokuroria e Posaçme dhe Njësia e Posaçme Hetimore për ndjekjen penale dhe hetimin e veprave penale të korrupsionit, krimit të organizuar dhe çështjeve penale sipas nenit 135, paragrafi 2, të Kushtetutës, janë të pavarura nga Prokurori i*



Përgjithshëm. Njësia e Posaçme Hetimore është në varësi të Prokurorisë së Posaçme.”

51. Neni 24/1, i K. Pr. Penale parashikon: *“Prokurori ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit, drejton dhe kontrollon hetimet paraprake dhe veprimtarinë e policisë gjyqësore, si dhe kryen vetë çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm, merr masa për ekzekutimin e vendimeve penale, mbikëqyr ekzekutimin e tyre, si dhe ushtron funksionet e bashkëpunimit gjyqësor me autoritetet e huaja, sipas rregullave të caktuara në këtë Kod.”* Neni 25 i K. Pr. Penale parashikon se: *“Për veprat penale të parashikuara nga neni 75/a, i këtij Kodi, funksionet, sipas nenit 24, të tij, ushtrohen në të gjitha shkallët e gjykimit nga prokurorët e Prokurorisë së Posaçme.”*

52. Neni 4, i ligjit nr. 95/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar”, parashikon: *“Prokuroria e Posaçme ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në emër të shtetit para Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Gjykatës së Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, dhe Gjykatës së Lartë, merr masa dhe mbikëqyr ekzekutimin e vendimeve penale, si dhe kryen detyra të tjera të ngarkuara me ligj.”*

53. Neni 8, i ligjit të mësipërm, parashikon se: *“Kompetenca lëndore parësore e gjykatave kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar parashikohet në nenin 75/a, të Kodit të Procedurës Penale, por nuk mund të tejkalojë kompetencën e përcaktuar nga neni 135, pika 2, të Kushtetutës. 2. Gjykata kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Prokuroria e Posaçme janë kompetente për të shqyrtuar, hetuar dhe ndjekur penalisht çdo veprë penale, sipas pikës 1, të këtij neni, edhe në rastet kur nuk ngrihet akuzë kundër një zyrtari, sipas nenit 135, pika 2, të Kushtetutës, ose kundër një drejtuesi të një institucioni qendror ose të pavarur, sipas këtij ligji, ose nëse ai zyrtar publik ose zyrtar i lartë largohet gjatë kohëzgjatjes së hetimit.”*

54. Referuar parashikimeve të mësipërme, Prokuroria e Posaçme ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson në gjyq akuzën penale për veprat penale që janë në kompetencë të GJKKO-së, sipas përcaktimit të bërë në nenin 75/a, të K. Pr. Penale. Nga ana tjetër, ligjvënësi për një kategori të caktuar veprash penale parashikon të drejtën e viktimës akuzuese për të paraqitur kërkesë në gjykatë, me qëllim për të marrë pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit, sipas nenit 59, të K. Pr. Penale që

parashikon: *“1. Ai që është dëmtuar nga veprat penale të parashikuara nga nenet 90, 91, 92, 112, paragrafi i parë, 119, 119/b, 120, 121, 122, 125, 127, dhe 254, të Kodit Penal, ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatë dhe të marrë pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit.”*

2. Prokurori merr pjesë në gjykimin e këtyre çështjeve dhe, sipas rastit, kërkon dënimin e të pandehurit ose pafajësinë e tij.”

55. Ligjvënësi parashikon se, për një kategori të caktuar veprash penale, viktimat akuzuese ka të drejtë të paraqitet vet në gjykim duke pasur si barrë prove vërtetimin e akuzës së ngritur prej tij. Veprat penale për të cilat parashikohet paraqitja e kërkesës nga viktimat akuzuese janë vepra penale me një rrezikshmëri më të ulët shoqërore, prandaj ligji parashikon se për këto kategori veprash penale është vet viktimat akuzuese që paraqitet në gjyq dhe provon akuzën e ngritur prej saj. Nga ana tjetër, prokurori merr pjesë në gjykimin e këtyre çështjeve dhe, sipas rastit, kërkon dënimin e të pandehurit ose pafajësinë e tij.

56. Nga interpretimi sistematik i dispozitave të K. Pr. Penale, rezulton se procesi gjyqësor penal fillon në bazë të depozitimit në Gjykatë:

- Të kërkesës së prokurorit, i cili në bazë të nenit 148/1 të Kushtetutës, ushtron ndjekjen penale dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit (neni 24/1, i K. Pr. Penale); për veprat penale të parashikuara nga neni 75/a, i këtij Kodi, funksionet, sipas nenit 24, të tij, ushtrohen në të gjitha shkallët e gjykimit nga prokurorët e Prokurorisë së Posaçme (neni 25 i këtij Kodi);

- Me kërkesë të viktimës akuzuese (në referim të nenit 60, të K. Pr. Penale) për kategorinë e veprave penale të parashikuara shprehimisht në nenin 59 të këtij Kodi.

57. Në lidhje me kërkesën e paraqitur nga viktimat akuzuese, sipas nenit 59, të K. Pr. Penale, **Gjykata Kushtetuese, me vendimin nr. 3, datë 6.2.2008**, me objekt: “Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i nenit 59/1 të Kodit të Procedurës Penale”, ka vendosur: “Rrëzimin e kërkesës”.

58. Në arsyetimin e këtij vendimi, ndër të tjera, theksohet se: “... si akuzat publike ashtu edhe akuzat private të parashikuara nga legjislacioni procedural penal janë dy mekanizma që shërbejnë për ndjekjen penale të autorit të veprës penale dhe në asnjë rast ato nuk kanë për qëllim eliminimin e njëra-tjetres. Ato bashkëveprojnë dhe në



raste të caktuara gjejnë zbatim veçmas. Gjykata Kushtetuese rithekson se në asnjë rast akuzë publike nuk mund të shmanget. Ajo ushtrohet sa herë që prokuroria krijon bindjen se vepra e kryer cenon rendin publik apo interesin e shoqërisë. Këtë prokuroria e bën edhe duke ndërhyrë në procesin e inicuar nga i dëmtuari akuzues. (neni 59/2 i Kodit të Procedurës Penale).

.... në rastet e parashikuara nga neni 59/1, nuk përjashtohet tërësisht pjesëmarrja e prokurorit. Ai ka të drejtë, që gjatë gjykimit të këtyre çështjeve të marrë pjesë duke kërkuar, sipas rastit, fajësinë ose jo të të pandehurit. Përjashtimi i hetimit paraprak nga këto çështje dhe lejimi i të dëmtuarit akuzues për të ngritur akuzë nuk është marrje e kompetencave të prokurorit, por thjesht dhënie e mundësisë të dëmtuarit për të qenë aktiv në një proces ku ai është i interesuar drejtpërdrejtë.

... Nga sa më sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se përmbajtja e nenit 59/1 të Kodit të Procedurës Penale nuk bie ndesh me nenin 148/1 të Kushtetutës. Ato plotësojnë njëri-tjetrin në funksion të harmonizimit më të mirë të interesit publik me atë privat. Ligjvënësi ka pasur për qëllim t'i krijojë mundësi individit të çmojë në mënyrë të pavarur shkallën e cenimit të interesave të tij dhe hapat që duhet të ndërmarrë ose jo për mbrojtjen juridike penale ose civile të tyre. Megjithatë, edhe në këto raste, ligji procedural penal nuk e shmang pjesëmarrjen e prokurorit në gjykimin e këtyre çështjeve. Prokurori jo vetëm merr pjesë në gjykimin e të pandehurit, por sipas rastit, kërkon dënimin ose pafajësinë e tij”.

59. Kolegji çmon të nevojshëm edhe trajtimin e mjetit procedural, kërkesën e viktimës akuzuese, parashikuar nga neni 59, i K. Pr. Penale. Së pari, Kolegji vë në dukje se termi akuzë private nuk është një term i parashikuar nga Kushtetuta dhe as nga ligji. Ky term është zhvilluar dhe përpunuar në doktrinën dhe teorinë e të drejtës procedurale penale dhe i referohet kërkesës që paraqitet në gjykim nga viktimat/i dëmtuari akuzues, i cili ka detyrimin të përfaqësojë akuzën e ngritur prej tij, si dhe barrën e provës për ta provuar atë. Referuar nenit 59, të K. Pr. Penale, prokurori merr pjesë në gjykimin e këtyre çështjeve dhe, sipas rastit, kërkon dënimin e të pandehurit ose pafajësinë e tij. Nga ana tjetër, prokurori në këtë gjykim nuk përfaqëson akuzën dhe as ka barrën e provës për ta provuar atë. Arsyeja e një parashikimi të tillë ligjor lidhet me kategorinë e veprave penale, që parashikohen nga neni 59, i K. Pr. Penale, të cilat më shumë se interesin publik cenojnë interesin privat të viktimës akuzuese, në funksion të harmonizimit më të mirë

të interesit publik me atë privat. Me anë të këtij mjeti procedural, ligjvënësi ka pasur për qëllim t'i krijojë mundësi individit të çmojë në mënyrë të pavarur shkallën e cenimit të interesave të tij dhe hapat që duhet të ndërmarrë ose jo për mbrojtjen juridike penale ose civile të tyre (*shih vendimin më sipër të Gjykatës Kushtetuese*).

60. Neni 59, i K. Pr. Penale, ka për qëllim t'i krijojë mundësi individit të çmojë në mënyrë të pavarur shkallën e cenimit të interesave të tij dhe hapat që duhet të ndërmarrë ose jo për mbrojtjen juridike penale ose civile të tyre. Ligjvënësi, me parashikimin e institutit të akuzës private, është përpjekur të vendosë një balancë sa më të drejtë midis interesave publikë, nga njëra anë, të përfaqësuara dhe të mbrojtura nga prokuroria, dhe interesave privatë, nga ana tjetër, që lidhen ngushtë me individin dhe që për këtë arsye mund të mbrohen drejtpërdrejt prej tij.

61. Neni 59, i K. Pr. Penale zbatohet vetëm për veprat penale që parashikohen nga nenet 90, 91, 92, 112, paragrafi i parë, 119, 119/b, 120, 121, 122, 125, 127, dhe 254 të Kodit Penal, të cilat përmenden në mënyrë taksative në paragrafin e parë të nenit 59. Këto vepra penale karakterizohen nga mungesa e rrezikshmërisë së lartë shoqërore dhe interesi i vogël publik në çështjen konkrete. Sa më serioze të jetë vepra penale ose sa më i madh të jetë rreziku për vepra penale të përshkallëzuara, aq më tepër duhet që ndjekja penale të vazhdojë kryesisht, në interes publik, edhe sikur viktimat t'i kenë tërhequr kallëzimet e tyre.

62. Në vijim të arsyetimit të mësipërm, Kolegji vlerëson se dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, që normojnë ushtrimin e funksioneve të Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe Prokurorisë së Posaçme pranë kësaj gjykate në gjykimin e akuzës penale ndaj funksionarëve publikë, nuk e kufizojnë gjykimin e tyre vetëm me shqyrtimin “akuzës publike” dhe as përjashtojnë “akuzën private”, siç parashtrohet nga GJKKO-ja në mosmarrëveshjen për kompetencë, por kanë përcaktuar në kompetencë lëndore të asaj gjykate të gjithë “akuzat penale” pa përjashtim në ngarkim të funksionarëve të lartë shtetërorë, sipas përcaktimit të nenit 75/a të Kodit, natyrisht kur vepra penale është kryer gjatë ushtrimit të detyrës.

63. Kolegji çmon se pavarësisht rrezikshmërisë më të ulët shoqërore që kanë veprat penale të



parashikuara nga neni 59, i K. Pr. Penale, këto vepra penale do të gjykohen nga Gjykata e Posaçme, pikërisht për shkak të faktit se janë akuza penale që ngrihen ndaj subjekteve të posaçme, me funksione të larta shtetërore, të lidhura drejtpërdrejt me interesin publik. Kompetencën Gjykata e Posaçme, në rastin e pikës “c” dhe “ç”, të nenit 75/a, të Kodit, e merr pikërisht për shkak se i akuzuar është subjekti i posaçëm dhe nuk kushtëzohet nga lloji i veprës penale apo ndaj faktit se kush e përfaqëson akuzën në gjykim. Në rast se ligjvënësi do të kishte pasur një qëllim të tillë, ai do e kishte parashikuar, siç ka bërë ndarjen në varësi të llojit të veprës penale në pikën “a”, të nenit 75/a të K. Pr. Penale.

64. Kolegji çmon se është e vërtetë se GJEDNJ-ja, në çështjen Deweer kundër Belgjikës, është shprehur se “akuza”, në kuptimin e nenit 6§1, mund të përkufizohet si “*njoftimi zyrtar i një individi, nga ana e autoritetit kompetent, se mendohet që ka kryer një veprë penale*”, megjithatë ky vendim duhet të interpretohet sipas kontekstit të dhënë nga kjo Gjykatë. GJEDNJ-ja, në këtë vendim, por edhe në vendime të tjera, ka mbajtur qëndrimin se një person i ndaluar dhe i detyruar për t’u betuar, përpara se të merrej në pyetje në cilësi dëshmitari, ishte tashmë objekt i një “akuze penale” dhe përfitonte nga e drejta për të heshtur (Brusco kundër Francës, §§46–50). Sipas GJEDNJ-së nuk është përfaqësimi i akuzës nga prokuroria që kushtëzon faktin nëse ka një akuzë të ngritur ndaj të akuzuarit apo jo. Akuza është e tillë, pavarësisht se përfaqësohet nga organi publik apo një subjekt privat. Akuza i referohet atribuimit ndaj të akuzuarit të kryerjes së një veprë penale, e cila sjell pasoja ndaj të akuzuarit, në lidhje me të drejtat apo liritë e tij personale.

65. Për sa i përket kuptimit autonom të termit “penal”, sipas GJEDNJ-së, Konventa nuk u kundërvihet prirjeve për “depenalizim” që hasen brenda shteteve kontraktuese. Megjithatë, veprat që pas depenalizimit klasifikohen si “shkelje administrative” mund t’i përkasin kuptimit autonom të veprës “penale”. Lënia në dorë të shteteve e kompetencës për t’i përjashtuar këto vepra mund të sillte rezultate të papajtueshme me objektin dhe qëllimin e Konventës (Öztürk k. Gjermanisë, §49).

66. Gjithashtu, GJEDNJ-ja ka arsyetuar se pikënisja e shqyrtimit të zbatueshmërisë së pjesës

penale të nenit 6 të Konventës, mbështetet te kriteret e parashtruara në vendimin *Engel me të tjerë k. Vendeve të Ulët*, §§82–83, kriteret që janë:

1. Cilësimi në të drejtën e brendshme;
2. Natyra e veprës;
3. Ashpërsia e dënimit që rrezikon t’i jepet personit të interesuar.

67. Kriteri i parë është me peshë relative dhe shërben vetëm si pikënisje. Vendimtare është të shihet nëse një veprë klasifikohet apo jo si veprë penale nga e drejta e brendshme. Në mungesë të këtij klasifikimi, Gjykata do të shohë se çfarë ka prapa klasifikimit kombëtar, duke marrë në shqyrtim realitetin substancial të procedurës në fjalë. Kriteri i dytë dhe ai i tretë, që parashtrohen në vendimin *Engel me të tjerë k. Vendeve të Ulët*, janë alternativë dhe jo medoemos të bashkueshëm; që neni 6 të gjykohet i zbatueshëm, mjafton që vepra në fjalë të konsiderohet, për vetë natyrën e saj, si “penale” nga këndvështrimi i Konventës ose që vepra ta bëjë personin subjekt për një sanksion, i cili, për vetë natyrën dhe shkallën e tij të ashpërsisë, i takon përgjithësisht sferës “penale” (*Lautz k. Gjermanisë*, §55; *Öztürk k. Gjermanisë*, §54).

68. Sipas GJEDN-së, fakti që një veprë mund të mos jetë e dënueshme me masë burgimi nuk është në vetvete vendimtar, sepse dobësia relative e masës së parashikuar të dënimit nuk e zhvesh një veprë nga karakteri i saj i brendshëm penal (*po aty*, §53; *Nicoleta Gheorghe k. Rumanisë*, §26). Megjithatë, mund të zgjidhet një qasje bashkuese në qoftë se një analizë më vete e secilit kriter nuk jep mundësi për të arritur në një përfundim të qartë, për sa i përket ekzistencës së një akuze në fushën penale (*Bendenoun k. Francës*, §47). Duke përdorur shprehjet “akuzë penale” dhe “i akuzuar për një veprë”, tre paragrafët e nenit 6 u referohen situatave identike. Për rrjedhojë, sipas GJEDNJ-së kriteri i zbatueshmërisë së nenit 6, në pjesën e tij penale, është i njëjti për të tre paragrafët.

69. Sa më sipër, duke marrë në konsideratë kriteret e përcaktuara nga GJEDNJ-ja si të rëndësishme në përcaktimin nëse kemi një akuzë penale, në kuptim të nenit 6 të Konventës, arrihet në përfundimin se edhe kërkesa me të dëmtuar akuzues përfshihet në konceptin e akuzës penale. Prandaj, edhe në vështrim të praktikës së GJEDNJ-së, Kolegji vlerëson se akuza penale përfshin si koncept si akuzën e përfaqësuar në gjykim nga prokuroria, ashtu edhe kërkesën e



paraqitur nga viktimat akuzuese, sipas nenit 59 të K. Pr. Penale.

70. Duke iu rikthyer kuadrit ligjor shqiptar, referuar interpretimit historik të dispozitave kushtetuese dhe atyre procedurale penale, para ndryshimeve të vitit 2016–2017, rezulton se juridiksioni fillestar për akuzat penale ndaj funksionarëve të lartë shtetërorë iu suprimua Gjykatës së Lartë dhe i kaloi një gjykatë të posaçme, Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Kjo gjykatë u krijua si një gjykatë e posaçme për gjykimin e veprave penale të parashikuar nga neni 75/a, paragrafi 1 dhe 2, i K. Pr. Penale, si dhe gjykatë që do të gjykonte subjekte të posaçme, konkretisht ata të parashikuar në paragrafin 3, të nenit 75/a, të Kodit.

71. Pra, rezulton se pas ndryshimeve kushtetuese, të miratuara me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, të pasuara me ndryshimet ligjore, juridiksioni fillestar i Gjykatës së Lartë i kaloi Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Në kushtet kur Gjykata e Lartë gjykonte të gjitha akuzat penale ndaj funksionarëve të lartë shtetërorë, pa u bërë dallimi nëse akuza përfaqësohej nga prokuroria apo nga viktimat akuzuese, Kolegji çmon se nuk ka arsye pse një dallim i tillë të bëhet tani që kompetencën lëndore për gjykimin e subjekteve të posaçme e ka Gjykata e Posaçme. Për më tepër, ky dallim nuk mund të bëhet për aq kohë sa nuk e bën vet ligji.

72. Pranimi i interpretimit të bërë nga Gjykata e Posaçme do të cenonte garancitë e vendosura nga vet Kushtetuta dhe ligji, që një kategori e subjekteve të posaçme të gjykoheshin jo nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, por nga një gjykatë e juridiksionit të posaçëm, e krijuar enkas për të ofruar garanci shtesë, në drejtim të garantimit të procesit të rregullt ligjor dhe një vendimmarrje të drejtë. Në kushtet kur vet ligjvënësi nuk ka bërë një dallim të tillë, interpretimi tej parashikimit kushtetues dhe ligjor do të cenonte jo vetëm parimin e ligjshmërisë, por edhe atë të ndarjes dhe balancimit të pushteteve.

73. Në mbështetje të këtij arsyetimi të Kolegjit vjen edhe interpretimi logjik, sipas qëllimit që ka pasur ligjvënësi kur ka bërë ndryshimet kushtetuese dhe ato ligjore. Krijimi i Gjykatës së Posaçme, si një gjykatë subjektive, që do të gjykonte funksionarët e lartë shtetërorë, kishte si qëllim ofrimin e

garancive shtesë që një kategori e veçantë subjektsh, për shkak të funksionit që mbajnë, e lidhur kjo drejtpërdrejtë me interesin publik, të gjykohen nga një gjykatë e posaçme, që ofron garanci shtesë si për sa i përket përbërjes së saj, mënyrës së zgjedhjes së gjyqtarëve dhe në funksion të rritjes së standardit të procesit të rregullt ligjor. Qëllimi i ligjvënësit ka qenë që juridiksioni fillestar që ushtronte Gjykata e Lartë t'i kalonte një gjykatë të posaçme dhe nuk rezulton që ligjvënësi të ketë bërë diferencim të kompetencave lëndore të Gjykatës së Posaçme, në varësi të faktit se kush e përfaqësonte akuzën në gjykim. Në kushtet kur vet ligjvënësi nuk ka bërë një dallim të tillë, Kolegji vlerëson se arsyetimi i Gjykatës së Posaçme, në ngritjen e mosmarrëveshjes së kompetencës, është një tejkalim i parashikimit ligjor.

74. Kolegji çmon se Gjykata e Posaçme ka interpretuar në mënyrë të ngushtuar, duke i dhënë nenit 75/a, paragrafët 3 dhe 4, një kuptim të ndryshëm nga ai që i ka dhënë ligjvënësi. Ligjvënësi ka përcaktuar se gjykata e posaçme gjykon akuzat penale ndaj funksionarëve të lartë shtetërorë dhe nuk përcakton se kompetenca i referohet vetëm akuzës që përfaqëson në gjykim Prokuroria e Posaçme. Në kushtet kur Kodi i Procedurës Penale parashikon se akuza në gjykim përfaqësohet nga prokuroria, por mund të ketë edhe kërkesë nga viktimat akuzuese, Kolegji vlerëson se kur i akuzuari është një nga subjektet e posaçme, të parashikuara nga neni 75/a i K. Pr. Penale, kompetenca lëndore për gjykimin e këtyre akuzave i përket Gjykatës së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar.

75. Sa më sipër, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, vlerëson që lidhje me pyetjen e shtruar për njësim, duhet të arrihet në këtë përfundim njësim:

Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar është kompetente për shqyrtimin e të gjitha akuzave penale të ngritura ndaj një subjekti të posaçëm të parashikuar nga neni 75/a i Kodit të Procedurës Penale. Gjykata e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar është kompetente për shqyrtimin e akuzave penale në të cilat akuza në gjykim përfaqësohet nga prokuroria, si dhe për gjykimin e akuzave penale të viktimës akuzuese, të ngritura ndaj një subjekti të posaçëm, sipas nenit 59 të K. Pr. Penale.



76. Në lidhje me zgjidhjen e çështjes objekt gjykimi, referuar përfundimit të mësipërm njësues, Kolegji Penal vendos zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës lëndore ndërmjet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për shqyrtimin e çështjes penale me nr. 227-2021 Regj. Themeltar, datë regjistrimi 30.3.2021, me viktimë akuzuese Lulzim Basha, kundër të akuzuarit Erion Veliaj për veprën penale “Shpifja”, parashikuar nga neni 120/2 i Kodit Penal, duke përcaktuar Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, si gjykata kompetente për shqyrtimin e çështjes.

PËR KËTO ARSYE:

Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbështetur në nenin 91 të Kodit të Procedurës Penale,

VENDOSI:

1. Zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës lëndore ndërmjet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për shqyrtimin e çështjes penale me nr. 227-2021 Regj. Themeltar, datë regjistrimi 30.3.2021, me viktimë akuzuese Lulzim Bashën, kundër të akuzuarit Erion Veliaj për veprën penale “Shpifja”, parashikuar nga neni 120/2 i Kodit Penal, duke përcaktuar Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar si gjykata kompetente për shqyrtimin e çështjes.

2. Ky vendim për njësimin e praktikës gjyqësore publikohet në Fletoren Zyrtare të radhës.

Tiranë, më 27.7.2021.

Anëtarë: Ilir Panda (kryesues), Albana Boksi, Sandër Simoni.

Anëtarë kundër: Klodian Kurushi, Sokol Binaj

MENDIM I PAKICËS

1. Ne gjyqtarët, Klodian Kurushi dhe Sokol Binaj, jemi kundër vendimit njehsues të dhënë nga Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në çështjen penale regjistruar në Gjykatën e Lartë me nr. 23-2021-vendimi, datë 27.7.2021, që i referohet rastit të zgjidhjes së mosmarrëveshjes për kompetencë midis Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar për gjykimin e veprës penale të “Shpifjes”, parashikuar nga neni 120/2, i Kodit Penal, ndaj të akuzuarit Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë.

2. Shtetasi Lulzim Basha, me cilësinë procedurale penale të viktimës akuzuese, i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me dy kërkesa penale, duke kërkuar gjykimin e të akuzuarit Erion Veliaj, për veprën penale “Shpifja” kryer botërisht, parashikuar nga neni 120, paragrafi i dytë, i Kodit Penal, konkretisht me kërkesën penale nr. 115/11 akti, datë 5.10.2020 dhe kërkesën penale nr. 117 akti, datë 6.10.2020. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin datë 26.10.2020, ka vendosur bashkimin e këtyre dy kërkesave penale, në bazë të neneve 79 dhe 92, të Kodit të Procedurës Penale, dhe gjykimin e tyre në një të vetme.

3. Nga aktet rezulton se viktima akuzuese, Lulzim Basha, është Kryetar i Partisë Demokratike të Shqipërisë, ndërsa i akuzuari, Erion Veliaj, është Kryetar i Bashkisë Tiranë. Viktima akuzuese ka pretenduar se i akuzuari, në datën 24.9.2020, ka qenë i ftuar në emisionin “Opinion” në televizionin kombëtar “Klan”, dhe aty ka shpifur për viktimën akuzuese duke pretenduar edhe se ka prova për to. Gjithashtu, në datën 2.10.2020, ka qenë duke drejtuar fushatën elektorale në Tiranë dhe ka vijuar të thellojë shpifjen në drejtëm të viktimës akuzuese. Viktima akuzuese ka pretenduar se i akuzuari ka konsumuar veprën penale “Shpifja”, duke deklaruar një sërë thëniesh të pavërteta, prandaj i është drejtuar gjykatës me kërkesën objekt gjykimi.

4. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për këtë çështje të regjistruar pranë saj, shpalli moskompetencën lëndore dhe i dërgoi aktet Gjykatës së Shkallës së Parë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar Tiranë. Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë, pasi mori në shqyrtim aktet e sjella, ngriti përpara Gjykatës së Lartë



çështjen e mosmarrëveshjes së kompetencës lëndore që kishte lindur midis dy gjykatave të shkallëve të para.

5. Në përfundim, Gjykata e Lartë, në zgjidhjen e mosmarrëveshjes për kompetencë lëndore, vendosi që Gjykata e Posaçme, në bazë të nenit 75/a, germa “c”, të KPP-së, është gjykatë kompetente për gjykimin e kërkesave të paraqitura drejtpërdrejtë në gjykatë nga viktimat akuzuese, në bazë të nenit 59, të KPP-së, ku si palë e akuzuar është një prej funksionarëve të parashikuar nga neni 75/a, germa “c”, i KPP-së.

6. Një ndër çështjet e shtruara për njehsim i referohej interpretimit të termit “akuzë penale”, i parashikuar si i tillë në nenin 75/a, germa “c”, të KPP-së. Në vendimin njehsues, Kolegji arriti në përfundimin se pavarësisht rrezikshmërisë më të ulët shoqërore që kanë veprat penale të parashikuara nga neni 59, i Kodit të Procedurës Penal, këto vepra penale do të gjykohen nga Gjykata e Posaçme, pikërisht për shkak të faktit se janë akuza penale që ngrihen ndaj subjekteve të posaçme, me funksione të larta shtetërore, të lidhura drejtpërdrejt me interesin publik¹³³.

7. Pakica nuk ndan të njëjtin mendim në lidhje me përfundimin e mësipërm. Formulimi i parashikuar në nenin 75/a, germa “c”, të KPP-së, i referohet si burim ligjor nenit 135, pika 2, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në këtë pikë përmbajtja e nenit 75/a, germa “c”, të KPP-së, është identike për nga formulimi me përmbajtjen e nenit 135, pika 2, të Kushtetutës, që i referohet rastit të gjykimit të akuzave penale kundër funksionarëve shtetërorë në Gjykatën e Posaçme. Kështu që interpretimi i termit “akuzë penale” duhet të mbështetet në burimet kushtetuese.

8. Në vlerësimin e pakicës termi “akuzë” dhe “akuzë penale”, parashikuar nga nenet 135, pika 2, 148, pika 1, 148/dh, pika 1, në Kushtetutë, përfshin vetëm Organin e Prokurorisë si subjekt kushtetues i ngarkuar me funksionin e ushtrimit të ndjekjes penale dhe përfaqësimit të akuzës në emër të shtetit përpara gjykatave. Në funksion të këtij qëllimi, edhe në aneksin e Kushtetutës, në nenin E, pika 2, të saj, që bën fjalë për rastin e “Vlerësimit të aftësive profesionale”, përmendet termi “Akuzë Publike”. Në asnjë dispozitë kushtetuese nuk është

parashikuar mundësia e subjekteve të tjera, të ndryshme nga Prokuroria, të ushtrojnë ndjekjen penale apo/dhe të përfaqësojnë akuzën përpara gjykatave. Në këtë kuptim, Kushtetuta i jep atributin kushtetues vetëm Prokurorisë, si subjekt i saj, për të ushtruar ndjekjen penale dhe përfaqësuar akuzën në emër të shtetit përpara gjykatave.

9. Si rrjedhim, edhe neni 75/a, germa “c”, të Kodit të Procedurës Penale, që është i njëjtë në formulim me nenin 135, pika 2, të Kushtetutës, në vlerësimin e pakicës, duhej të interpretohej në të njëjtën frymë, duke e lidhur termin e “akuzës penale” me Prokurorinë e Posaçme që është subjekti i vetëm procedural, që pasi ushtron ndjekjen penale në vijim të saj, përfaqëson akuzën përpara gjykatës së posaçme ndaj funksionarëve shtetërorë. Akuza e integruar në kërkesën për gjykim nga viktimat akuzuese ndaj të akuzuarit, sipas nenit 59, pika 1, të Kodit të Procedurës Penale, nuk është njëjtë dhe e barasvlershme me akuzën penale të parashikuar si term nga neni 135, pika 2, i Kushtetutës dhe neni 75/a, germa “c”, i Kodit të Procedurës Penale.

10. Akuza penale përbëhet nga disa komponentë të rëndësishëm kushtetues që janë ushtrimi i ndjekjes penale dhe përfaqësimi i saj nga prokuroria përpara gjykatave. Në këtë kuptim “akuza penale” përgjatë procesit penal përfaqëson sintezën e hetimeve paraprake, konkretizon ushtrimin e ndjekjes penale, si dhe lejon prokurorin ta prezantojë atë përpara gjykatës. Me fillimin e përfaqësimit të akuzës penale përpara gjykatës, prokurori nuk ka mundësi të disponojë mbi vetë akuzën e paraqitur prej tij në gjykim.

11. Këto komponentë të përmendur më lart, nuk i gjejmë tek akuza e përfaqësuar nga viktimat akuzuese sipas nenit 59, të Kodit të Procedurës Penale. Pakica mendon se në gjykimet mbi bazën e kërkesës së viktimit akuzuese nuk ka ndjekje penale dhe as hetime paraprake, siç ndodh në rastin e akuzës publike. Në rastet e parashikuara nga neni 59/1, i KPP-së, ka vetëm hetim gjyqësor, i cili shërben për të vërtetuar bazueshmërinë e kërkesës së të dëmtuarit akuzues (*shih vendimin nr. 3, datë 6.2.2008, dhe vendimin nr. 27, datë 9.5.2012, të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kuptim “akuza penale” nuk është e njëjtë me “akuzën” që përfaqëson viktimat akuzuese para gjykatës.

12. Interpretimi i termit “akuzë penale”, në rastin në gjykim, merr një rëndësi të veçantë në

¹³³ Një përfundim i tillë është pasqyruar në paragrafët 63, 64, 65 të vendimit njehsues.



aspektin e procesit të rregullt ligjor duke iu referuar elementit të “*gjykatës së krijuar me ligj*”. Sipas mendimit të pakicës, gjykata e posaçme, në bazë të nenit 75/a, germa “c”, të Kodit të Procedurës Penale gjykon funksionarët shtetërorë për akuzat penale që detyrimisht përfaqësohen nga Prokuroria e Posaçme, për të gjitha arsyet e përmendura më lart. Akuza e ngritur nga viktima akuzuese në bazë të nenit 59, të Kodit të Procedurës Penale, të cilës i mungon faza e hetimeve paraprake, si dhe ushtrimi i ndjekjes penale, nuk duhet të shqyrtohet nga gjykata e posaçme pasi ajo nuk është akuzë penale. Si rrjedhim, në gjykimin e veprave penale dhe subjekteve të parashikuara nga neni 75/a, i Kodit të Procedurës Penale, sipas pakicës gjykata e posaçme vihet në lëvizje vetëm nga Prokuroria e Posaçme. Gjykimi i akuzave të ngritura nga viktima akuzuese përpara gjykatës së posaçme nuk përshtatet me elementin e “*gjykatës së krijuar me ligj*”.

13. Sipas mendimit të pakicës, veprat penale që ndiqen me ankimin e viktimës akuzuese sipas nenit 59, të Kodit të Procedurës Penale, duhet të gjykohen nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm. Duke iu referuar rastit në gjykim, pakica mendon se gjykimi i veprës penale të “Shpifjes” parashikuar nga neni 120/2, i Kodit Penal, kërkuar nga viktima akuzuese, Lulzim Basha, Kryetar i Partisë Demokratike, ndaj të akuzuarit, Erion Veliaj, Kryetar i Bashkisë Tiranë, duhet të gjykohet nga Gjykata e Shkallës së Parë Tiranë.

Tiranë më 27.7.2021.

Anëtarë: Sokol Binaj, Klodian Kurushi.

VENDIM

Nr. 233, datë 19.11.2021

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË TARIFAVE TË OPERATORIT TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES, PËR VITIN 2022

Në mbështetje të nenit 16, nenit 19, pika “c”, germa “i”; nenit 20 dhe nenit 21, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit

publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar; të VKM-së nr. 620, datë 22.10.2021, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, gjatë gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike dhe për përballimin e parandalimit e saj”; të “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 182, datë 10.11.2017; të nenit 15, të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.11.2021, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur me nr. 144/4 prot., datë 17.11.2021, nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve, “Mbi shqyrtimin e aplikimit të tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, për vitin 2022”,

konstatoi se:

- Shoqëria OSSH sh.a., me shkresën nr. 8016 prot., datë 3.9.2021, protokolluar me tonën me nr. 925 prot., datë 7.9.2021, ka paraqitur aplikimin për tarifa të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike për vitin 2022.

- Me shkresën nr. 8016/1 prot., datë 30.9.2021, shoqëria OSSH sh.a. ka kërkuar të përditësojë përllogaritjet e saj në aplikimin e dërguar dhe ERE të shqyrtojë aplikimin e përditësuar.

- Këshilli i Ministrave, me anë të vendimit nr. 584, datë 8.10.2021, ka vendosur shpalljen e gjendjes së emergjencës së furnizimit me energji elektrike. Ky vendim, ndër të tjera, përcaktoi një sërë detyrash ndaj OSHEE Group, OST sh.a. dhe KESH sh.a., të cilat lidhen me ndryshimet e çmimeve të importit të energjisë elektrike në tregun e lirë dhe sigurimin e furnizimit të pandërprerë të energjisë elektrike për klientët fundorë.

- ERE, me anë të shkresës nr. 925/2 prot., datë 11.10.2021, kërkoi ndaj OSSH sh.a. që aplikimi të konsideronte përditësimin e të dhënave, në përputhje me kërkesat e rregullores



“Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, “Metodologjinë e llogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 182, datë 10.11.2017, si dhe VKM-në nr. 584, datë 8.10.2021, “Për shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike”.

- Shoqëria OSSH sh.a., me shkresën nr. 8016/3 prot., datë 18.10.2021, ka depozituar në ERE aplikimin e përditësuar për tarifa të OSSH sh.a., për vitin 2022.

- Në këtë aplikim konstatohet se përditësimi i të dhënave ka konsideruar rilogaritjet e komponentëve të të ardhurave të kërkuara, të pritshme për vitet 2021 dhe 2022, si vijon:

- kosto e blerjes së humbjeve;

- kapitali e punës;

- sasia e energjisë që do të lëvrohet në rrjetin e shpërndarjes;

- kthimi mbi bazën e rregulluar të aseteve.

- Në aplikimin e përditësuar, konstatohet se OSSH sh.a. ka vijuar të kryejë llogaritjet e shpenzimeve të transmetimit të energjisë elektrike, për mbulimin e humbjeve në rrjetin e shpërndarjes, bazuar në tarifën e transmetimit në fuqi.

- Totali i të ardhurave të kërkuara nga shoqëria OSSH sh.a., për vitin 2022, është në vlerën 37,108 miliardë lekë, ku sasia e energjisë elektrike, e parashikuar për t'u lëvruar në rrjetin e shpërndarjes është 5,776 gWh, duke rezultuar në një tarifë mesatare shpërndarje prej 6.42 lekë/kWh ose në një rritje prej 34% nga tarifa prej 4.79 lekë/kWh në fuqi, e miratuar nga ERE. Shoqëria OSSH sh.a., gjithashtu, ka propozuar miratimin e tarifave sipas nivelit të tensionit për vitin 2022, si më poshtë vijon:

a) tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike në tension 35 kV - 2.61 lekë/kWh;

b) tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike në tension 20-6 kV - 3.99 lekë/kWh;

c) tarifa e shpërndarjes së energjisë elektrike në tension 0.4 kV - 6.63 lekë/kWh.

- ERE do të konsiderojë, në përlllogaritjen e të ardhurave të kërkuara, pritshmërinë mbi shlyerjen e detyrimeve të ndërsjella të OSSH sh.a., mbështetur në marrëveshjet përkatëse midis shoqërive.

- Shoqëria OSSH sh.a. duhet të dërgojë në ERE çdo të dhënë, argument apo dokumentacion mbështetës, të nevojshëm, që do të kërkohej gjatë këtij procesi, gjithashtu, dhe duhet të plotësojë të gjitha kërkesat dhe detyrat që mund të lindin gjatë zhvillimit të seancave teknike dhe seancave publike me palët e përfshira dhe që impaktohen nga efektet e tarifës mesatare të transmetimit të energjisë elektrike.

- Analiza e kostove të realizuara por dhe të parashikuara, si dhe e treguesve teknik, ekonomik dhe financiar të OSSH sh.a., do të shërbejë për të vlerësuar nëse shoqëria është në rrethanat të cilat kërkojnë rivlerësimin e nivelit të tarifës mesatare të transmetimit e si rrjedhojë komponentët e të ardhurave, në zbatim të përcaktimeve të “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes”, si dhe në mbështetje të përcaktimeve të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave, për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë OSSH sh.a., për përcaktimin e tarifave të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes, për vitin 2022.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM**Nr. 234, datë 19.11.2021****MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR
SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË
SHOQËRISË OST SHA, PËR TARIFËN E
TRANSMETIMIT TË ENERGJISË
ELEKTRIKE, PËR VITIN 2022 DHE
PERIUDHËN 2022–2024**

Në mbështetje të nenit 19, germa “c”, pika “i” dhe nenit 55, pika 1, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM-së) nr. 244, datë 30.3.2016, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, që do të zbatohen ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, të cilët ushtrojnë aktivitetin e prodhimit, transmetimit, shpërndarjes dhe furnizimit me energji elektrike”, të ndryshuar; të VKM-së nr. 620, datë 22.10.2021, “Për miratimin e kushteve për vendosjen e detyrimit të shërbimit publik, ndaj të licencuarve në sektorin e energjisë elektrike, gjatë gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike dhe për përballimin e parandalimin e saj”; “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 180, datë 8.11.2017; dhe të neneve 15, 19, pika 1, germa “c”, nenit 21, pika 3, dhe nenit 22, pika 1 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 19.11.2021, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 144/5 prot., datë 17.11.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve “Mbi shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë OST sh.a., për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike, për vitin 2022 dhe periudhën 2022–2024”,

konstatoi se:

- Shoqëria Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST sh.a.), me shkresën nr. 5215 prot., datë 31.8.2021, protokolluar me tonën nr. 914 prot., datë 2.9.2021, ka paraqitur në ERE kërkesën për aplikim për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike, për vitin 2022, si dhe për periudhën 2022–2024.

- OST sh.a., me anë të shkresës nr. 5215/1 prot., datë 5.10.2021, protokolluar në ERE me nr.

914/1 prot., datë 6.10.2021, përditësoi koston e blerjes së energjisë për mbulimin e humbjeve të rrjetit të transmetimit, për efekt të situatës aktuale në tregun rajonal të energjisë elektrike.

- VKM-ja nr. 584, datë 8.10.2021, miratoi shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike, në vijim të faktorëve të cilësuar dhe nga OST sh.a. në kërkesën e saj, por dhe nga faktorë të ndryshëm në të cilat ndodhen tregjet ndërkombëtare të energjisë, ku efekti në rritje i çmimeve të blerjes së energjisë ka impaktuar kostot për mbulimin e kërkesës për furnizim, por dhe të mbulimit të humbjeve të rrjeteve të operatorëve.

- ERE, me shkresën nr. 914/2, datë 11.10.2021, kërkoi nga OST sh.a. që aplikimi të konsideronte përditësimin e të dhënave, në përputhje me kërkesat e rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; “Metodologjinë e llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 180, datë 8.11.2017, si dhe parashikimet e VKM-së nr. 584, datë 8.10.2021, lidhur me shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike.

- OST sh.a., me anë të shkresës nr. 5215/3 prot., datë 4.11.2021, protokolluar me tonën nr. 914/3 prot., datë 5.11.2021, është përgjigjur duke përcjellë një sërë të dhënash dhe dokumentesh të cilat kanë shërbyer për rillogaritjen e tarifës mesatare të transmetimit, për vitin 2022 dhe periudhën rregullatore 2022–2024.

- Totali i të ardhurave të kërkuara nga shoqëria OST sh.a., për vitin 2022, është në vlerën 11,876 milionë lekë, ku sasia e energjisë elektrike e parashikuar për t’u lëvruar në rrjetin e transmetimit është 7,720 gWh, duke rezultuar në një tarifë mesatare të transmetimit të energjisë elektrike prej 1.54 lekë/kWh, për vitin 2022 dhe për periudhën rregullatore 3-vjeçare 2022–2024, një tarifë mesatare transmetimi prej 1.47 lekë/ kWh ose një rritje prej 96% nga tarifa prej 0.75 lekë/kWh në fuqi, e miratuar nga ERE.

- ERE do të konsiderojë në përllogaritjen e të ardhurave të kërkuara, pritshmërinë mbi shlyerjen e detyrimeve të ndërsjella të shoqërisë, mbështetur në marrëveshjet përkatëse midis shoqërive.

- OST sh.a. duhet të dërgojë në ERE çdo të dhënë, argument apo dokumentacion mbështetës, të nevojshëm që do të kërkohet gjatë



këtij procesi, gjithashtu duhet të plotësojë të gjitha kërkesat dhe detyrat që mund të lindin gjatë zhvillimit të seancave teknike dhe seancave publike me palët e përfshira dhe që impaktohen nga efektet e tarifës mesatare të transmetimit të energjisë elektrike.

- Analiza e kostove të realizuara por dhe të parashikuara, si dhe e treguesve teknik, ekonomik dhe financiar të operatorit të transmetimit, do të shërbejë për të vlerësuar nëse shoqëria është në rrethanat të cilat kërkojnë rivlerësimin e nivelit të tarifës mesatare të transmetimit e si rrjedhojë komponentët e të ardhurave të kërkuara/lejuara, në zbatim të përcaktimeve të “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave të transmetimit të energjisë elektrike”, si dhe në mbështetje të përcaktimeve të rregullores “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurës për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë OST sh.a. për tarifën e transmetimit të energjisë elektrike, për vitin 2022 dhe periudhën 2022–2024.

2. Drejtoria e Tarifave dhe Çmimeve të njoftojë aplikuesin dhe palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 560 lekë